



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02
Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 dhjetor 2023

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Salih Mustafës:

Julius von Bone

Mbrojtëses së Viktimave:

Ani Pues

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	1
A.	Procesi i gjykimit	1
B.	Procedura e apelit	3
II.	Standardi i shqyrtimit	5
III.	Aspekte të përgjithshme	9
A.	Kriteret formale në lidhje me apelet dhe hedhja poshtë e menjëhershme e tyre	9
B.	Arsye të kufizuara për ndërhyrje të apelit	13
1.	Mendimi i arsyetuar i Trupit Gjykes	13
2.	Kompetenca diskrecionale e Trupit Gjykes	14
3.	Prezumimi i paanshmërisë së Trupit Gjykes	16
C.	Siguria juridike	17
IV.	Pranueshmëria e parashtrimeve të Mbrojtëses së Viktimave	17
V.	Diskutim	20
A.	Pretendimet për gabime në lidhje me cilësimin e konfliktit si jondërkombëtar prej Trupit Gjykes (nënpika 1A)	20
1.	Parashtrimet e palëve	21
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	24
B.	Pretendimet për gabime në lidhje me mbështetjen e Trupit Gjykes në deklaratën si i dyshuar të Mustafës (nënpika 1B)	30
1.	Parashtrimet e palëve	30
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	32
C.	Pretendimet për gabime në lidhje me pranimin si provë dhe mbështetjen e Trupit Gjykes në identifikimin fotografik të Mustafës në sallën e gjyqit (nënpika 1C)	36
1.	Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve	36
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	38
D.	Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin dhe mbështetjen e Trupit Gjykes në Listën e të Burgosurve (nënpika 1D)	40
1.	Parashtrimet e palëve	40
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	42
E.	Pretendimet për gabime në lidhje me pranimin si prova dhe mbështetjen e Trupit Gjykes në deklaratat me shkrim të W04648-ës dhe W04712-shit dhe në “deklaratën gojore” të [REDAKTUAR] (nënpika 1E)	46
1.	Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve	47

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	49
F. Pretendimet për gabime në lidhje me marrjen në pyetje të W03594-ës dhe vlerësimin prej Trupit Gjykses të dëshmisë së tij (nënpika 1F)	56
1. Parashtrimet e palëve	56
2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	58
G. Pretendimet për gabime në lidhje me garancitë e dhëna W04600-s në bazë të rregullës 151(3) të Rregullores (nënpika 1G).....	60
1. Parashtrimet e palëve	60
2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	61
H. Pretendimet për gabime në lidhje me mbështetjen e Trupit Gjykses në dëshminë e [REDAKTUAR] (nënpikat 1H, 1I)	62
1. Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve	63
2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	65
I. Pretendimet për gabime në lidhje me shqyrtimin e motivit financiar nga Trupi Gjykses në vlerësimin e dëshmisë së [REDAKTUAR] (nënpika 1K).....	67
1. Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve	68
2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	69
J. Pretendimet për gabime në lidhje me pranimin e aktekspertizave mjekësore si prova prej Trupit Gjykses (nënpika 1N)	72
1. Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve	72
2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	74
K. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për vendin e kryerjes së krimeve të pretenduara (nënpikat 2A pjesërisht, 2B, 2C, 2D, 2E pjesërisht, 2F, 2H pjesërisht)	75
1. Pretendimet për gabime në lidhje me “etiketimin” e parakohshëm nga Trupi Gjykses të kompleksit në Zllash si kompleks ndalimi (nënpika 2A pjesërisht).....	76
2. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për vendosjen e BIA-s në kompleks (nënpika 2C).....	78
3. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses për “kontrollin” e BIA-s mbi kompleksin e ndalimit në Zllash (nënpika 2B)	81
4. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses për “ndryshimin” e qëndrimit të ZPS-së sa i përket vendit të krimeve (nënpika 2D)	84
5. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi aftësinë e dëshmitarëve të ZPS-së që të identifikonin kompleksin e ndalimit në Zllash (nënpikat 2E pjesërisht, 2H pjesërisht)	89
6. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykses të dëshmisë së W04600-s sa i takon identifikimit të kompleksit të ndalimit në Zllash (nënpika 2F)	97

L.	Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e dëshmitarëve nga Trupi Gjykses (nënpikat 1J, 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2G, 2H pjesërisht, 2I, 2J, 2K, 2L, 2M pjesërisht, 2N)	98
1.	Mangësitë formale që përlijin rrëzim të menjëhershëm	100
2.	Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e dëshmitarëve nga Trupi Gjykses.....	103
M.	Pretendimet për gabime në vlerësimin e Trupit Gjykses të dëshmisë së [REDAKTUAR] në lidhje me praninë e Mustafës në kompleksin e ndalimit në Zllash (Nënpika 2P)	136
1.	Parashtrimet e palëve	137
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	138
N.	Pretendimet për gabime në lidhje me shqyrtimin nga Trupi Gjykses të Pretendimit të Mustafës për alibi (nënpikat 1L, 1M, 2M pjesërisht, 2O)	142
1.	Parashtrimet e palëve	142
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	144
O.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pikat 3, 4, 5)	151
1.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme si krim lufte (Pikat 3, 4)	152
2.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të krimit të luftës të vrasjes së paligjshme (nënpikat 5A, 5B të Apelit)	184
P.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi krimin e luftës të torturës (Pikat 6, 7 të apelit).....	198
1.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të luftës të torturës (Pika 6 e Apelit)	199
2.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi fajësinë e të akuzuarit për krimin e luftës të torturës në bazë të NKP I (Pika 7 e Apelit)	206
Q.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi bazën ligjore të krimit të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 8 e Apelit)	208
1.	Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve	209
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	211
R.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi përcaktimin e dënimit (nënpikat 9A, 9B, 9C, 9D, 9E, 9F, 9G, 9H, 9I, 9J, 9K të Apelit)	214
1.	Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve	216
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	222
VI.	VENDIM	242

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 46 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 172, 176 dhe 183 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim apelin e z. Mustafa (“Mustafa” ose “i akuzuari”, i cili është apeluesi) kundër Aktgjykimit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*, KSC-BC-2020-05 (“Aktgjykimi”), të shqiptuar dhe të dorëzuar me shkrim më 16 dhjetor 2022 në përputhje me rregullën 159 të Rregullores. Paneli i Apelit lëshon këtë Aktgjykim së bashku me Shtojcën 1, ku jepen të dhëna për shkurtesat e përdorura dhe materialet e cituara në këtë Aktgjykim.

I. HYRJE

A. PROCESI I GJYKIMIT

1. Gjykimi në këtë çështje gjyqësore filloi më 15 shtator 2021 dhe përfundoi më 15 shtator 2022. Midis 20 shtatorit 2021 dhe 26 majit 2022, Trupi Gjykues mori dhe dëgjoi prova dhe dëshmi nga 30 dëshmitarë dhe dëgjoi mendimet dhe shqetësimet e një viktime pjesëmarrëse në proces.² Gjatë gjykimit, Trupi Gjykues pranoi si prova, ndër të tjera, dëshmi të dëshmitarëve të drejtpërdrejtë, deklarata me shkrim të dëshmitarëve dhe të të akuzuarit, prova dokumentare dhe aktekspertiza.³

2. Trupi Gjykues konstatoi se faktet që u bënë shkas për nisjen e kësaj çështjeje gjyqësore ndodhën në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe,⁴ afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, ose rreth kësaj date, në një kompleks në Zllash, Kosovë – më tej në tekst: kompleksi i

¹ Vendimi për Caktimin.

² Aktgjykimi, para. 9, 11, 13, 30.

³ Aktgjykimi, para. 30.

⁴ Aktgjykimi, para. 710.

ndalimit në Zllash – që ishte baza e njësitetit gueril BIA në Zllash. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se në këtë vend, të paktën gjashtë personave - mes të cilëve W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] - iu hoq liria nga anëtarë të BIA-s, që ishin nën kontrollin dhe pushtetin e komandantit të BIA-s, të akuzuarit.⁵ Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se gjatë së njëjtës periudhë kohore, i akuzuari dhe anëtarët e tjerë të BIA-s nën pushtetin e tij, i mbajtën të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash në kushte ndalimi çnjerëzore dhe poshtëruese dhe i keqtrajtuuan rregullisht, si fizikisht dhe psikologjikisht, me qëllim marrjen e informacionit ose të deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose për t'i ndëshkuar, frikësuar, detyruar dhe/ose diskriminuar për arsye politike.⁶ Së fundi, Trupi Gjykses konstatoi se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq “afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999”, si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të të akuzuarit dhe vartësve të tij të BIA-s.⁷

3. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin e shpalli të akuzuarin fajtor për kryerjen e drejtpërdrejtë të krimit të luftës të torturës (Pika 3) dhe për kryerjen, si pjesë e NKP I, të krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4).⁸ Trupi Gjykses gjykoi se akuza për krimin e luftës të trajtimit mizor “mbulohet plotësisht” nga akuza e torturës dhe, rrjedhimisht, e shpalli të akuzuarin të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor (Pika 2).⁹ Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me një dënim të njësuar prej 26 vjetësh burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim.¹⁰

⁵ Aktgjykimi, para. 495. Shih gjithashtu poshtëshënimin 703 të Aktgjykimit, ku Trupi Gjykses shpjegon se në të gjithë Aktgjykimin përdor formulimin “të paktën gjashtë persona”, ndonëse evidenton shtatë viktima, sepse i përmbahet formulimit të akuzave të paraqitura nga ZPS-ja në Aktakuzën e Konfirmuar. Shih konkretisht, Aktakuzën, para. 18; Aktgjykimin, para. 347.

⁶ Aktgjykimi, para. 584-588.

⁷ Aktgjykimi, para. 638-639, 695.

⁸ Aktgjykimi, para. 758-760, 831.

⁹ Aktgjykimi, para. 667, 831.

¹⁰ Trupi Gjykses i shqiptoi të akuzuarit këto dënime për secilën vepër penale: (i) Pika 1 (për krimin e luftës të ndalimit arbitrar, të kryer kundër së paku gjashtë personave) – dhjetë vjet burgim; (ii) Pika 3

4. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër kundër të akuzuarit, me të cilin u akordoi dëmshpërblime tetë viktimave pjesëmarrëse në proces.¹¹ Mustafa nuk e ka apeluar Urdhrin për Zhdëmtim.

B. PROCEDURA E APELIT

5. Më 9 janar 2023, me kërkesë të të akuzuarit, Paneli i Apelit miratoi zgjatjen e afatit për dorëzimin e njoftimit për apel kundër Aktgjykimit deri më 3 shkurt 2023.¹²

6. Më 2 shkurt 2023, i akuzuari dorëzoi njoftimin për apel kundër Aktgjykimit, në të cilin paraqiti nëntë pika apeli, të ndara në 51 nënpika.¹³ I akuzuari kërkoi që Paneli i Gjykatës së Apelit: (a) të prapësonte verdiktet e fajësisë për Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës dhe ose (i) ta shpallte atë të pafajshëm për të gjitha akuzat ose (ii) t'ia kthente çështjen Trupit Gjykses; ose (b) në rast se liheshin në fuqi të gjitha ose ndonjë prej verdikteve të fajësisë, të ulte dënimin e dhënë.¹⁴

7. Më 13 shkurt 2023, i akuzuari dorëzoi një mocion me të cilin kundërshtonte pjesëmarrjen e Mbrojtëses së Viktimave në konferencën para apelit dhe në fazën e mëtejshme të apelit.¹⁵ Më 15 shkurt 2023, Trupi Gjykses hodhi poshtë mocionin e të akuzuarit dhe miratoi modalitetet për pjesëmarrjen e viktimave.¹⁶

(për krimin e luftës të torturës, të kryer kundër së paku gjashtë personave) – 22 vjet burgim; dhe (iii) Pika 4 (për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme, të kryer kundër një personi) – 25 vjet burgim. Mbi bazën e këtyre dënime të dhëna për secilën vepër penale, Trupi Gjykses shqiptoi dënimin e njësuar me 26 vjet burgim, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale të të akuzuarit dhe zbriti kohën e kaluar në paraburgim që prej arrestimit të tij më 24 shtator 2020. Shih Aktgjykimin, para. 829-831.

¹¹ Urdhri për Zhdëmtim.

¹² Vendimi mbi Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, para. 11; Mocioni i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit.

¹³ Njoftimi për Apel. Paneli thekson se në Aktgjykimin aktual të Apelit, do t'u referohet atyre si "nënpika të Apelit".

¹⁴ Njoftimi për Apel, para. 2; Dosja e Apelit, para. 3, 446. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 323, 341, 367, 378, 390, 400, 438; Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 3, 5, 138.

¹⁵ Mocioni i Mbrojtjes në lidhje me Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit.

¹⁶ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit, para. 4-14, 17.

8. Më 16 shkurt 2023, Kryegjykatësja e Panelit të Apelit mbajti konferencën para apelit në emër të Panelit.¹⁷
9. Më 21 mars 2023, Paneli rrëzoi kërkesën e të akuzuarit për leje për apelimin e Vendimit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave gjatë Procedurës së Apelit.¹⁸
10. Më 3 prill 2023, Paneli miratoi kërkesën e të akuzuarit për zgjatjen e afatit për dorëzimin e Dosjes së Apelit kundër Aktgjyqimit dhe rrëzoi kërkesën e tij për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve në të.¹⁹
11. Më 24 prill 2023, i akuzuari dorëzoi Dosjen e Apelit dhe, më 2 maj 2023, versionin e korrigjuar të saj.²⁰
12. Më 5 maj 2023, Paneli i Apelit miratoi pjesërisht kërkesat e ZPS-së dhe të Mbrojtëses së Viktimave për zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjeve të përgjigjeve të tyre.²¹
13. Më 5 qershor 2023, Mbrojtësja e Viktimave dhe ZPS-ja dorëzuan dosjet e përgjigjeve të tyre.²²
14. Më 16 qershor 2023, i akuzuari dorëzoi kundërpërgjigje.²³

¹⁷ Urdhri për Caktimin e Datës së Konferencës Para Apelit, para. 7, 11; Transkripti, 16 shkurt 2023.

¹⁸ Vendimi mbi Lejen për Apelimin e Vendimit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 9, 12; Kërkesa e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave. Shih gjithashtu Përgjigjen e Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave; Përgjigjen e ZPS-së ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje për Apelimin të Vendimit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave.

¹⁹ Vendimi për Ndryshimin e Afatit dhe Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Dosjes së Apelit.

²⁰ Në këtë Aktgjykim, "Dosja e Apelit" i referohet versionit të korrigjuar të Dosjes së Apelit që u dorëzua nga i akuzuari më 2 maj 2023.

²¹ Vendimi mbi Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Dosjeve të Përgjigjeve; Kërkesa e ZPS-së për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjes së Përgjigjes; Kërkesa e Viktimave për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjes së Përgjigjes.

²² Dosja e Përgjigjes së Viktimave; Dosja e Përgjigjes së ZPS-së.

²³ Dosja e Kundërpërgjigjes. Mustafa parashtron, ndër të tjera, se Dosja e Përgjigjes së ZPS-së dhe Dosja e Përgjigjes së Viktimave duhet të hidhen poshtë në tërësi. Shih Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 4.

15. Më 26 dhe 27 tetor 2023, Paneli i Apelit dëgjoji parashtrimet gojore të palëve dhe pjesëmarrësve në lidhje me apelin.²⁴ Në vijim të pyetjeve të bëra nga Paneli gjatë seancës së apelit, palët dorëzuan parashtrime të mëtejshme me shkrim në lidhje me akuzën e vrasjes së paligjshme.²⁵

16. Në përputhje me Urdhrin për Caktimin e Datës së Seancës për Aktgjykimin e Apelit të datës 27 nëntor 2023, Paneli vendosi të shqiptonte Aktgjykimin e Apelit të enjten, më 14 dhjetor 2023.²⁶

II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

17. Neni 46 i Ligjit përcakton standardin e shqyrtimit të apeleve kundër aktgjykimeve. Sipas nenit 46 të Ligjit, Paneli i Apelit mund ta lerë në fuqi, prapësojë, ose ndryshojë Aktgjykimin, dhe mund të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, në bazë të arsyeve në vijim: (i) “ndonjë gabimi rreth ndonjë çështjeje juridike që e shfuqizon aktgjykimin”; (ii) “ndonjë gabimi faktik, i cili ka shkaktuar gabim gjyqësor”; ose (iii) “ndonjë gabimi për sa i përket dhënies së dënimit”.²⁷

18. Pala që pretendon gabim juridik duhet ta evidentojë atë, të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimit të saj dhe të shpjegojë se si gabimi e bën të pavlefshëm vendimin.²⁸ Gjithashtu, kur një palë pretendon gabim juridik mbi bazën e mungesës së një mendimi të arsyetuar, ajo duhet të evidentojë pikat konkrete, konstatimet faktike ose argumentet që pretendohet se Trupi Gjykses nuk i ka shqyrtuar dhe duhet

²⁴ Urdhri për Caktimin e Datës së Seancës së Apelit; Transkripti, 26 tetor 2023; Transkripti, 27 tetor 2023. Shih gjithashtu Urdhrin për Përgatitjen e Seancës së Apelit.

²⁵ Parashtrimet e Mëtejshme të ZPS-së mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme; Parashtrimet e Mëtejshme të Mbrojtjes mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme.

²⁶ Urdhri për Caktimin e Datës së Seancës për Aktgjykimin e Apelit, para. 3, 5.

²⁷ Neni 46(1)(a)-(c), (3) i Ligjit. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 21.

²⁸ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 22 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih gjithashtu *Ongwen Appeal Judgment*, para. 76; *Mladić Appeal Judgment*, para. 16; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgment*, para. 30; *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 29.

të shpjegojë pse kjo mungesë e bën të pavlefshëm vendimin.²⁹ Paneli i Apelit gjykon se pretendimi për gabim juridik që nuk ka asnjë gjasë të ndryshojë rezultatin e një vendimi, mund të rrëzohet për këtë arsye.³⁰ Megjithatë, edhe nëse argumentet e palës janë të pamjaftueshme për të mbështetur pretendimin për gabimin në fjalë, Paneli mund të konstatojë gabim juridik duke u bazuar në arsye të tjera.³¹ Paneli i Apelit do të shqyrtojë konstatimet juridike të Trupit Gjykses për të vendosur nëse janë të sakta.³²

19. Gjithashtu, neni 46(4) i Ligjit saktëson se:

Kur paneli i Gjykatës së Apelit përcakton se ndonjë trup gjykses ka bërë gabim juridik në ndonjë aktgjykim, që rrjedh nga zbatimi i ndonjë standardi të pasaktë ligjor, Dhoma e Gjykatës së Apelit e artikulon standardin e duhur ligjor dhe e zbaton atë standard ndaj provave të përfshira në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor për të përcaktuar nëse fajësia e apeluar duhet të konfirmohet, të pranohet apo të hidhet poshtë. Përndryshe, nëse trupi gjykses është në dispozicion dhe mund ta trajtojë çështjen në mënyrë më efikase, Paneli i Gjykatës së Apelit mund ta kthejë rastin te trupi gjykses për të rishikuar konstatimet e tij dhe provat bazuar në standardin e duhur ligjor.

20. Kur vetë Paneli i Apelit zbaton standardin e saktë juridik për provat që përfshihen në dokumentacionin gjyqësor dhe përcakton nëse është bindur për standardin e nevojshëm të vërtetimit në lidhje me konstatimin faktik që kundërshtohet,³³ ai do të marrë parasysh vetëm provat që përmenden në Aktgjykim, provat e përfshira në dokumentacionin gjyqësor të përmendura nga palët, dhe ku

²⁹ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 22 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih gjithashtu *Ongwen Appeal Judgment*, para. 88; *Mladić Appeal Judgment*, para. 16; *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 29.

³⁰ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 22 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih gjithashtu *Mladić Appeal Judgment*, para. 16; *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 29.

³¹ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 22 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih gjithashtu *Karadžić Appeal Judgment*, para. 15; *Šešelj Appeal Judgment*, para. 13; *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 29.

³² Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 22 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih gjithashtu *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 29.

³³ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 24 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih gjithashtu *Mladić Appeal Judgment*, para. 17; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgment*, para. 31.

është e zbatueshme, prova shtesë të pranuar gjatë apelit në përputhje me rregullën 181 të Rregullores.³⁴

21. Në rrethana të veçanta, Paneli i Apelit mund të shqyrtojë edhe argumente të parashtruara nga një palë në apel lidhur me gabime juridike që nuk çojnë në pavlefshmërinë e Aktgjyimit, nëse ato janë të një rëndësie të përgjithshme për jurisprudencën e Dhomave të Specializuara.³⁵

22. Paneli gjithashtu vëren se, kur një palë në apel pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, pala në fjalë duhet të demonstrojë se kjo shkelje ka shkaktuar padrejtësi në atë masë sa që përbën gabim juridik, i cili, nga ana e tij, e bën të pavlefshëm vendimin e kundërshtuar.³⁶

23. Në lidhje me gabimet faktike, në nenin 46(5) të Ligjit përcaktohet se:

Me rastin e shqyrtimit të konstatimeve faktike të trupit gjykues, Paneli i Gjykatës së Apelit vetëm i zëvendëson konstatimet e trupit gjykues me konstatimet e veta atëherë kur provat në të cilat është bazuar trupi gjykues nuk kanë mundur të pranohen nga asnjë gjykim i arsyeshëm i fakteve apo kur vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar.

24. I njëjti standard zbatohet në lidhje me pretendimet për gabime faktike, pavarësisht nëse konstatimi i kundërshtuar bazohet në prova të drejtpërdrejta apo rrethano.³⁷ Paneli i Apelit nuk i prapëson me lehtësi konstatimet faktike të Trupit

³⁴ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 24 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih gjithashtu *Mladić Appeal Judgement*, para. 17; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 17; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*, para. 31.

³⁵ Shih *Prlić et al. Appeal Judgement*, para. 18 dhe jurisprudencën e cituar aty; *Krnojelac Appeal Judgement*, para. 6-8; Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 9; *Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgement*, para. 9; *Nahimana et al. Appeal Judgement*, para. 12.

³⁶ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 44. Shih gjithashtu *Galić Appeal Judgement*, para. 21; *Hadžihasanović and Kubura Appeal Judgement*, para. 130; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 26; *Kordić and Čerkez Appeal Judgement*, para. 119.

³⁷ Aktgjykimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 26 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih *Mladić Appeal Judgement*, para. 18; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 17; *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 32.

Gjykues, sepse është në radhë të parë detyra e këtij të fundit që të dëgjojë, shqyrtojë dhe peshojë provat e paraqitura gjatë gjykimit.³⁸ Paneli i Apelit prapëson vendimin e Trupit Gjykues vetëm kur gabimi faktik ka rezultuar në gabim gjyqësor.³⁹ Në këtë aspekt, Paneli vëren se thjesht mospajtimi me përfundimet e nxjerra nga Trupi Gjykues bazuar në faktet e disponueshme, ose me peshën që ai u ka dhënë faktorëve të veçantë, nuk mjafton për të përcaktuar një gabim të qartë.⁴⁰

25. Paneli i Apelit nuk ka detyrimin t'i përmbahet cilësimit që i bën një palë një gabimi të pretenduar si juridik apo faktik.⁴¹ Nëse pala bën cilësim të gabuar të një gabimi të pretenduar, Paneli i Apelit zbaton standardin e saktë të shqyrtimit.⁴² Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vëren se nganjëherë Mustafa nuk e cilëson saktë ose nuk e artikulon qartë llojin e gabimit të pretenduar.⁴³ Në këto raste, Paneli i Apelit ka zbatuar standardin përkatës të shqyrtimit bazuar në argumentet e Mustafës.

26. Gjithashtu, kur evidenton një gabim që është edhe juridik, edhe faktik, Paneli i Apelit trajton së pari dispozitat ligjore përkatëse dhe më pas përcakton nëse përfundimi faktik që arriti Trupi Gjykues ishte përfundim në të cilin nuk do të arrinte asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh.⁴⁴

³⁸ Aktgjykimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 26 dhe jurisprudenca e cituar aty. Shih *Ongwen Appeal Judgment*, para. 78, 80, 82; *Mladić Appeal Judgment*, para. 18; *Karadžić Appeal Judgment*, para. 17; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgment*, para. 32; *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 31.

³⁹ Aktgjykimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 26. Shih gjithashtu *Mladić Appeal Judgment*, para. 18; *Karadžić Appeal Judgment*, para. 17; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgment*, para. 32; *Lubanga Appeal Judgment*, para. 25; *Merhi and Oneissi Appeal Judgment*, para. 31.

⁴⁰ Vendimi i Apelit lidhur me Arrestimin dhe Mbajtjen në Paraburgim të Gucatit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 64.

⁴¹ Shih *Dragomir Milošević Appeal Judgment*, para. 18; *Strugar Appeal Judgment*, para. 252, 269; *Blagojević and Jokić Appeal Judgment*, para. 144-145.

⁴² Shih *Dragomir Milošević Appeal Judgment*, para. 18; *Strugar Appeal Judgment*, para. 252, 269; *Blagojević and Jokić Appeal Judgment*, para. 144-145.

⁴³ Shih p.sh. nënpikat 1L, 1M, 5B.

⁴⁴ Shih *Strugar Appeal Judgment*, para. 269.

III. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

27. Paneli vëren se në Aktgjykim, Trupi Gjykses u bazua në nenin 31(5) të Kushtetutës së Kosovës, nenet 3(2), 14(1)(c) dhe (2), 16(1)(a), 21, 23(1), 34, 40(5), 43, dhe 44(1), (2) dhe (5) të Ligjit dhe rregullat 23(1), 24(1) deri (3), 138, 139, 140, 158, 159(1) deri në (4) dhe (6) dhe 163(1), (3), (4) dhe (6) të Rregullores.⁴⁵

28. Paneli rikujton se Ligji përcakton qartë se gjatë shqyrtimit të Apelit, gjykatësit mund të ndihmohen nga burime të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë burime dytësore, siç janë jurisprudenca nga gjykatat ndërkombëtare *ad hoc*, GJPN-ja dhe gjykata të tjera penale.⁴⁶ Këto burime dytësore mund të orientojnë gjykatësit në rastet kur burimet parësore nuk ofrojnë orientim mbi një aspekt konkret.⁴⁷

A. KRITERET FORMALE NË LIDHJE ME APELET DHE HEDHJA POSHTË E MENJËHERSHME E
TYRE

29. Paneli i Apelit vë në dukje se vlerësimi i argumenteve të palëve prej tij varet nga paraqitja e argumenteve në mënyrë të qartë, të logjikshme dhe shteruese prej palëve.⁴⁸ Nga pala apeluese kërkohet që t'u referohet saktësisht paragrafëve përkatës në aktgjykimin e apeluar, ose faqeve të transkriptit në lidhje me të cilat është ngritur kundërshtim dhe jurisprudencës që citohet në mbështetje të tij.⁴⁹ Nuk mund të pritët që Paneli i Apelit të shqyrtojë parashtrimet e një pale nëse ato janë të paqarta, kundërthënëse, të vagullta, të pabaza ose kanë mangësi të tjera formale dhe të

⁴⁵ Aktgjykimi, para. 21.

⁴⁶ Neni 3(3) i Ligjit.

⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 28; Vendimi i Apelit lidhur me Arrestimin dhe Mbajtjen në Paraburgim të Gucatit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 11.

⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 29 dhe jurisprudenca e cituar aty.

⁴⁹ Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet e Protokolluara, nenet 32(2), 47(1)(b)(2)-(3), 48(1)(b)(1)-(2). Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 29; *Ongwen Appeal Judgment*, para. 88; *Mladić Appeal Judgment*, para. 21; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgment*, para. 35. Dosja e Apelit përfshin edhe një shtojcë që përmban listën e burimeve ligjore që përmenden në Dosjen e Apelit. Shih Udhëzuesin e Punës për Parashtrimet e Protokolluara, neni 48(1)(e).

dukshme.⁵⁰ Në lidhje me këtë, Paneli vëren se, në disa pika të Apelit, Mustafa nuk i mbështet argumentet e tij me jurisprudencën përkatëse, nuk evidenton konstatimet konkrete të Trupit Gjykses që kundërshton, ose nuk citon paragrafët përkatës të Aktgjykimit dhe, nganjëherë madje as nuk formulon fjali të plota.⁵¹ Ndonëse, në parim mangësi të tilla përlligjin rrëzimin e menjëhershëm të pikës së apelit, në raste të veçanta Paneli i Apelit mund të vendosë të shqyrtojë parashtrime që janë të vagullta ose të pafaktuara, kur gjithsesi arrin të kuptojë se cilat konstatime ose prova konkrete po kundërshton Mustafa dhe e gjykon të nevojshme t'i shqyrtojë ato për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.

30. Apeli nuk është gjykim *de novo*.⁵² Një palë nuk mundet thjesht të përsërisë argumentet që ishin të pasuksesshme gjatë gjykimit, përveç nëse arrin të tregojë se rrëzimi nga Trupi Gjykses i këtyre argumenteve përbën gabim që përlligj ndërhyrjen e Panelit të Apelit.⁵³ Gjithashtu, një palë nuk duhet të heshtë për një aspekt që ishte i dukshëm gjatë gjykimit dhe në vijim ta ngrëjë atë për herë të parë në apel.⁵⁴ Rëndësia e paraqitjes në kohë të kundërshtimit qëndron në faktin që Trupit Gjykses duhet t'i jepet mundësia të korrigjojë mangësitë e pretenduara. Paneli i Apelit gjykon se, në mungesë të rrethanave të veçanta, nëse pala nuk e paraqet në kohë pretendimin e vet për një aspekt të caktuar gjatë gjykimit, kur logjikisht mund ta kishte bërë këtë, ajo

⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 29; *Mladić Appeal Judgement*, para. 21; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*, para. 35.

⁵¹ Shih p.sh. nënpikat 1B, 1J, 1K, 2G, 2I, 2J, 2K, 2L dhe 2M. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 19, ku theksohet se “parashtrimet e pashtjelluara dhe të pabaza të Mustafës, me të cilat pretendon mangësi të përgjithshme në të gjithë Aktgjykimin dhe kërkon rishikim të konstatimeve të paspecifikuara, janë krejt të pamjaftueshme për përmbushjen e detyrimit të tij si apelues”.

⁵² Neni 46(2) i Ligjit; Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 21; Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 223; *Tadić Appeal Judgement*, para. 55.

⁵³ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 29. Shih gjithashtu *Mladić Appeal Judgement*, para. 20; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*, para. 34.

⁵⁴ *Karadžić Appeal Judgement*, para. 25, 312; Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 112; *Tolimir Appeal Judgement*, para. 183; Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 125, 223; *Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment*, para. 91; *Niyitegeka Appeal Judgment*, para. 199.

palë efektivisht ka hequr dorë nga e drejta për ta ngritur atë aspekt në apel.⁵⁵ Po kështu, në bazë të rregullës 138(1) të Rregullores, kundërshtimi ndaj pranueshmërisë së provave duhet të paraqitet sapo të bëhen të qarta arsyet në të cilat bazohet.⁵⁶ Në lidhje me këtë, Paneli vëren se në disa pika të Apelit, Mustafa kundërshton pranueshmërinë e provave që nuk i ka kundërshtuar gjatë gjykimit.⁵⁷ Në parim, kur një palë nuk i paraqet zyrtarisht dhe në kohë kundërshtimet për pranueshmërinë e provave gjatë gjykimit, kjo përlligj rrëzimin e menjëhershëm të kundërshtimit të ngritur për herë të parë në apel. Vetëm në raste të veçanta, Paneli i Apelit mund të vendosë t'i shqyrtojë këto parashtrime kur është e nevojshme për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.

31. Paneli i Apelit gjithashtu mund të refuzojë shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në dosjen e apelit ose në dosjen e kundërpërgjigjes të papërfshira në njoftimin për apel,⁵⁸ përveç nëse është dorëzuar në kohë kërkesë për ndryshimin e tyre, e cila është miratuar nga Paneli i Apelit në përputhje me rregullën 176(3) të Rregullores. Paneli i Apelit gjithashtu mund të refuzojë të shqyrtojë argumente që paraqiten për herë të parë gjatë seancës së apelit. Gjithashtu, pikat dhe argumentet e apelit paraqiten dhe numërtohen në të njëjtën renditje si në njoftimin për apel të apellesit, përveçse

⁵⁵ *Karadžić Appeal Judgement*, para. 25, 312; *Prlić et al. Appeal Judgement*, para. 165; *Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgement*, para. 185; *Tolimir Appeal Judgement*, para. 170; Aktgjykimi i Apelit *Shainović dhe të tjerët*, para. 223; *Kunarac et al. Appeal Judgement*, para. 61; *Niyitegeka Appeal Judgement*, para. 199. Shih gjithashtu *Ongwen Sentencing Appeal Judgment*, para. 108.

⁵⁶ Rregulla 138(1) e Rregullores kërkon specifikisht që palët të ngrenë pretendim në kohën e paraqitjes së provës dhe u lejon palëve që pretendimin ta ngrenë më vonë “menjëherë pasi bëhet i njohur” vetëm në “rrethana të posaçme, në qoftë se trupi gjykues bindet se aspekti nuk ishte i njohur në kohën e paraqitjes së provës”.

⁵⁷ Shih p.sh. nënpikat 1B, 1C, 1D, 1E pjesërisht, 1F, 1G, 1N dhe 2E. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 8-10, ku theksohet se shumë prej kundërshtimeve të Mustafës lidhen me pranueshmërinë e provave të cilat nuk u kundërshtuan në gjykim dhe se, duke qenë se nuk ka evidentuar rrethana të veçanta për të arsyetuar mosngritjen e pretendimit në kohën e pranimin të provës, “ai e ka humbur të drejtën për t'i ngritur këto pretendime në apel”.

⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 30, që i referohet *Marijačić and Rebić Appeal Judgement*, para. 18. Shih gjithashtu *Ntakirutimana and Ntakirutimana Appeal Judgement*, para. 370, 524; *Vasiljević Appeal Judgement*, para. 15; *Galić Appeal Judgement*, para. 78; *Orić Appeal Judgement*, para. 65.

kur ndryshohen me lejen e Panelit të Apelit.⁵⁹ Në parim, nëse nuk veprohet kështu, për ligjet rrëzimi i menjëhershëm i tyre. Sidoqoftë, në raste të veçanta, Paneli i Apelit mund të vendosë t'i shqyrtojë këto parashtrime kur e gjykon të nevojshme për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.

32. Paneli gjithashtu mund të refuzojë të shqyrtojë pikat e ngritura në njoftimin për apel të cilat nuk shtjellohen më pas në Dosjen e Apelit.⁶⁰ Përgjithësisht, argumentet e paraqitura në njoftimin për apel duhet të shtjellohen në Dosjen e Apelit, përndryshe konsiderohen "se është hequr dorë prej tyre".⁶¹ Sidoqoftë, Paneli i Apelit mund të vendosë t'i shqyrtojë këto argumente për hir të drejtësisë.⁶²

33. Gjithashtu, Paneli mund të rrëzojë menjëherë argumentet që nuk kanë gjasë të shkaktojnë prapësimin ose ndryshimin e vendimit të apeluar dhe që nuk ka nevojë të shqyrtohen në lidhje me themelësinë.⁶³ Paneli i Apelit gëzon kompetencë diskrecionale në përzgjedhjen e parashtrimeve që meritojnë arsyetim të hollësishëm me shkrim, dhe mund të hedhë poshtë argumente qartazi të pabaza pa dhënë arsyetim të hollësishëm.⁶⁴ Konkretisht, Paneli i Apelit vë në dukje se mund të rrëzohen menjëherë argumentet si në vijim:

- (i) argumente që nuk evidentojnë konstatimet faktike të apeluara, që shtrembërojnë konstatimet faktike ose provat, ose që shpërfillin konstatime faktike përkatëse të tjera;

⁵⁹ Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet e Protokolluara, neni 48(2). Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 30, që i referohet *Boskoški and Tarčulovski* Decision on Notice of Appeal, para. 19.

⁶⁰ Shih *Brima et al.* Appeal Judgment, poshtëshënimi 69; *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgment, poshtëshënimi 441; *Rutaganda* Appeal Judgment, poshtëshënimi 1081; *Kayishema and Ruzindana* Appeal Judgment, para. 46.

⁶¹ *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgment, poshtëshënimi 441.

⁶² *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgment, poshtëshënimi 441.

⁶³ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 31. Shih gjithashtu *Mladić* Appeal Judgment, para. 20; *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgment, para. 34; *Merhi and Oneissi* Appeal Judgment, para. 33; *Ongwen* Appeal Judgment, para. 89.

⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 31. Shih gjithashtu *Mladić* Appeal Judgment, para. 21; *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgment, para. 35; *Merhi and Oneissi* Appeal Judgment, para. 33.

- (ii) deklarata që thjesht pretendojnë se dhoma gjyqësore me siguri nuk mori parasysh prova përkatëse, pa demonstruar se bazuar në prova asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në të njëjtin përfundim me dhomën gjyqësore;
- (iii) kundërshtime ndaj konstatimeve faktike që nuk janë bazë e një verdikti fajësie, dhe argumente që nuk kanë aspak lidhje, që mbështetin ose që nuk janë mospërputhëse me përfundimin e apeluar;
- (iv) argumente kundër mbështetjes ose mosmbështetjes prej dhomës gjyqësore në një provë konkrete, pa ofruar shpjegim se pse verdikti i fajësisë nuk duhet të qëndrojë bazuar në provat e tjera;
- (v) argumente kundër gjykimit të shëndoshë;
- (vi) kundërshtime ndaj konstatimeve faktike, ku relevanca e konstatimit faktik është e paqartë dhe nuk është shpjeguar nga pala apeluere;
- (vii) përsëritjet e argumenteve që rezultuan të pasuksesshëm në gjykim, pa ofruar shpjegim se rrëzimi i tyre nga dhoma gjyqësore përbënte gabim i cili përligj ndërhyrjen e Panelit [të Apelit];
- (viii) akuza mbështetur në material që nuk është dokumentacionin gjyqësor;
- (ix) pretendime të pabazuara në ndonjë provë, pretendime të pashtjelluara, mospërshkrimi i gabimeve; dhe
- (x) pretendimet se dhoma gjyqësore nuk u dha peshën e duhur, ose nuk interpretoi provat në një mënyrë të caktuar.⁶⁵

B. ARSYE TË KUFIZUARA PËR NDËRHYRJE TË APELIT

1. Mendimi i arsyetuar i Trupit Gjykses

34. Paneli i Apelit vë në dukje se, për të përmbushur detyrimin për dhënien e mendimit të arsyetuar, Trupi Gjykses duhet të japë arsyet që mbështesin konstatimet e veta mbi aspektet materiale relevante për vendimin. Sidoqoftë, nuk është e

⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 32. Shih gjithashtu *Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgement*, para. 18; Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 29; Vendimin e Apelit lidhur me Vendimin mbi Mocionet Paraprake në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 15; Vendimin e Apelit mbi Lirimin e Përkohshëm në Çështjen *Shala*, para. 8; Vendimin e Apelit në lidhje me Vendimin e Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 8, 17, 24; Vendimin e Apelit në lidhje me Vendimin e Pestë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 29.

nevojshme që Trupi Gjykses të sqarojë çdo hap të arsytimit të vet e as të trajtojë të gjitha argumentet e ngritura nga palët ose çdo provë që ka lidhje me një konstatim konkret, në qoftë se ka paraqitur bazën e vendimit të vet me qartësi të mjaftueshme.⁶⁶ Merret si e mirëqenë se Trupi Gjykses i ka vlerësuar të gjitha provat e administruara, në qoftë se nuk ka ndonjë tregues se Trupi Gjykses ka shpërfillur krejtësisht prova konkrete.⁶⁷ Rrjedhimisht, në rast se Trupi Gjykses nuk përmend një provë konkrete në konstatimet e veta, merret si e mirëqenë se ai e ka vlerësuar dhe peshuar atë provë, por ka nxjerrë përfundimin se ajo nuk e pengonte të arrinte në këto konstatime. Ky supozim mund të hidhet poshtë në rastet kur në arsytimin e vet Trupi Gjykses nuk ka trajtuar prova që kanë qartësisht lidhje me konstatimet.⁶⁸

35. Gjithashtu, e drejta e të akuzuarit për mendim të arsytuar nuk kërkon kryerjen e analizës së hollësishme të besueshmërisë së dëshmitarëve, në qoftë se Trupi Gjykses jep arsytet për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit pavarësisht nga mospërputhje të pretenduara ose materiale.⁶⁹

2. Kompetenca diskrecionale e Trupit Gjykses

36. Paneli i Apelit rikujton se, nëse vendimi që kundërshtohet është diskrecional, pala duhet të provojë se paneli i shkallës më të ulët ka kryer një gabim të dukshëm, në kuptimin që vendimi: (i) është bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi; (ii) është bazuar në një përfundim faktik qartësisht të pasaktë; ose (iii) është kaq i padrejtë

⁶⁶ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 33, që i referohet *Bemba et al.* Appeal Judgment, para. 105; Vendimi i Apelit lidhur me Lirimën e Përkohshëm të Veselit, para. 72; Vendimi i Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 154.

⁶⁷ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 33, që i referohet *Bemba et al.* Appeal Judgment, para. 105. Shih gjithashtu *Halilović* Appeal Judgment, para. 121; *Kvočka et al.* Appeal Judgment, para. 23.

⁶⁸ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 33, që i referohet *Bemba et al.* Appeal Judgment, para. 105. Shih gjithashtu *Halilović* Appeal Judgment, para. 188; *Kvočka et al.* Appeal Judgment, para. 23.

⁶⁹ Shih *Popović et al.* Appeal Judgment, para. 133. Shih gjithashtu *Kajelijeli* Appeal Judgment, para. 60-61.

apo i paarsyeshëm saqë përbën shpërdorim të diskrecionit nga paneli i shkallës më të ulët.⁷⁰

37. Paneli rikujton se vendimi për pranimin apo mospranimin e provave në përrputhje me rregullën 138(1) të Rregullores, është vendim që përfshihet në kompetencën diskreionale të Trupit Gjykses gjatë vlerësimit të relevancës për çështjen, të autenticitetit dhe vlerës provuese të provave të paraqitura.⁷¹ Trupi Gjykses mund të refuzojë pranimin e provave nëse relevanca e tyre për çështjen nuk është provuar në mënyrë të arsyeshme.⁷² Për marrjen e vendimit mbi pranueshmërinë e provave, relevanca vlerësohet në bazë të faktit nëse provat e propozuara kanë të bëjnë me elementet e veprës (veprave) penale ose me formën (format) e përgjegjësisë penale të paraqitura në aktakuzë, ose me fakte dhe rrethana të tjera juridikisht thelbësore për provat dhe argumentet e palëve.⁷³ Gjithashtu, ndërhyrja e apelit për vendimet në lidhje me pranimin e provave përligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.⁷⁴

38. Paneli rikujton gjithashtu se Trupi Gjykses ka për detyrë që të vlerësojë besueshmërinë e një dëshmitari, si dhe mbështetshmërinë në provat e paraqitura nga palët,⁷⁵ dhe ka diskrecion të gjerë për të vlerësuar peshën e saktë që i duhet dhënë

⁷⁰ Vendimi i Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme në Çështjen *Shala*, para. 8; Vendimi i Apelit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 14 dhe jurisprudenca e cituar aty. Në lidhje me diskrecionin e Trupit Gjykses për përcaktimin e dënimit, shih më poshtë paragrafin 453.

⁷¹ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 35; Vendimi i Apelit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 14.

⁷² Aktgjykimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 35; Vendimi i Apelit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 20. Shih gjithashtu *Prlić et al.* Appeal Decision on Admission of Evidence, para. 17; *Bagosora et al.* Decision on Admission of Binder, para. 7; Rregullat 137(1) dhe 138(1) të Rregullores.

⁷³ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 35; Vendimi i Apelit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 20. Shih gjithashtu p.sh. *Prlić et al.* Appeal Decision on Admission of Evidence, para. 17; *Ruto et al.* Confirmation Decision, para. 66; *Katanga and Ngudjolo Bar Table Decision*, para. 16.

⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 35; Vendimi i Apelit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 14, që i referohet *Simba Appeal Judgement*, para. 19; *Bagosora et al.* Appeal Decision on Exclusion of Evidence, para. 11.

⁷⁵ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 36, që i referohet *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 131, 1228. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Shainović dhe të tjerët*, para. 437, 464, 1296; *Lukić and Lukić Appeal Judgement*, para. 296; Aktgjykimin e Apelit *Gjorgjeviq*, para. 395;

dëshmisë së dëshmitarit.⁷⁶ Në qoftë se dëshmia e një dëshmitari gjykohet e besueshme, nuk ekziston kriter i përgjithshëm që kërkon që ajo të konfirmohet.⁷⁷ Në fakt, konfirmimi nuk është as kusht, as garanci e mbështetshmërisë në një dëshmi të veçantë.⁷⁸ Trupi Gjykes ka diskrecionin që të vendosë, në rrethanat e secilës çështje, nëse është e nevojshme që dëshmia të konfirmohet dhe që të mbështetet në dëshmi të pakonfirmuara, por të besueshme të dëshmitarëve.⁷⁹

39. Paneli gjithashtu vë në dukje se, kur pretendimi për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë ka të bëjë me një vendim diskrecional, apeluesi duhet të provojë se Trupi Gjykes ka kryer një gabim të dallueshëm që si rezultat ka dëmtuar apeluesin.⁸⁰

3. Prezumi i paanshmërisë së Trupit Gjykes

40. Paneli rikujton se merret si e mirëqenë që gjykatësit e Trupit Gjykes janë të paanshëm dhe se i takon palës apeluese që ta hedhë poshtë këtë mbi bazën e provave të mjaftueshme dhe të mbështetshme.⁸¹

Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Limaj dhe të tjerët*, para. 88; *Aleksovski* Appeal Judgment, para. 63; *Kayishema and Ruzindana* Appeal Judgment, para. 187.

⁷⁶ *Popović et al.* Appeal Judgment, para. 131; Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*, para. 781, 797, 819; *Ndahimana* Appeal Judgment, para. 43, 93; *Lukić and Lukić* Appeal Judgment, para. 86, 235, 363, 375; *Kupreškić et al.* Appeal Judgment, para. 32; *Rutaganda* Appeal Judgment, para. 28.

⁷⁷ Rregulla 139(3) e Rregullores; Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 36. Shih gjithashtu *Ntaganda* Appeal Judgment, para. 782; *Dragomir Milošević* Appeal Judgment, para. 215; *Ntawukulilyayo* Appeal Judgment, para. 21.

⁷⁸ *Dragomir Milošević* Appeal Judgment, para. 248; Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Limaj dhe të tjerët*, para. 203 dhe jurisprudenca e cituar aty.

⁷⁹ *Karera* Appeal Judgment, para. 45; *Ntawukulilyayo* Appeal Judgment, para. 21; *Dragomir Milošević* Appeal Judgment, para. 215. Shih gjithashtu *Musema* Appeal Judgment, para. 36; *Aleksovski* Appeal Judgment, para. 63.

⁸⁰ *Mladić* Appeal Judgment, para. 63, 107; *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgment, para. 431. Shih gjithashtu *Prlić et al.* Appeal Judgment, para. 119.

⁸¹ Shih p.sh. Vendimin e Apelit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Veselit, para. 34; *Akayesu* Appeal Judgment, para. 91; *Furundžija* Appeal Judgment, para. 196-197.

C. SIGURIA JURIDIKE

41. Paneli vë në dukje se, në interes të sigurisë dhe parashikueshmërisë juridike, nga Paneli i Apelit pritet që t'u përmbahet vendimeve të mëparshme të Dhomës së Gjykatës së Apelit dhe ai devijon prej tyre vetëm për arsye bindëse në interes të drejtësisë.⁸² Rrjedhimisht, pala që kërkon një devijim të tillë duhet të demonstrojë se ai është i përligjur për arsye bindëse.⁸³

IV. PRANUESHMËRIA E PARASHTRIMEVE TË MBROJTËSES SË VIKTIMAVE

42. Në Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave gjatë Procedurës së Apelit, Paneli i Apelit vendosi që viktimat që morën pjesë në procedurën paraprake dhe në gjykim mund të marrin pjesë në procedurën e apelit, por vetëm në lidhje me aspekte që burojnë nga pikat e Apelit.⁸⁴ Paneli gjithashtu përcaktoi se Mbrojtësja e Viktimave mund të paraqesë përgjigje dhe kundërpërgjigje ndaj çdo parashtrimi të bërë para Panelit, përfshirë dosjet e apelit, por duhet të shtjellojë shprehimisht se si lidhen këto parashtrime me interesat personale të viktimave pjesëmarrëse.⁸⁵ Paneli saktësoi se “në qoftë se Paneli nuk bindet për këtë lidhje [...], kjo mund të çojë në hedhjen poshtë menjëherë të parashtrimeve”.⁸⁶

43. Paneli i Apelit vë në dukje se në Dosjen e Përgjigjes së Viktimave, Mbrojtësja e Viktimave u përgjigjet vetëm atyre pikave të Apelit që “ndikojnë drejtpërdrejt në

⁸² Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 37; Vendimi i Apelit në lidhje me Vendimin e Pestë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 10; Vendimi i Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 15. Shih gjithashtu *Mladić Appeal Judgement*, para. 14; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 13; *Semanza Appeal Decision*, para. 92; *Aleksovski Appeal Judgement*, para. 107-111; *Šešelj Appeal Judgement*, para. 11 (ku Dhoma e Apelit e MPNTP-së u shpreh, ndër të tjera se, ndër rastet kur duhet devijuar prej vendimeve të mëparshme të apelit për arsye bindëse në interes të drejtësisë, përfshihen edhe ato ku vendimet u morën mbi bazën e një parimi juridik të pasaktë ose kur gjykatësit ishin keqinformuar për dispozitat ligjore përkatëse).

⁸³ *Mladić Appeal Judgement*, para. 14; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 13; *Šešelj Appeal Judgement*, para. 11.

⁸⁴ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave gjatë Procedurës së Apelit, para. 7-8.

⁸⁵ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave gjatë Procedurës së Apelit, para. 13.

⁸⁶ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave gjatë Procedurës së Apelit, para. 13.

interesat personale të viktimave pjesëmarrëse” dhe “nuk bën parashtrime thelbësore për ndonjë pikë tjetër”.⁸⁷ Paneli gjithashtu vëren se, për secilën pikë të Apelit, Mbrojtësja e Viktimave përshkruan se si ndikon në të drejtat dhe interesat personale të viktimave.⁸⁸ Në veçanti, Mbrojtësja e Viktimave parashtron se pikat përkatëse të Apelit kanë të bëjnë me: “(i) pranimin e vuajtjeve të viktimave, (ii) [...] besueshmërinë e dëshmitarëve me status të dyfishtë dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, (iii) interesin e viktimave që të dëgjohet zëri i tyre, dhe (iv) arsyet materiale për kërkesat e tyre për zhdëmtim”.⁸⁹

44. Në Dosjen e Kundërpërgjigjes së tij, Mustafa kërkon që parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave të rrëzohen, sepse kanë të bëjnë me pika të Apelit që nuk ndikojnë në interesat personale të viktimave pjesëmarrëse.⁹⁰ Konkretisht, Mustafa parashtron, ndër të tjera, se viktimat pjesëmarrëse nuk kanë interes personal që dëshmitë e tyre “të përfshihen”⁹¹ në cilësimin dhe vërtetimin e krimeve,⁹² apo në aspektet procedurale të ngritura nga Mbrojtja.⁹³ Mustafa gjithashtu argumenton se nuk kundërshton “pranimin” e viktimave apo të vuajtjeve të tyre, por “përmbajtjen” e dëshmive të dhëna prej tyre.⁹⁴ Rrjedhimisht, Mustafa argumenton se parashtrimet e

⁸⁷ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 1-2, 7. Paneli thekson se Mbrojtësja e Viktimave bëri parashtrime në lidhje me nënpikat 1C, 1E, 1I, 1J, 1K, 1N, 2E, 2H, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, dhe nuk bëri parashtrime në lidhje me nënpikat e tjera të Apelit të paraqitura nga Mbrojtja (konkretisht nënpikat 1A, 1B, 1D, 1F, 1G, 1H, 1L, 1M, 2A deri 2D, 2F, 2G, 2I deri 2P dhe 9A deri 9K).

⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 8 (nënpika 1C), 15 (nënpika 1E), 21 (nënpika 1I), 25 (nënpika 1J), 28 (nënpika 1K), 33 (nënpika 1N), 44 (nënpikat 2E dhe 2H), 67 (Pika 3 e Apelit), 72 (Pikat 4 dhe 5 të Apelit), 81 (Pikat 6 dhe 7 të Apelit), 87 (Pika 8 e Apelit).

⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 7.

⁹⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 114-137. Paneli thekson se, ndonëse Mustafa kërkon që parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave të rrëzohen në tërësi, ai nuk kundërshton në mënyrë specifike parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave të paraqitura në Pikën 8 të Apelit.

⁹¹ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 123, 129. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 120.

⁹² Dosja e Kundërpërgjigjes, para 134-136.

⁹³ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 127, 131.

⁹⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 116-118, 120. Në nënpikën 1C, Mustafa parashtron se nuk ka asgjë kundër pranimit të çka kishte përjetuar W01679. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 114-115.

Mbrojtëses së Viktimave, ku pretendohet interes i bazuar në njohjen e vuajtjeve të viktimave, duhet të rrëzohen.⁹⁵

45. Paneli rikujton se, në bazë të nenit 22(3) të Ligjit dhe Vendimit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave gjatë Procedurës së Apelit, i rrëzon parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave për aspekte që nuk ndikojnë në interesat personale të viktimave pjesëmarrëse,⁹⁶ dhe se duhet të sigurojë që pjesëmarrja e viktimave të mos cenohet, as të bjerë ndesh me të drejtat e të akuzuarit.⁹⁷

46. Pasi u shpall fajtor për tri akuza për krime lufte, Mustafa tani kërkon prapësimin e të gjitha verdikteve të fajësisë ose, si alternativë, lëshimin e një urdhri që çështja t'i kthehet Trupit Gjykses, ose, në rast se Paneli i Apelit lë në fuqi verdiktet e fajësisë, uljen e dënimit të tij.⁹⁸ Ndonëse Paneli gjykon se, në përgjithësi, interesat e viktimave pjesëmarrëse ndikohen nga apeli i Mbrojtjes, Paneli duhet të bindet se interesat personale të tyre preken nga pika konkrete e apelit për të cilën bëjnë parashtrime.⁹⁹

47. Paneli vëren se Mbrojtësja e Viktimave ka bërë parashtrime vetëm për 14 prej 51 nënpikave të Apelit të paraqitura nga Mbrojtja dhe se shtatë prej këtyre nënpikave kanë të bëjnë me dëshmitë dhe provat e dhëna nga [REDAKTUAR] ose kanë lidhje me [REDAKTUAR].¹⁰⁰ Sa u përket këtyre shtatë nënpikave, Paneli është bindur se parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave kanë të bëjnë me interesat personale të viktimave pjesëmarrëse, ndër to dhe e drejta e tyre për njohje të çdo dëmi të pësuar dhe për të kontribuar në përcaktimin e së vërtetës. Gjithashtu, viktimat pjesëmarrëse

⁹⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 114-119.

⁹⁶ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit, para. 13.

⁹⁷ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit, para. 10.

⁹⁸ Njoftimi për Apel, para. 2; Dosja e Apelit, para. 3, 446; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 138.

⁹⁹ Shih për ngjashmëri, *Ayyash et al.* Appeal Decision on Modalities of Victim Participation in Appeal, para. 51-52, 62.

¹⁰⁰ Nënpikat 1C, 1E, 1J, 1K, 1N, 2E dhe 2H. Paneli thekson se në seancën e apelit, Mbrojtësja e Viktimave iu përgjigj edhe kërkesës së Mustafës për t'i referuar një aspekt për shqyrtim Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Shih më poshtë, para. 439, 444; Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 129-130.

kanë interes të veçantë për pranimin prej Trupit Gjykses të dëshmvive të dhëna prej [REDAKTUAR] dhe mbështetjen në to në Aktgjykim. Paneli gjithashtu vëren se gjashtë nënpika të tjera të Apelit lidhen me të drejtën e viktimave pjesëmarrëse që gjykata të pranojë se viktimat, ose anëtarë të familjeve të tyre, u bënë objekt i krimeve të ndalimit arbitrar, torturës, dhe/ose vrasjes së paligjshme dhe se, rrjedhimisht, ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtën e tyre për t'u zhdëmtuar për dëmin e pësuar.¹⁰¹ Së fundi, Paneli vëren se argumentet e Mbrojtjes në Pikën 3 të Apelit lidhur me zhvarrosjen e kufomës së anëtarit të familjes së viktimave pjesëmarrëse përkatëse, prekin interesat më vetjake të tyre, konkretisht të drejtën e tyre për privatësi, dinjitet dhe mirëqenie psikologjike, si dhe të drejtën për njohjen e dëmit të pësuar.¹⁰²

48. Bazuar në sa më lart, Paneli është bindur se parashtrimet e Mbrojtësës së Viktimave në lidhje me nënpikat 1C, 1E, 1I, 1J, 1K, 1N, 2E, 2H, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 ndikojnë në interesat personale të viktimave pjesëmarrëse. Gjithashtu, Paneli i Apelit konstaton se pjesëmarrja e viktimave në lidhje me këto nënpika as cenon, as bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit. Rrjedhimisht, rrëzohet kërkesa e Mbrojtjes për hedhjen poshtë të parashtrimeve të Mbrojtësës së Viktimave.

V. DISKUTIM

A. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME CILËSIMIN E KONFLIKTIT SI JONDËRKOMBËTAR PREJ TRUPIT GJYKUES (NËNPIKA 1A)

49. Paneli rikujton se Mustafa u akuzua dhe u shpall fajtor për disa akuza për krime lufte sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, të cilat përbëjnë shkelje të rëndë të Nenit të

¹⁰¹ Nënpika 1I dhe Pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 të Apelit.

¹⁰² Në Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit, Paneli konstatoi se "sipas nenit 23 të Ligjit, mbrojtja e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së viktimave, është interes personal dhe e drejtë e katërt që kanë viktimat pjesëmarrëse në proces". Shih Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit, para. 9, që i referohet Vendimit mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave në Gjykim, para. 9-19.

Përbashkët 3 e që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar.¹⁰³ Rrjedhimisht, cilësimi i konfliktit si jondërkombëtar është relevant për përcaktimin e përgjegjesisë penale të Mustafës sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.

50. Duke marrë parasysh kriteret e nenit 14(1)(c) të Ligjit, Trupi Gjykses konstatoi se: (i) në kohën që mbulojnë akuzat ekzistonte një konflikt i armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe;¹⁰⁴ (ii) krimet për të cilat u ngritën akuzat në Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës kishin lidhjen e nevojshme me konfliktin e armatosur jondërkombëtar;¹⁰⁵ (iii) Mustafa dhe anëtarët e BIA-s që ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999, kishin dijeni për ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar;¹⁰⁶ dhe (iv) viktimat nuk merrnin pjesë aktive në luftime, për shkak se në kohën e kryerjes së krimeve mbaheshin të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe, si rezultat, ishin të mbrojtur nga Neni i Përbashkët 3.¹⁰⁷

51. Mustafa kundërshton cilësimin që Trupi Gjykses i bën konfliktit në Kosovë gjatë kohës që mbulojnë akuzat si konflikt i armatosur jondërkombëtar.¹⁰⁸ ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk arrin të demonstrojë gabim në këtë aspekt dhe se disa prej parashtrimeve të tij duhet të rrëzohen menjëherë.¹⁰⁹

1. Parashtrimet e palëve

52. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që konstatoi se gjatë periudhës që përfshin Aktakuza, ekzistonte një konflikt i armatosur jondërkombëtar,

¹⁰³ Aktakuza, para. 35. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 23, 758-760 (veçanërisht në lidhje me Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës), 831.

¹⁰⁴ Aktgjykimi, para. 710.

¹⁰⁵ Aktgjykimi, para. 717.

¹⁰⁶ Aktgjykimi, para. 721.

¹⁰⁷ Aktgjykimi, para. 722.

¹⁰⁸ Dosja e Apelit, para. 5-20; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 77-80.

¹⁰⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 91-96.

kur në fakt konflikti duhej të ishte cilësuar si ndërkombëtar,¹¹⁰ dhe se, për pasojë, neni 14(1)(c) i Ligjit nuk është i zbatueshëm në çështjen aktuale.¹¹¹

53. Së pari, Mustafa argumenton se, në kundërshtim me konstatimet e Trupit Gjykses, Mbrojtjes duhet t'i lejohet të paraqesë prova në lidhje me cilësimin e konfliktit deri në fazën e deklaratave përmbyllëse.¹¹² Ai parashtron se cilësimi i konfliktit përbën "fakt juridik", për të cilin nuk mund të vendoset në bazë të konstatimit gjyqësor të fakteve të shqyrtuara, sikurse veprimi Trupi Gjykses në mënyrë të gabuar, sipas tij.¹¹³

54. Së dyti, në lidhje me vlerësimin që Trupi Gjykses u bëri kriterëve të nenit 14(2) të Ligjit për të vendosur në lidhje me zbatimin e nenit 14(1)(c) të Ligjit, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses zbatoi kriteret e gabuara në përcaktimin e "grupeve të armatosura të organizuara" që mund të kryejnë "dhunë të armatosur të zgjatur".¹¹⁴ Sipas tij, Trupi Gjykses nuk zbatoi kriteret e renditura në nenin 1(1) të Protokollit Shtesë II, dhe në vend të tyre "shpik[u] kriteret shtesë" duke iu referuar jurisprudencës së TPNJ-së dhe TPNR-së.¹¹⁵

55. Së treti, Mustafa parashtron se, në kundërshtim me interpretimin e Trupit Gjykses, në aktgjykimet e TPNJ-së në çështjen gjyqësore *Gjorgjeviq* nuk u përcaktua "në mënyrë përfundimtare" se në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur

¹¹⁰ Dosja e Apelit, para. 5-8, 14, 17-18, 20; Njoftimi për Apel, nënpika 1A, para. 4; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 78-79. Paneli thekson se në paragrafin 18 të Dosjes së Apelit, duket se Mustafa i referohet gabimisht poshtëshënimit 1525 të Aktgjykimit në vend që t'i referohet poshtëshënimit 1524.

¹¹¹ Dosja e Apelit, para. 20. Paneli i ka trajtuar argumentet e Mustafës në paragrafin 19 të Dosjes së Apelit në lidhje me alibinë në pjesën që lidhet me mbrojtjen përmes alibisë të Mustafës. Shih më poshtë, pjesën N, para. 310-324.

¹¹² Dosja e Apelit, para. 16, që i referohet paragrafit 706 të Aktgjykimit.

¹¹³ Dosja e Apelit, para. 18.

¹¹⁴ Dosja e Apelit, para. 9-13. Paneli thekson se në paragrafin 9 të Dosjes së Apelit, duket se Mustafa i referohet gabimisht paragrafit 693 të Aktgjykimit në vend që t'i referohet paragrafit 697. Gjithashtu, në paragrafin 12 të Dosjes së Apelit, Mustafa i referohet gabimisht poshtëshënimit 1403 të Aktgjykimit në vend që t'i referohet poshtëshënimeve 1503-1504.

¹¹⁵ Dosja e Apelit, para. 9-12.

jondërkombëtar ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së, midis fundit të majit 1998 dhe së paku qershorit 1999.¹¹⁶

56. Së katërti, Mustafa pretendon se, duke pasur parasysh se konflikti i armatosur ndërkombëtar përcaktohet nga përfshirja e dy apo më shumë shteteve në konflikt,¹¹⁷ bombardimi i Serbisë nga NATO, që filloi më 24 mars 1999, i dha karakter ndërkombëtar konfliktit në Kosovë.¹¹⁸ Në vijim Mustafa vëren se Trupi Gjykses konstatoi se “një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të shndërrohet në një konflikt të armatosur ndërkombëtar nëse një grup i armatosur i organizuar është nën kontrollin e përgjithshëm të një shteti të tretë”,¹¹⁹ dhe parashtron se as Kosova, as UÇK-ja, nuk ishin nën kontrollin e një shteti të tretë.¹²⁰

57. ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk shpjegon se pse Trupi Gjykses gaboi që zbatoi kriteret nga jurisprudenca e TPNJ-së, konkretisht Aktgjykimi në çështjen *Boshkoski dhe Tarçulovski*, në vlerësimin e “shkallës së nevojshme të organizimit të [...] një grupi të armatosur në kuptim të Nenit të Përbashkët 3”.¹²¹ Sipas ZPS-së, kriteret shtesë dhe standardi më i lartë që burojnë nga Protokollit Shtesë II, nuk janë të zbatueshme, pasi në akuzat e kësaj çështjeje gjyqësore pretendohet për shkelje të rënda të Nenit të Përbashkët 3 dhe jo të Protokollit Shtesë II.¹²²

58. Në lidhje me pretendimin e Mustafës se konflikti i armatosur ishte ndërkombëtar, ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në jurisprudencën tashmë të pranuar gjerësisht se një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të ekzistojë krahas një konflikti të armatosur

¹¹⁶ Dosja e Apelit, para. 17.

¹¹⁷ Dosja e Apelit, para. 6.

¹¹⁸ Dosja e Apelit, para. 7-8, 19; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 78-79.

¹¹⁹ Dosja e Apelit, para. 14. Paneli thekson se në paragrafin 14 të Dosjes së Apelit, duket se Mustafa i referohet gabimisht paragrafit 694, në vend të paragrafit 709 të Aktgjykimit.

¹²⁰ Dosja e Apelit, para. 14.

¹²¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 92, që i referohet paragrafit 697 të Aktgjykimit dhe paragrafëve 194-203 të Aktgjykimit *Boshkoski dhe Tarçulovski*.

¹²² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 93.

ndërkombëtar.¹²³ Në lidhje me këtë, ZPS-ja parashtron gjithashtu se gjatë procesit gjyqësor Mustafa nuk i kundërshtoi në asnjë moment faktet e shqyrtuara mbi të cilat Trupi Gjykes bazoi përfundimin lidhur me ekzistencën e një konflikti të armatosur jondërkombëtar.¹²⁴

59. ZPS-ja gjithashtu e kundërshton si të rremë dhe të pafaktuar pretendimin e Mustafës se në aktgjykimet e TPNJ-së në çështjen *Gjorgjeviq* nuk u bë konstatim përfundimtar se në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur jondërkombëtar midis fundit të majit 1998 dhe së paku qershorit 1999.¹²⁵ Së fundi, ZPS-ja argumenton se pjesa e mbetur e parashtrimeve të Mustafës duhet të rrëzohet menjëherë.¹²⁶

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

60. Paneli do të trajtojë fillimisht argumentin e Mustafës se ekzistenca e një konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë nuk mund të vërtetohet në bazë të konstatimit gjyqësor të fakteve të shqyrtuara, pasi përbën “fakt juridik në këtë çështje gjyqësore”.¹²⁷

61. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se rregulla 157(2) e Rregullores kufizon mundësinë e Trupit Gjykes për të bërë konstatim gjyqësor lidhur me konstatimet *faktike*.¹²⁸ Për të përcaktuar nëse një fakt i propozuar është vërtet konstatim faktik, është e nevojshme të vlerësohet rast pas rasti nëse fakti i propozuar përmban konstatime ose cilësime që në thelb janë juridike dhe që, për rrjedhojë, duhet të përjashtohen.¹²⁹

¹²³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 94.

¹²⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, poshtëshënimi 264.

¹²⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 95, që i referohet paragrafit 1579 të Aktgjyimit *Gjorgjeviq*; Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*, para. 521.

¹²⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 96.

¹²⁷ Dosja e Apelit, para. 18.

¹²⁸ Shih për ngjashmëri, Vendimin mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Faktet e Shqyrtuara në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 31.

¹²⁹ *Stanišić and Simatović* Decision on Adjudicated Facts, para. 39; *Popović et al.* Decision on Adjudicated Facts, para. 10. Shih gjithashtu Vendimin mbi Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera, para. 10 dhe jurisprudencën e cituar në të. Paneli i Apelit vëren se Dhomat e TPNJ-së kanë vlerësuar se “shumë

62. Fillimisht, Paneli i Apelit vëren se përfundimi i Trupit Gjykses në Aktgjykim se në Vendimin e vet mbi Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera kishte bërë konstatim gjyqësor për ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar midis UÇK-së dhe forcave serbe gjatë kohës që mbulojnë akuzat, është çorientues.¹³⁰ Sipas Panelit të Apelit, Trupi Gjykses nuk bëri shprehimisht konstatim gjyqësor lidhur me përfundimet e arritura nga gjykata të tjera për ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar midis UÇK-së dhe forcave serbe në kohën e kryerjes së krimeve për të cilat u ngritën akuzat.¹³¹ Faktikisht, ai bëri konstatim gjyqësor për *faktet* që ishin relevante për përcaktimin e ekzistencës, llojit dhe kuadrit kohor të atij konflikti. Paneli i Apelit vëren se, më pas, Trupi Gjykses i mori parasysh këto fakte në Aktgjykim, për përcaktimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur jondërkombëtar.¹³² Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi që iu referua fakteve të shqyrtuara dhe Vendimit mbi Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera për nxjerrjen e përfundimit mbi ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe rrëzon argumentin e Mbrojtjes në këtë aspekt.

63. Sa i përket pretendimit të Mustafës lidhur me kohën kur i paraqiti kundërshtimet ndaj saktësisë së fakteve të shqyrtuara në procese të tjera,¹³³ Paneli vëren se Trupi Gjykses nuk i rrëzoi argumentet e Mbrojtjes vetëm sepse u paraqitën

konstatime kanë një aspekt juridik, në qoftë se bëhet interpretim i gjerë i kësaj shprehjeje". Shih *Dragomir Milošević Appeal Decision on Adjudicated Facts*, para. 22; *Krajišnik Decision on Adjudicated Facts*, para. 15.

¹³⁰ Shih Aktgjykimin, para. 701-702, 710.

¹³¹ Vendimi mbi Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera, para. 12; Lista e Fakteve të Shqyrtuara, Nr. 1-6, 32-52; Aktgjykimi, para. 701, 710. Shih gjithashtu Vendimin mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Faktet e Shqyrtuara në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 32.

¹³² Paneli vëren se në Vendimin mbi Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera, Trupi Gjykses vetëm "*vuri në dukje se faktet e propozuara kanë lidhje kryesisht me ekzistencën e konfliktit të armatosur [...] ndërmjet UÇK-së dhe forcave të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, që luftonin së bashku me forcat serbe [...]*". Shih Vendimin mbi Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera, para. 12 (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 48. Paneli gjykon se të gjitha faktet e shqyrtuara të përfshira nën titullin "Konflikti i armatosur" (faktet e pranuar nr. 1-6) përshkruajnë situata faktike, po kështu edhe faktet e shqyrtuara nën titullin "Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)" (faktet e pranuar nr. 32-52). Shih Listën e Fakteve të Shqyrtuara.

¹³³ Dosja e Apelit, para. 16.

me vonesë, por edhe sepse Mbrojtja duhej të kishte paraqitur prova në gjykim, në vend që të paraqiste “thjesht pretendime apo argumente [...] me vonesë gjatë fazës së deklaratave përmbyllëse”.¹³⁴ Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në këtë qasje të Trupit Gjykues.

64. Në lidhje me argumentet materiale të Mustafës që kanë të bëjnë me cilësimin e konfliktit të armatosur, Paneli vëren se ekzistojnë dy kritere, që “tashmë janë pranuar gjerësisht si kriteret më relevante për vlerësimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur jondërkombëtar”, konkretisht që dhuna duhet të ketë arritur një intensitet të caktuar dhe që ajo duhet të jetë ndërmjet të paktën dy palëve të organizuara/grupeve të armatosura.¹³⁵ Pas vendimit themelor të Dhomës së Apelit të TPNJ-së në çështjen *Tadiq*, Dhomat e TPNJ-së dhe TPNR-së vendosën dhe zbatuan në vazhdimësi këtë standard: “konflikt i armatosur ekziston sa herë që përdoret forca e armatosur midis shteteve ose *dhunë e armatosur e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti*”.¹³⁶

65. Në këtë aspekt, Paneli rikujton se formulimi i nenit 14(2) të Ligjit pasqyron qasjen e tribunalëve ndërkombëtarë të përkohshëm.¹³⁷ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se, për të përcaktuar ekzistencën e konfliktit të armatosur me karakter jondërkombëtar sipas nenit 14(1)(c) dhe (2) të Ligjit, trupi gjykues duhet të vlerësojë dy faktorë:

¹³⁴ Shih Aktgjykimin, para. 706.

¹³⁵ Shih 2020 ICRC Commentary GCIII, Common Article 3, para. 455. Shih gjithashtu Zimmermann, A., Geiß, R., in *Ambos Rome Statute Commentary, Article 8*, shënimet 883-885.

¹³⁶ *Tadić* Appeal Decision on Jurisdiction, para. 70 (theksimi i shtuar); *Boškoski and Tarčulovski* Appeal Judgement, para. 21; Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 175; *Tadić* Trial Judgement, para. 562; *Milutinović et al.* Trial Judgement (Vol. I), para. 791; Aktgjykimi në Çështjen *Limaj dhe të tjerët*, para. 84; *Akayesu* Trial Judgement, para. 619-620; *Rutaganda* Trial Judgment, para. 91-92. Shih gjithashtu *Ongwen* Trial Judgment, para. 2683; *Katanga* Trial Judgment, para. 1173; *Lubanga* Trial Judgment, para. 537-538. KNKK-ja vuri në dukje se jurisprudenca e TPNJ-së dhe TPNR-së dha kontribut të rëndësishëm në sqarimin e përkufizimit ose të kriterëve përbërëse të konflikteve të armatosura jondërkombëtare. Shih 2020 ICRC Commentary GCIII, Common Article 3, para. 460-462.

¹³⁷ Neni 14(2) i Ligjit përcakton se konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar “ndodhin në territorin e një shteti kur ekziston konflikt i armatosur i zgjatur mes organeve të autoritetit dhe grupeve të armatosura të organizuara apo mes këtyre grupeve”.

(i) nivelin e intensitetit të konfliktit; dhe (ii) shkallën e organizimit të grupit ose grupeve të armatosura joshtetërore të përfshira në konflikt.¹³⁸ Paneli vëren se Mbrojtja nuk i kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me nivelin e intensitetit të konfliktit, por vetëm në lidhje me shkallën e organizimit të njëjës prej palëve në konflikt, konkretisht të UÇK-së.¹³⁹

66. Në lidhje me këtë, Paneli i konstaton jobindëse argumentet e pafaktuara të Mustafës se Trupi Gjykses zbatoi kriteret e gabuara në përkufizimin e UÇK-së si “grup i armatosur i organizuar”.¹⁴⁰ Së pari, në lidhje me argumentin e Mustafës se në Aktgjykim “citohen [...] pa u thelluar shumë disa aktgjykime për të cilat merret si e mirëqenë se janë pjesë e [...] së drejtës zakonore ndërkombëtare”,¹⁴¹ Paneli i Apelit vëren se KNKK-ja është shprehur me miratim për standardin e evidentuar nga TPNJ-ja¹⁴² dhe të përmendur nga Trupi Gjykses.¹⁴³ Paneli i Apelit gjithashtu vëren se këta faktorë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm nga Dhomat e TPNJ-së,¹⁴⁴

¹³⁸ Shih Aktgjykimin, para. 697-698, 708.

¹³⁹ Dosja e Apelit, para. 5-20. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 708, që i referohet Aktgjykimit në Çështjen *Gjorgjeviq*, para. 1536, ku Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së konstatoi se, nga fundi i majit 1998, konflikti në Kosovë ndërmjet forcave serbe (që përbënin autoritetet qeveritare) dhe UÇK-së kishte nivelin e duhur të intensitetit për t’u konsideruar si konflikt i armatosur.

¹⁴⁰ Dosja e Apelit, para. 9-13.

¹⁴¹ Dosja e Apelit, para. 9.

¹⁴² Shih 2020 ICRC Commentary GCIII, Common Article 3, para. 464.

¹⁴³ Shih Aktgjykimin, para. 697, ku Trupi Gjykses jep në mënyrë të përmbledhur një listë të faktorëve tregues që mund të merren parasysh për të përcaktuar nëse një entitet joshtetëror mund të kryejë dhunë të armatosur të zgjatur: (i) ekzistenca e një strukture komanduese, ku përfshihen ekzistenca e një selie të shtabit, e një shtabi të përgjithshëm ose komande të lartë, e gradave dhe posteve të identifikueshme dhe e rregulloreve të brendshme; (ii) lëshimi i deklaratave politike ose komunikatave dhe përdorimi i zëdhënësve; (iii) kapaciteti operativ dhe aftësia për kryerjen e operacioneve ushtarake; (iv) kapaciteti logjistik që përfshin disponueshmërinë e armëve dhe pajisjeve dhe kapaciteti për të lëvizur trupat dhe për të rekrutuar dhe stërvitur personelin; (v) kontrolli territorial që përfshin ndarjen në zona të përgjegjësive; (vi) sistemi i brendshëm disiplinor që përfshin zbatimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare në radhët e grupit të armatosur; dhe (vii) aftësia për të folur me një zë të vetëm në emër të grupit të armatosur, për shembull në negociata politike apo marrëveshje armëpushimi.

¹⁴⁴ Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 198-203. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Rigjykimit në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 17-124, 395, 406-409; Aktgjykimin *Gjorgjeviq*, para. 1526, 1537-1577; Aktgjykimin *Millutinoviq dhe të tjerët* (Vëllimi I), para. 821-840; *Martić Trial Judgement*, para. 344; Aktgjykimin në Çështjen *Limaj dhe të tjerët*, para. 90, 94-133; *Slobodan Milošević Decision on Acquittal*, para. 23-24; *Tadić Appeal Judgement*, para. 120.

por edhe nga GJPN-ja.¹⁴⁵ Paneli konstaton se Mustafa nuk shpjegon pse Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në jurisprudencën e TPNJ-së për të përcaktuar nivelin e organizimit të UÇK-së si grup i armatosur joshtetëror.¹⁴⁶ Gjithashtu, ndonëse do të kishte qenë më mirë që Trupi Gjykses të shpjegonte më tej se si i zbatoi faktorët e shtjelluar në jurisprudencën e TPNJ-së, ishte e mundur për Trupin Gjykses që, mbi bazën e kësaj jurisprudence, të arrinte në përfundimin se “nga maji 1998, UÇK-ja kishte karakteristika të mjaftueshme të një grupi të armatosur të organizuar, që ishte në gjendje të përfshihej në një konflikt të armatosur jondërkombëtar”.¹⁴⁷ Në lidhje me këtë, sipas Panelit të Apelit, marrja në konsideratë nga Trupi Gjykses i konstatimeve në çështjen *Gjorgjeviq*, mbështet konkluzionin përfundimtar të Trupit Gjykses mbi shkallën e organizimit të UÇK-së.

67. Së dyti, në kundërshtim me argumentin e Mbrojtjes, Paneli gjykon se për të përcaktuar shkallën e organizimit të UÇK-së, Trupi Gjykses nuk kishte nevojë të zbatonte standardin (më të lartë) të nenit 1(1) të Protokollit Shtesë II.¹⁴⁸ Siç u përmend më lart, në përputhje me nenin 14(1)(c) të Ligjit, akuzat në këtë çështje kanë të bëjnë me shkelje të rënda të Nenit të Përbashkët 3, e jo të Protokollit Shtesë II. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se standardi më i lartë që vendos Protokollit Shtesë II, nuk është i zbatueshëm.¹⁴⁹

68. Së fundi, sa i përket argumentit të Mustafës lidhur me ndikimin e ndërhyrjes së NATO-s, që sipas tij e shndërroi konfliktin që po zhvillohej në Kosovë në konflikt

¹⁴⁵ *Ongwen Trial Judgment*, para. 2685; *Ntaganda Trial Judgment*, para. 704. Shih gjithashtu *Katanga Trial Judgment*, para. 1186; *Lubanga Trial Judgment*, para. 537.

¹⁴⁶ *Contra* Dosja e Apelit, para. 12, ku argumentohet se në Aktgjykim “u shpikën kritere shtesë” dhe u renditën faktorë që vlejné për konflikte të armatosura ndërkombëtare.

¹⁴⁷ Aktgjykimi, para. 708, që u referohet paragrafëve 1532-1578 të Aktgjykimit në Çështjen *Gjorgjeviq*.

¹⁴⁸ Protokollit Shtesë II kërkon që “forcat e armatosura disidente apo grupe të tjera të armatosura të organizuara [të jenë] nën një komandë përgjegjëse dhe të ushtrojnë të tillë kontroll mbi një pjesë të territorit të vet që u mundëson kryerjen e operacioneve ushtarake të vazhdueshme dhe të bashkërenduara”. Shih nenin 1(1) të Protokollit Shtesë II.

¹⁴⁹ Aktgjykimi, poshtëshënimi 1503. Shih gjithashtu Aktgjykimin *Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 197; *Lubanga Trial Judgment*, para. 536; *Katanga Trial Judgment*, para. 1185-1186.

ndërkombëtar ndërmjet NATO-s dhe forcave serbe duke filluar nga 24 marsi 1999,¹⁵⁰ Paneli i Apelit pajtohet me Trupin Gjykses se (i) sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare është përcaktuar se një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të ekzistojë krahas një konflikti të armatosur ndërkombëtar,¹⁵¹ dhe (ii) një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të shndërrohet në një konflikt të armatosur ndërkombëtar nëse një grup i armatosur i organizuar është nën “kontrollin e përgjithshëm” të një shteti të tretë.¹⁵² Në lidhje me skenarin e dytë, Paneli vëren se Mustafa bie në kundërshtim me veten kur pretendon se UÇK-ja nuk ishte nën “kontrollin e përgjithshëm” të një apo më shumë prej shteteve të NATO-s – gjë që zhvlerëson argumentin e tij për klasifikimin e konfliktit si ndërkombëtar.¹⁵³ Duke pasur parasysh jurisprudencën tashmë të pranuar mbi mundësinë e bashkekzistencës së konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe konfliktit të armatosur ndërkombëtar, Paneli nuk do ta shqyrtojë më tej argumentin e Mustafës sipas skenarit të dytë.

69. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Mustafa nuk arrin të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses mbi ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon nënpikën 1A të Apelit të Mustafës.¹⁵⁴

¹⁵⁰ Dosja e Apelit, para. 5-8; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 78-79.

¹⁵¹ Aktgjykimi, para. 699, 707, që i referohet Aktgjykimit të Apelit *Gjorgjeviq*, para. 521; *Tadić* Appeal Judgment, para. 84; *Lubanga* Trial Judgment, para. 540. Shih gjithashtu 2020 ICRC Commentary GCIII, Common Article 3, para. 438-439, 447.

¹⁵² Aktgjykimi, para. 699, 709, që i referohen *Tadić* Appeal Judgment, para. 120, 137; *Ntaganda* Trial Judgment, para. 727. Shih gjithashtu *Kordić and Čerkez* Trial Judgment, para. 306-307; *Delalić et al.* Appeal Judgment, para. 14; *Ongwen* Trial Judgment, para. 2687; 2020 ICRC Commentary GCIII, Common Article 3, para. 440-444.

¹⁵³ Dosja e Apelit, para. 14.

¹⁵⁴ Argumentet e Mustafës në lidhje me alibinë në paragrafin 19 të Dosjes së Apelit, Paneli i ka trajtuar në pjesën mbi mbrojtjen e Mustafës përmes alibisë. Shih më poshtë, Pjesën N, para. 310-324.

B. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME MBËSHTETJEN E TRUPIT GJYKUES NË
DEKLARATËN SI I DYSHUAR TË MUSTAFËS (NËNPIKA 1B)

70. Në Aktgjykim, Trupi Gjykes u mbështet në deklaratën që Mustafa i dha ZPS-së.¹⁵⁵ Mustafa e kundërshton këtë¹⁵⁶ dhe pretendon shkelje të nenit 3 të Ligjit dhe rregullës 138(2) të Rregullores, si dhe të së drejtës për mosinkriminimin e vetes.¹⁵⁷ ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk e kundërshtoi pranimin e deklaratës gjatë gjyqimit dhe nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykes bëri gabim të dallueshëm që e mori parasysh deklaratën.¹⁵⁸

1. Parashtrimet e palëve

71. Mustafa parashtron se Trupi Gjykes gaboi që pranoi si provë dhe u mbështet në deklaratën e tij si i dyshuar.¹⁵⁹ Si argument, Mustafa parashtron se ai nuk u informua për llojin dhe shkakun e pretendimit nën hetim dhe se kjo shkelje krijoi dyshim të konsiderueshëm për mbështetshmërinë në deklaratën e tij si i dyshuar dhe dëmtoi rëndë integritetin e procesit sipas rregullës 138(2) të Rregullores.¹⁶⁰ Gjithashtu, Mustafa argumenton se, duke pranuar si provë deklaratën e tij si i dyshuar dhe duke

¹⁵⁵ Aktgjykimi, para. 235-239. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 30. Në veçanti, Trupi Gjykes u mbështet në dëshminë e Mustafës në lidhje me: (i) praninë e të akuzuarit në periudhat që kanë lidhje me akuzat në prill 1999 në vendin e krimeve të pretenduara në Zllash; (ii) aftësinë e tij për të shkuar dhe ardhur nga Zllashi, si dhe për të lëvizur nëpër territorin përreth gjatë prillit 1999; (iii) disponueshmërinë e automjeteve të ndryshme, ndër të cilat edhe automjete për terren të vështirë dhe malor; (iv) pronësinë e kompleksit të ndalimit në Zllash ku ishte vendosur baza e BIA-s; dhe (v) pozitën komanduese të të akuzuarit në BIA dhe pushtetin e tij për t'u dhënë urdhra vartësve të tij në BIA. Shih Aktgjykimin, para. 236. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 248-252.

¹⁵⁶ Paneli nxjerr përfundimin se Mustafa kundërshton deklaratën që ai i dha ZPS-së si i dyshuar. Shih P00111 deri P00118 (Salih Mustafa), 19 dhe 20 nëntor 2019 (konfidenciale). Ndonëse në Dosjen e Apelit Mustafa parashtron në mënyrë të përgjithshme se Trupi Gjykes gaboi që pranoi dhe u mbështet në "deklaratat që apeluesi i dha ZPS-së", në Njoftimin për Apel Mustafa i referohet më saktësisht "intervistave të apeluesit si i dyshuar". Shih Dosjen e Apelit, para. 24; Njoftimin për Apel, nënpika 1B, para. 4, poshtëshënimi 2, që i referohet paragrafit 238 të Aktgjyqimit, ku Trupi Gjykes trajton deklaratën e tij si i dyshuar.

¹⁵⁷ Dosja e Apelit, para. 21-25; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 38-40.

¹⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 48.

¹⁵⁹ Njoftimi për Apel, nënpika 1B, para. 4; Dosja e Apelit, para. 21-26.

¹⁶⁰ Njoftimi për Apel, nënpika 1B, para. 4; Dosja e Apelit, para. 21, 23.

u mbështetur në të, Trupi Gjykses shkeli të drejtën e tij për mosinkriminim të vetvetes, të mbrojtur nga neni 31(1) dhe (2) i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 6(1) i KEDNJ-së.¹⁶¹

72. ZPS-ja përgjigjet se, gjatë gjykimit Mustafa nuk e kundërshtoi pranueshmërinë e deklaratës së tij si i dyshuar, as nuk e fakton pretendimin e tij në apel dhe, për rrjedhojë, parashtrimet e tij duhet të rrëzohen menjëherë.¹⁶² Sa i përket themelësisë, ZPS-ja parashtron se të drejtat e Mustafës si i dyshuar u respektuan plotësisht dhe se ai nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykses ka gabuar.¹⁶³ Konkretisht, ZPS-ja argumenton se, në kohën kur dha deklaratë si i dyshuar, Mustafa u informua për të drejtat e tij sipas nenit 38(2) të Ligjit, dhe se “ekzistonin arsye për të besuar se ai kishte kryer vepër penale brenda juridiksionit të [Dhomave të Specializuara]”;¹⁶⁴ gjithashtu atij iu “rikujtua” “disa herë” e drejta për të heshtur dhe e drejta për të pasur mbrojtës.¹⁶⁵ Më tej, ZPS-ja argumenton se neni 30(1) i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 6(3) i KEDNJ-së nuk “kërkojnë që prokuroria t’ia bëjë të ditur fokusin e hetimeve të saj” të dyshuarit dhe se “nuk ekziston një kriter apo standard i përgjithshëm që i dyshuari të njoftohet për kohën, vendin dhe sjelljen konkrete për të cilën dyshohet”.¹⁶⁶ Rrjedhimisht, ZPS-ja argumenton se zotit Mustafa iu dhanë hollësi të mjaftueshme dhe se Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të të drejtave të Mustafës që do të përlligjte përjashtimin e deklaratës së tij si i dyshuar.¹⁶⁷

73. Mustafa kundërpërgjigjet se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në deklaratën e tij si i dyshuar duke mos marrë parasysh “kontekstin” në të cilin u dha deklarata,¹⁶⁸

¹⁶¹ Dosja e Apelit, para. 24, 26.

¹⁶² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 48.

¹⁶³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 50.

¹⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 50.

¹⁶⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 51.

¹⁶⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 49, që i referohet Vendimit të Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme në Çështjen *Shala*, para. 42.

¹⁶⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 50.

¹⁶⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 40.

konkretisht faktin se Mustafa nuk kishte dijeni për “llojin e saktë të akuzave” kundër tij dhe veprat për të cilat dyshohej dhe, si rezultat i kësaj, edhe përgjigjeve të Mustafës “u mungonin hollësitë dhe saktësia”.¹⁶⁹

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

74. Paneli i Apelit vëren se Mustafa kundërshton për herë të parë në apel pranimin prej Trupit Gjykses të deklaratës së tij si i dyshuar, ndërkohë që pati mundësi të shumta ta bënte këtë në shkallën e parë. Konkretisht, Paneli vëren se më 13 shtator 2021, ZPS-ja paraqiti kërkesë për pranim si provë, ndër të tjera, të deklaratës së tij si i dyshuar,¹⁷⁰ së cilës Mustafa nuk iu përgjigj. Paneli gjithashtu vë në dukje se më 13 dhjetor 2021, Trupi Gjykses lëshoi vendimin mbi pranueshmërinë e deklaratës si i dyshuar, të cilin Mustafa nuk e kundërshtoi.¹⁷¹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se, në parim, Mustafa ka humbur të drejtën për ta ngritur këtë aspekt në apel dhe për të pretenduar se u dëmtua nga pranimi si provë i deklaratës së tij si i dyshuar.¹⁷²

75. Gjithashtu, Paneli i Apelit vëren se Mustafa nuk evidenton konstatimet konkrete që kundërshton, për të cilat Trupi Gjykses u mbështet në deklaratën si i dyshuar;¹⁷³ dhe më tej, ishte vetëm përmes një poshtëshënimi në Njoftimin për Apel që Paneli mundi të deduktonte se argumentet e Mustafës kishin të bënin specifikisht me deklaratën e tij si i dyshuar.¹⁷⁴ Paneli rikujton se argumente të tilla të pafaktuara për ligjin rrëzim të menjëhershëm.¹⁷⁵ Sidoqoftë, me gjithë këto mangësi, Paneli i Apelit është në gjendje të deduktojë se për cilat prova dhe konstatime bën fjalë Mustafa. Për

¹⁶⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 39. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 38, 40.

¹⁷⁰ Kërkesa e ZPS-së në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, para. 33-34, 41; Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, materialet 87-95.

¹⁷¹ Vendimi në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, para. 23, 26(f).

¹⁷² Shih më lart, para. 30.

¹⁷³ Shih Dosjen e Apelit, para. 21-26; Njoftimin për Apel, nënpikën 1B, para. 4.

¹⁷⁴ Njoftimi për Apel, nënpika 1B, poshtëshënimi 2, që i referohet paragrafit 238 të Aktgjykimit, ku Trupi Gjykses konstatoi se “nuk vjen asnjë dëm nga përdorimi i deklaratës që i akuzuari i dha ZPS-së në kuadër të aktgjykimit”. Shih gjithashtu më lart, poshtëshënimin 155.

¹⁷⁵ Shih më lart, para. 29. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 32(i).

këtë arsye dhe, duke marrë gjithashtu parasysh se provat e kundërshtuara lidhen me të drejtën për gjykim të drejtë, Paneli do të bëjë përjashtim e do t'i shqyrtojë argumentet e Mustafës të paraqitura në nënpikën 1B të Apelit, për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.

76. Paneli rikujton se neni 38(3) i Ligjit dhe rregulla 43(2) e Rregullores përcaktojnë të drejtat e të dyshuarve gjatë marrjes në pyetje nga Dhomat e Specializuara. Gjithashtu, rregulla 138(2) e Rregullores përcakton përjashtimin e provave të siguruara nëpërmjet shkeljes së Ligjit, Rregullores apo normave të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në lidhje me këtë dhe, siç nënvizohet nga Trupi Gjykses, në rast të një verifikimi në kuadër të rregullës 138(2) të Rregullores, zbatohet një standard me dy elemente. Së pari, provat duhet të jenë siguruar në shkelje të Ligjit, Rregullores ose të normave të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Vetëm nëse vërtetohet kjo shkelje, Trupi Gjykses vijon me elementin e dytë të verifikimit dhe shqyrton dy kushtet alternative të përcaktuara në rregullën 138(2)(a) dhe (b) të Rregullores.¹⁷⁶

77. Paneli rikujton se standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që mbrojnë të drejtën për gjykim të drejtë garantohen nga neni 6 i KEDNJ-së.¹⁷⁷ Neni 6(3)(a) i KEDNJ-së nuk vendos ndonjë kriter formal konkret në lidhje me mënyrën në të cilën duhet të informohet i akuzuari për llojin dhe shkakun e akuzës kundër tij.¹⁷⁸ Shkalla e hollësive që priten të jepen gjatë intervistimit të një të dyshuari është përgjithësisht më e ulët se ajo që kërkohet kur ndaj personit që merret në pyetje është ngritur aktakuzë.¹⁷⁹ Kjo është në përputhje me vërejtjen e GJEDNJ-së se mënyra se si duhet të zbatohet neni 6(3)(a) i KEDNJ-së gjatë fazës së hetimeve dhe sasia e informacionit që përmendet

¹⁷⁶ Shih p.sh. Vendimin në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, para. 21.

¹⁷⁷ Shih në veçanti nenin 6(3)(a) të KEDNJ-së që garanton të drejtën “për t’u informuar brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij”. Shih gjithashtu nenin 3(2)(e) të Ligjit.

¹⁷⁸ Vendimi i Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme në Çështjen *Shala*, para. 42.

¹⁷⁹ Vendimi i Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme në Çështjen *Shala*, para. 43.

në këtë dispozitë, ndryshojnë varësisht prej rrethanave konkrete të secilës çështje.¹⁸⁰ Paneli gjithashtu rikujton se e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së përfshin të drejtën e personit për t'u informuar për të drejtën e mosinkrimimit të vetes dhe të drejtën për të heshtur kur merret në pyetje si i dyshuar.¹⁸¹

78. Paneli i Apelit vë në dukje se në Aktgjykim, Trupi Gjykses vendosi që deklarata e tij si i dyshuar të ishte e disponueshme "për t'u marrë parasysh".¹⁸² Duke theksuar se nuk kishte konstatuar asnjë shkelje të Ligjit apo Rregullores në lidhje me deklaratën si i dyshuar dhe se Mbrojtja nuk e kishte kundërshtuar pranueshmërinë apo përdorimin e saj si provë në gjykim, Trupi Gjykses konstatoi se mbështetja në të në kuadër të Aktgjykimit nuk shkaktonte asnjë dëm.¹⁸³

79. Kur vendosi në lidhje me pranueshmërinë e deklaratës së apellesit si i dyshuar, në Vendimin në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, Trupi Gjykses vuri në dukje se, në fillim të marrjes në pyetje nga ZPS-ja, Mustafa u informua në një gjuhë që e flet dhe e kupton se, ndër të tjera, ekzistonin arsye për të besuar se ai kishte kryer vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe, në përgjigje, Mustafa konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tij.¹⁸⁴ Gjithashtu, me ndihmën e një përkthyesi dhe në prani të mbrojtësit, Mustafa u informua për të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për mbrojtës të zgjedhur prej tij.¹⁸⁵

80. Paneli i Apelit rikujton se neni 38(3)(a) i Ligjit kërkon specifikisht që i dyshuari që merret në pyetje nga ZPS-ja të informohet "se ekzistojnë arsye për të besuar se ai ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara". Mustafa

¹⁸⁰ Vendimi i Apelit mbi Deklaratat e Mëparshme në Çështjen *Shala*, para. 43.

¹⁸¹ *Ibrahim and Others Judgment*, para. 272. Shih gjithashtu *O'Halloran and Francis Judgment*, para. 45; *Murray Judgment*, para. 45.

¹⁸² Aktgjykimi, para. 235, që i referohet Vendimit në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, para. 23, 26(f).

¹⁸³ Aktgjykimi, para. 238.

¹⁸⁴ Vendimi në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, para. 22, që i referohet P00111 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 3-4 dhe P00118 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 32.

¹⁸⁵ Vendim në lidhje me Materialet sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera, para. 22.

u informua në mënyrë të ngjashme në fillim të intervistës së tij.¹⁸⁶ Paneli gjykon se informacioni që iu dha Mustafës përmbush kriterin e mësipërm të nenit 38(3)(a) të Ligjit dhe ZPS-ja nuk kishte detyrim t'i jepte Mustafës hollësi të mëtejshme.

81. Paneli i Apelit gjithashtu rikujton se neni 38(3)(b) i Ligjit kërkon specifikisht që i dyshuari që merret në pyetje nga ZPS-ja të informohet për “të drejtën për të heshtur [...]” dhe se çdo deklaratë që jep “mund të përdoret si provë”. Paneli vëren se Mustafa u informua në mënyrë të ngjashme gjatë intervistës së tij¹⁸⁷ dhe rrjedhimisht gjykon se informacioni që iu dha Mustafës ishte i mjaftueshëm dhe përmbushte kriteret e nenit 38(3)(b) të Ligjit.

82. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit është bindur se deklarata e Mustafës si i dyshuar u mor në përputhje me nenin 38(3)(a) dhe (b) të Ligjit dhe rregullën 43 të Rregullores, që përcaktojnë të drejtat e të dyshuarve para Dhomave të Specializuara. Duke qenë se nuk konstatoi shkelje të Ligjit, Rregullores, apo të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, nuk është e nevojshme që Paneli i Apelit të shqyrtojë elementin e dytë të rregullës 138(2) të Rregullores dhe, rrjedhimisht, rrëzon argumentet e Mustafës në lidhje me pranueshmërinë e deklaratës së tij si i dyshuar.

83. Në lidhje me pretendimin e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në deklaratën e tij si i dyshuar,¹⁸⁸ Paneli i Apelit vëren se Mustafa nuk jep argumente në mbështetje të këtij pretendimi të përgjithshëm.¹⁸⁹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se deklarata e tij si i dyshuar ishte “shumë relevante, autentike dhe

¹⁸⁶ P00111 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 3.

¹⁸⁷ P00111 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 3. Shih gjithashtu P00118 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 32.

¹⁸⁸ Njoftimi për Apel, nënpika 1B, para. 4; Dosja e Apelit, para. 23-24, 26.

¹⁸⁹ Megjithatë, Paneli vëren se Mustafa ngre kundërshtime në lidhje me deklaratën si i dyshuar në nënpikat 2B dhe 2I. Shih Dosjen e Apelit, para. 90, 182-187. Këto kundërshtime, që bazohen në arsye të tjera, trajtohen në ato nënpika. Shih më poshtë paragrafët 190, 276.

konfirmuese e provave të tjera” që lidhen me lëndën.¹⁹⁰ Rrjedhimisht, rrëzohen argumentet e Mustafës në lidhje me këtë aspekt.

84. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 1B të Apelit të Mustafës.

C. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME PRANIMIN SI PROVË DHE MBËSHTETJEN E TRUPIT GJYKUES NË IDENTIFIKIMIN FOTOGRAFIK TË MUSTAFËS NË SALLËN E GJYQIT
(NËNPIKA 1C)

85. Trupi Gjykues pranoi si provë dhe u mbështet në identifikimin fotografik të Mustafës në sallën e gjyqit nga W01679.¹⁹¹ Mustafa e kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykues në këtë identifikim, me pretendimin se identifikimi u bë në mënyrë të parregullt dhe, për rrjedhojë, duhej të ishte përjashtuar në bazë të rregullës 138 të Rregullores.¹⁹² ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykues gaboi që mori parasysh identifikimin e bërë në sallën e gjyqit.¹⁹³

1. Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

86. Mustafa parashtron se Trupi Gjykues gaboi që pranoi si provë identifikimin e Mustafës nga W01679 në sallën e gjyqit, pasi kjo dëshmi nuk ka vlerë provuese dhe duhet të përjashtohet në bazë të rregullës 138 të Rregullores.¹⁹⁴ Konkretisht, Mustafa argumenton se: (i) fotografitë që iu treguan W01679-ës ishin shfaqur në mediat e

¹⁹⁰ Aktgjykimi, para. 236.

¹⁹¹ Aktgjykimi, para. 541.

¹⁹² Dosja e Apelit, para. 27-30; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 41-44. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpikën 1C, para. 4. Paneli thekson se në Njoftimin për Apel, Mustafa përmend paragrafët 404 dhe 541 të Aktgjykimit. Faktikisht, paragrafi 404 ka të bëjë me identifikimin prej W01679-ës të një kryesi tjetër, konkretisht të z. Brahim Mehmetaj (“z Mehmetaj”), dhe jo të Mustafës. Shih Njoftimin për Apel, nënpika 1C, poshtëshënimi 3.

¹⁹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 53-57; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 11-12, 14.

¹⁹⁴ Dosja e Apelit, para. 27-29; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 41-42; Njoftimi për Apel, nënpika 1C, para. 4. Paneli i Apelit thekson se Mustafa i referohet rregullës 138(2) të Rregullores në paragrafin 27(c) të Dosjes së Apelit, kur argumenton se provat duhej të ishin përjashtuar për shkak të mungesës së vlerës provuese, ndërkohë që, në fakt, dispozita relevante në këtë rast është rregulla 138(1) e Rregullores. Paneli i Apelit i vlerësoi argumentet e Mustafës mbi bazën e dispozitës së duhur.

Kosovës dhe në deklaratën hyrëse publike të ZPS-së, duke komprometuar vlerën provuese të dëshmisë identifikuese; dhe (ii) marrja në pyetje e W01679-ës prej Trupit Gjykues në lidhje me fotografitë tregoi anshmëri dhe bëri që dëshmitari të jepte një përgjigje “të sugjeruar”.¹⁹⁵ Mustafa gjithashtu pretendon se si rezultat, identifikimi i bërë në sallën e gjyqit nga W01679 “u pranua si provë në mënyrë të palejueshme” në shkelje të rregullës 139(2) të Rregullores dhe “dëmtoi rëndë integritetin e procesit”.¹⁹⁶ Rrjedhimisht, Mustafa pretendon se Trupi Gjykues gaboi që u mbështet në identifikimin e bërë nga W01679 në sallën e gjyqit, çka e bën të pavlefshëm Aktgjykimin sa i përket identifikimit të tij.¹⁹⁷

87. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës duhet të rrëzohen *in limine*, pasi ai nuk e kundërshtoi identifikimin e bërë në sallën e gjyqit në kohën kur Trupi Gjykues i bëri pyetje W01679-ës, as nuk e hulumtoi këtë aspekt me dëshmitarin gjatë dhënies së dëshmisë.¹⁹⁸ ZPS-ja gjithashtu argumenton se: (i) parashtrimet e Mustafës që pretendojnë shkelje të rregullës 139(2) të Rregullores dhe vlerësim të njëanshëm të parashtrimeve të tij për këtë aspekt, janë të pafaktuara, dalin jashtë kuadrit të Njoftimit për Apel dhe duhet të rrëzohen menjëherë;¹⁹⁹ dhe (ii) pretendimi i Mustafës për shkelje të rregullës 138(2) të Rregullores është hamendësues dhe i pafaktuar, pasi ai nuk e pyeti W01679-ën nëse e kishte parë më herët fotografinë, as nuk paraqiti prova në mbështetje të kundërshtimit të tij.²⁰⁰ Gjithsesi, ZPS-ja parashtron se identifikimi i bërë

¹⁹⁵ Dosja e Apelit, para. 27, 29.

¹⁹⁶ Dosja e Apelit, para. 29; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 43-44. Paneli i Apelit thekson se, ndonëse në paragrafin 29 të Dosjes së Apelit Mustafa i referohet rregullës 139(2) të Rregullores, ai deklaroi se pranimiti si provë i identifikimit të bërë nga W01679 “dëmtoi rëndë integritetin e procesit”, çka në fakt pasqyron formulimin e rregullës 138(2) të Rregullores. Paneli i Apelit i vlerësoi argumentet e Mustafës mbi bazën e dispozitës së duhur.

¹⁹⁷ Dosja e Apelit, para. 30; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 43-44. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 38.

¹⁹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 53.

¹⁹⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 54-55. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 58.

²⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 54, 56.

nga W01679 përmbush kriteret për t'u pranuar si provë dhe shërbeu vetëm për të konfirmuar provat e tjera për identifikimin e Mustafës.²⁰¹

88. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se Trupi Gjykses e vlerësoi saktë identifikimin e Mustafës prej W01679-ës, bazuar në tërësinë e provave sipas rregullës 139(2) të Rregullores.²⁰² Gjithashtu, Mbrojtësja e Viktimave parashtron se gjatë vlerësimit të mbështetshmërisë në dëshminë e W01679-ës, Trupi Gjykses nuk i vuri "theks të veçantë" identifikimit në sallën e gjyqit, as nuk u mbështet në identifikimin e Mustafës nga W01679 në bazë të ndonjë prej fotografive publike.²⁰³

89. Mustafa kundërpërgjigjet se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në identifikimin "pa mëdyshje" të tij nga W01679, ndërkohë që W01679 thjesht kishte deklaruar se personi në fotografi "përngjan me të akuzuarin".²⁰⁴ Mustafa parashtron se ky nuk ishte përfundim që mund të deduktohej logjikisht nga provat dhe se, rrjedhimisht, Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e identifikimit të bërë në sallën e gjyqit dhe që u mbështet në të.²⁰⁵

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

90. Paneli i Apelit fillimisht vëren se gjatë gjykimit Mustafa nuk kundërshtoi pranimin si provë të identifikimit fotografik nga W01679 në sallën e gjyqit, nuk paraqiti kundërshtime në lidhje me të as në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare, as në deklaratat përmbyllëse të tij.²⁰⁶ Gjithashtu, Mustafa nuk demonstroi ekzistencën e rrethanave të veçanta, që do të përligjinin shqyrtim të parashtrimeve të tij.

²⁰¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 57.

²⁰² Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 10-11.

²⁰³ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 12, 14.

²⁰⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 41-42.

²⁰⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 43-44.

²⁰⁶ Paneli i Apelit thekson se, ndonëse pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitari, Mbrojtja përmendi se fotografitë ishin shfaqur publikisht në media, Mustafa nuk kundërshtoi pranimin e tyre si prova, as nuk paraqiti më vonë kundërshtime për pranueshmërinë e tyre. Shih Transkriptin (W01679), 5 tetor 2021, f. 1005, 1014.

Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa ka humbur të drejtën për ta paraqitur këtë pretendim në apel²⁰⁷ dhe rrëzon menjëherë parashtrimet e tij në lidhje me pranueshmërinë e identifikimit sipas rregullës 138 të Rregullores.

91. Sa i takon parashtrimet të Mustafës se Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e identifikimit të bërë në sallën e gjyqit nga W01679 dhe që u mbështet në të,²⁰⁸ Paneli i Apelit vëren se parashtrimet e Mustafës dalin jashtë kuadrit të Njoftimit për Apel, çka përlligj rrëzimin e menjëhershëm të tyre.²⁰⁹ Gjithsesi, Paneli i Apelit vëren se, sipas tij, Trupi Gjykses e peshoi me kujdes mbështetshmërinë në dëshminë e W01679-ës, në kuadër të provave të tjera të përfshira në dokumentacionin e çështjes, dhe e trajtoi me kujdes identifikimin e të akuzuarit prej W01679-ës.²¹⁰ Konkretisht, Trupi Gjykses vlerësoi se, megjithëse W01679 nuk e identifikoi të akuzuarin me emër, por vetëm si “komandant Cali” dhe në atë kohë nuk e njihte, dëshmia e tij përputhej me provat e tjera të paraqitura në gjykim lidhur me pozitën e Mustafës si komandant i vetëm i BIA-s gjatë periudhës përkatëse, si edhe me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të cilët konfirmuan atë që ishte pranuar nga vetë Mustafa – se kishte përdorur nofkën “Cali”.²¹¹ Trupi Gjykses më pas arriti në përfundimin se dëshmia identifikuese e W01679-ës konfirmonte “provat e shumta që tregojnë faktin se komandanti në fjalë

²⁰⁷ Shih më lart, para. 30.

²⁰⁸ Shih Dosjen e Apelit, para. 30; Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 43-44.

²⁰⁹ Njoftimi për Apel, nënpika 1C, para. 4, ku Mustafa kundërshton pranueshmërinë e identifikimit të bërë në sallën e gjyqit dhe parashtron se ai “nuk ka peshë provuese dhe rrjedhimisht, duhet të përjashtohet në bazë të rregullës 138” të Rregullores. Paneli thekson se, në Njoftimin për Apel, Mustafa nuk kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykses në këtë identifikim.

²¹⁰ Paneli i Apelit gjithashtu rikujton se përcaktimi sa peshë do t'i jepet, në rast se do t'i jepet peshë, identifikimit të të akuzuarit nga një dëshmitar, është pjesë e kompetencës diskrecionale të Trupit Gjykses. Shih *Lukić and Lukić Appeal Judgement*, para. 187. Megjithatë, duhet treguar kujdes i veçantë në vlerësimin e dëshmimeve identifikuese të të akuzuarit, në qoftë se identifikimi nga dëshmitari është bërë në rrethana të vështira, si në errësirë, me pamje të penguar, kur dëshmitari është i sëmurë apo pa ndjenja, ose kur dëshmitari e ka parë të akuzuarin vetëm kalimthi. Shih *Popović et al. Appeal Judgement*, para. 382; Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 152-156; *Kupreškić et al. Appeal Judgement*, para. 39-40. Për këtë qëllim, Trupi Gjykses duhet të japë mendim të arsyetuar, ku të artikulojë qartë faktorët në të cilët është mbështetur për pranimin e identifikimit dhe të trajtojë të gjithë faktorët që kanë ndikim negativ në mbështetshmërinë në atë dëshmi. Shih Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 152-156; *Kupreškić et al. Appeal Judgement*, para. 39-40.

²¹¹ Aktgjykimi, para. 340, 541.

ishte i akuzuari".²¹² Në këto rrethana, Paneli i Apelit është i mendimit se Trupi Gjykses nuk i dha rëndësi të tepruar identifikimit fotografik që W01679 i bëri Mustafës në sallën e gjyqit.

92. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se, edhe nëse do të ishin paraqitur në mënyrën e duhur, argumentet e Mustafës nuk demonstrojnë se Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e identifikimit fotografik që W01679 i bëri të akuzuarit në sallën e gjyqit dhe që u mbështet në atë identifikim, dhe rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrezon nënpikën 1C të Apelit të Mustafës.

D. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME VLERËSIMIN DHE MBËSHTETJEN E TRUPIT
GJYKUES NË LISTËN E TË BURGOSURVE (NËNPIKA 1D)

93. Trupi Gjykses u mbështet në Listën e të Burgosurve²¹³ në Aktgjykim.²¹⁴ Mustafa e kundërshton mbështetjen në Listë, me pretendimin se dokumentit i mungojnë treguesit e autenticitetit dhe mbështetshmërisë dhe nuk i mbështet konstatimet e Trupit Gjykses.²¹⁵ ZPS-ja përgjigjet se Mustafa e ka humbur të drejtën për të kundërshtuar pranueshmërinë e kësaj prove materiale sepse nuk e ngriti këtë kundërshtim gjatë gjyqimit dhe se ai nuk ka demonstruar se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në këtë dokument.²¹⁶

1. Parashtrimet e palëve

94. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në Listën e të Burgosurve, së cilës ai pretendon se i mungojnë treguesit e autenticitetit dhe

²¹² Aktgjykimi, para. 542.

²¹³ P00305 (konfidenciale). Lista e të Burgosurve "është një përmbledhje shënimesh me shkrim dore, që përfshihet në një grup më të madh materialesh të marra prej forcave serbe nga baza të ndryshme të UÇK-së në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, të cilat iu dorëzuan TPNJ-së dhe, më pas, Task Forcës Hetimore Speciale, pararendëses së ZPS-së". Shih Aktgjykimin, para. 22.

²¹⁴ Aktgjykimi, para. 225-228. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 389, 394, 396, 400, 403, 413, 424, 433, 436, 465, 475, 490-492, 534.

²¹⁵ Dosja e Apelit, para. 31-32; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 45-46.

²¹⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 59-61.

mbështetshmërisë.²¹⁷ Konkretisht, Mustafa argumenton se: (i) shënimet në lidhje me W01679-ën, W03593-shin dhe W03594-ën mund të ishin manipuluar; (ii) për vlerësimin e autenticitetit të dokumentit dhe të mbështetshmërisë në të nevojitej dëshmi eksperti, e cila nuk u paraqit në gjykim; (iii) Lista e të Burgosurve nuk mbështet konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me vendndodhjen e të ndaluarve dhe praninë e tyre në kompleksin e ndalimit në Zllash; (iv) shënimi “për Calin” në dokument nuk mbështet konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me praninë e Mustafës në kompleksin e ndalimit; dhe (v) treguesit e autenticitetit të (a) prejardhjes (b) autorësisë ose burimit, dhe (c) kronologjisë së mbajtjes në ruajtje, nuk janë vërtetuar.²¹⁸ Rrjedhimisht, Mustafa pretendon se këto gabime e bëjnë të pavlefshëm Aktgjykimin sa i përket kësaj prove dhe “komprometojnë faktet” e konstatuara përmes saj dhe në lidhje me të.²¹⁹ Mustafa gjithashtu parashtron se ka përfundime të tjera të logjikshme që mund të nxirren nga ajo provë.²²⁰

95. ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk e kundërshtoi pranimin si provë të Listës së të Burgosurve në gjykim dhe paraqiti “parashtrime të paqarta” vetëm në deklaratat përmbyllëse, në të cilat nuk i trajtoi pretendimet për “shënime të manipuluar”, “nevojën për dëshmi nga një ekspert”, apo shënimin e “nofkës së Mustafës në listë”.²²¹ Rrjedhimisht, ZPS-ja argumenton se Mustafa ka humbur të drejtën për t’i ngritur këto pretendime në apel dhe ato duhet të rrëzohen.²²² Gjithsesi, ZPS-ja argumenton se parashtrimet e Mustafës thjesht tregojnë mospajtim me vlerësimin e provave nga Trupi Gjykses, dhe se Mustafa nuk specifikon se cilat konstatime konkrete do të bëheshin të pavlefshme nga gabimi, që do të çonte në një përfundim të ndryshëm.²²³

²¹⁷ Dosja e Apelit, para. 31; Njoftimi për Apel, nënpika 1D, para. 4; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 45.

²¹⁸ Dosja e Apelit, para. 31; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 45-46. Shih gjithashtu Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 139.

²¹⁹ Dosja e Apelit, para. 32.

²²⁰ Dosja e Apelit, para. 32.

²²¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 59.

²²² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 59.

²²³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 60-61.

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

96. Paneli i Apelit rikujton se më 4 shkurt 2022, ZPS-ja, në bazë të nenit 37 të Ligjit, paraqiti për pranim materialet e mbledhura para themelimit të Dhomave të Specializuara, ku përfshihej edhe Lista e të Burgosurve.²²⁴

97. Më 29 mars 2022, Trupi Gjykses lëshoi vendimin mbi vlerësimin e pranueshmërisë, ndër të tjera, të Listës së të Burgosurve, dhe e pranoi atë dokument si provë.²²⁵

98. Paneli i Apelit vëren se, edhe pse Mustafa tani e kundërshton autenticitetin e Listës së të Burgosurve dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në të, ai nuk e kundërshtoi pranimin e saj si provë gjatë gjykimit, ndonëse i kishte të gjitha mundësitë ta bënte këtë. Konkretisht, Paneli i Apelit vëren se: (i) Mustafa nuk parashtrroi përgjigje ndaj kërkesës së ZPS-së për pranimin e dokumentit, as e kundërshtoi vendimin e Trupit Gjykses për pranimin e tij;²²⁶ dhe (ii) nuk e kundërshtoi autenticitetin e dokumentit në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare apo në deklaratat përmbyllëse të tij.²²⁷ Mustafa thjesht iu referua Listës së të Burgosurve gjatë deklaratave përmbyllëse për të kundërshtuar argumentet e ZPS-së, duke vënë në dukje mospërputhjet ndërmjet datave në Listën e të Burgosurve dhe përshkrimit të ngjarjeve nga ZPS-ja,²²⁸ dhe përmendi kalimthi mundësinë që Lista e të Burgosurve mund të mos ishte “e saktë” dhe, për rrjedhojë, nuk kishte vlerë provuese.²²⁹ Sipas Panelit, deklarata të tilla të

²²⁴ Kërkesa e ZPS-së në bazë të Nenit 37; Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së sipas Nenit 37.

²²⁵ Vendimi mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04484, W04485 dhe W04849 dhe Materialet e Nenit 37, para. 21-23, 25; Shtojca 1 e Vendimit mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04484, W04485 dhe W04849 dhe Materialet e Nenit 37, f. 3.

²²⁶ Vendimi mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04484, W04485 dhe W04849 dhe Materialet e Nenit 37, para. 7, 23.

²²⁷ Ndonëse Mustafa e trajtoi aspektin e vlerës provuese të Listës së të Burgosurve gjatë deklaratave përmbyllëse, ai nuk e kundërshtoi specifikisht autenticitetin e dokumentit. Shih Transkriptin, 14 shtator 2022, f. 4711-4713.

²²⁸ Transkripti, 14 shtator 2022, f. 4710, 4712; Transkripti, 15 shtator 2022, f. 4839.

²²⁹ Transkripti, 14 shtator 2022, f. 4713: “Në qoftë se dokumenti që quhet lista e të burgosurve është i saktë, atëherë nuk është data 4. Sipas atij dokumenti, është data 2 prill. Mbase dëshmitari ka të drejtë.

përgjithshme nuk përbëjnë kundërshtim ndaj provave dhe, në mungesë të një kundërshtimi formal, Mustafa në parim e ka humbur të drejtën për ta ngritur këtë pretendim në apel.²³⁰ Sidoqoftë, Paneli i Apelit vendos të bëjë përjashtim e t'i shqyrtojë argumentet e Mustafës për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.

99. Paneli i Apelit vëren diskrecionin e gjerë që ka Trupi Gjykses në përcaktimin e autenticitetit të një dokumenti.²³¹ Në këtë aspekt, Paneli i Apelit rikujton se pranimi i një prove nuk kërkon vërtetim absolut të autenticitetit të saj, por është vetëm një faktor që Trupi Gjykses e merr parasysh gjatë përcaktimit të peshës që duhet t'i jepet asaj prove.²³²

100. Paneli i Apelit së pari do të shqyrtojë argumentet e Mustafës se gjatë vlerësimit të Listës së të Burgosurve, Trupi Gjykses nuk mori parasysh treguesit e autenticitetit të (i) prejardhjes (ii) autorësisë ose burimit, dhe (iii) kronologjisë së mbajtjes në ruajtje, dhe se shënimet në dokument mund të ishin manipuluar.²³³ Në lidhje me këtë Paneli vëren se, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës, Trupi Gjykses mori parasysh prejardhjen e dokumentit dhe kronologjinë e raportuar të mbajtjes në ruajtje të Listës së të Burgosurve, duke vënë në dukje se dokumenti “është një përmbledhje shënimesh me shkrim dore, që përfshihet në një grup më të madh materialesh të marra prej forcave serbe nga baza të ndryshme të UÇK-së në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, të

Përfundimi është se lista e të burgosurve nuk është e saktë dhe nuk ka vlerë provuese dhe nuk konfirmon asgjë në atë drejtim”.

²³⁰ Shih më lart, para. 30.

²³¹ *Halilović Appeal Judgement*, para. 39; *Delalić et al. Appeal Judgement*, para. 533.

²³² *Prlić et al. Appeal Decision on Admission of Documentary Evidence*, para. 34-35, ku citohet *Popović et al. Decision on Defence Appeal Concerning Expert Witness*, para. 22, dhe *Delalić et al. Decision on Leave to Appeal Decision for Admissibility of Evidence*, para. 20.

²³³ Dosja e Apelit, para. 31(a), (h).

cilat iu dorëzuan TPNJ-së dhe, më pas, Task Forcës Hetimore Speciale, pararendëses së ZPS-së”.²³⁴

101. Sa i takon autorësisë ose burimit, Trupi Gjykses konstatoi se, ndonëse Listës së të Burgosurve i mungonin treguesit e autorësisë, si nënshkrimi, stema ose koha e përpilimit, dokumenti përmbante “hollësi të shumta që të bëjnë të besosh në autenticitetin dhe mbështetshmërinë në të”.²³⁵ Konkretisht, Trupi Gjykses konstatoi se në dokument evidentoheshin saktë të dhënat personale dhe data e arrestimit të W01679-ës, W03593-shit, W03594-ës, viktimës së vrasjes së paligjshme dhe të ndaluarve të tjerë, dhe se përmbajtja e dokumentit konfirmonte dëshmitë e disa dëshmitarëve dhe prova të tjera dokumentare në lidhje me praninë e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash.²³⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se Lista e të Burgosurve përmbante shënimin “për Calin”, që, sikurse u konstatua, ishte nofka e Mustafës në periudhën që lidhet me akuzat, siç e pranoi edhe vetë z. Mustafa dhe siç është konfirmuar nga burime të tjera të shumta.²³⁷ Trupi Gjykses arriti në përfundimin se “shënimet për të dhënat personale të të burgosurve dhe për hollësitë e marrjes në pyetje të tyre mund të jenë bërë vetëm nga persona me dijeni për statusin e këtyre viktimave si të ndaluar” dhe, rrjedhimisht, konstatoi se Lista e të Burgosurve është “dokument i asaj kohe” dhe se është tejet e pagjasë që të jetë falsifikuar, apo edhe ndryshuar, pas ngjarjeve.²³⁸

102. Paneli i Apelit nuk sheh gabim në konstatimin e Trupit Gjykses, i cili pranon mungesën e disa veçorive treguese të autenticitetit të një dokumenti, por megjithatë konstaton elemente të mjaftueshme autenticiteti që mbështesin përfundimin se është dokument i mbështetshëm. Gjithashtu, Mustafa nuk jep argumente për pretendimin

²³⁴ Aktgjykimi, para. 225, që i referohet Njoftimit të ZPS-së për Nxjerrjen e Materialit sipas Rregullës 102, para. 2-3. Shih gjithashtu Vendimin mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04484, W04485 dhe W04849 dhe Materialet e Nenit 37, para. 21-23, 25(d).

²³⁵ Aktgjykimi, para. 226.

²³⁶ Aktgjykimi, para. 226.

²³⁷ Aktgjykimi, para. 226. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 340, 541, 551-552.

²³⁸ Aktgjykimi, para. 227.

e tij se, për shkak të këtyre mangësive, Trupi Gjykses nuk duhej të ishte bazuar në këtë dokument. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës në lidhje me vlerësimin e autenticitetit të Listës së të Burgosurve nga Trupi Gjykses.

103. Sa i takon parashtrimin të Mustafës se për vlerësimin e autenticitetit dhe mbështetshmërisë në Listën e të Burgosurve nevojitej dëshmia e një eksperti,²³⁹ Paneli i Apelit rikujton se qëllimi i dëshmisë së ekspertit është që të ofrojë njohuri të specializuara të cilat mund ta ndihmojnë gjyksesin e fakteve të kuptojë provat e paraqitura.²⁴⁰ Në veçanti, dëshmia e ekspertit nuk duhet të uzurpojë funksionet e panelit si gjykses përfundimtar i fakteve dhe ligjit.²⁴¹ Sipas mendimit të Panelit të Apelit, vlerësimi i autenticitetit dhe i mbështetshmërisë në një dokument përfshihet në kuadrin e përgjegjësive të Trupit Gjykses dhe për të nuk kërkohet dëshmia e ekspertit kur Trupi Gjykses, si në rastin aktual, është i aftë të marrë vendim mbi bazën e njohurive dhe ekspertizës së vet. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës në lidhje me këtë aspekt.

104. Mustafa gjithashtu pretendon se Lista e të Burgosurve nuk mbështet konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me praninë dhe vendndodhjen e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe praninë e Mustafës në atë kompleks gjatë periudhës përkatëse.²⁴² Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit fillimisht vëren se, kur konstatoi se provat vërtetonin praninë e të akuzuarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, Trupi Gjykses nuk u mbështet në Listën e të Burgosurve, por në dëshmitë identifikuese të dëshmitarëve dhe në dëshmi të tjera - ndër to dhe deklaratat pranuese të vetë Mustafës - që vërtetojnë rolin e tij në BIA dhe përdorimin e nofkës "Cali" prej

²³⁹ Dosja e Apelit, para. 31(b). Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 45.

²⁴⁰ Vendimi i Apelit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 28. Shih gjithashtu *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 375; *Nahimana et al.* Appeal Judgement, para. 198.

²⁴¹ Vendimi i Apelit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 26. Shih gjithashtu *Ntaganda* Decision on Expert Witnesses, para. 8; *Ruto et al.* Decision on Expert Report, para. 12.

²⁴² Dosja e Apelit, para. 31(c)-(g); Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 46.

tij.²⁴³ Në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykues mbi praninë e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash, Paneli i Apelit vëren se Mustafa shpërfill prova të tjera të konsiderueshme për këtë aspekt dhe vë në dukje gjithashtu se në konstatimet e veta, Trupi Gjykues u mbështet në Listën e të Burgosurve thjesht si material konfirmues i atyre provave të tjera.²⁴⁴ Së fundi, Mustafa nuk demonstroi se si gabimi i pretenduar në konstatimet e Trupit Gjykues do të çonte në një përfundim të ndryshëm. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës në lidhje me këtë aspekt.

105. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se, edhe sikur të ishin paraqitur në mënyrën e duhur, parashtrimet e Mustafës nuk demonstrojnë gabim në vlerësimin dhe mbështetjen e Trupit Gjykues në Listën e të Burgosurve dhe, rrjedhimisht, rrëzon nënpikën 1D të Apelit të Mustafës.

E. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME PRANIMIN SI PROVA DHE MBËSHTETJEN E TRUPIT GJYKUES NË DEKLARATAT ME SHKRIM TË W04648-ËS DHE W04712-SHIT DHE NË “DEKLARATËN GOJORE” TË [REDAKTUAR] (NËNPIKA 1E)

106. Trupi Gjykues pranoi si prova dhe u mbështet në deklaratat me shkrim të W04648-ës dhe W04712-shit, përkatësisht në bazë të rregullave 155(1) dhe 153(1) të Rregullores²⁴⁵, si edhe në deklaratat e [REDAKTUAR], që u paraqitën si dëshmi të dorës së dytë gjatë dëshmisë nga W04390.²⁴⁶ Mustafa kundërshton vlerën provuese të

²⁴³ Shih p.sh. Aktgjykimin, para. 341, 349, 352, 468-473, 541-542, 545, 551-554, 556.

²⁴⁴ Shih Aktgjykimin, para. 226, 389, 394, 397, 400, 413, 424, 436, 465, 475, 490-492.

²⁴⁵ Aktgjykimi, para. 91, 99. Shih gjithashtu Vendimin mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 155, para. 16(b) ku pranohet si provë, ndër të tjera, P00001 (W04648) (konfidenciale); Vendimin mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 153, para. 37(b) ku, ndër të tjera, pranohen si prova P00013 (W04712) (konfidenciale) dhe P00014 (W04712) (konfidenciale).

²⁴⁶ Aktgjykimi, para. 461, që i referohet Transkriptit (W04390), 24 nëntor 2021, f. 1861-1865 (redaktuar).

deklaratave,²⁴⁷ ndërsa ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk ka demonstruar se Trupi Gjykses gaboi që i mori parasysh këto deklarata.²⁴⁸

1. Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

107. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që pranoi si prova dhe u mbështet në deklaratat me shkrim të W04648-ës dhe W04712-shit dhe në “deklaratën gojore” të [REDAKTUAR].²⁴⁹ Mustafa pretendon se deklaratat e dëshmitarëve nuk kanë vlerë provuese dhe se duhej të ishin përjashtuar ose të mos u jepej asnjë peshë.²⁵⁰ Në mbështetje të këtyre pretendimeve, Mustafa argumenton se këta dëshmitarë nuk i panë personalisht ngjarjet që pretendohet se ndodhën në kompleksin e ndalimit ose ato para vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.²⁵¹ Mustafa gjithashtu parashtron se W04648 tani nuk është gjallë dhe, për pasojë, deklarata e tij nuk mund të verifikohet.²⁵² Rrjedhimisht, Mustafa pretendon se mbështetja e Trupit Gjykses në këto deklarata e bën të pavlefshëm Aktgjykimin sa i përket shkakut ose rrethanave të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.²⁵³

108. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës nuk arrijnë të vërtetojnë ndonjë gabim dhe rrjedhimisht duhet të rrëzohen.²⁵⁴ ZPS-ja argumenton se Mustafa nuk i mbështet me fakte pretendimet e tij se deklarata e W04648-ës nuk mund të verifikohet dhe se deklarata e W04712-shit nuk është relevante dhe pretendimi i tij që

²⁴⁷ Dosja e Apelit, para. 34, 36-39.

²⁴⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 63; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 18, 20.

²⁴⁹ Dosja e Apelit, para. 33-39; Njoftimi për Apel, nënpika 1E, para. 4; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 48-51.

²⁵⁰ Dosja e Apelit, para. 34, 36-38; Njoftimi për Apel, para. 4.

²⁵¹ Dosja e Apelit, para. 37-38; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 48-49.

²⁵² Dosja e Apelit, para. 35. Paneli i Apelit vëren se, në Dosjen e Apelit, Mustafa i referohet gabim W04712-shit si dëshmitar që ka ndërruar jetë, kur në fakt duhej t'i ishte referuar W04648-ës, deklarata e të cilit u pranua si provë në bazë të rregullës 155 të Rregullores. Sidoqoftë, Paneli i Apelit vëren se në Dosjen e Kundërpërgjigjes, Mustafa e pranon gabimin e bërë në Dosjen e Apelit. Shih Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 47, 121. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së Viktimave, para. 16-17.

²⁵³ Dosja e Apelit, para. 39.

²⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 63-65.

[REDAKTUAR] është i gabuar, pasi [REDAKTUAR].²⁵⁵ ZPS-ja gjithashtu argumenton se: (i) Mustafa nuk e kundërshtoi pranimin si provë të deklaratës me shkrim të W04648-ës; (ii) parashtrimet e tij në lidhje me deklaratën e W04712-shit gjatë gjykimit nuk janë të njëjta me parashtrimet e tij në apel; dhe (iii) ai nuk i trajtoi deklaratat me shkrim as në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare dhe as në deklaratat përmbyllëse.²⁵⁶ Si rezultat, ZPS-ja parashtron se Mustafa e ka humbur të drejtën për apel kundër pranimin të tyre si prova dhe mbështetjes së Trupit Gjyqësor në to.²⁵⁷ Gjithsesi, ZPS-ja parashtron se Mustafa nuk ka vërtetuar se si mund ta ndryshonin rezultatin e gjykimit këto gabime të pretenduara.²⁵⁸

109. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se Trupi Gjyqësor i shqyrtoi siç duhej të gjithë faktorët e duhur kur pranoi si provë deklaratën me shkrim të W04712-shit, në kuadër të ushtrimit të diskrecionit sipas rregullës 153(1) të Rregullores.²⁵⁹ Mbrojtësja e Viktimave parashtron se, ndonëse Mustafa e kundërshtoi pranimin si provë të deklaratës, ai nuk demonstroi se në atë deklaratë nuk mund të mbështetesh, as që efekti dëmtues i deklaratës e zhbënte vlerën provuese të saj.²⁶⁰ Në lidhje me peshën që iu dha deklaratës me shkrim të W04712-shit, Mbrojtësja e Viktimave argumenton se Trupi Gjyqësor bëri shqyrtim të saktë të deklaratës, së bashku me deklarata të tjera konfirmuese të dëshmitarëve, vetëm për vërtetimin e “atmosferës së frikës dhe frikësimit” të përjetuar nga dëshmitarët.²⁶¹

110. Në kundërpërgjigje, Mustafa parashtron se Trupi Gjyqësor gaboi që u mbështet në deklaratën e shkruar nga vetë W04648, në deklaratën që W04712-shi i dha ZPS-së dhe në “deklaratën gojore” të [REDAKTUAR], sepse deklaratat e tyre nuk janë të

²⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. [REDAKTUAR].

²⁵⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 62.

²⁵⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 62.

²⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 64.

²⁵⁹ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 18.

²⁶⁰ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 19.

²⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 20.

besueshme dhe asnjëri prej tyre nuk u mor në pyetje nga Mbrojtja, as nuk u zbatua për ta ndonjë “standard i ngjashëm”.²⁶² Së fundi, si sqarim për parashtrimin në Dosjen e Apelit, Mustafa argumenton se ndonëse [REDAKTUAR] ishte [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] nuk ishte [REDAKTUAR].²⁶³

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

(a) W04648

111. Paneli i Apelit rikujton se më 13 shtator 2021, ZPS-ja bëri kërkesë për pranimin e deklaratave të mëparshme të W04648-ës dhe të dokumenteve shoqëruese të tyre, në bazë të rregullës 155(1) të Rregullores.²⁶⁴

112. Më 15 tetor 2021, Trupi Gjykses lëshoi një vendim për vlerësimin e pranueshmërisë së deklaratave me shkrim të W04648-ës si prova, dhe i pranoi deklaratat.²⁶⁵

113. Paneli i Apelit vëren se, ndonëse tani Mustafa kundërshton pranimin si provë të deklaratës me shkrim të W04648-ës nga Trupi Gjykses, këtë aspekt ai e ngre për herë të parë në apel, ndërkohë që pati mundësi të shumta ta bënte këtë në shkallën e parë. Konkretisht, Paneli vë në dukje se: (i) Mustafa nuk iu përgjigj kërkesës së ZPS-së për pranimin e deklaratave të mëparshme të W04648-ës dhe dokumenteve në lidhje me to;²⁶⁶ dhe (ii) nuk paraqiti kundërshtim për deklaratën me shkrim të W04648-ës, as në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare, as gjatë deklaratave përmbyllëse. Për këto arsye, Paneli i Apelit gjykon se Mustafa e ka humbur të drejtën për ta ngritur këtë pretendim në apel.²⁶⁷ Gjithashtu, Mustafa nuk ka demonstruar ekzistencën e rrethanave të veçanta që përlligjin shqyrtimin e parashtrimeve të tij. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit

²⁶² Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 50.

²⁶³ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 48. Paneli i Apelit vëren parashtrimin e bërë më parë nga Mustafa në Dosjen e Apelit se [REDAKTUAR]. Shih Dosjen e Apelit, para. 38.

²⁶⁴ Kërkesa e ZPS-së sipas Rregullës 155.

²⁶⁵ Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 155, para. 16(b).

²⁶⁶ Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 155, para. 4.

²⁶⁷ Shih më lart, para. 30.

rrëzon parashtrimet e Mustafës në lidhje me pranueshmërinë e deklaratës me shkrim të W04648-ës.

114. Në lidhje me argumentin e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në deklaratën me shkrim të W04648-ës, pasi ishte “e shkruar vetë” (ose “e bërë vetë”) e për të nuk u bënë pyetje nga pala jothirrëse dhe për këtë arsye, nuk i duhej dhënë peshë,²⁶⁸ Paneli i Apelit fillimisht vëren se Trupi Gjykses pranoi si prova disa deklarata të W04648-ës të marra në kuadër të një [REDAKTUAR], ndër të cilat edhe një “deklaratë pa datë dhe pa nënshkrim”.²⁶⁹ Paneli i Apelit vëren gjithashtu se Mustafa, as i mbështet argumentet me referenca të sakta në paragrafët përkatës të Aktgjykimit, as jep numrin e regjistrimit të provës (ERN) të deklaratës së kundërshtuar. Në parim, këto mangësi përlligjin rrëzimin e menjëhershëm të parashtrimeve të Mustafës.²⁷⁰ Sidoqoftë, ndonëse Mustafa nuk saktëson se cilës deklaratë i referohet, bazuar në përshkrimin “e bërë vetë” dhe faktin se deklaratat e tjera të W04648-ës ishin regjistruar në formularë zyrtarë [REDAKTUAR] ose [REDAKTUAR], ose nga hetues [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], Paneli i Apelit arrin në përfundimin se Mustafa e ka fjalën për “deklaratën pa datë dhe pa nënshkrim”.²⁷¹

115. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses e vlerësoi me kujdes mbështetshmërinë në deklaratat me shkrim të W04648-ës, duke vënë në dukje mospërputhjet në deklaratat e ndryshme “përfshirë, ndër të tjera, një numër deklaratash [REDAKTUAR] dhe një deklaratë pa datë dhe pa nënshkrim”.²⁷² Në veçanti, Trupi Gjykses vuri në dukje “mospërputhjet e dukshme lidhur me datat dhe

²⁶⁸ Dosja e Apelit, para. 34, 36, 39; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 47, 50-51.

²⁶⁹ Shih Vendimin mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 155, para. 16(b); Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 155; Aktgjykimin, para. 97.

²⁷⁰ Shih më lart, para. 29.

²⁷¹ Shih Aktgjykimin, para. 97, që i referohet P00001 (konfidenciale), f. 7-11; P00009 (konfidenciale), f. 2-3.

²⁷² Aktgjykimi, para. 97.

personat e pranishëm gjatë disa takimeve të caktuara”.²⁷³ Ndonëse konstatoi se këto mospërputhje nuk ndikuan në besueshmërinë e përgjithshme të W04648-ës, Trupi Gjykses më pas vuri në dukje shprehimisht se për shkak të këtyre mospërputhjeve, nuk ishte mbështetur në asnjë pjesë të deklaratës pa datë dhe pa nënshkrim të W04648-ës.²⁷⁴ Bazuar në këto konstatime, Paneli i Apelit rrëzon argumentet e Mustafës me të cilat ai kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykses në deklaratën “e bërë vetë” të W04648-ës.

116. Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se W04648 ishte i besueshëm dhe se mund të mbështetej në dëshminë e tij.²⁷⁵ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës të paraqitura në nënpikën 1E të Apelit lidhur me vlerësimin që Trupi Gjykses i bëri deklaratës me shkrim të W04648-ës.

(b) W04712

117. Paneli i Apelit rikujton se, në bazë të rregullës 153 të Rregullores, dhe në varësi të rregullës 155 të Rregullores, Trupi Gjykses mund të pranojë deklaratat me shkrim të dëshmitarit, ose transkriptin e dëshmisë dhe provat materiale shoqëruese të dhëna nga dëshmitari në procese gjyqësore në Dhomat e Specializuara, nëse ato janë për vërtetimin e një aspekti tjetër dhe jo për veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit për të cilat akuzohet në Aktakuzë.

118. Paneli i Apelit vëren se, më 19 nëntor 2021, ZPS-ja kërkoi pranimin si provë të deklaratave të mëparshme të W04712-shit në bazë të rregullës 153(1) të Rregullores.²⁷⁶ Në përgjigjen ndaj kërkesës, Mustafa kundërshtoi pranueshmërinë e deklaratave për arsye se: (i) deklaratat nuk janë thjesht konfirmuese, pasi dëshmitë e dhëna nga

²⁷³ Aktgjykimi, para. 97.

²⁷⁴ Aktgjykimi, para. 97-98.

²⁷⁵ Aktgjykimi, para. 91-99.

²⁷⁶ Kërkesa e ZPS-së sipas Rregullës 153.

dëshmitarët e tjerë për të njëjtat aspekte janë shumë të ndryshme; (ii) deklaratat përbëjnë prova të qenësishme që ndikojnë në dënimin që mund të jepet; dhe (iii) ai nuk është në gjendje të verifikojë vërtetësinë e deklaratave nëpërmjet pyetjeve për dëshmitarin.²⁷⁷

119. Paneli i Apelit gjithashtu vëren se, më 17 dhjetor 2021, Trupi Gjykses lëshoi vendim mbi kërkesën e ZPS-së dhe pranoi si prova deklaratat me shkrim të W04712-shit dhe provat materiale në lidhje me to.²⁷⁸ Në vlerësimin e pranueshmërisë së tyre, Trupi Gjykses së pari gjykoi se deklarata e W04712-shit “ofron vetëm prova për krimet dhe nuk përmend apo jep informacion lidhur me të akuzuarin, rolin apo përfshirjen e tij në krimet për të cilat janë ngritur akuzat” dhe, rrjedhimisht, “shërben për të vërtetuar aspekte të tjera, jo për veprimet dhe sjellje të të akuzuarit”.²⁷⁹ Trupi Gjykses gjithashtu vuri në dukje se, ndonëse deklarata e W04712-shit vërtet “lidhet me faktorët që duhen marrë parasysh në përcaktimin e dënimit, nëse do të jepet dënim, siç është pesha e veprave penale” në bazë të rregullës 153(1)(a)(vii) të Rregullores, “ky faktor është më tepër argument në favor të pranimit të këtyre provave, sesa kundër [tij]”.²⁸⁰ Trupi Gjykses gjithashtu gjykoi se deklarata e W04712-shit u plotësua dhe konfirmua nga dëshmitë e tetë dëshmitarëve të tjerë në sallën e gjyqit²⁸¹ dhe nga dëshmitë në deklaratat me shkrim të W04648-ës dhe se Mustafës iu dha mundësia t’u bënte pyetje dëshmitarëve të ndryshëm për të njëjtat aspekte që përmbante deklarata e W04712-shit.²⁸² Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit është i

²⁷⁷ Përgjigja e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së ZPS-së sipas Rregullës 153, para. 14-16.

²⁷⁸ Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 153, para. 37(b).

²⁷⁹ Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 153, para. 24. Konkretisht, Trupi Gjykses vuri në dukje se deklarata e W04712-shit jepte informacion në lidhje me: (i) arrestimin e [REDAKTUAR], nga persona të tjerë e jo nga i akuzuari; (ii) identifikimin e ushtarëve të UÇK-së që kryen arrestimin; (iii) përpjekjet e [REDAKTUAR] për ta gjetur [REDAKTUAR] pas arrestimit; (iv) një vizitë nga [REDAKTUAR]; dhe (v) zhvarrosjen e [REDAKTUAR].

²⁸⁰ Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 153, para. 26.

²⁸¹ Konkretisht [REDAKTUAR].

²⁸² Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së sipas Rregullës 153, para. 25, 27.

mendimit se pranimi si provë i deklaratës me shkrim të W04712-shit ishte plotësisht brenda kuadrit të ushtrimit të diskrecionit të Trupit Gjykses.

120. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykses gaboi që e pranoi si provë deklaratën e W04712-shit dhe, rrjedhimisht, rrezon parashtrimet e tij në lidhje me këtë aspekt.

121. Në lidhje me argumentin e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në deklaratën me shkrim të W04712-shit, Mustafa parashtron se deklarata e W04712-shit: (i) nuk është relevante, pasi ai nuk i pa personalisht ngjarjet në kompleksin e ndalimit që lidheshin me shkakun ose rrethanat e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme;²⁸³ dhe (ii) nuk është e besueshme, pasi atij nuk iu bënë pyetje nga Mbrojtja.²⁸⁴ Paneli i Apelit fillimisht vëren se Trupi Gjykses bëri vlerësim të kujdesshëm të besueshmërisë së W04712-shit dhe mbështetshmërisë në deklaratën me shkrim të tij²⁸⁵ dhe mbajti parasysh praninë ose mungesën e faktorëve që ndikojnë në besueshmërinë e tij²⁸⁶ si edhe mospërputhjet midis deklaratës së tij dhe dëshmimeve të dëshmitarëve të tjerë.²⁸⁷ Ndonëse vuri në dukje se këto mospërputhje nuk cenuan besueshmërinë e përgjithshme të W04712-shit, në konstatimet faktike të tij²⁸⁸ Trupi Gjykses i mori parasysh mospërputhjet përkatëse dhe u mbështet në deklaratën e W04712-shit vetëm për aq sa ajo u konfirmua nga dëshmi të tjera të besueshme dhe të mbështetshme.²⁸⁹

²⁸³ Dosja e Apelit, para. 37.

²⁸⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 50.

²⁸⁵ Aktgjykimi, para. 40, 91-99. Paneli thekson se, ndonëse Mustafa kundërshton specifikisht deklaratën me shkrim të vetë W04712-shit, Trupi Gjykses e vlerësoi deklaratën e W04712-shit në kontekstin e tërësisë së deklaratave të [REDAKTUAR].

²⁸⁶ Aktgjykimi, para. 35, 93-95.

²⁸⁷ Aktgjykimi, para. 36, 96.

²⁸⁸ Shih p.sh. Aktgjykimin, para. 608 (ku përmenden dëshmitë e ndryshme lidhur me [REDAKTUAR]), 613 (ku përmenden dëshmitë e ndryshme lidhur me [REDAKTUAR]). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 37.

²⁸⁹ Shih p.sh. Aktgjykimin, para. 37, 606-609, 612-613.

122. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk demonstroi se Trupi Gjyqësor gaboi që konstatoi se W04712 ishte i besueshëm dhe se mund të mbështetej në dëshminë e tij.²⁹⁰ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës në lidhje me mbështetjen e Trupit Gjyqësor në deklaratën me shkrim të W04712-shit.

(c) [REDAKTUAR]

123. Paneli i Apelit fillimisht vëren se “deklarata gojore” e [REDAKTUAR] që kundërshtohet, përbëhet nga deklaratime të dorës së dytë lidhur me rrethanat e arrestimit të viktimës së vrasjes së paligjshme, për të cilat W04390 dëshmoi në gjykatë.²⁹¹ Paneli i Apelit gjithashtu vëren se, sipas W04390-s, [REDAKTUAR], siç pranon edhe Mustafa në parashtrimet e tij.²⁹²

124. Paneli i Apelit vëren se Mustafa i ngre për herë të parë në apel kundërshtimet ndaj deklaratimeve të dorës së dytë, ndonëse pati mundësi të arsyeshme për ta bërë këtë në shkallën e parë. Konkretisht, Paneli i Apelit vëren se Mustafa nuk i kundërshtoi deklaratimet e dorës së dytë gjatë kohës kur dha dëshmi W04390, as nuk kundërshtoi pranimin e tyre si prova në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare apo në deklaratat përmbyllëse të tij, çka në parim përlligj rrëzimin e menjëhershëm të parashtrimeve të tij.²⁹³ Megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat në cilat dolën këto deklaratime dhe llojin dhe përmbajtjen e provave që lidhen me të drejtën për gjykim të drejtë dhe, pavarësisht se Mustafa nuk i kundërshtoi ato kur pati mundësi të arsyeshme për ta bërë, Paneli i Apelit do të bëjë përjashtim dhe do t'i trajtojë parashtrimet e tij për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.

²⁹⁰ Aktgjykimi, para. 99.

²⁹¹ Shih Aktgjykimin, para. 461.

²⁹² Aktgjykimi, para. 461; [REDAKTUAR].

²⁹³ Shih më lart, para. 30.

125. Fillimisht, Paneli i Apelit vëren se, në vlerësimin e vet, Trupi Gjykses shqyrtoi me kujdes dëshmitë e dorës së dytë “për të minimizuar dëmin që mund t’i shkaktohej të akuzuarit nga pamundësia e ballafaqimit me burimin parësor të informacionit”.²⁹⁴ Në lidhje me [REDAKTUAR], Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses i përmendi vetëm një herë deklaratimet e [REDAKTUAR] dorës së dytë dhe vuri në dukje se “gjithashtu, W04390 dha dëshmi të dorës së dytë që konfirmon dëshminë e W04391-shit, pasi [REDAKTUAR] mësoi rrethanat e arrestimit të viktimës së vrasjes së paligjshme nga [REDAKTUAR].²⁹⁵ Sipas Panelit të Apelit, Trupi Gjykses nuk u dha peshë të tepruar deklaratimeve të dorës së dytë të [REDAKTUAR], të paraqitura gjatë dëshmisë së W04390-s, por u mbështet në to si konfirmim i dëshmive të tjera gojore në gjykim.²⁹⁶ Për më tepër, si W04390, ashtu edhe W04391, dhanë dëshmi në gjykatë dhe u morën në pyetje nga Mbrojtja.²⁹⁷ Rrjedhimisht, Mustafës nuk iu shkaktua padrejtësi nga pranimi i deklaratimeve.

126. Paneli i Apelit rikujton se, kur kundërshton mbështetjen e trupit gjykses në dëshmi të dorës së dytë, apeluasi duhet të demonstrojë se asnjë gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do t’i kishte marrë parasysh dëshmitë e dorës së dytë, ose se vlerësimi i provave nga trupi gjykses është tërësisht i gabuar,²⁹⁸ gjë që Mustafa nuk e ka bërë. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës në lidhje me pranimin si provë prej Trupit Gjykses të “deklaratës gojore” të [REDAKTUAR] dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në të.

²⁹⁴ Aktgjykimi, para. 44.

²⁹⁵ Aktgjykimi, para. 461.

²⁹⁶ Paneli rikujton se dëshmitë e dorës së dytë në përgjithësi janë të pranueshme, por pesha dhe vlera provuese që u jepet, nëse do t’u jepet, duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke marrë parasysh edhe sa mundësi pati Mbrojtja për t’i verifikuar dhe kundërshtuar provat. Shih *Aleksovski* Appeal Decision on Admissibility, para. 15; *Bemba et al.* Appeal Judgment, para. 874. Shih gjithashtu Aktgjykimin në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 24-25, 43; *Karadžić* Trial Judgment, para. 13.

²⁹⁷ Transkripti (W04390), 24 nëntor 2021; Transkripti (W04391), 22 dhe 23 nëntor 2021.

²⁹⁸ Shih nenin 46(5) të Ligjit; *Nahimana et al.* Appeal Judgment, para. 509. Shih gjithashtu më lart, para. 23.

127. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se, edhe sikur të ishin paraqitur në mënyrën e duhur, parashtrimet e Mustafës nuk demonstrojnë se Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e deklarimeve të dorës së dytë dhe që u mbështet në to dhe, rrjedhimisht, rrëzon nënpikën 1E të Apelit të Mustafës.

F. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME MARRJEN NË PYETJE TË W03594-ËS DHE
VLERËSIMIN PREJ TRUPIT GJYKUES TË DËSHMISË SË TIJ (NËNPIKA 1F)

128. Trupi Gjykses e lejoi ZPS-në që ta ballafaqonte W03594-ën me deklaratat mospërputhëse që kishte dhënë më parë²⁹⁹ dhe konstatoi se nuk mund të mbështetej në dëshminë e W03594-ës lidhur me trajtimin e tij gjatë kohës kur ishte i ndaluar, për shkak të mospërputhjeve me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë.³⁰⁰ Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që e lejoi ZPS-në t'i bënte pyetje W03594-ës si "dëshmitar antagonist" dhe që i shpërfilli provat në favor të të akuzuarit gjatë vlerësimit të dëshmisë së W03594-ës, pa dhënë mendim të arsyetuar për refuzimin e tyre.³⁰¹ ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës nuk demonstrojnë gabim në vendimin e Trupit Gjykses dhe duhet të rrëzohen.³⁰²

1. Parashtrimet e palëve

129. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që e lejoi ZPS-në "t'i bënte pyetje" W03594-ës si "dëshmitar antagonist", kur dëshmitari mohoi që të ndaluarit ishin keqtrajtuar apo kishin pësuar lëndime.³⁰³ Mustafa gjithashtu parashtron se Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e dëshmisë së W03594-ës, që: (i) nuk e mori parasysh dëshminë në favor të të akuzuarit lidhur me kushtet e ndalimit, sepse ishte në kundërshtim me dëshmitë e të ndaluarve të tjerë; (ii) u mbështet "në mënyrë

²⁹⁹ Shih p.sh. Transkriptin (W03594), 12 tetor 2021, f. 1043-1072; Transkriptin (W03594), 13 tetor 2021, f. 1132-1156.

³⁰⁰ Aktgjykimi, para. 78-83.

³⁰¹ Dosja e Apelit, para. 40-50; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 8-13.

³⁰² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 23-24.

³⁰³ Dosja e Apelit, para. 42, 44, 48.

përzgjedhëse” në dëshminë e W03594-ës, vetëm për atë që konfirmohet nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë; dhe (iii) nuk dha mendim të arsyetuar për refuzimin e pjesëve të tjera të dëshmisë së W03594-ës.³⁰⁴ Në mbështetje të këtyre pretendimeve, Mustafa parashtron se Trupi Gjykes konstatoi në mënyrë të pasaktë se, bazuar në dëshminë e W03594-ës, ishte e qartë se ai nuk donte ta implikonte të akuzuarin dhe argumentoi se dëshmitari kishte qenë “më se i qartë” se i akuzuari nuk ishte i pranishëm, dhe se po të kishte qenë, “sigurisht nuk do ta kishte kursyer”.³⁰⁵ Për këtë arsye, Mustafa parashtron se asnjë gjykatë e arsyeshme nuk do ta përjashtonte dëshminë e W03594-ës, apo t’i jepte asaj pak apo aspak peshë.³⁰⁶

130. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës mbi refuzimin e pjesëve të dëshmisë së W03594-ës nga Trupi Gjykes nuk përfshihen në kuadrin e Njoftimit për Apel dhe, rrjedhimisht, duhet të rrëzohen.³⁰⁷ ZPS-ja gjithashtu parashtron se pretendimi i Mustafës se ZPS-ja u lejua që “t’i bënte pyetje” W03594-ës si “dëshmitar antagonist”, shtrembëron vendimin e Trupit Gjykes, që në fakt i dha leje ZPS-së t’i freskonte kujtesën dëshmitarit, në bazë të rregullës 143(1) të Rregullores.³⁰⁸ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se Mustafa nuk ngriti kundërshtime gjatë dëshmisë së W03594-ës dhe, për rrjedhojë, e ka humbur të drejtën për ta ngritur këtë pretendim në apel.³⁰⁹

131. Mustafa kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk i “freskoi” kujtesën dëshmitarit, por “e ballafaqoi” atë me deklaratën e mëparshme.³¹⁰ Rrjedhimisht, Mustafa argumenton se W03594 u trajtua si dëshmitar antagonist, gjë që çoi në diskreditimin e dëshmisë së tij e cila ishte në favor të të akuzuarit.³¹¹

³⁰⁴ Dosja e Apelit, para. 40-41, 45-50; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 10-13.

³⁰⁵ Dosja e Apelit, para. 42-43; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 11-12.

³⁰⁶ Dosja e Apelit, para. 48.

³⁰⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 23.

³⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 24.

³⁰⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 24.

³¹⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 8.

³¹¹ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 9.

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

132. Fillimisht, Paneli i Apelit vëren se parashtrimet e Mustafës në lidhje me vlerësimin e dëshmisë së W03594-ës nga Trupi Gjykues janë jashtë kuadrit të Njoftimit për Apel,³¹² çka përlligj rrëzimin e menjëhershëm të tyre.³¹³ Gjithashtu, Mustafa nuk ka demonstruar se ekzistojnë rrethana të veçanta që përlligjin shqyrtimin e tyre. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës për këtë aspekt.

133. Në lidhje me pretendimin e Mustafës se Trupi Gjykues e lejoi ZPS-në “t’i bënte pyetje” W03594-ës si “dëshmitar antagonist”,³¹⁴ Paneli i Apelit fillimisht vëren se, gjatë procesit gjyqësor, Mustafa nuk ngriti kundërshtime ndaj marrjes në pyetje të W03594-ës nga ZPS-ja si “dëshmitar antagonist”.³¹⁵ Kjo përlligj rrëzimin e menjëhershëm të këtij parashtrimi.³¹⁶ Sidoqoftë, Paneli i Apelit vendos të bëjë përjashtim dhe t’i shqyrtojë argumentet e Mustafës për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë, duke pasur parasysh rëndësinë që ka aspekti i kuadrit të marrjes në pyetje në kontekstin e dëshmisë së dëshmitarit.

134. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit vë në dukje se gjatë dhënies së dëshmisë në sallën e gjyqit, W03594 u dha përgjigje pyetjeve të ZPS-së që ishin në mospërputhje me deklaratat e dhëna më parë prej tij. Si rezultat, ZPS-ja kërkoi t’i “freskonte” kujtesën W03594-ës duke i lexuar deklaratat e mëhershme të tij.³¹⁷ Konkretisht, ZPS-ja i lexoi

³¹² *Krahaso*, paragrafin 4 të nënpikës 1F të Njoftimit për Apel me paragrafët 45-50 të Dosjes së Apelit.

³¹³ Shih më lart, para. 31. Gjithashtu, Paneli thekson se Trupi Gjykues ka diskrecion të gjerë në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit dhe të mbështetshmërisë në dëshmisë së tij. Shih më lart, para. 38.

³¹⁴ Paneli thekson se paragrafët 89 dhe 551 të Aktgjykimit, të përmendur në poshtëshënimin 6 të Njoftimit për Apel, lidhen me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë dhe nuk janë relevante për pretendimin e ngritur në nënpikën 1F të Apelit.

³¹⁵ Shih, në veçanti, Transkriptin (W03594), 12 tetor 2021, f. 1043-1091; Transkriptin (W03594), 13 tetor 2021, f. 1132-1160.

³¹⁶ Shih më lart, para. 30.

³¹⁷ Shih p.sh. Transkriptin (W03594), 12 tetor 2021, f. 1043-1044, 1047-1053, 1058-1060, 1067-1072; Transkriptin (W03594), 13 tetor 2021, f. 1132-1133, 1138, 1140-1141, 1146-1147, 1155-1156.

dëshmitarit pjesët përkatëse të deklaratave të mëparshme dhe u lejua t'i bënte pyetje sugjeruese për të sqaruar dëshminë e tij.³¹⁸

135. Sipas Panelit të Apelit, ndonëse W03594 nuk tha se nuk i mbante mend faktet për të cilat kishte dëshmuar më parë, siç përcaktohet në rregullën 143(1) të Rregullores, ai dëshmoi në një mënyrë që ishte në mospërputhje me deklaratat e tij të mëparshme.³¹⁹ Në këto rrethana, Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në vendimin e Trupit Gjykses për ta lejuar ZPS-në që ta ballafaqonte W03594-ën me deklaratat e tij të mëparshme, që lejohet në bazë të rregullës 143(2) të Rregullores.³²⁰ Gjithashtu, Paneli i Apelit konstaton se vendimi i Trupit Gjykses për ta lejuar ZPS-në që t'i bënte W03594-ës pyetje sugjeruese, përfshihet në kompetencën diskreionale të Trupit Gjykses për të ushtruar kontroll mbi mënyrën e pyetjes së dëshmitarëve, për të mundësuar paraqitjen e efektshme të provave dhe përcaktimin e së vërtetës.³²¹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se nuk ka gabim në vendimin e Trupit Gjykses.

³¹⁸ Ndonëse Mustafa vëren se Trupi Gjykses e lejoi ZPS-në që W03594-ës "t'i bënte pyetje si dëshmitar antagonist", Paneli i Apelit me këtë kupton se ZPS-ja u lejua t'i bënte dëshmitarit pyetje sugjeruese. Shih Dosjen e Apelit, para. 44, 48.

³¹⁹ Shih p.sh. Transkriptin (W03594), 12 tetor 2021, f. 1043-1044 (ku pasi dëshmitari dha një përgjigje që nuk përputhej me deklaratën e mëparshme të tij, ZPS-ja tha: "ndoshta mund t'ia freskoj kujtesën dëshmitarit duke i lexuar një pjesë të vogël nga deklarata që i ka dhënë ZPS-së"); f. 1058-1060 (ku, pasi dëshmitari dha një përgjigje që nuk përputhej me deklaratën e mëparshme të tij, ZPS-ja i lexoi pjesë të deklaratës dhe e pyeti dëshmitarin: "ato që i keni thënë prokurorit gjatë intervistës janë krejt ndryshe nga këto që po thoni sot para Trupit Gjykses. Tani që jua lexova këtë pjesë të intervistës, a ju kujtohet ndopak që i keni thënë këto fjalë?"); f. 1067-1072 (ku, pasi dëshmitari mohoi se ishte rrahur gjatë ndalimit, ZPS-ja i lexoi pjesë të deklaratës së mëparshme të tij dhe e pyeti dëshmitarin: "Vërej dy mospërputhje të vogla me atë që i thatë Trupit Gjykses sot [...] pasi jua lexova këtë pjesë, a mund t'i thoni Trupit Gjykses a ishte në fakt një person, apo disa persona, që godisnin me shkopin e trashë të gomës?"). Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 24.

³²⁰ Paneli i Apelit gjithashtu thekson se pyetjet sugjeruese që ZPS-ja i bëri W03594-ës ishin vetëm për të sqaruar përgjigjet e dhëna gjatë dëshmisë së tij në sallën e gjyqit, që ishin në kundërshtim me deklaratat e mëparshme të tij.

³²¹ Shih rregullën 143(4) të Rregullores.

136. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se, edhe sikur parashtrimet e Mustafës të ishin paraqitur siç duhet, ato nuk vërtetojnë gabim të Trupit Gjykses dhe rrjedhimisht, rrezon nënpikën 1F të Apelit të Mustafës.

G. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME GARANCITË E DHËNA W04600-S NË BAZË TË RREGULLËS 151(3) TË RREGULLORES (NËNPIKA 1G)

137. Më 20 shtator 2021, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e W04600-s që t'i jepeshin garanci në lidhje me vetinkriminimin në bazë të rregullës 151(3) të Rregullores.³²² Trupi Gjykses më pas ia dha gojarisht këto garanci W04600-s më 23 shtator 2021, përpara fillimit të dëshmisë së tij.³²³ Mustafa kundërshton vendimin e Trupit Gjykses për dhënien e këtyre garancive W04600-s.³²⁴ ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk ka demonstruar gabim në vendimin e Trupit Gjykses.³²⁵

1. Parashtrimet e palëve

138. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që i dha W04600-s garanci në bazë të rregullës 151(3) të Rregullores "gojarisht", si edhe që nuk dha një vendim të arsyetuar për ta detyruar dëshmitarin të dëshmonte.³²⁶ Mustafa argumenton se, si rezultat, mbështetja e Trupit Gjykses në dëshminë e W04600-s është në shkelje të Rregullores dhe "i bën të pavlefshme pjesët e Aktgjykimit që mbështeten te ky dëshmitar".³²⁷

³²² Urdhri Gojor lidhur me Garancitë për W04600-n; Kërkesa sipas Rregullës 151(3). Shih gjithashtu Njoftimin e ZPS-së sipas Rregullës 151(3). ZPS-ja nuk e kundërshtoi kërkesën. Shih Parashtrimet e ZPS-së sipas Rregullës 151(3).

³²³ Transkripti (W04600), 23 shtator 2021, f. 706-707. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 100.

³²⁴ Dosja e Apelit, para. 51-52; Njoftimi për Apel, nënpika 1G, para. 4, poshtëshënimi 7. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 14.

³²⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 25.

³²⁶ Dosja e Apelit, para. 51-52; Njoftimi për Apel, nënpika 1G, para. 4, poshtëshënimi 7; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 14. Paneli i Apelit thekson se në poshtëshënimin 7 të Njoftimit për Apel, Mustafa i referohet "para. 185" por, në fakt, duhet t'i referohej poshtëshënimit 185. Shih Aktgjykimin, para. 100, poshtëshënimi 185.

³²⁷ Dosja e Apelit, para. 52.

139. ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se si u dëmtua nga garancitë që iu dhanë W04600-s në bazë të rregullës 151(3) të Rregullores dhe se ai nuk paraqet argumente apo jurisprudencë bindëse në mbështetje të pretendimit se për vendimet sipas rregullës 151(3) të Rregullores duhet të jepen arsye me shkrim.³²⁸ ZPS-ja argumenton se e drejta për të marrë vendim të arsyetuar varet nga lloji i vendimit dhe se nuk është kusht që për çdo vendim të jepen arsye të hollësishme me shkrim, sidomos kur vendimi ka të bëjë me aspekte rutinë ose, si në këtë rast, kur nuk u kundërshtua në kohën kur u dha.³²⁹

140. Mustafa kundërpërgjigjet se fakti që ky është vendim rutinë nuk do të thotë se ai nuk duhet të jetë i arsyetuar mirë.³³⁰ Ai gjithashtu kundërpërgjigjet se çdo aspekt inkriminues i diskutuar nga dëshmitari duhet të "trajtohet me kujdes të jashtëzakonshëm", gjë që Trupi Gjykses nuk e bëri për dëshminë W04600-s.³³¹

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

141. Paneli i Apelit rikujton se në bazë të rregullës 151(1) dhe (2) të Rregullores, nëse një dëshmitar kundërshton të japë dëshmi që mund të priret ta inkriminojë, trupi gjykses mund ta detyrojë dëshmitarin të dëshmojë, pasi të ketë shqyrtuar: (a) rëndësinë e dëshmisë që pritet të jepet; (b) nëse dëshmitari do të japë dëshmi unike në lidhje me çështjen; (c) llojin e vetinkriminimit të mundshëm, në qoftë se bëhet i njohur; dhe (d) mjaftueshmërinë e masave mbrojtëse për dëshmitarin në rrethanat përkatëse.

142. Gjithashtu, në bazë të rregullës 151(3) të Rregullores, në qoftë se trupi gjykses vendos ta detyrojë dëshmitarin të dëshmojë, pasi të ketë kërkuar *ex parte* mendimin e Prokurorit të Specializuar, trupi gjykses mund të përcaktojë se para dhënies së dëshmisë, dëshmitarit i duhet dhënë garanci në lidhje me vetinkriminimin. Trupi gjykses e siguron dëshmitarin se dëshmia e dhënë në përgjigjet ndaj pyetjeve: (a) jepet

³²⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 25.

³²⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 25.

³³⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 14-15.

³³¹ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 15.

in camera dhe nuk i bëhet në asnjë mënyrë e njohur publikut, Kosovës apo ndonjë shteti të tretë; dhe (b) nuk do të përdoret as drejtpërdrejt, as tërthorazi, kundër atij personi në një procedim penal të mëvonshëm në Dhomat e Specializuara, përveçse në bazë të nenit 15(2) të Ligjit dhe rregullës 65 të Rregullores.

143. Paneli i Apelit vëren se, ndonëse Mustafa tani e kundërshton Urdhrin Gojor lidhur me Garancitë për W04600-n, këtë pretendim ai e ngre për herë të parë në apel, ndërkohë që pati mundësi të shumta ta bënte këtë në shkallën e parë. Më konkretisht, Paneli vëren se Mustafa: (i) nuk iu përgjigj Njoftimit të ZPS-së sipas Rregullës 151(3) ose Kërkesës sipas Rregullës 151(3); (ii) nuk kundërshtoi në kohën kur Trupi Gjykses lëshoi Urdhrin Gojor lidhur me Garancitë për W04600-n; ose (iii) nuk e kundërshtoi Urdhrin Gojor lidhur me Garancitë për W04600-n në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare apo në deklaratat përmbyllëse. Për këto arsye, Paneli i Apelit gjykon se Mustafa e ka humbur të drejtën për ta ngritur këtë pretendim në apel. Gjithashtu, ai nuk ka demonstruar se ekzistojnë rrethana të veçanta që do të përlligjin shqyrtimin e parashtrimeve të tij.³³² Rrjedhimisht, Paneli rrëzon nënpikën 1G të Apelit të Mustafës.

H. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME MBËSHTETJEN E TRUPIT GJYKUES NË DËSHMINË E [REDAKTUAR] (NËNPIKAT 1H, 1I)

144. Mustafa kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykses në [REDAKTUAR], në lidhje me: (i) arrestimin e viktimës së vrasjes së paligjshme;³³³ dhe (ii) synimin e Mustafës për të kryer vrasje të paligjshme.³³⁴ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se kundërshtimet e Mustafës janë të pafaktuara, nuk arrijnë të vërtetojnë gabim dhe, rrjedhimisht, duhet të rrëzohen.³³⁵

³³² Shih më lart para. 30.

³³³ Dosja e Apelit, para. 53-56 (nënpika 1H); Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 52-61 (nënpika 1H).

³³⁴ Dosja e Apelit, para. 57-61 (nënpika 1I); Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 62-67 (nënpika 1I).

³³⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 66-70; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 23-24.

1. Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

145. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që nuk ushtroi kujdes të veçantë kur u mbështet në [REDAKTUAR], që e implikonte Mustafën në [REDAKTUAR].³³⁶ Mbrojtja argumenton se për konstatimin faktik lidhur me ekzistencën [REDAKTUAR] Trupi Gjykses u mbështet në dëshmitë e [REDAKTUAR], ndërsa për konstatimin se [REDAKTUAR],³³⁷ ai u mbështet vetëm në [REDAKTUAR]. Mustafa parashtron se [REDAKTUAR].³³⁸

146. Mustafa gjithashtu parashtron se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në dëshminë [REDAKTUAR] lidhur me një bisedë ndërmjet [REDAKTUAR], në konstatimet e veta mbi synimin e Mustafës për të kryer vrasje.³³⁹ Mustafa argumenton se kjo bisedë nuk është relevante për të vërtetuar “elementin mendor të krimeve të kryera”, ose se “ajo bisedë ndodhi faktikisht” dhe se deklarata e Mustafës, siç e kujton [REDAKTUAR], nuk përbën pranim.³⁴⁰

147. ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk e mbështet me fakte pretendimin e tij se dëshmitë [REDAKTUAR] duhet të refuzohen dhe, për më tepër, ky argument bie ndesh me formulimin e rregullës 139(3) të Rregullores dhe jurisprudencën ekzistuese.³⁴¹ ZPS-ja gjithashtu përgjigjet se Trupi Gjykses ka diskrecion të gjerë në vlerësimin e provave, ndër to edhe dëshmitë [REDAKTUAR] por të besueshme të personave që mund të kenë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në

³³⁶ Dosja e Apelit, para. 56; Njoftimi për Apel, nënpika 1H, para. 4; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 52, 54, 57-60.

³³⁷ Dosja e Apelit, para. 53-56; [REDAKTUAR].

³³⁸ Dosja e Apelit, para. 53-54; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 59.

³³⁹ Dosja e Apelit, para. 57-61; Njoftimi për Apel, nënpika 1I, para. 4; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 62-64, 66-67.

³⁴⁰ Dosja e Apelit, para. 59-60; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 63, 65, 67.

³⁴¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 66, 68; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 24, ku Mbrojtësja e Viktimave gjithashtu përgjigjet se, në bazë të rregullës 137(2) të Rregullores, Trupi Gjykses ka kompetencë të vlerësojë pranueshmërinë dhe peshën që u jepet të gjitha provave të paraqitura.

ngjarje, në qoftë se shqyrtohen me kujdesin e duhur.³⁴² ZPS-ja parashtron se, [REDAKTUAR].³⁴³

148. ZPS-ja gjithashtu përgjigjet se Trupi Gjykses vlerësoi se biseda ndërmjet [REDAKTUAR] është relevante për krimet dhe se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se konstatimet e Trupit Gjykses në këtë aspekt janë krejtësisht të gabuara, ose se asnjë trup gjykses i arsyeshëm nuk mund të kishte arritur në të njëjtin përfundim.³⁴⁴ Gjithashtu, ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk merr parasysh faktet e tjera që shqyrtoi Trupi Gjykses lidhur me konstatimin e synimit të Mustafës për të kryer vrasje, dhe se ai nuk demonstroi se konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të Mustafës për akuzën e vrasjes së paligjshme nuk mund të qëndrojnë bazuar në provat e tjera.³⁴⁵ Së fundi, sa i takon argumentit se [REDAKTUAR] – nuk përbën pranim, ZPS-ja parashtron se Mustafa shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykses, pasi Trupi Gjykses u mbështet në pjesë të tjera të bisedës për konstatimin se dëshmia e [REDAKTUAR] është e besueshme.³⁴⁶

149. Mustafa kundërpërgjigjet se në përgjithësi Trupi Gjykses u mbështet në dëshminë e [REDAKTUAR] për aq sa ajo u [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR].³⁴⁷ Megjithatë, Mustafa argumenton se, ndonëse Trupi Gjykses mund të ketë diskrecion të gjerë për t'i konstatuar të besueshme dëshmitë [REDAKTUAR] në qoftë se mbështeten nga prova të tjera rrethore, dëshmia e [REDAKTUAR] në lidhje me [REDAKTUAR] nuk u [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe rrjedhimisht, nuk duhej të ishte konstatuar e besueshme.³⁴⁸

³⁴² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 67.

³⁴³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. [REDAKTUAR].

³⁴⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 69.

³⁴⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 69; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 23.

³⁴⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 70, që i referohet paragrafit 694 të Aktgjykimit.

³⁴⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 53, [REDAKTUAR].

³⁴⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 54, 61. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 55-59.

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

150. Paneli së pari vëren se Trupi Gjykses konstatoi se [REDAKTUAR] ishte përgjithësisht i besueshëm për sa u përket aspekteve thelbësore të dëshmisë së tij, në veçanti duke marrë parasysh se dëshmitari [REDAKTUAR] – një fakt “[REDAKTUAR]”.³⁴⁹ Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se [REDAKTUAR] përshkroi rrethanat dhe ngjarjet që ndodhën në lidhje me [REDAKTUAR] në mënyrë kronologjike dhe të hollësishme.³⁵⁰ Së fundi, Trupi Gjykses konstatoi se përshkrimi i ngjarjeve nga [REDAKTUAR] u [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe W04391, përfshirë se [REDAKTUAR].³⁵¹

151. Trupi Gjykses konstatoi më tej se, [REDAKTUAR].³⁵² Trupi Gjykses vuri në dukje se, sipas [REDAKTUAR].³⁵³

152. Trupi Gjykses shqyrtoi besueshmërinë e dëshmisë së [REDAKTUAR] lidhur me këtë bisedë, dhe konstatoi se “[REDAKTUAR]”.³⁵⁴ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se një bisedë e tillë është plotësisht e besueshme, dhe ajo demonstronte se i akuzuari synonte të vriste viktimën e vrasjes së paligjshme dhe më pas të shmangte çfarëdo procesi gjyqësor të nisur në lidhje me vdekjen e tij.³⁵⁵ Bazuar në këto prova dhe faktorë të tjerë që Trupi Gjykses i mori parasysh në Aktgjykim, ai konstatoi se ky është i vetmi përfundim i arsyeshëm, çka rrjedhimisht vërteton ekzistencën e elementit mendor për vrasjen si krim lufte.³⁵⁶

³⁴⁹ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. [REDAKTUAR].

³⁵⁰ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

³⁵¹ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR]. Paneli rikujton gjithashtu konstatimin e Trupi Gjykses se, bazuar në dëshminë e [REDAKTUAR] që [REDAKTUAR]. Shih Aktgjykimin, para. [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 345.

³⁵² Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR], që i referohet [REDAKTUAR].

³⁵³ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR], që i referohet [REDAKTUAR].

³⁵⁴ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

³⁵⁵ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

³⁵⁶ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu më poshtë, para. [REDAKTUAR].

153. Paneli rikujton se nuk ekziston një kriter i përgjithshëm që dëshmia e një dëshmitari të konfirmohet nga prova të tjera, në qoftë se ajo konsiderohet e besueshme.³⁵⁷ Në veçanti, një trup gjykues ka diskrecion të mbështetet në dëshmi të pakonfirmuara të një dëshmitari i cili mund të ketë motivin ta implikojë të akuzuarin, me kusht që dëshmia e tij/saj të vlerësohet me kujdesin e duhur.³⁵⁸ Paneli rikujton më tej se trupi gjykues është në pozitën më të mirë për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe ka diskrecion të gjerë për vlerësimin e mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre.³⁵⁹

154. Bazuar në konstatimet e Trupit Gjykues të përmendura më lart,³⁶⁰ Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykues bëri vlerësim të hollësishëm dhe të kujdesshëm të besueshmërisë së [REDAKTUAR]. Konkretisht, Trupi Gjykues konstatoi se [REDAKTUAR] ishte përgjithësisht i besueshëm për sa u përket aspekteve thelbësore të dëshmisë së tij, duke vënë në dukje se ai dha dëshmi të hollësishme për ngjarje të caktuara që i kishte përjetuar vetë, përfshirë për fakte që ishin "[REDAKTUAR]", dhe se përshkrimi i ngjarjeve prej tij lidhur me [REDAKTUAR] u konfirmua edhe nga dëshmitarë të tjerë.³⁶¹ Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Trupi Gjykues nuk gaboi që u mbështet në dëshminë e [REDAKTUAR] për konstatimet e tij lidhur me [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues rrëzon nënpikën 1H të Apelit të Mustafës.

155. Sa i përket nënpikës 1I, Paneli vëren se Mustafa kundërshton konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me dëshminë e [REDAKTUAR] për një bisedë ndërmjet [REDAKTUAR]. Paneli rikujton konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me këtë aspekt³⁶²

³⁵⁷ Shih më lart, para. 38.

³⁵⁸ Shih p.sh. *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 135; Aktgjykimin e Apelit *Shainović dhe të tjerët*, para. 1101.

³⁵⁹ Shih më lart, para. 38.

³⁶⁰ Shih më lart, para. 150-152.

³⁶¹ Shih Aktgjykimin, para. [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu më lart, para. 150.

³⁶² Shih më lart, para. 151-152.

dhe vë në dukje se Trupi Gjykses nuk u mbështet vetëm në bisedën ndërmjet [REDAKTUAR] për të konstatuar se Mustafa synonte të kryente krimin e vrasjes së paligjshme. Përkundrazi, ai e shqyrtoi bisedën “krahas”³⁶³ disa faktorëve të tjerë, ndër të cilët: (i) faktorë që tregojnë se Mustafa “pranoi se disa nga të ndaluarit që ai mbante aty mund të vdisnin si pasojë e keqtrajtimit”;³⁶⁴ (ii) vendimet e Mustafës për të mos liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme, çka sipas mendimit të Trupit Gjykses, ishin “faktikisht barabar me një vendim për ta vlarë viktimën e vrasjes së paligjshme”;³⁶⁵ dhe (iii) faktin se viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], dhe për pasojë nuk mund të lejonin që viktima të mbetej i gjallë.³⁶⁶

156. Sipas mendimit të Panelit, këto konstatime përforcojnë përfundimin se konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me dëshminë e [REDAKTUAR] për bisedën nuk ishin konstatime që nuk mund të ishin bërë nga asnjë trup gjykses i arsyeshëm. Përmbajtja e bisedës që tregon dijeninë e Mustafës për vdekjen dhe rrethanat e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, jo vetëm që e bën bisedën të besueshme, por është relevante edhe për vërtetimin e elementit mendor të krimit. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në ushtrimin e diskrecionit nga Trupi Gjykses për t’u mbështetur në dëshminë e [REDAKTUAR] në lidhje me elementin mendor të vrasjes së paligjshme si krim lufte. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon nënpikën 1I të Apelit të Mustafës.

I. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME SHQYRTIMIN E MOTIVIT FINANCIAR NGA TRUPI GJYKSES NË VLERËSIMIN E DËSHMISË SË [REDAKTUAR] (NËNPIKA 1K)

157. Në arsyetimin e tij në Aktgjykim, Trupi Gjykses nuk identifikoi shprehimisht mundësinë e “motivit financiar për të gënjer” si faktor në të cilin u mbështet për

³⁶³ Aktgjykimi, para. 694.

³⁶⁴ Aktgjykimi, para. 691.

³⁶⁵ Aktgjykimi, para. 692.

³⁶⁶ Aktgjykimi, para. 693.

vlerësimin e besueshmërisë së [REDAKTUAR], përfshirë të [REDAKTUAR].³⁶⁷ Mustafa thotë se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh motivin financiar të [REDAKTUAR] për të dëshmuar dhe që nuk e lejoi Mbrojtjen t'i bënte pyetje dëshmitarit në lidhje me këtë.³⁶⁸ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk arrin të demonstrojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses.³⁶⁹

1. Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve

158. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që “nuk pranoi dhe nuk mori parasysh” “motivin e mundshëm financiar për të gënjer, trilluar ose shtrembëruar informacionin” të [REDAKTUAR].³⁷⁰ Konkretisht, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses i gjykoi dëshmitarët “të besueshëm dhe dëshmitë e tyre të mbështetshme”, duke shpërfillur se ata “pruan hapur” që dëshmitë e tyre ishin nxitur nga “lakmia për para”.³⁷¹ Mustafa parashtron më tej se Trupi Gjykses i shkeli atij të drejtën e barazisë së palëve, sepse nuk e lejoi Mbrojtjen t'i bënte pyetje [REDAKTUAR] në lidhje me motivet financiare [REDAKTUAR].³⁷²

159. ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se, parashtrimi i Mustafës që dëshmitarët e ZPS-së ishin motivuar nga “lakmia për para” është i pabazë dhe se referenca e vetme e tij ndaj dëshmisë së [REDAKTUAR] “e shtrembëron së tepërmi” dëshminë e [REDAKTUAR].³⁷³ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave parashtrajnë më tej se, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës, Trupi Gjykses nuk ia ndaloi, por vetëm ia kufizoi Mbrojtjes kuadrin e pyetjeve për dëshmitarët lidhur me motivin e mundshëm financiar të tyre për të dëshmuar.³⁷⁴ Si mbështetje, ato argumentojnë se

³⁶⁷ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

³⁶⁸ Dosja e Apelit, para. 67-69; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 73-76, 126.

³⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 89-90; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 31-32.

³⁷⁰ Dosja e Apelit, para. 69.

³⁷¹ Dosja e Apelit, para. 67.

³⁷² Dosja e Apelit, para. 68. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 126.

³⁷³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 88; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 29-30.

³⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 89-90; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 31-32.

Trupi Gjykses u shpreh konkretisht që dëshmitarëve mund t'u bëheshin pyetje për aspektin e dëmshpërblimit në kuadër të ndikimit të mundshëm të këtij aspekti në besueshmërinë e tyre, por nuk do të lejoheshin pyetjet për llojin ose shumën e dëmshpërblimit, duke theksuar se "kuadri dhe modalitetet e zhdëmtimeve, nëse do të ketë, do të diskutohen në një fazë të mëvonshme".³⁷⁵ Së fundi, ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykses nuk ishte i detyruar ta trajtonte këtë aspekt në Aktgjykim.³⁷⁶

160. Në kundërpërgjigje, Mustafa parashtron se motivi financiar i dëshmitarit "asnjëherë nuk mund të përjashtohet në një procedim penal"³⁷⁷ dhe se Trupi Gjykses duhej të kishte vlerësuar besueshmërinë e secilit dëshmitar dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre lidhur me këtë aspekt.³⁷⁸

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

161. Fillimisht, Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa kundërshton ndërhyrjen e Trupit Gjykses gjatë marrjes në pyetje të [REDAKTUAR] nga Mbrojtja në lidhje me një motiv të mundshëm financiar, duke pretenduar shkelje të "barazisë së palëve", ndërkohë që këtë aspekt konkret nuk e ngriti në Njoftimin për Apel.³⁷⁹ Megjithatë, Paneli konstaton se kjo pikë lidhet ngushtë me kundërshtimin e Mustafës sa i takon marrjes parasysh nga Trupi Gjykses të motivit të mundshëm financiar të [REDAKTUAR] dhe, për këtë arsye, Paneli do t'i shqyrtojë parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me të.

162. Paneli i Apelit vë në dukje se, megjithëse Mustafa u referohet në përgjithësi "dëshmitarëve të ZPS-së" dhe "[REDAKTUAR]",³⁸⁰ ai citon vetëm dëshminë e një dëshmitari, [REDAKTUAR], në mbështetje të argumentit të tij.³⁸¹ Rrjedhimisht, Paneli

³⁷⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 89-90; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 31-32.

³⁷⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 90.

³⁷⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 74, 126.

³⁷⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 76.

³⁷⁹ *Krahaso* Njoftimin për Apel, nënpika 1K, para. 4 *me* Dosjen e Apelit, para. 68.

³⁸⁰ Dosja e Apelit, para. 67, 69; Njoftimi për Apel, nënpika 1K, para. 4.

³⁸¹ Dosja e Apelit, para. 68.

i Apelit do t'i shqyrtojë argumentet e Mustafës vetëm nëse ato mbështeten me referenca të sakta në paragrafët e Aktgjykimit, ose në faqet përkatëse të transkriptit të dëshmimeve të dëshmitarëve.³⁸²

163. Lidhur me thelbin e argumenteve të Mustafës, Paneli vëren se gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmisë së [REDAKTUAR], Trupi Gjykses përmendi se shqyrtoi një numër faktorësh, ndër të cilët edhe ndonjë "shtysë ose motiv për të gënjer, trilluar, shtrembëruar ose fshehur informacionin".³⁸³ Paneli i Apelit vëren gjithashtu se Trupi Gjykses vlerësoi në hollësi besueshmërinë e [REDAKTUAR] dhe mbështetshmërinë në dëshminë e [REDAKTUAR] duke mbajtur parasysh këta faktorë.³⁸⁴ Paneli vë në dukje se, megjithëse në vlerësimin e dëshmisë së [REDAKTUAR] Trupi Gjykses nuk e përmend konkretisht "motivin financiar për të gënjer",³⁸⁵ fakti që një faktor i caktuar nuk përmendet në arsyetimin e Trupit Gjykses nuk do të thotë domosdoshmërisht se Trupi Gjykses nuk e shqyrtoi atë.³⁸⁶ Gjithashtu, Paneli konstaton se Mustafa nuk demonstroi se si provat kishin "qartësisht lidhje" me ndonjë prej konstatimeve konkrete dhe, për më tepër, nuk jep prova në mbështetje të pretendimit se Trupi Gjykses nuk i mori parasysh dëshmitë.³⁸⁷

164. Gjithashtu, Paneli i Apelit vëren se, sikurse theksuan ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave, Mustafa keqinterpretonte dëshminë e [REDAKTUAR] dhe arsyen e ndërhyrjes së Trupit Gjykses gjatë marrjes në pyetje të [REDAKTUAR]. Në veçanti, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses nuk e pengoi Mbrojtjen t'i bënte [REDAKTUAR] pyetje lidhur me motivin e mundshëm financiar, por kufizoi llojin e pyetjeve. Konkretisht, ndonëse vuri në dukje se, sipas rregullës 143(3) të Rregullores,

³⁸² Shih më lart, para. 29.

³⁸³ Aktgjykimi, para. 35.

³⁸⁴ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

³⁸⁵ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

³⁸⁶ Shih më lart, para. 34.

³⁸⁷ Shih më lart, para. 34. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 33.

pala jothirrëse lejohet të bëjë pyetje lidhur me aspekte që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit, përfshirë arsyet për dhënien e dëshmisë, Trupi Gjykses vendosi të mos lejonte pyetjet që synonin marrjen e përgjigjeve për arsyet e kërkimit të dëshmshpërblimit, ose llojin e dëshmshpërblimit të kërkuar. Trupi Gjykses vuri në dukje se, “kuadri dhe modalitetet e zhdëmtimit, nëse do të ketë, do të diskutohen vetëm në një fazë të mëvonshme” të procesit gjyqësor.³⁸⁸ Sipas Panelit të Apelit, Trupi Gjykses nuk e pengoi Mustafën që të kundërshtonte besueshmërinë e [REDAKTUAR] në lidhje me motivin e mundshëm financiar për të dhënë dëshmi, por vendosi kufizimet e duhura për kuadrin e pyetjeve të tij.

165. Sa i përket pretendimit për shkelje të parimit të barazisë mes palëve,³⁸⁹ Paneli i Apelit vëren se Mustafa nuk eidenton se si u vu në pozitë të pafavorshme në marrjen në pyetje të dëshmitarëve, as nuk e mbështet këtë pretendim të përgjithshëm me referenca në paragrafët përkatës në Aktgjykim ose faqet e transkriptit të dëshmive të dëshmitarëve, në lidhje me të cilët ai pretendon se Trupi Gjykses zbatoi standard të ndryshëm nga ai i marrjes në pyetje nga ZPS-ja në cilësinë e palës jothirrëse. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës mbi këtë aspekt.³⁹⁰

166. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk demonstroi gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses për besueshmërinë e [REDAKTUAR] dhe rrjedhimisht, rrëzon nënpikën 1K të Apelit të Mustafës.

³⁸⁸ Transkripti ([REDAKTUAR]), [REDAKTUAR]. Paneli vëren gjithashtu se kuadri dhe modalitetet e zhdëmtimit u diskutuan gjatë deklaratave përmbyllëse dhe se Mbrojtjes iu dha mundësia të paraqiste parashtrime me shkrim lidhur me zhdëmtimet. Shih Vendimin mbi Deklaratat Përmbyllëse dhe Çështjen në lidhje me To, para. 7, 20.

³⁸⁹ Paneli i Apelit rikujton se e drejta për gjykim të drejtë që garanton neni 21 i Ligjit mbulon parimin e barazisë së palëve midis prokurorit dhe të akuzuarit gjatë gjykimit penal. Ky parim mishëron detyrimin për të garantuar barazi procedurale midis palëve dhe që asnjë palë të mos jetë në pozitë të pafavorshme gjatë paraqitjes së provave të veta. Me fjalë të tjera, për të dyja palët duhet të zbatohen të njëjtat rregulla. Shih Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 50.

³⁹⁰ Shih më lart, para. 29.

J. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME PRANIMIN E AKTEKSPERTIZAVE MJEKËSORE SI
 PROVA PREJ TRUPIT GJYKUES (NËNPIKA 1N)

167. Trupi Gjykes pranoi si prova aktekspertizat mjekësore në lidhje me viktimat 08/05 dhe 09/05 [REDAKTUAR] sipas rregullës 132 të Rregullores.³⁹¹ Mustafa kundërshton pranimin e tyre, me argumentin se afati për paraqitjen e parashtrimeve mbi pranueshmërinë e tyre ishte i pamjaftueshëm dhe shkelte të drejtën e tij për gjykim të drejtë, konkretisht të drejtën për të pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.³⁹² ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk arrin të demonstrojë gabim ose dëm që do ta bënte të pavlefshëm Aktgjykimin.³⁹³

1. Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve

168. Mustafa parashtron se Trupi Gjykes bëri gabim që pranoi si prova aktekspertizat mjekësore në lidhje me viktimat 08/05 dhe 09/05 pas mbylljes së paraqitjes së provave nga Mbrojtja.³⁹⁴ Konkretisht, Mustafa argumenton se afati prej gjashtë ditësh që caktoi Trupi Gjykes për dorëzimin e parashtrimeve dhe paraqitjen e kundërprovave lidhur me aktekspertizat e *iMMO*-së ishte “shumë i shkurtër” dhe nuk i dha kohë e mundësi të mjaftueshme të përgatiste strategjinë e përgjigjes, në

³⁹¹ Aktgjykimi, para. 30; Vendimi sipas Rregullës 132, para. 8-9, 13(a); Aktekspertiza e *iMMO*-së për [REDAKTUAR]; Aktekspertiza e *iMMO*-së për [REDAKTUAR].

³⁹² Dosja e Apelit, para. 78-81; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 16.

³⁹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 28-29; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 34-43.

³⁹⁴ Dosja e Apelit, para. 78-81; Njoftimi për Apel, nënpika 1N, para. 4. Paneli i Apelit vëren se në Dosjen e Apelit Mustafa përmend edhe “viktimën 05”. Shih Dosjen e Apelit, para. 78. Megjithatë, është e paqartë se cilës viktimë i referohet. Paneli i Apelit rikujton se, në fakt, viktima 10/05 nuk u ekzaminua nga ekspertët sepse kërkesa fillestare për këtë u tërhoq; rrjedhimisht, nuk u përpilua – as u pranua si provë – ndonjë aktekspertizë për këtë viktimë. Shih Vendimin sipas Rregullës 132, para. 2; Parashtrimin e Aktekspertizave të *iMMO*-së, para. 2. Shih gjithashtu Parashtrimet e Viktimave në lidhje me Zhdëmtimet, para. 5, 12-13. Sa i përket viktimit 05/05, që nuk u thirr si dëshmitar në bazë të rregullës 132 të Rregullores, për të nuk u bë kërkesë për ekzaminim mjekësor sepse [REDAKTUAR]. Shih Urdhrin Gojor mbi Provat lidhur me Viktimën; Urdhrin Gojor mbi Caktimin e *iMMO*-së.

shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë që mbrohet prej nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës.³⁹⁵

169. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës janë të mangëta nga ana formale dhe duhet të hidhen poshtë *in limine*.³⁹⁶ Sa i përket themelësisë, ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave argumentojnë se Mustafa ishte njoftuar që më 24 janar 2022, përpara mbylljes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja, se Mbrojtësja e Viktimave kërkoi pranimin si prova të aktekspertizave mjeko-ligjore dhe rrjedhimisht, pati kohë më se të mjaftueshme për të përgatitur strategjinë në lidhje me të.³⁹⁷ Gjithashtu, ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave vërejnë se Mustafa nuk dorëzoi parashtrime sipas rregullës 149(2) të Rregullores për të kundërshtuar pranimin e aktekspertizave të *IMMO*-së, as nuk kërkoi zgjatje të afatit për dorëzimin e tyre.³⁹⁸ Madje, në fakt, pasi ato u pranuan si prova, ai njoftoi se nuk do të bënte kërkesë për të paraqitur kundërprova në lidhje me aktekspertizat.³⁹⁹ ZPS-ja parashtron se, rrjedhimisht, Mustafa humbi të drejtën të kundërshtonte pranimin e aktekspertizave dhe, për më tepër, nuk ka vërtetuar se i është shkaktuar ndonjë dëm si pasojë e pranimit të tyre.⁴⁰⁰ Mbrojtësja e Viktimave shton se neni 6 i KEDNJ-së ka relevancë të kufizuar sa i takon kundërshtimit të Mustafës ndaj afateve për dorëzimin e përgjigjes lidhur me pranimin e aktekspertizave të *IMMO*-së nga Trupi Gjykses, sepse Mustafës iu dha mundësia që t'i kundërshtonte aktekspertizat, por nuk e kundërshtoi mbështetshmërinë në to.⁴⁰¹

³⁹⁵ Dosja e Apelit, para. 79-81; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 16; Njoftimi për Apel, nënpika 1N, para. 4, që i referohet Vendimit sipas Rregullës 132. Paneli i Apelit supozon se, megjithëse Mustafa përmend vendimin e "23 qershorit 2022", ai në fakt i referohet Vendimit sipas Rregullës 132 (të 3 qershorit 2022). Shih Dosjen e Apelit, para. 79.

³⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 27.

³⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 28; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 36, 38, 40-41, 43. Mbrojtësja e Viktimave shton se, duke qenë se raportet u dorëzuan më 24 mars 2022, Mbrojtja në fakt pati shumë më tepër kohë se gjashtë ditë për t'u përgjigjur. Shih Dosjen e Përgjigjes së Viktimave, para. 38.

³⁹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 28; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 39-40, 43.

³⁹⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 28; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 34.

⁴⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 29.

⁴⁰¹ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 42.

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

170. Paneli i Apelit rikujton se me kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave, Trupi Gjykses caktoi *iMMO*-në të vlerësonte gjendjen psikiatrike të [REDAKTUAR], viktimave 08/05 dhe 09/05, dhe simptomat e lëndimeve fizike dhe psikologjike që mund të kenë pësuar si pasojë e keqtrajtimit dhe të përpilonte një aktekspertizë në lidhje me këtë vlerësim.⁴⁰² Mbrojtësja e Viktimave i dorëzoi aktekspertizat më 24 maj 2022.⁴⁰³ Më 3 qershor 2022, Trupi Gjykses vendosi që t'i pranonte aktekspertizat e *iMMO*-së si prova sipas rregullës 132 të Rregullores⁴⁰⁴ dhe urdhëroi Mbrojtjen që, nëse do të paraqiste kërkesë për paraqitjen e kundërprovave, përfshirë në lidhje me aktekspertizat e *iMMO*-së, ta dorëzonte atë deri më 9 qershor 2022.⁴⁰⁵

171. Paneli i Apelit vëren se, ndonëse Mustafa tani kundërshton afatin gjashtëditor për dorëzimin e parashtrimeve dhe paraqitjen e kundërprovave ndaj aktekspertizave të *iMMO*-së, këtë problem ai e ngre për herë të parë në apel, ndërkohë që pati mundësi të shumta ta ngrinte në shkallë të parë. Më konkretisht, Paneli vë në dukje se Mustafa: (i) nuk paraqiti përgjigje ndaj kërkesës fillestare të Mbrojtëses së Viktimave për caktimin e ekspertëve të *iMMO*-së;⁴⁰⁶ (ii) nuk kundërshtoi kualifikimet e ekspertëve apo aktekspertizat e tyre, as nuk shprehu dëshirën t'i merrte në pyetje ekspertët,⁴⁰⁷ megjithëse Trupi Gjykses bëri të qartë se pas parashtrimit të aktekspertizave të *iMMO*-së ishin të zbatueshme procedurat sipas rregullës 149(2) deri (5) të

⁴⁰² Shih Vendimin sipas Rregullës 132, para. 1; Urdhrin Gojor mbi Provat lidhur me Viktimën, f. 2519-2521; Urdhrin Gojor mbi Caktimin e *iMMO*-së, f. 2533-2534. Shih gjithashtu Kërkesën e Viktimave mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 23-26, 31(a).

⁴⁰³ Parashtrimi i Aktekspertizave të *iMMO*-së; Aktekspertiza e *iMMO*-së për [REDAKTUAR]; Aktekspertiza e *iMMO*-së për [REDAKTUAR].

⁴⁰⁴ Shih Vendimin sipas Rregullës 132, para. 8, 13(a). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 15, 30. Në përfundim, Trupi Gjykses u mbështet në [REDAKTUAR]. Shih p.sh. Aktgjykimin, para. [REDAKTUAR].

⁴⁰⁵ Vendimi sipas Rregullës 132, para. 12, 13(e). Shih gjithashtu Vendimin mbi Aspekte të Provave, para. 7.

⁴⁰⁶ Shih Vendimin sipas Rregullës 132, poshtëshënimi 1 (ku vihet në dukje se nuk u dorëzua përgjigje).

⁴⁰⁷ Vendimi sipas Rregullës 132, para. 9. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 30, poshtëshënimi 46.

Rregullores;⁴⁰⁸ (iii) nuk bëri të ditur asnjëherë se afati i caktuar nga Trupi Gjykses për kërkesën për paraqitjen e kundërprovave në lidhje me aktekspertizat e *IMMO*-së nuk mjaftonte për përgatitjen e strategjisë, as kërkoi zgjatje të afatit; (iv) informoi shprehimisht se nuk synonte të paraqiste kundërprova në lidhje me aktekspertizat e *IMMO*-së;⁴⁰⁹ dhe (v) nuk i kundërshtoi këto aspekte as në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare, as gjatë deklaratave përmbyllëse. Bazuar në këto arsye, Paneli i Apelit gjykon se Mustafa ka humbur të drejtën për ta kundërshtuar këtë pikë në apel.⁴¹⁰ Gjithashtu, Mustafa nuk demonstroi ekzistencën e rrethanave të veçanta që do të përlligjnin shqyrtimin e parashtrimeve të tij.

172. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 1N të Apelit të Mustafës.

K. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES PËR VENDIN E KRYERJES SË KRIMEVE TË PRETENDUARA (NËNPIKAT 2A PJESËRISHT, 2B, 2C, 2D, 2E PJESËRISHT, 2F, 2H PJESËRISHT)

173. Trupi Gjykses konstatoi se BIA kishte një bazë në Zllash në periudhën e akuzave, e cila ishte nën kontrollin dhe pushtetin e komandantit të BIA-s, Mustafa.⁴¹¹ Gjithashtu ai konstatoi se një nga qëllimet e bazës së BIA-s në Zllash ishte që aty të mbaheshin persona të ndaluar.⁴¹² Duke u bazuar kryesisht në identifikimin fotografik nga dëshmitarë të cilët dhanë dëshmi në sallë të gjyqit,⁴¹³ Trupi Gjykses konstatoi se baza e BIA-s në Zllash përkonte me kompleksin e ndalimit në Zllash si vendi ku u kryen krimet e paraqitura në Aktakuzë.⁴¹⁴

⁴⁰⁸ Shih Vendimin sipas Rregullës 132, para. 7; Urdhrin Gojor mbi Provat lidhur me Viktimën, f. 2521. Shih gjithashtu Transkriptin, 22 prill 2022, f. 4089.

⁴⁰⁹ Kërkesa e Mbrojtjes për Paraqitjen e Kundërprovave, para. 4, 7; Vendimi mbi Aspekte të Provave, para. 13.

⁴¹⁰ Shih më lart, para. 30.

⁴¹¹ Aktgjykimi, para. 353. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 355.

⁴¹² Aktgjykimi, para. 377. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 374-376.

⁴¹³ Aktgjykimi, para. 364-373.

⁴¹⁴ Aktgjykimi, para. 378.

174. Mustafa kundërshton konstatimin e Trupit Gjykses, duke parashtruar se Trupi Gjykses gaboi që: (i) e etiketoi në mënyrë të parakohshme kompleksin e shtëpive në Zllash si kompleks ndalimi (konkretisht, kompleksi i ndalimit në Zllash);⁴¹⁵ (ii) konstatoi se BIA ishte vendosur në atë kompleks;⁴¹⁶ (iii) konstatoi se ai ishte nën “kontrollin” e BIA-s;⁴¹⁷ (iv) hodhi poshtë pretendimin e Mbrojtjes se ZPS-ja ndryshoi qëndrimin e saj lidhur me ndërtesën/ndërtesat konkrete ku pretendohet se u mbajtën të ndaluara viktimat, duke e bërë gjykimin të padrejtë;⁴¹⁸ (v) e gjykoi të besueshëm identifikimin e vendit të ndalimit nga dëshmitarë të ZPS-së;⁴¹⁹ dhe (vi) citoi dhe vlerësoi dëshminë e W04600-s në lidhje me identifikimin e vendit të ndalimit.⁴²⁰ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk ka përmbushur standardin përkatës për rishikim dhe nuk ka vërtetuar gabim në konstatimet e Trupit Gjykses.⁴²¹

1. Pretendimet për gabime në lidhje me “etiketimin” e parakohshëm nga Trupi Gjykses të kompleksit në Zllash si kompleks ndalimi (nënpika 2A pjesërisht)

(a) Parashtrimet e palëve

175. Mustafa parashtron se, në vlerësimin e dëshmitarëve të ZPS-së, Trupi Gjykses gaboi që pranoi si të vërtetë se kompleksi në Zllash ishte kompleks ndalimi, para se të

⁴¹⁵ Dosja e Apelit, para. 83-84; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 83. Një pjesë e argumenteve të Mustafës në nënpikën 2A përkojnë me argumentet e tij në nënpikën 2G dhe janë trajtuar në pjesën ku trajtohet vlerësimi i dëshmitarëve. Shih më poshtë, Pjesën L, para. 249-278.

⁴¹⁶ Dosja e Apelit, para. 92-96; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 83, 85.

⁴¹⁷ Dosja e Apelit, para. 85-91; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 83-85.

⁴¹⁸ Dosja e Apelit, para. 97-114; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 17-21; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 23-33, 36-38.

⁴¹⁹ Dosja e Apelit, para. 115-150, 179; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 86; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 33-36. Paneli vëren se, në Dosjen e Apelit, në nënpikën 2H, Mustafa vetëm i referohet nënpikës 2E dhe nuk bën parashtrime të mëtejshme. Me këtë, Paneli kupton se nënpika 2H tani është përfshirë në nënpikën 2E. Gjithashtu, një pjesë e argumenteve të Mustafës në nënpikat 2E dhe 2H përkojnë me argumentet e tij në nënpikën 2G dhe janë trajtuar në pjesën ku trajtohet vlerësimi i dëshmitarëve. Shih më poshtë, Pjesën L, para. 249-278.

⁴²⁰ Dosja e Apelit, para. 151-157; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 86.

⁴²¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 107-122; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 45-66 (sa u përket nënpikave 2E dhe 2H).

bënte konstatimin faktik.⁴²² Gjithashtu, ai parashtron se Trupi Gjykses “nuk i mori parasysh” dëshmitë e dëshmitarëve znj. Teuta Hadri (“znj. Hadri”), z. Fatmir Sopi (“z. Fatmir Sopi”), z. Sejdi Veseli (“z. Veseli”) dhe z. Fatmir Humolli (“z. Humolli”) – të cilët ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash në periudhën përkatëse dhe thanë se atje nuk ishte mbajtur i ndaluar askush.⁴²³ Mustafa pretendon se është e “tejet e qartë” se Trupi Gjykses përcaktoi në mënyrë të parakohshme se kompleksi në Zllash ishte në fakt një kompleks ndalimi ku ndodhën krimet e paraqitura në Aktakuzë, ndërkohë që ai konstatim bëhet vetëm në paragrafin 348 të Aktgjykimit.⁴²⁴

176. ZPS-ja përgjigjet se “pretendimet e tërthorta” të Mustafës nuk arrijnë të rrëzojnë prezumimin e fortë për paanshmëri të Trupit Gjykses.⁴²⁵ ZPS-ja shton se Mustafa shtrembëron karakterin dhe qëllimin e Aktgjykimit, që është produkt i kuvendimeve të Trupit Gjykses mbi akuzat në Aktakuzë, dhe se Trupi Gjykses mund ta organizojë Aktgjykimin ashtu si e gjykon të arsyeshme.⁴²⁶

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

177. Në këtë nënpikë, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses e etiketoi në mënyrë të parakohshme kompleksin e Zllashit si kompleks *ndalimi*. Nëse ai synon që ky parashtrim të kuptohet si pretendim për njëanshmëri të Trupit Gjykses gjatë vlerësimit të provave relevante,⁴²⁷ Paneli vëren se Mustafa nuk paraqet asnjë argument

⁴²² Dosja e Apelit, para. 83-84; Njoftimi për Apel, nënpika 2A, para. 5. Mustafa përmend në veçanti vlerësimin e dëshmitarëve të ZPS-së W01679, W03593, W04669 dhe W03594. Shih Dosjen e Apelit, para. 83(a)-(e). Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 82; Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 83.

⁴²³ Dosja e Apelit, para. 83(f)-(h). Argumenti i Mustafës se Trupi Gjykses “nuk i mori parasysh” dëshmitë e dëshmitarëve që pretenduan se në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk u mbajt i ndaluar askush, përkon me argumentet e tij në nënpikën 2G dhe rrjedhimisht, trajtohet në kuadër të asaj nënpike. Shih më poshtë, para. 271-278. Shih gjithashtu nënpikat 2E dhe 2H, ku Mustafa paraqet të njëjtat argumente. Shih më poshtë, para. 250.

⁴²⁴ Dosja e Apelit, para. 83(i)-(j), 84.

⁴²⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 108.

⁴²⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 109.

⁴²⁷ Shih Dosjen e Apelit, para. 83-84.

që mund të rrëzojë prezumimin e paanshmërisë së gjykatësve të Trupit Gjykses.⁴²⁸
Rrjedhimisht, Paneli e hedh poshtë këtë pretendim.

178. Paneli i Apelit gjykon se fakti që pjesa e Aktgjykimit ku bëhet vlerësimi i përgjithshëm i besueshmërisë së dëshmitarëve të ZPS-së dhe i mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre⁴²⁹ i paraprin konstatimeve të Trupit Gjykses mbi vendin e krimeve, nuk është relevant, sepse trupat gjykses kanë diskrecion t'i organizojnë aktgjykimet ashtu si e gjykojnë të arsyeshme.⁴³⁰ Mustafa nuk demonstroi gabim të Trupit Gjykses në ushtrimin e diskrecionit në këtë aspekt, as se një gabim i tillë, nëse vërtetohet, do të ndryshonte rezultatin e Aktgjykimit. Një lexim i thjeshtë i pjesëve përkatëse të Aktgjykimit nuk përmban asnjë tregues se Trupi Gjykses "paragjykoj" llojin dhe qëllimin e kompleksit të ndalimit në Zllash para se të dëgjonte dhe vlerësonte dëshmitë, apo se nuk dha mendim të arsyetuar lidhur me atë përcaktim. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon pjesërisht nënpikën 2 A të Apelit të Mustafës.⁴³¹

2. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për vendosjen e BIA-s në kompleks (nënpika 2C)⁴³²

(a) Parashtrimet e palëve

179. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se BIA ishte e vendosur në një kompleks specifik dhe, veçanërisht, që Trupi Gjykses e citoi gabim Mustafën kur bëri atë konstatim.⁴³³ Sipas Mustafës, gjatë intervistës me ZPS-në ai shpjegoi thjesht se "në atë kompleks ishte një shtëpi ku mund të qëndronin ai dhe të

⁴²⁸ Shih më lart, para. 40.

⁴²⁹ Shih Aktgjykimin, para. 49, 58-137.

⁴³⁰ *Mladić* Appeal Judgement, para. 243.

⁴³¹ Pjesa tjetër e nënpikës 2A është trajtuar në pjesën ku trajtohet vlerësimi i dëshmitarëve. Shih më poshtë, Pjesën L, para. 218-278.

⁴³² Paneli i Apelit do të trajtojë në fillim parashtrimin e Mustafës në nënpikën 2C, lidhur me atë nëse BIA ishte vendosur në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe më pas do të trajtojë parashtrimin në nënpikën 2B lidhur me atë nëse kompleksi i ndalimit ishte nën kontrollin e BIA-s.

⁴³³ Dosja e Apelit, para. 92-93, që i referohet Aktgjykimit, para. 349; Njoftimi për Apel, nënpika 2C, para. 5. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 82, 89, 94-96; Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 83-85.

tjerë” dhe se, në skicën që e vizatoi gjatë intervistës, ai nuk shkroi vetëm “BIA”, por edhe “UÇK”, që do të thotë se shtëpinë e përdornin edhe ushtarë të tjerë të UÇK-së.⁴³⁴

180. ZPS-ja përgjigjet se pretendimi i Mustafës se Trupi Gjykses e citoi gabim është shtrembërim, sepse Trupi Gjykses nuk e citoi Mustafën fjalë për fjalë, por vetëm përshkroi “atë që kishte pranuar ai vetë”.⁴³⁵

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

181. Trupi Gjykses vuri në dukje se vetë i akuzuari, në deklaratat e mëparshme, dha dëshmi për praninë e anëtarëve të BIA-s në Zllash gjatë periudhës së akuzave dhe tha se BIA ishte e vendosur në kompleks specifik, në një “bazë të sigurt”.⁴³⁶ Bazuar në pohimin e Mustafës se ishte komandant i BIA-s, Trupi Gjykses konstatoi se ai kishte njohuri të drejtpërdrejtë për atë vend dhe kjo e bën atë personin më të përshtatshëm për ta përshkruar vendin në mënyrë të saktë dhe të besueshme.⁴³⁷ Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se kishte dëshmi gojore konfirmuese nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Fatmir Sopi, z. Veseli dhe W04600, se kompleksi ishte nën kontrollin e BIA-s.⁴³⁸

182. Paneli i Apelit vëren se, ndonëse Mustafa pretendon se Trupi Gjykses e “citoi gabim” atë kur u shpreh se “Mustafa deklaroi se BIA ishte vendosur në një kompleks specifik ndërtesash”, Trupi Gjykses në fakt nuk citoi drejtpërdrejt Mustafën në lidhje

⁴³⁴ Dosja e Apelit, para. 92. Mustafa shton se ai foli vetëm për një a dy dhoma të quajtura “shtëpi e sigurt” që shfrytëzohej nga anëtarët e BIA-s, dhe bëri të qartë se “kishin qenë mysafirë” aty. Shih Dosjen e Apelit, para. 95, që i referohet P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 5. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 85. Megjithëse, Mustafa nuk jep referencat për skicat që i vizatoi gjatë intervistës me ZPS-së, Paneli kupton se ai e ka fjalën për P00110. Shih P00110 (konfidenciale).

⁴³⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 115, që i referohet Aktgjykimit, para. 34

9. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 114. Në lidhje me kontrollin e BIA-s mbi kompleksin e ndalimit në Zllash, ZPS-ja përgjigjet më tej edhe në nënpikën 2B. Shih më poshtë, para. 185.

⁴³⁶ Aktgjykimi, para. 349.

⁴³⁷ Aktgjykimi, para. 349.

⁴³⁸ Aktgjykimi, para. 352.

me këtë aspekt, por vetëm rikujtoi çfarë ishte thënë prej tij në deklaratë.⁴³⁹ Sipas Panelit, Trupi Gjykses përsëriti me saktësi përmbajtjen e deklaratave të Mustafës,⁴⁴⁰ duke qenë se Mustafa në fakt kishte konfirmuar praninë e ushtarëve të BIA-s, përfshirë të atij vetë në kompleks gjatë periudhës përkatëse.⁴⁴¹ Paneli i Apelit vëren gjithashtu se Trupi Gjykses konstatoi se këto prova u konfirmuan edhe nga dëshmitarë të tjerë dhe më tej vëren se, në apelin e tij, Mustafa nuk kundërshton konstatimin e Trupit Gjykses për ekzistencën e provave konfirmuese në lidhje me këtë.⁴⁴² Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në vlerësimin e deklaratave të Mustafës nga Trupi Gjykses dhe në konstatimet përkatëse të tij.⁴⁴³ Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e Mustafës në lidhje me këtë aspekt.

183. Bazuar në sa më lart, Paneli rrëzon nënpikën 2C të Apelit të Mustafës.

⁴³⁹ Shih Aktgjykimin, para. 349.

⁴⁴⁰ Aktgjykimi, para. 349, poshtëshënimi 709, që i referohet P00118 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 1-4.

⁴⁴¹ Shih p.sh. P00118 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 2-4, 7 (ku Mustafa pranoi se kishte qëndruar në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe që ushtarët e tij kishin fjetur aty); P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 5 (ku Mustafa tha se e kishte vizituar shtëpinë e sigurt në kompleksin e ndalimit në Zllash “shumë herë” sepse ushtarët e tij flinin aty); P00113 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 18 (ku Mustafa, megjithëse kundërshtoi sugjerimin e ZPS-së se ushtarët e BIA-s ishin “vendosur” në Zllash, konfirmoi “prezencën” e tyre), 20 (ku Mustafa konfirmoi se kishte kaluar disa ditë në shtëpinë e sigurt).

⁴⁴² Shih Aktgjykimin, para. 350-351 dhe provat e cituara aty. Megjithatë, Mustafa kundërshton në veçanti citimin dhe vlerësimin vijues nga Trupi Gjykses të dëshmisë së W04600-s lidhur me një aspekt të identifikimit të kompleksit të ndalimit në Zllash në nënpikën 2F më poshtë. Shih më poshtë, para. 213-217.

⁴⁴³ Sa i takon argumentit të Mbrojtjes se Trupi Gjykses e “citoi gabim” Mustafën në lidhje me këtë aspekt, Paneli i Apelit vëren se e vetmja referencë e cituar në thonjëza nga Trupi Gjykses ishte “shtëpia e sigurt” – një term që Mustafa pranon se e përdori në deklaratën si i dyshuar. Shih Aktgjykimin, para. 349; Dosjen e Apelit, para. 95, që i referohet P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 5. Shih gjithashtu P00113 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 14, 17-18, 20.

3. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses për “kontrollin” e BIA-s mbi kompleksin e ndalimit në Zllash (nënpika 2B)

(a) Parashtrimet e palëve

184. Mustafa parashtron se konstatimi i Trupit Gjykses, që mori si të mirëqenë se kompleksi i ndalimit në Zllash “kontrollohej” nga BIA, ishte i gabuar.⁴⁴⁴ Në lidhje me këtë, ai pretendon se Trupi Gjykses e citoi vetëm pjesërisht dëshminë e z. Fatmir Sopi dhe se dëshmia e tij nuk e mbështet këtë konstatim.⁴⁴⁵ Ai pretendon gjithashtu se Trupi Gjykses keqinterpretoi praninë e BIA-s në kompleks dhe gabo i që u mbështet në dëshminë e W04600-s dhe të z. Veseli si konfirmuese të dëshmisë së z. Fatmir Sopi, kur konstatoi se kompleksi ishte nën “kontrollin” e BIA-s.⁴⁴⁶ Në lidhje me këtë, Mustafa argumenton se faktikisht asnjëri prej tyre nuk ishte i pranishëm në kompleks gjatë periudhës së akuzave.⁴⁴⁷ Së fundi, Mustafa parashtron se ai vetë nuk tha asnjëherë në deklaratën si i dyshuar se kompleksi ishte nën kontrollin e tij ose të BIA-s.⁴⁴⁸

185. ZPS-ja përgjigjet se Mustafa “shtrembëron në mënyrë përzgjedhëse” dëshmitë e z. Fatmir Sopi, të W04600-s dhe të z. Veseli, sepse: (i) z. Fatmir Sopi dëshmoi se kompleksi i ndalimit në Zllash konsiderohej si bazë e BIA-s dhe se Mustafa ishte komandant i BIA-s; (ii) W04600 [REDAKTUAR] që në gjendje të përshkruante planimetrinë e kompleksit të ndalimit në Zllash dhe të vizatonte skicën; (iii) z. Veseli

⁴⁴⁴ Dosja e Apelit, para. 85; Njoftimi për Apel, nënpika 2B, para. 5. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 82, 93, 95-96; Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 83.

⁴⁴⁵ Dosja e Apelit, para. 85, 87-88. Mustafa parashtron gjithashtu se z. Fatmir Sopi dëshmoi se në atë vend nuk kishte asnjë gjë të veçantë dhe se ajo ishte një shtëpi e zakonshme. Shih Dosjen e Apelit, para. 87. Për më tepër, Mustafa shton se kompleksin e shfrytëzonin persona të tjerë, si ushtarët e UÇK-së të “zonës së Karadakut”. Shih Dosjen e Apelit, para. 86.

⁴⁴⁶ Dosja e Apelit, para. 89.

⁴⁴⁷ Dosja e Apelit, para. 90-91. Megjithatë, Paneli vëren se gjatë seancës së Apelit, Mbrotjtja tha se z. Veseli ishte “komandant i UÇK-së që e njihte kompleksin” dhe se Trupi Gjykses gabo i që e konstatoi të pagjasë dëshminë e tij se në Zllash nuk kishte persona të ndaluar apo të keqtrajtuar. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 19-21.

⁴⁴⁸ Dosja e Apelit, para. 90. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 95; Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 84-85. Në Njoftimin për Apel, Mustafa argumenton gjithashtu se Trupi Gjykses gabo i që konstatoi se ai dha dëshmi që Mustafa ishte përgjegjës për bazën. Shih Njoftimin për Apel, nënpika 2B, para. 5.

“kishte dijëni për kompleksin e ndalimit në Zllash dhe për BIA-n që ishte e vendosur aty”, dhe pa shpesh anëtarë të njësitit BIA, përfshirë Mustafën, në Zllash në prill 1999; dhe (iv) vetë Mustafa, në deklaratën si i dyshuar, tha qartë se BIA ishte vendosur në një vend specifik në Zllash në prill 1999 dhe se ai ishte komandant i BIA-s.⁴⁴⁹

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

186. Sa i përket vlerësimit nga Trupi Gjykses të dëshmisë së z. Fatmir Sopi në lidhje me kontrollin e BIA-s mbi kompleksin, Paneli vëren se z. Fatmir Sopi dëshmoi se kompleksi ku ishte vendosur BIA ishte pikë e vërtetë ushtarake⁴⁵⁰ dhe konsiderohej “baza e Skifterëve ose baza e gueriljes”,⁴⁵¹ si edhe se Mustafa ishte komandant i BIA-s.⁴⁵² Në kundërshtim me parashtrimet e Mustafës, Paneli i Apelit pajtohet me Trupin Gjykses se dëshmia e z. Fatmir Sopi mbështet konstatimin se kompleksi ishte nën kontrollin e BIA-s e cila e përdorte atë si bazë.⁴⁵³

187. Paneli i Apelit vëren gjithashtu se Trupi Gjykses shqyrtoi prova, ndër to edhe dëshminë e z. Fatmir Sopi, të cilat tregojnë se gjatë periudhës përkatëse, në bazën e BIA-s në Zllash mund të kenë qenë të pranishëm ndonjëherë edhe ushtarë nga njësite të tjera të UÇK-së apo civilë.⁴⁵⁴ Paneli gjykon se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se këto prova nuk e ndryshonin konstatimin se baza në fakt ishte nën kontrollin e BIA-s.⁴⁵⁵

⁴⁴⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 111-114. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 116.

⁴⁵⁰ Transkripti (Fatmir Sopi), 18 janar 2022, f. 2049.

⁴⁵¹ Transkripti (Fatmir Sopi), 18 janar 2022, f. 2089. Shih gjithashtu Transkriptin (Fatmir Sopi), 19 janar 2022, f. 2172.

⁴⁵² Transkripti (Fatmir Sopi), 18 janar 2022, f. 2060.

⁴⁵³ Aktgjykimi, para. 352. *Contra* Dosja e Apelit, para. 85, 88. Gjithashtu, përgjigja e z. Fatmir Sopi ndaj pyetjes se pse BIA shfrytëzonte pikërisht atë vend – konkretisht që në atë vend nuk kishte “asnjë gjë të veçantë” dhe se “ajo ishte një shtëpi e zakonshme” – nuk cenon saktësinë e konstatimit të Trupit Gjykses. Shih Transkriptin (Fatmir Sopi), 18 janar 2022, f. 2090. Shih gjithashtu Transkriptin (Fatmir Sopi), 19 janar 2022, f. 2172 (ku z. Fatmir Sopi saktëson se ajo bazë nuk kishte asgjë të veçantë dhe ishte “sikur të gjitha bazat e tjera të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”).

⁴⁵⁴ Aktgjykimi, para. 352. Shih Dosjen e Apelit, para. 86, 92.

⁴⁵⁵ Aktgjykimi, para. 352.

188. Sa i përket pretendimit të Mustafës se W04600 dhe z. Veseli nuk kishin njohuri faktike për këtë kontroll sepse nuk ishin të pranishëm në kompleks gjatë periudhës përkatëse të Aktakuzës,⁴⁵⁶ Paneli i Apelit vëren se Mustafa shtrembëron dëshmitë e tyre. Në fakt, dhe sikurse rikujtoi Trupi Gjykses, W04600, [REDAKTUAR],⁴⁵⁷ dëshmoi se [REDAKTUAR].⁴⁵⁸ W04600 shpjegoi se [REDAKTUAR],⁴⁵⁹ si edhe se [REDAKTUAR].⁴⁶⁰ Paneli konstatoi se W04600 ishte [REDAKTUAR].⁴⁶¹ Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e Mustafës në lidhje me dëshminë e W04600-s.

189. Në lidhje me dëshminë e z. Veseli, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses u mbështet veçanërisht në dëshminë gojore të tij kur konstatoi se BIA kishte një bazë në Zllash⁴⁶² e cila ishte nën kontrollin e të akuzuarit.⁴⁶³ Megjithëse z. Veseli dëshmoi se nuk kishte hyrë asnjëherë në bazën e BIA-s,⁴⁶⁴ Paneli gjykon se nuk ishte e paarsyeshme që Trupi Gjykses të merrte parasysh dijeninë e z. Veseli që BIA ishte e vendosur në atë bazë.⁴⁶⁵ Në fakt, Trupi Gjykses vuri në dukje se: (i) z. Veseli ishte zëvendëskomandant i Brigadës 153 gjatë periudhës së Aktakuzës;⁴⁶⁶ (ii) ai e kishte bazën në shtabin e Brigadës 153, që gjendej shumë afër kompleksit të ndalimit në

⁴⁵⁶ Dosja e Apelit, para. 90-91.

⁴⁵⁷ Aktgjykimi, para. 101, [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu Transkriptin (W04600), 23 shtator 2021, f. [REDAKTUAR].

⁴⁵⁸ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu, ndër të tjera, Transkriptin (W04600), 23 shtator 2021, f. 722-723 (redaktuar); Transkriptin (W04600), 24 shtator 2021, f. 801-803 (redaktuar).

⁴⁵⁹ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu Transkriptin (W04600), 23 shtator 2021, f. 721, 728-729 (redaktuar).

⁴⁶⁰ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu Transkriptin (W04600), 23 shtator 2021, f. [REDAKTUAR].

⁴⁶¹ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

⁴⁶² Aktgjykimi, para. 352, poshtëshënimi 719, që i referohet, ndër të tjera, Transkriptit (Sejdi Veseli), 25 janar 2022, f. 2195-2197.

⁴⁶³ Aktgjykimi, para. 352, poshtëshënimi 720, që i referohet, ndër të tjera, Transkriptit (Sejdi Veseli), 25 janar 2022, f. 2198-2199.

⁴⁶⁴ Transkripti (Sejdi Veseli), 25 janar 2022, f. 2197. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 90-91.

⁴⁶⁵ Aktgjykimi, para. 352, poshtëshënimet 719-721.

⁴⁶⁶ Aktgjykimi, para. 344 dhe referencat e cituara aty. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 124.

Zllash;⁴⁶⁷ dhe (iii) z. Veseli deklaroi se e njihnte të akuzuarin,⁴⁶⁸ i cili ishte shpesh në Zllash në prill 1999.⁴⁶⁹ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se nuk ka gabim në konstatimin e Trupit Gjykses në lidhje me dëshminë e z. Veseli.⁴⁷⁰

190. Sa i përket kundërshtimit të Mustafës ndaj mbështetjes së Trupit Gjykses në deklaratën e të akuzuarit si i dyshuar dhe përdorimin e saj si dëshmi konfirmuese,⁴⁷¹ Paneli i Apelit vëren se, megjithëse Mustafa nuk tha se kompleksi ishte nën kontrollin e BIA-s, ai pranoi qartë se ishte komandant i BIA-s⁴⁷² si edhe se BIA kishte “nën kontroll” një vend specifik në kompleksin e ndalimit në Zllash.⁴⁷³ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se nuk ka gabim në konstatimin e Trupit Gjykses në lidhje këtë pikë.

191. Bazuar në sa më lart, Paneli rrëzon nën pikën 2B të Apelit të Mustafës.

4. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses për “ndryshimin” e qëndrimit të ZPS-së sa i përket vendit të krimeve (nënpika 2D)

(a) Parashtrimet e palëve

192. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh pretendimin e tij se ZPS-ja mashtrroi Mbrojtjen sepse e ndryshoi qëndrimin e saj lidhur me

⁴⁶⁷ Aktgjykimi, para. 342. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 124; Transkriptin (Sejdi Veseli), 25 janar 2022, f. 2192, 2194-2195, 2197, 2226.

⁴⁶⁸ Aktgjykimi, para. 127, që i referohet Transkriptit (Sejdi Veseli), 25 janar 2022, f. 2202-2203. Shih gjithashtu Transkriptin (Sejdi Veseli), 25 janar 2022, f. 2195-2196.

⁴⁶⁹ Aktgjykimi, para. 330, që i referohet Transkriptit (Sejdi Veseli), 25 janar 2022, f. 2233. Shih gjithashtu Aktgjykimin, poshtëshënimi 219.

⁴⁷⁰ Paneli i Apelit vëren se, në seancën e Apelit, vetë Mbrojtja deklaroi se z. Veseli ishte “komandant i UÇK-së që e njihnte kompleksin” dhe argumentoi se Trupi Gjykses duhej të kishte marrë parasysh dëshminë dhe njohuritë e tij për Zllashin. Kjo deklaratë bie ndesh me argumentin e Mustafës në këtë nënpikë të Apelit se z. Veseli nuk kishte njohuri faktike për kontrollin e BIA-s në Zllash, sepse nuk kishte qenë asnjëherë në kompleksin e ndalimit në Zllash. *Krahaso* Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 19-20 *me* Dosjen e Apelit, para. 90-91.

⁴⁷¹ Dosja e Apelit, para. 90. Shih Aktgjykimin, para. 352, poshtëshënimi 721.

⁴⁷² P00111 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 28, 31-32; P00113 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 24; P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 30; P00118 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 7, 34. Shih gjithashtu deklaratën e mëparshme të të akuzuarit në çështjen gjyqësore *Agron Zeqiri*, P00046 (konfidenciale), f. 2, 6-7. Shih Aktgjykimin, para. 203, 338.

⁴⁷³ Shih P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 5 (ku ai thotë: “[unë kam pas nën kontroll me ushtarët e mi qato dy dhomat, që i kemi shfrytëzuar për vete”).

ndërtesën/ndërtesat konkrete në kompleksin e ndalimit në Zllash ku pretendohet se u mbajtën të ndaluara viktimat.⁴⁷⁴ Ai argumenton se gjatë të gjithë gjykimit ZPS-ja specifikoi një ndërtesë konkrete në kompleks ku u mbajtën të ndaluarit,⁴⁷⁵ ndërsa kur iu përgjigj kërkesës së Trupit Gjykses për sqarim “diku nga fundi i gjykimit”, ZPS-ja ndryshoi qëndrim dhe argumentoi se të ndaluarit nuk u mbajtën në një ndërtesë, por në tri ndërtesa.⁴⁷⁶ Bazuar në këtë, Mustafa kundërshton konstatimin e Trupit Gjykses se “për marrjen e vendimit në lidhje me akuzat, nuk është e rëndësishme të vlerësohet me saktësi absolute se në cilën prej këtyre ndërtesave u mbajt secili prej të ndaluarve, dhe për sa kohë” dhe argumenton se ndryshimi i qëndrimit të ZPS-së e bën procesin gjyqësor të padrejtë.⁴⁷⁷ Gjatë seancës së apelit, Mustafa theksoi më tej se ZPS-ja duhej ta kishte ndryshuar Aktakuzën për të pasqyruar këtë ndryshim⁴⁷⁸ dhe se Trupi Gjykses “nuk mund të plotësojë zbrazëtitë e Aktakuzës, apo t’i ndryshojë a interpretojë ato për t’i bërë që t’u përshtaten akuzave”.⁴⁷⁹

193. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës janë të pasakta nga pikëpamja faktike, sepse në Aktakuzë nuk identifikohet një ndërtesë në kompleksin e ndalimit në Zllash; aty i akuzuari akuzohet për krime që u kryen në kompleksin e ndalimit në

⁴⁷⁴ Njoftimi për Apel, nënpika 2D, para. 5; Dosja e Apelit, para. 97, 108, 113; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 17-21; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 23-33. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 373; Transkriptin, 15 shtator 2022, f. 4771, 4782-4785.

⁴⁷⁵ Dosja e Apelit, para. 97-102, 104; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 23-32, 37-38. Konkretisht, Mustafa u referohet Aktakuzës, Vendimit të Konfirmimit, Dosjes Paraprake të ZPS-së, deklaratës hyrëse të ZPS-së dhe Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, si dhe marrjes në pyetje të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 17, 20-21.

⁴⁷⁶ Dosja e Apelit, para. 103, 105-108, që i referohet, ndër të tjera, Vendimit mbi Deklaratat Përmbyllëse dhe Çështje në lidhje me To. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 27.

⁴⁷⁷ Dosja e Apelit, para. 108, 110-114, që i referohet Aktgjykimit, para. 372. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 20-21; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 28-33, 37-38. Mustafa parashtron se, në qoftë se do të kishte ditur më herët për pretendimin se krimet u kryen në disa ndërtesa, Mbrojtja do t’i kishte marrë në pyetje dëshmitarët ndryshe. Shih Dosjen e Apelit, para. 108-109; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 27-29, 31. Në seancën e apelit, Mbrojtja parashtrroi më tej se do të kishte hetuar dhe do të kishte kërkuar edhe prova ose dëshmitarë të tjerë lidhur me shfrytëzimin e ndërtesave të tjera në kompleks. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 28.

⁴⁷⁸ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 27.

⁴⁷⁹ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 33.

Zllash, pa saktësuar se në cilën nga ndërtesat u kryen krimet.⁴⁸⁰ ZPS-ja pretendon se Trupi Gjykses konstatoi saktë se akuzat në Aktakuzë përfshijnë “të gjitha ndërtesat e bazës së BIA-s në Zllash”.⁴⁸¹ ZPS-ja është e mendimit se Mustafa shpërfill qëllimin dhe kuadrin e Dosjes Paraprake të ZPS-së, e cila nuk është shteruese, por vetëm një përmbledhje e provave që synon të paraqesë ZPS-ja,⁴⁸² si edhe se mbështetja e Mustafës në Vendimin e Konfirmimit “nuk është relevante”, sepse qëllimi i këtij vendimi nuk është që të njoftojë për akuzat.⁴⁸³

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

194. Paneli i Apelit rikujton se Trupi Gjykses konstatoi se të ndaluarit u mbajtën në tri ndërtesa konkrete në kompleksin e ndalimit në Zllash, që gjendeshin “në të majtë të kompleksit”.⁴⁸⁴ Për të arritur në këtë konstatim, Trupi Gjykses theksoi se “për marrjen e vendimit në lidhje me akuzat, nuk është e rëndësishme të vlerësohet me saktësi absolute se në cilën prej këtyre ndërtesave u mbajt secili prej të ndaluarve, dhe për sa kohë”, sepse ai duhet të bindej se krimet për të cilat u ngritën akuzat “u kryen në një ose më shumë prej ndërtesave” në bazën e BIA-s gjatë periudhës që mbulon Aktakuza.⁴⁸⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses hodhi poshtë pretendimin e Mbrojtjes se ZPS-ja “e mashtroi Mbrojtjen sepse e ndryshoi qëndrimin e saj lidhur me ndërtesën/ndërtesat konkrete në kompleksin e ndalimit në Zllash ku pretendohet se u mbajtën të ndaluara viktimat”, duke theksuar se “Mbrojtja pati mundësinë gjatë të gjithë gjykimit që t’u bënte pyetje dëshmitarëve të ZPS-së dhe të paraqiste prova

⁴⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 30-31; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 64-65. ZPS-ja shton se Mustafa nuk kundërshtoi formën e Aktakuzës. Shih Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 31.

⁴⁸¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 34, që i referohet Aktgjykimit, para. 373.

⁴⁸² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 32. ZPS-ja argumenton se e njëjta gjë vlen edhe për argumentet e Mustafës në lidhje me deklaratat hyrëse të ZPS-së. Shih Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 32.

⁴⁸³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 33.

⁴⁸⁴ Aktgjykimi, para. 372, ku Trupi Gjykses konstatoi se ndërtesat e shënuara nga z. Krasniqi, me numrat 4, 4A dhe 5 (pamje nga terreni) që përkojnë përkatësisht me ndërtesat 12, 11 dhe 10 (pamje nga ajri), janë “ndërtesat që lidhen me” akuzat.

⁴⁸⁵ Aktgjykimi, para. 372.

lidhur me kuadrin gjeografik të akuzave, i cili qartësisht përfshin të gjitha ndërtesat e bazës së BIA-s në Zllash”.⁴⁸⁶

195. Sa i përket pretendimit se ZPS-ja e ndryshoi qëndrimin lidhur me vendin e krimeve të pretenduara gjatë gjyqimit, fillimisht Paneli vëren se Mustafa duket se ngatërroi Aktakuzën e Konfirmuar, të dorëzuar nga ZPS-ja, me Vendimin e Konfirmimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.⁴⁸⁷ Paneli e gjykon më të rëndësishme të theksojë se Aktakuza nuk “veçon” një ndërtesë në kompleksin e ndalimit në Zllash, por akuzon Mustafën për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme të kryera në kompleksin e ndalimit në Zllash, pa përcaktuar konkretisht se në cilën nga ndërtesat u kryen krimet e pretenduara.⁴⁸⁸ Në fakt, në Aktakuzë thuhet se gjatë periudhës përkatëse, “njësiti BIA vepronte nga një kompleks që përfshinte një numër ndërtesash në Zllash” dhe se “njësiti BIA e përdorte kompleksin si vendstrehim të sigurt dhe si qendër ndalimi dhe marrjeje në pyetje”.⁴⁸⁹ Paneli vë në dukje gjithashtu se në Vendimin e Konfirmimit Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi se ekzistonte dyshim i bazuar mirë se krimet e pretenduara “u kryen në kompleksin e ndalimit në Zllash”.⁴⁹⁰ Gjithashtu, Paneli vëren se parashtrimet e ZPS-së në Dosjen Paraprake⁴⁹¹ dhe në deklaratat hyrëse të ZPS-së⁴⁹² nuk ishin në kundërshtim me formulimin e Aktakuzës, por paraqitën hollësi të mëtejshme në lidhje me vendin e krimeve të pretenduara.⁴⁹³

⁴⁸⁶ Aktgjykimi, para. 373.

⁴⁸⁷ Shih Dosjen e Apelit, para. 97, 99. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 31-32, 37-38.

⁴⁸⁸ Aktakuza, para. 5, 18, 21, 31-32, 35. *Contra* Dosja e Apelit, para. 97. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 36.

⁴⁸⁹ Aktakuza, para. 5.

⁴⁹⁰ Shih për shembull, Vendimin e Konfirmimit, para. 102, 110, 115, 120. Shih gjithashtu Vendimin e Konfirmimit, para. 125-127, 132, 135, 143, 147, 149-150.

⁴⁹¹ Shih për shembull, Dosjen Paraprake të ZPS-së, para. 2-4, 30, 51-59, 63, 74, 82, 91, 104-105, 107, 109, 111, 116-117, 119-123, 125, që i referohet “kompleksit të ndalimit në Zllash”.

⁴⁹² Shih për shembull, Transkriptin, 15 shtator 2021, f. 319-321, 324, 327-328.

⁴⁹³ *Krahaso* Aktakuzën, para. 5, 18, 21, 31-32, 35 me Dosjen Paraprake të ZPS-së, para. 1-2, 29-30, 64, 69, 71, 73; Transkripti, 15 shtator 2021, f. 328-329.

196. Paneli rikujton se Aktakuza është instrumenti kryesor akuzues që paraqet me konkretësi dhe qartësi të mjaftueshme faktet në të cilat bazohen akuzat për krime, me qëllim që i akuzuari të informohet për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij dhe t'i mundësohet përgatitja e mbrojtjes së njëmendtë.⁴⁹⁴ Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se Mustafa nuk paraqiti kundërshtime për formën e Aktakuzës, përfshirë nëse ishte e mjegullt apo e paqartë lidhur me vendin ku u kryen krimet, me anë të një mocioni paraprak,⁴⁹⁵ ose gjatë gjykimit.⁴⁹⁶

197. Gjithashtu, Paneli gjykon se në Parashtrimet e ZPS-së mbi Deklaratat Përmbyllëse dhe Çështje në lidhje me To, ZPS-ja nuk e modifikoi kuadrin gjeografik të Aktakuzës dhe të pretendimeve të paraqitura në të, por thjesht specifikoi, në bazë të provave të paraqitura gjatë gjykimit, se në cilën nga ndërtesat në kompleksin e ndalimit në Zllash pretendohet se u kryen krimet.⁴⁹⁷ Paneli vëren se kompleksi i ndalimit në Zllash është një vend relativisht i vogël dhe se tri ndërtesat ishin ngjitur me njëra-tjetrën.⁴⁹⁸

198. Bazuar në sa më lart, Paneli e konstaton të pabazë pretendimin e Mustafës se ZPS-ja e mashtroi Mbrojtjen duke ndryshuar qëndrimin e saj për vendin e kryerjes së

⁴⁹⁴ Vendimi i Apelit mbi Mocionet Paraprake në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 35-36, 49 dhe referencat e cituara aty. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit mbi Mangësi në Aktakuzë në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 17-19; Vendimin e Apelit mbi Mangësi në Aktakuzë në Çështjen *Shala*, para. 15; *Blaškić Appeal Judgement*, para. 220.

⁴⁹⁵ Shih nenin 40(1) të Ligjit dhe rregullën 97(1)(b) të Rregullores në lidhje me pretendimet për mangësi në formën e Aktakuzës.

⁴⁹⁶ Paneli vëren se argumentin që ZPS-ja duhej të kishte ndryshuar Aktakuzën, Mbrojtja e ngriti për herë të parë gjatë seancës së apelit. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 27.

⁴⁹⁷ *Krahaso* Aktakuzën, para. 5, 18, 21, 31-32, 35 me Parashtrimet e ZPS-së mbi Deklaratat Përmbyllëse dhe Çështje në lidhje me To; Transkripti, 13 shtator 2022, f. 4525-4527. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 372. Paneli vëren gjithashtu se në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, ajo përmendi “të paktën dy ndërtesa në kompleksin e ndalimit në Zllash” ku anëtarë të BIA-s, përfshirë të akuzuarin, ndaluan, morën në pyetje dhe torturuan civilë shqiptarë të Kosovës. Shih Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, para. 23. Shih gjithashtu Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, para. 24-27.

⁴⁹⁸ Shih D00016 (konfidenciale); D00014 (konfidenciale). Në seancën e apelit, Mbrojtja tha se i gjithë kompleksi “është më i vogël se një e katërta e një fushe futbollit”. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 40.

krimeve të pretenduara dhe se, për pasojë, procesi gjyqësor ishte i padrejtë.⁴⁹⁹
Rrjedhimisht, Paneli rrëzon nënpikën 2D të Apelit të Mustafës.

5. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi aftësinë e dëshmitarëve të ZPS-së që të identifikonin kompleksin e ndalimit në Zllash (nënpikat 2E pjesërisht, 2H pjesërisht)

(a) Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

199. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim faktik që konstatoi se dëshmitarët W01679, W03593 dhe W04669 të ZPS-së mundën të identifikonin dhe përshkruanin vendin konkret të ndalimit në kompleksin e ndalimit në Zllash, me gjithë pranimin prej Trupit Gjykses se këta dëshmitarë nuk ishin në gjendje ta vrojtonin vendin mjaftueshëm.⁵⁰⁰

200. Sipas Mustafës, identifikimi fotografik nga W01679, W03593 dhe W04669 në sallën e gjyqit nuk mund të përbëjë identifikim të mirëfilltë të ndërtesës ku pretendohet se u mbajtën të ndaluar.⁵⁰¹ Ai argumenton se këto dëshmi nuk mbështesin konstatimin e Trupit Gjykses se këta dëshmitarë “duhet t’i kenë parë më parë ndërtesat të cilat më pas i njohën në sallën e gjyqit”,⁵⁰² sepse ata: (i) nuk e njohnin vendin e ndalimit;⁵⁰³ (ii) dëshmuuan se secili prej tyre e kishte kokën të mbuluar me

⁴⁹⁹ Aktgjykimi, para. 373.

⁵⁰⁰ Njoftimi për Apel, nënpika 2E, para. 5; Njoftimi për Apel, nënpika 2H, para. 5; Dosja e Apelit, para. 82, 115, 141-142, 149; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 33-35. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 86. Duke marrë parasysh që në nënpikën 2H Mustafa i referohet nënpikës 2E, Paneli gjykon se nënpika 2H përfshihet në nënpikën 2E. Shih Dosjen e Apelit, para. 179. Në seancën e apelit, Mustafa parashtrroi më tej se “të tre dëshmitarët” jo vetëm që nuk identifikuan vendin ku u mbajtën të ndaluar, por edhe se identifikimi i të akuzuarit prej tyre nuk ishte “identifikimi i duhur”. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 38-39. Paneli nuk do ta trajtojë këtë argument, i cili tejkalon kuadrin e Njoftimit për Apel.

⁵⁰¹ Dosja e Apelit, para. 120, 125-127, 136, 139. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 119, 124, 141-142; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 34-36. Në seancën e apelit, Mustafa theksoi më tej se “asnjë dëshmitar, në asnjë rast, nuk tregoi ndërtesën specifike [të identifikuar nga ZPS-ja në deklaratën hyrëse], dhe vetëm një prej tyre tha thjesht se ajo i ngjante ndërtesës ku pretendohet se ishte mbajtur”. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 30.

⁵⁰² Dosja e Apelit, para. 116, 122, 125.

⁵⁰³ Dosja e Apelit, para. 116 (W01679), 121 (W03593).

thes kur e arrestuan dhe kur e transferuan për t'u marrë në pyetje;⁵⁰⁴ dhe (iii) nuk i kushtuan vëmendje vendit të ndalimit pasi u liruan, as nuk e përshkruan atë gjatë dhënies së dëshmisë.⁵⁰⁵

201. Gjithashtu, Mustafa parashtron se në kundërshtim me konstatimin e Trupit Gjykses: (i) skica e vendit të ndalimit që vizatoi W03593 nuk është relevante për besueshmërinë e tij;⁵⁰⁶ (ii) dëshmia e W04669-ës se vendi nuk ishte më larg se 200 metra nga shkolla e Zllashit, që ai e vizitoi në disa raste, është “në mospërputhje të plotë” me situatën faktike;⁵⁰⁷ dhe (iii) W04669 nuk e identifikoi vetë ndërtesën, por tha se dikush tjetër kishte bërë shënime në fotografitë që ia treguan,⁵⁰⁸ dhe identifikoi një “ndërtesë krejt tjetër” nga ajo që identifikuan W01679 dhe W03593.⁵⁰⁹ Mustafa argumenton gjithashtu se fotografitë që iu treguan secilit dëshmitar ishin sugjeruese dhe në to shihej gjithmonë një ndërtesë dykatëshe.⁵¹⁰

202. Krahas kësaj, Mustafa argumenton se identifikimi i vendit nga W04600 nuk është relevant, sepse ai nuk dëshmoi asnjëherë se aty ishte mbajtur i ndaluar ndonjë person.⁵¹¹ Së fundi, Mustafa vë në dukje dëshmitë kundërshtuese të dëshmitarëve të cilët mohuan se në kompleksin e ndalimit në Zllash ishte mbajtur ndokush i ndaluar.⁵¹²

⁵⁰⁴ Dosja e Apelit, para. 116-117 (W01679), 121 (W03593), 130, 134 (W04669). Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 30, 34-35.

⁵⁰⁵ Dosja e Apelit, para. 116, 118 (W01679), 121-123 (W03593), 135 (W04669), 141.

⁵⁰⁶ Dosja e Apelit, para. 124.

⁵⁰⁷ Dosja e Apelit, para. 131, 137.

⁵⁰⁸ Dosja e Apelit, para. 132.

⁵⁰⁹ Dosja e Apelit, para. 133. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 22. Mustafa argumenton gjithashtu se rrethoja që përshkroi W04669 në sallën e gjyqit nuk është tipar dallues i vendit. Shih Dosjen e Apelit, para. 138.

⁵¹⁰ Dosja e Apelit, para. 140; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 34. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 119-120, 128-129, 132, 136.

⁵¹¹ Dosja e Apelit, para. 143.

⁵¹² Z. Fatmir Sopi, z. Humolli, z. Selatin Krasniqi, z. Muhamet Ajeti (“z. Ajeti”), znj. Hadri dhe znj. Ibadete Canolli-Kaçiu (“znj. Canolli-Kaçiu”). Dosja e Apelit, para. 144-148. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 149-150. Paneli vëren se Mustafa paraqet argumente lidhur me z. Humolli, z. Selatin Krasniqi, znj. Hadri dhe znj. Canolli-Kaçiu edhe në nënpikën 2G. Shih Dosjen e Apelit, para. 158-177. Paneli i ka trajtuar argumentet përsëritëse në nënpikën 2G. Shih më poshtë, para. 249-278. Edhe pse Mustafa nuk e përmend z. Fatmir Sopi në nënpikën 2G, Paneli e gjykon më të përshtatshme që t'i

203. ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mbrojtja shtrembëron dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës, dhe se parashtrimet e Mustafës duhet të hidhen poshtë sepse nuk përmbushin standardin e rishikimit për pretendimet lidhur me gabime faktike.⁵¹³ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave argumentojnë se këta dëshmitarë ishin në gjendje ta vrojtonin kompleksin e ndalimit në Zllash, sidomos pasi u liruan,⁵¹⁴ dhe secili prej tyre i identifikoi ndërtesat në kompleksin e ndalimit në Zllash në fotografitë që iu treguan.⁵¹⁵ Sa i përket dëshmisë së W04669-ës, Mbrojtësja e Viktimave parashtron gjithashtu se: (i) edhe pse rrathët në fotografitë mund t'i ketë vizatuar dikush tjetër, kjo u bë sipas udhëzimeve të W04669-ës dhe ai i nënshkroi ato;⁵¹⁶ dhe (ii) përshkrimi i ndërtesës nga W046690 "përgjithësisht përkon" me dëshmitë e W03593-shit dhe W01679-ës, megjithëse mund të ketë dallime në hollësitë e imta.⁵¹⁷

204. ZPS-ja argumenton gjithashtu se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykues gaboi në ushtrimin e diskrecionit lidhur me pranimin e dëshmimeve të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës, as që dëshmia e tyre përputhet me përshkrimet e vendit nga dëshmitarët e Mbrojtjes dhe nga W04600.⁵¹⁸ Së fundi, ZPS-ja kundërshton pretendimin e Mustafës se identifikimi fotografik i kompleksit të ndalimit në Zllash

vlerësojë argumentet e Mustafës lidhur me dëshminë e tij në kuadër të asaj nënpike. Shih më poshtë, para. 271-278.

⁵¹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 117-119; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 45-49, 54-55, 59, 61, 64, 66.

⁵¹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 118; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 49-53, 57, 62. Në veçanti, Mbrojtësja e Viktimave parashtron se, megjithëse W03593 tha se nuk i kishte interesuar të shihte përfaqë kur u lirua, sepse i interesonte jeta e tij, ai shpjegoi më pas se kishte parë aq sa të ishte në gjendje të njihnte ndërtesat në fotografitë që iu paraqitën gjatë gjykimit. Mbrojtësja e Viktimave argumenton se dëshmia e W04669-ës nuk e përjashton faktin se ai e kishte parë vendin ku u mbajt i ndaluar.

⁵¹⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 118; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 53, 57-58, 62. Në veçanti, Mbrojtësja e Viktimave parashtron se W01679 dha dëshmi se ndërtesa që iu tregua në fotografi "ngjan shumë" me atë që pa kur u lirua dhe se dëshmia e W04669-ës nuk përjashton faktin që ai e pa vendin ku u mbajt i ndaluar. Mbrojtësja e Viktimave thotë gjithashtu se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, W03593 në fakt e kishte njohur zonën edhe para se të mbahej i ndaluar aty.

⁵¹⁶ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 63.

⁵¹⁷ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 65. Mbrojtësja e Viktimave shton se Mbrojtja nuk identifikon se cilës pjesë të dëshmisë së W04669-ës i referohet. Shih Dosjen e Përgjigjes së Viktimave, para. 64.

⁵¹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 118, 120.

ishite sugjerues dhe parashtrori se gjatë intervistës me ZPS-në, që të tre dëshmitarëve iu tregua një broshurë me fotografi të shumë ndërtesave në Zllash dhe se ata “në mënyrë spontane zgjodhën fotografitë ku shihej kompleksi i ndalimit në Zllash”.⁵¹⁹ ZPS-ja vë në dukje se, për rrjedhojë, këto ishin të vetmet fotografi që ZPS-ja u tregoi dëshmitarëve gjatë dhënies së dëshmisë prej tyre.⁵²⁰

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

205. Paneli vë në dukje se Trupi Gjykses hodhi poshtë kundërshtimet e Mustafës ndaj identifikimit fotografik dhe dëshmive të këtyre dëshmitarëve lidhur me vendin e ndalimit.⁵²¹ Në veçanti, Trupi Gjykses konstatoi se dëshmitarët ishin në gjendje ta përshkruanin siç duhej vendin ku ishin mbajtur të ndaluar⁵²² dhe se, bazuar në dëshmitë e tyre, së bashku me dëshmitë e W04600-s, të z. Fatmir Sopi dhe të z. Selatin Krasniqi, ata “duhet t’i kenë parë më parë ndërtesat të cilat më pas i njohën në sallën e gjyqit”.⁵²³ Në kundërshtim me pretendimin e Mbrojtjes, Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se viktimat e pretenduara nuk i kishin kokat të mbuluara gjatë të gjithë kohës dhe më së paku, në momentin e lirimit, ata patën mundësi ta shihnin vendin e ndalimit.⁵²⁴

206. Paneli i Apelit rikujton se në bazë të rregullës 139(2) të Rregullores, paneli i vlerëson provat në tërësinë e tyre për të përcaktuar nëse janë vërtetuar pretendimet faktike. Duke rikujtuar se trupi gjykses është në pozitën më të mirë për dëgjimin, vlerësimin dhe peshimin e dëshmive të paraqitura gjatë gjykimit, përfshirë të dëshmive të dëshmitarëve,⁵²⁵ Paneli i Apelit nuk i prapëson lehtë konstatimet faktike dhe ndërhyt vetëm kur provat në të cilat është bazuar Trupi Gjykses nuk mund të

⁵¹⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 119.

⁵²⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 119.

⁵²¹ Aktgjykimi, para. 364-371.

⁵²² Aktgjykimi, para. 368. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 364, 366.

⁵²³ Aktgjykimi, para. 368.

⁵²⁴ Aktgjykimi, para. 368.

⁵²⁵ Shih më lart, para. 24, 38.

pranoheshin nga asnjë gjykues i arsyeshem faktesh apo kur vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar.⁵²⁶

207. Konkretisht, sa i përket dëshmisë së W01679-ës, Paneli vëren se Mustafa nuk shpjegon se pse fakti që W01679 nuk e kishte parë kompleksin e ndalimit në Zllash para se të mbahej i ndaluar atje ndikonte në aftësinë e tij për ta identifikuar vendin.⁵²⁷ Gjithashtu, pjesa e dëshmisë së W01679-ës që përmend Mustafa mbështet faktin që dëshmitari në fakt mundi të shihte se ku po e çonin.⁵²⁸ Krahas kësaj, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës, dëshmitari nuk dëshmoi se kishte thes në kokë kur u transferua nga shkolla në vendin e ndalimit, por se ia vunë thesin pasi kishin mbërritur te vendi, “kur jena afru [...] afër do objekteve dikund”.⁵²⁹ Sa i përket pretendimit të Mustafës se “dëshmitari, pas lirit, nuk përshkroi asnjë ndërtesë”, Paneli i Apelit vëren se dëshmia e W01679-ës faktikisht mbështet faktin se ai e pa mjedisin përreth kur u lirua dhe mundi ta identifikonte atë në sallën e gjyqit.⁵³⁰ Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentin e Mustafës se W01679 “[nuk mund] të thoshte se ndërtesa që iu tregua në sallën e gjyqit i ngjante ndërtesës ku u mbajt dhe keqtrajtua”.⁵³¹

208. Sa i përket W03593-shit, Paneli i Apelit vë në dukje se, megjithëse dëshmoi se nuk i kishte kushtuar vëmendje mjedisit kur u lirua,⁵³² ai shpjegoi gjithashtu se kishte

⁵²⁶ Shih më lart, para. 23-24.

⁵²⁷ Shih Dosjen e Apelit, para. 116, 120.

⁵²⁸ Shih Dosjen e Apelit, para. 116(a), që i referohet Transkriptit (W01679), 4 tetor 2021, f. 867.

⁵²⁹ Transkripti (W01679), 4 tetor 2021, f. 867.

⁵³⁰ Transkripti (W01679), 4 tetor 2021, f. 905-906 (W01679 dha dëshmi se, në kohën kur u lirua, ai po qëndronte “para asaj objektit mbetëm aty pak”), 919-920 (ku W01679 dha dëshmi se ndërtesa që iu tregua “po i përngjan shumë asaj pamjes që më ka mbetë mu kur jam liru. Kur e kam pa kështu shumë ngjan edhe shembull edhe është podrumi poshtë edhe është kjo pjesa, që po them, kur na merrshin na çojshin nalt edhe shumë ngjan shumë me atë objekt. Ngjan, mu më duket i ngjajshëm kështu diçka”. *Contra* Dosja e Apelit, para. 116(d).

⁵³¹ Shih Dosjen e Apelit, para. 119.

⁵³² Transkripti (W03593), 21 shtator 2021, f. 516, ku W03593 tha: “kur jam dalë prej atyhit, kam parë shumë njerëz në oborr, jashtë. Dhe ma veç kena kqyr me ik, ka kena mujt. Kena pasur frikë se po na kthenin apet mrena aty e po na mbajnë. As kur jom shku në shtëpinë, as nuk më ka interesu kurrgjë hiç. Veç më ka interesu jeta jeme me shpëtu.” Shih Dosjen e Apelit, para. 121(b).

parë aq sa të ishte në gjendje të njihje ndërtesat në fotografitë që iu paraqitën gjatë gjykimit.⁵³³ Gjithashtu, Paneli vëren se Mustafa shtrembëron dëshminë e W03593-shit, kur argumenton se W03593 nuk e njihje vendin e ndalimit dhe Zllashin në përgjithësi.⁵³⁴ Në fakt, W03593 dëshmoi se [REDAKTUAR].⁵³⁵ Paneli gjykon gjithashtu se, sikurse konstatoi Trupi Gjykses, skica e W03593-shit e vendit ku u mbajt i ndaluar është relevante dhe konfirmon dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë.⁵³⁶

209. Sa i takon W04669-ës, Paneli vë në dukje se Mbrojtja shtrembëron dëshminë e dëshmitarit,⁵³⁷ i cili në fakt tha se, edhe pse “nuk [ka] dashur” të shihte përqark, ai e pa vendin ku ishte mbajtur dhe tha se “prej asaj pozite mund t’i shohësh objektet, të gjitha objektet çka ekzistojnë aty për rreth”.⁵³⁸ Sa u përket argumenteve të Mbrojtjes se W04669 identifikoi një “ndërtesë krejt tjetër” nga ajo që identifikuan W01679 dhe W03593⁵³⁹ dhe tha se vendi ishte 200 metra larg nga shkolla,⁵⁴⁰ Paneli vëren se W04669

⁵³³ Aktgjykimi, para. 368, që i referohet Transkriptit (W03593), 21 shtator 2021, f. 517. Shih gjithashtu Transkriptin (W03593), 21 shtator 2021, f. 558.

⁵³⁴ Shih Dosjen e Apelit, para. 121(c), 122.

⁵³⁵ Transkripti (W03593), 21 shtator 2021, f. 555 (redaktuar); Transkripti (W03593), 20 shtator 2021, f. 401. W03593 dha dëshmi se “kam qenë një herë” në Zllash dhe se, para se të arrestohej, mund të ketë kaluar pranë vendit ku u ndalua. Shih Transkriptin (W03593), 21 shtator 2021, f. 557; Transkriptin (W03593), 22 shtator 2021, f. 609. Shih gjithashtu Transkriptin (W03593), 22 shtator 2021, f. 649 (redaktuar).

⁵³⁶ Transkripti (W03593), 21 shtator 2021, f. 517-518, që i referohet P00020 (konfidenciale), f. 2, ku ai tha se pjesa poshtë (“stalla”) ishte pjesa ku mbaheshin të ndaluarit, dhe pjesa sipër ishte “dhoma e rrahjeve”. Shih Aktgjykimin, para. 368. Paneli vëren se W01679 dha dëshmi se atë dhe të ndaluarit e tjerë i mbajtën në bodrum dhe i çonin sipër për t’i marrë në pyetje dhe keqtrajtuar. Shih Transkriptin (W01679), 4 tetor 2021, f. 920-922. W03594 tha gjithashtu se të ndaluarit i çonin sipër. Shih Transkriptin (W03594), 12 tetor 2021, f. 1073.

⁵³⁷ Mustafa argumenton se W04669 e kishte kokën të mbuluar me thes gjatë transferimit nga njëra ndërtesë në tjetrën dhe se nuk e pa vendin e ndalimit kur u lirua. Shih Dosjen e Apelit, para. 134-135. Paneli vëren se gjatë deklaratave përmbyllëse, Mbrojtja argumentoi të kundërtën, duke thënë se W04669 “nuk e kishte kokën të mbuluar me thes dhe ishte në gjendje të shihte me sy të lirë”. Shih Transkriptin, 14 shtator 2022, f. 4649.

⁵³⁸ Transkripti (W04669), 11 nëntor 2021, f. 1574-1575. Ndër të tjera, W04669 dëshmoi gjithashtu se i pa ndërtesat përreth tij kur shkante në tualet. Shih Transkriptin (W04669), 11 nëntor 2021, f. 1542-1543. *Contra* Dosja e Apelit, para. 130. Gjithashtu, Paneli vëren se Mbrojtja përsëri e shtrembëron dëshminë e dëshmitarit kur argumenton se ai “nuk i identifikoi ndërtesat vetë”. Në fakt, është e qartë nga dëshmia e W04669-ës se gjatë intervistës me ZPS-në, ndërtesat u identifikuan prej tij, por një person tjetër i pranishëm bëri shënimet në dokument sipas identifikimit të tij. Shih Transkriptin (W04669), 10 nëntor 2021, f. 1471-1472. *Contra* Dosja e Apelit, para. 132.

⁵³⁹ Shih Dosjen e Apelit, para. 133.

⁵⁴⁰ Shih Dosjen e Apelit, para. 131, 137.

faktikisht identifikoi të njëjtin grup ndërtesash në fotografinë që iu tregua gjatë gjykimit.⁵⁴¹ Paneli pajtohet me Trupin Gjykues se çfarëdo dallimesh që mund të ketë në përshkrimet e dëshmitarëve të kompleksit, janë për shkak të faktit se të ndaluarit i lëviznin nga ahuri ku mbaheshin të ndaluar në dhomën e marrjes në pyetje dhe të keqtrajtimit dhe, rrjedhimisht, nuk kishin mundësi të shihnin përqark siç duhet.⁵⁴² Gjithashtu, sikurse u konstatua më lart, Paneli gjykon se për marrjen e vendimit në lidhje me akuzat, nuk është e rëndësishme të vlerësohet me saktësi absolute se në cilën prej këtyre ndërtesave u mbajt secili prej të ndaluarve, dhe për sa kohë.⁵⁴³

210. Sa i përket pretendimit të Mustafës se ZPS-ja ua paraqiti dëshmitarëve fotografitë e kompleksit të ndalimit në Zllash në mënyrë “sugjeruese”,⁵⁴⁴ Paneli vëren se gjatë gjykimit Mustafa nuk ngriti kundërshtim për faktin që ZPS-ja u tregoi dëshmitarëve fotografi të të njëjtit grup ndërtesash,⁵⁴⁵ as për pranimin si prova të fotografive në fjalë. Konkretisht, Mustafa nuk dorëzoi përgjigje ndaj kërkesave të ZPS-së për pranimin e provave të paraqitura gjatë marrjes në pyetje prej saj të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës,⁵⁴⁶ ndër të cilat ishin edhe fotografitë, as nuk kundërshtoi

⁵⁴¹ Transkripti (W04669), 10 nëntor 2021, f. 1470-1472, që i referohet P00202 (konfidenciale), f. 3 (ku W04669 identifikoi ndërtesën e parë, në të majtë të fotografisë); Transkripti (W01679), 4 tetor 2021, f. 919-925; P00029 (konfidenciale), f. 3; Transkripti (W03593), 21 shtator 2021, f. 512-518; P00018 (konfidenciale), f. 3.

⁵⁴² Aktgjykimi, para. 369.

⁵⁴³ Shih më lart, para. 194-198.

⁵⁴⁴ Dosja e Apelit, para. 128-129, 140.

⁵⁴⁵ Shih p.sh. Transkriptin (W01679), 4 tetor 2021, f. 919-926 (ku ZPS-ja i paraqet dëshmitarit P00029 (konfidenciale), f. 3, 5-6; P00065 (konfidenciale), f. 3; P00030 (konfidenciale)); Transkriptin (W03593), 21 shtator 2021, f. 512-518 (ku ZPS-ja i paraqet dëshmitarit P00018 (konfidenciale), f. 3; P00065 (konfidenciale), f. 3); Transkriptin (W04669), 10 nëntor 2021, f. 1470-1472 (ku ZPS-ja i paraqet dëshmitarit P00202 (konfidenciale), f. 3).

⁵⁴⁶ Shih Kërkesën e ZPS-së për Pranimin e Provave Materiale (W03593 dhe W04600) dhe Shtojcën e saj; Kërkesën e ZPS-së për Pranimin e Provave Materiale (W01679 dhe W03594) dhe Shtojcën e saj; Vendimin mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W03593, W04600, W01679 dhe W03594, para. 5, 8; Kërkesën e ZPS-së për Pranimin e Provave Materiale (W04603, W04669, W04676, W04391, dhe W04390) dhe Shtojcën e saj; Vendimin mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04603, W04669, W04676, W04391, W04390 dhe W04674, para. 4.

vendimin për miratimin e pranimit të tyre.⁵⁴⁷ Gjatë deklaratave përmbyllëse, Mustafa e kundërshtoi për herë të parë si “sugjerues” faktin që ZPS-ja u tregoi W01679-ës dhe W03593-shit vetëm një fotografi, në vend të një numri fotografish nga të cilat do të mund të zgjidhnin.⁵⁴⁸

211. Sipas mendimit të Panelit, një deklaratë e tillë e përgjithshme nuk përbën kundërshtim të provave dhe, duke mos paraqitur kundërshtim zyrtar, Mustafa ka humbur të drejtën për ta ngritur këtë çështje në apel.⁵⁴⁹ Gjithashtu, Mustafa nuk ka demonstruar ekzistencën e rrethanave të veçanta që do të përlligjinin shqyrtimin e parashtrimeve të tij. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon parashtrimet e Mustafës në lidhje me identifikimin e kompleksit të ndalimit në Zllash.⁵⁵⁰

212. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte pranuar si prova dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës që identifikojnë vendin e ndalimit, ose se konstatimet e Trupit Gjykues janë tërësisht të gabuara. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon pjesërisht nënpikën 2E dhe pjesërisht nënpikën 2H të Apelit të Mustafës.⁵⁵¹

⁵⁴⁷ Vendim mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W03593, W04600, W01679, dhe W03594, para. 20(c); Vendim mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04603, W04669, W04676, W04391, W04390, dhe W04674, para. 16(c).

⁵⁴⁸ Shih Transkriptin, 14 shtator 2022, f. 4675, 4690.

⁵⁴⁹ Shih më lart, para. 30.

⁵⁵⁰ Gjithsesi, Paneli vëren se Mustafa nuk paraqet asnjë provë në mbështetje të pretendimit se metodologjia e përdorur nga ZPS-ja ishte e papërshtatshme, ose se fotografitë ishin “sugjeruese”. Paneli i Apelit pajtohet me Trupin Gjykues se fakti që këta dëshmitarë e bazuan identifikimin e tyre në një fotografi të vetme nuk është i palejueshëm, pasi mund të kishin thënë thjesht që nuk mbanin mend dhe të mos i identifikonin ndërtesat. Shih Aktgjykimin, para. 364. Gjithashtu, dëshmitarët i panë fotografitë në fjalë gjatë intervistave me ZPS-në dhe konfirmuan në sallë të gjyqit se i kishin identifikuar më parë. Shih Transkriptin (W01679), 4 tetor 2021, f. 921-925; P00029 (konfidenciale), f. 3, 5-6; Transkriptin (W03593), 21 shtator 2021, f. 514-515; P00018 (konfidenciale), f. 3; Transkriptin (W04669), 10 nëntor 2021, f. 1470-1471; P00202 (konfidenciale), f. 3.

⁵⁵¹ Pjesët e tjera të nënpikave 2E dhe 2H trajtohen në pjesën ku trajtohet vlerësimi i dëshmitarëve. Shih më poshtë, Pjesën L, para. 249-278.

6. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykses të dëshmisë së W04600-s sa i takon identifikimit të kompleksit të ndalimit në Zllash (nënpika 2F)

(a) Parashtrimet e palëve

213. Në Njoftimin për Apel, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses e citoi gabim W04600-n kur konstatoi se ai e identifikoi vendin e ndalimit.⁵⁵² Në Njoftimin për Apel Mustafa pretendon gjithashtu se, megjithëse Trupi Gjykses e citoi saktë dëshmitarin, dëshmia e tij nuk u vlerësua siç duhet në kontekst.⁵⁵³ Mustafa parashtron gjithashtu se asnjë prej dëshmitarëve në të cilët u mbështet Trupi Gjykses për konstatimin e tij, konkretisht W04600, z. Fatmir Sopi dhe z. Selatin Krasniqi, nuk deklaroi se pronën e “Sfarcëve” ia kishin “dhënë në shfrytëzim UÇK-së për krijimin e bazës së BIA-s”.⁵⁵⁴ Sipas Mustafës, Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në këtë pretendim për të konstatuar se kompleksi ishte nën kontrollin e BIA-s dhe se i akuzuari ishte komandant në atë kompleks.⁵⁵⁵

214. ZPS-ja përgjigjet se, si rezultat i dallimeve midis argumenteve të Mustafës në Njoftimin për Apel dhe në Dosjen e Apelit,⁵⁵⁶ nënpika 2F duhet të rrëzohet menjëherë, për shkak të “mungesës së lidhjes logjike” midis parashtrimeve.⁵⁵⁷ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykses e vlerësoi drejt identifikimin prej W04600-s të kompleksit të ndalimit në Zllash në kontekstin e dëshmisë së tij në tërësi dhe të dëshmimeve të dëshmitarëve të tjerë dhe se, përshkrimi i vendit prej tij nuk lë asnjë dyshim se faktikisht e kishte fjalën për kompleksin e ndalimit në Zllash.⁵⁵⁸

⁵⁵² Njoftimi për Apel, nënpika 2F, para. 5, që i referohet Aktgjykimit, para. 365, 368.

⁵⁵³ Dosja e Apelit, f.40, para. 151-152, 155. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 86.

⁵⁵⁴ Dosja e Apelit, para. 153-155, 157.

⁵⁵⁵ Dosja e Apelit, para. 156. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 82.

⁵⁵⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 121.

⁵⁵⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 121.

⁵⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 122.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

215. Fillimisht, Paneli i Apelit gjykon se fakti që në nënpikën 2F argumentet e paraqitura nga Mustafa në Njoftimin për Apel ishin të ndryshme nga ato në Dosjen e Apelit, në parim për ligj rrëzim të menjëhershëm.⁵⁵⁹

216. Gjithsesi, dhe në kundërshtim me argumentet e Mustafës, Paneli vë në dukje se konstatimin që kompleksi i ndalimit në Zllash ishte nën kontrollin e BIA-s, Trupi Gjykses nuk e bazoi në përfundimin se prona e z. Adem Krasniqit iu dha në shfrytëzim UÇK-së për krijimin e bazës së BIA-s në Zllash.⁵⁶⁰ Në fakt, Paneli i Apelit gjykon se qëllimi konkret për të cilin iu dha në shfrytëzim ajo pronë UÇK-së nuk është juridikisht thelbësor për konstatimin lidhur me kontrollin e BIA-s mbi atë kompleks. Rrjedhimisht, edhe nëse do të ishin paraqitur siç duhet, argumentet e Mustafës nuk do të ndikonin në rezultatin e Aktgjykimit. Për pasojë, Paneli rrëzon argumentet e Mustafës në lidhje me këtë aspekt.⁵⁶¹

217. Për këtë arsye, Paneli rrëzon nënpikën 2F të Apelit të Mustafës.

L. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E DËSHMITARËVE NGA TRUPI GJYKUES (NËNPIKAT 1J, 2A PJESËRISHT, 2E PJESËRISHT, 2G, 2H PJESËRISHT, 2I, 2J, 2K, 2L, 2M PJESËRISHT, 2N)

218. Fillimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit gjykon se nënpikat 1J, 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2G, 2H pjesërisht, 2I, 2J, 2K, 2L, 2M pjesërisht, dhe 2N, përsërisin njëra-tjetrën dhe janë mjaft të ngjashme, sepse në to pretendohet se Trupi Gjykses gaboi në

⁵⁵⁹ Shih më lart, para. 31. Paneli vëren se, megjithëse në Njoftimin për Apel, Mustafa pretendon se Trupi Gjykses e "citoi gabim" W04600-n lidhur me identifikimin që i bëri vendit të ndalimit, në Dosjen e Apelit ai pranon se W04600 u citua saktë. *Krahaso* Njoftimin për Apel, nënpika 2F, para. 5 me Dosjen e Apelit, para. 152, 155. Gjithashtu, në Dosjen e Apelit, Mustafa nuk kundërshton vetëm dëshminë e W04600-s, por edhe dëshmitë e z. Fatmir Sopi dhe të z. Selatin Krasniqi. *Krahaso* Njoftimin për Apel, nënpika 2F, para. 5 me Dosjen e Apelit, para. 153-154.

⁵⁶⁰ Aktgjykimi, para. 352. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 349-351. Paneli i referohet gjithashtu konstatimit të vet në nënpikën 2B. Shih më lart, para. 186-190.

⁵⁶¹ Shih më lart, para. 33.

vlerësimin e besueshmërinë së dëshmitarëve të ZPS-së dhe të Mbrojtjes dhe të mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre; rrjedhimisht, Paneli do t'i shqyrtojë të gjitha këto pika së bashku.

219. Në Aktgjykim, Trupi Gjykues vlerësoi besueshmërinë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe të Mbrojtjes dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, duke marrë parasysh një numër faktorësh joshterues.⁵⁶²

220. Mustafa kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykues, me pretendimin se Trupi Gjykues nuk i vlerësoi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes kundrejt të njëjtit standard që zbatoi kur vlerësoi dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së.⁵⁶³ Mustafa argumenton gjithashtu se dëshmitë e dëshmitarëve që ishin të favorshme për Mbrojtjen, Trupi Gjykues i hodhi poshtë bazuar në arsye jorelevante, dhe presupozoi se disa dëshmitarë patën tendencë për të dhënë dëshmi të favorshme

⁵⁶² Aktgjykimi, para. 49, 58-223. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 34-39, dhe në veçanti para. 35, ku Trupi Gjykues shtjelloi faktorët e ndryshëm që mori parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmisë së dëshmitarëve, si: (i) hollësitë e dhëna nga dëshmitari, të cilat tregojnë se dëshmitari i përjetoi ngjarjet personalisht; (ii) lidhjen e brendshme logjike dhe përputhshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve, përfshirë përputhshmërinë e dëshmimeve gojore me deklaratën/deklaratat e tyre me shkrim, dhe shpjegimet e dhëna prej tyre për mospërputhjet që u diskutuan me ta në sallën e gjyqit; (iii) lidhjen e brendshme logjike dhe përputhshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve me prova të tjera të administruara prej Trupit Gjykues; (iv) gjasat që dëshmia e dëshmitarit të jetë e vërtetë; (v) orvatjet ose përpjekjet e dëshmitarit për të qenë i saktë (për shembull, pranimi se e ka të vështirë t'i kujtojë disa ngjarje ose hollësi, ose bërja e dallimit midis asaj që ka përjetuar vetë dhe asaj që ka dëgjuar nga të tjerët); (vi) ndikimin e kalimit të kohës dhe të traumës mbi kujtesën e dëshmitarit, që mund të ndikojnë në aftësinë e dëshmitarit për t'i rikujtuar ngjarjet siç ndodhën; (vii) sjelljen e dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë në gjyq, përfshirë gatishmërinë për t'iu përgjigjur pyetjeve si dhe çdo ndryshim në qëndrim gjatë pyetjeve të palës kundërshtare; (viii) marrëdhënien midis dëshmitarit dhe secilës palë ose mbrojtëses së viktimave, përfshirë ekzistencën e lidhjeve, anshmërisë, apo motiveve për ta implikuar ose shfajësuar të akuzuarin, lidhjen me BIA-n ose UÇK-në, përfshirje të tyre në ngjarjet nën shqyrtim apo shtysë ose motiv tjetër për të gënjer, trilluar, për të shtrembëruar ose për të mos dhënë informacion; (ix) qëndrimin e njëanshëm kundër Dhomave të Specializuara dhe/ose ZPS-së që mund të ketë pasur ndikim negativ mbi gatishmërinë e dëshmitarit ose ndjenjën e tij të detyrës për t'i dhënë Trupit Gjykues dëshmi që e ndihmon në përcaktimin e së vërtetës; dhe (x) tregues se dëshmitari mund të ketë qenë objekt i frikësimit, kërcënimit, trysnisë ose ndikimit, ose se është marrë vesh me dëshmitarë të tjerë.

⁵⁶³ Dosja e Apelit, para. 62-66 (nënpika 1J); Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 69; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 17-18, 21. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpika 1J, para. 4.

për të akuzuarin.⁵⁶⁴ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk ka demonstruar gabim në vlerësimin e dëshmitarëve nga Trupi Gjykses.⁵⁶⁵

1. Mangësitë formale që përlligjin rrëzim të menjëhershëm

221. Fillimisht, Paneli vë në dukje se pjesa dërmuese e parashtrimeve të Mustafës në nënpikat 1J, 2G, 2I, 2J, 2K, 2L dhe 2M nuk përmbushin kriteret formale për apel.

222. Paneli gjykon se një ndër mangësitë më të theksuara të parashtrimeve të Mustafës në këto nënpika të Apelit – që Paneli vëren se është problem i hasur rëndom në të gjitha parashtrimet e tij në apel – është se ai në mënyrë të përsëritur nuk evidenton se cilin konstatimin specifik të Trupit Gjykses kundërshton.⁵⁶⁶ Së pari, Paneli vë në dukje se në Njoftimin për Apel, në nënpikat 1J, 2K, 2L dhe 2M, Mustafa i referohet një vargu të madh, dhe kryesisht të njëjtë, të paragrafëve të Aktgjykimit.⁵⁶⁷ Në këtë aspekt, Paneli rikujton se njoftimi për apel duhet të përmbajë “konstatimin ose vendimin në aktgjykimin e apeluar, duke përmendur konkretisht numrin e faqes

⁵⁶⁴ Dosja e Apelit, para. 83(f)-(h) (nënpika 2A), 144-149 (nënpika 2E), 158-161, 163, 166-167, 168, 172, 174, 176 (nënpika 2G), 179 (nënpika 2H), 181-182, 185-186, 188-189 (nënpika 2I), 193, 199-203 (nënpika 2J), 205-208 (nënpika 2K), 210-211, 217 (nënpika 2L), 220-225, 227-229, 233, 235, 237, 239, 241, 244-245, 251, 253, 257, 259, 262, 265-269, 274, 276, 278-279, 284-286, 291, 295-297 (nënpika 2M), 303 (nënpika 2N). Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpika 2G, 2I-2N, para. 5; Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 68-72; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 18-23, 40-45.

⁵⁶⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 71-87, 110, 123-126; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 25-27. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 71-72; Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 128-129.

⁵⁶⁶ Dosja e Apelit, para. 160-161, 163, 165, 168, 172, 174, 176 (nënpika 2G), ku argumentohet se Trupi Gjykses “nuk i mori parasysh” vrojtmet e dëshmitarëve të Mbrojtjes, z. Selatin Krasniqi, z. Ajeti, znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu, dhe z. Humolli lidhur me kompleksin e ndalimit në Zllash. Paneli vëren se në Dosjen e Apelit, Mustafa u referohet disa konstatimeve të Trupit Gjykses në pjesën e Vlerësimit të Përgjithshëm (Shih Dosjen e Apelit, para. 158-161, 165-166, 168-169, 172, 174), por nuk identifikon se në cilat konstatime faktike Trupi Gjykses “nuk mori parasysh” ndonjë prej dëshmive të dëshmitarëve të Mbrojtjes lidhur me kompleksin e ndalimit në Zllash. Ndonëse në Njoftimin për Apel, Mustafa u referohet paragrafëve 368 deri 370 të Aktgjykimit, në Dosjen e Apelit ai nuk i diskuton këta paragrafë. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 189 (nënpika 2I), 190-203 (nënpika 2J), 204-209 (nënpika 2K), ku Mustafa nuk jep referenca për asnjë prej konstatimeve që kundërshton.

⁵⁶⁷ Njoftimi për Apel, nënpika 1J, para. 4, që i referohet Aktgjykimit, para. 34-39, 49-223 (gjithsej 181 paragrafë); Njoftimi për Apel, nënpikat 2K-2M, para. 5, ku në secilën prej nënpikave, Mustafa u referohet paragrafëve 138-223, 263-333 të Aktgjykimit (gjithsej 157 paragrafë).

dhe/ose paragrafit përkatës”.⁵⁶⁸ Paneli i Apelit konstaton se në Njoftimin për Apel, Mustafa nuk i përmbahet këtij kriteri për këto nënpika. Për më tepër, Paneli vëren se në nënpikat përkatëse të Apelit në Dosjen e Apelit, Mustafa as nuk i përmend shumicën e vargjeve të paragrafëve të Aktgjykimit të cituar në Njoftimin për Apel.⁵⁶⁹

223. Paneli i Apelit rikujton se ka diskrecion të brendaqenësishëm për të vendosur se cilat parashtrime të palëve meritojnë arsyetim të hollësishëm me shkrim, dhe mund të hedhë poshtë argumente qartazi të pabaza pa dhënë arsyetim të hollësishëm.⁵⁷⁰ Paneli rikujton gjithashtu se apeli nuk është gjykim *de novo* dhe se nuk mund të pritet nga Paneli i Apelit që të rishikojë pjesë të tëra të Aktgjykimit në qoftë se pala apeluese nuk evidenton konstatimin konkret që kundërshton.⁵⁷¹ Në parim, parregullsi të tilla përlligjin rrëzimin e menjëhershëm të parashtrimeve.⁵⁷²

224. Paneli vëren gjithashtu, veçanërisht në nënpikat 2K dhe 2L, se parashtrimet e Mustafës në Dosjen e Apelit devijojnë konsiderueshëm nga pikat përkatëse të Apelit të paraqitura në Njoftimin për Apel.⁵⁷³ Duke pasur parasysh se këto parregullsi në nënpikat 2K dhe 2L të Apelit të Mustafës janë serioze, Paneli i rrëzon ato menjëherë.

225. Gjithashtu, Paneli i Apelit vëren se në nënpikën 1J, Mustafa i referohet përgjithësisht vlerësimit të Trupit Gjykses për “dëshmitarët e Mbrojtjes” dhe nuk

⁵⁶⁸ Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet e Protokolluara neni 47(1)(b)(2). Shih, për ngjashmëri, *Boskoški and Tarčulovski* Decision on Notice of Appeal, para. 30.

⁵⁶⁹ Në veçanti, në nënpikën 2K të Dosjes së Apelit, Mustafa nuk citon asnjë paragraf të Aktgjykimit. Në nënpikën 2L, Mustafa citon disa grupe paragrafësh në Aktgjykim, pa saktësuar gabimin që pretendon se ka kryer Trupit Gjykses. Shih Dosjen e Apelit, para. 213-216.

⁵⁷⁰ Shih më lart, para. 33.

⁵⁷¹ Shih më lart, para. 29-30.

⁵⁷² Shih më lart, para. 29-30.

⁵⁷³ *Krahaso* Njoftimin për Apel, nënpika 2K, para. 5 *me* Dosjen e Apelit, para. 204-209 (nënpika 2K). Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 70-71. *Krahaso* Njoftimin për Apel, nënpika 2L, para. 5 *me* Dosjen e Apelit, para. 210-218 (nënpika 2L). Paneli vëren të njëjtat mospërputhje në nënpikën 2I. Megjithatë, Paneli konstaton se ato nuk janë aq serioze, ndaj i ka shqyrtuar kundërshtimet e Mustafës në nënpikën 2I më poshtë. *Krahaso* Njoftimin për Apel, nënpika 2I, para. 5 *me* Dosjen e Apelit, para. 180-189 (nënpika 2I), ku Mustafa nuk kundërshton të njëjtat konstatime të Trupit Gjykses. Shih më poshtë, para. 242-278.

identifikon dëshmitarët konkretë për të cilët pretendon se Trupi Gjykses nuk i vlerësoi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme dëshmitë e tyre. Paneli vë në dukje gjithashtu se Mustafa nuk e mbështet këtë pretendim të përgjithshëm me referenca të sakta të paragrafëve përkatës në Aktgjykim, ose faqeve të transkriptit të dëshmive të dëshmitarëve. Paneli i Apelit vëren se argumente të përgjithësuara e të pafaktuara si këto përlijin rrëzim të menjëhershëm⁵⁷⁴ dhe rrjedhimisht rrëzon parashtrimet e Mustafës në nënpikën 1J në lidhje me vlerësimin e dëshmitarëve të Mbrojtjes nga Trupi Gjykses.⁵⁷⁵

226. Në nënpikën 2M, Paneli vëren se Mustafa nuk ngre në Njoftimin për Apel argumentin që shtjellon në Dosjen e Apelit se Trupi Gjykses bëri “karakterizim qartësisht të gabuar të BIA-s”.⁵⁷⁶ Paneli rikujton se mund të refuzojë të shqyrtojë një argument që ngrihet për herë të parë në Dosjen e Apelit⁵⁷⁷ dhe, mbi këtë bazë, rrëzon argumentin e Mustafës në lidhje me këtë pikë.⁵⁷⁸

227. Në lidhje me nënpikat e tjera, konkretisht nënpikat 1J pjesërisht, 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2G, 2H pjesërisht, 2I, 2J, 2M pjesërisht dhe 2N, Paneli gjykon se, me gjithë mangësitë e mëdha,⁵⁷⁹ ka arritur t’i kuptojë mjaftueshëm argumentet e Mustafës dhe

⁵⁷⁴ Shih më lart, para. 29.

⁵⁷⁵ Shih Dosjen e Apelit, para. 62-63.

⁵⁷⁶ Dosja e Apelit, para. 229. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 243, 245.

⁵⁷⁷ Shih më lart, para. 31.

⁵⁷⁸ Në Njoftimin për Apel, Mustafa nuk përmend se kundërshton konstatimet faktike të Trupit Gjykses mbi strukturën e BIA-s. Shih Aktgjykimin, para. 334-337. *Krahaso* Dosjen e Apelit, para. 229, që i referohet Aktgjykimit, para. 334-337 me Njoftimin për Apel, nënpika 2M, para. 5, që u referohet 157 paragrafëve të Aktgjykimit, ku nuk përfshihen paragrafët 334 deri 337. Paneli i ka shtjelluar argumentet e mbetura në nënpikën 2M më poshtë. Shih më poshtë, para. 242-296.

⁵⁷⁹ Paneli vëren në veçanti se shumë prej argumenteve të Mustafës janë të paqarta, kundërthënëse, të pashtjelluara dhe të pabazuara. Për shembull, në nënpikën 2G, në argumentet e Mustafës mungojnë disa fjalë dhe në vend të tyre Mustafa përdor elipsin “...”. Shih Dosjen e Apelit, para. 161. Në nënpikën 2I, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses “nuk i mori parasysh” vërtetimet e shtatë dëshmitarëve të Mbrojtjes, pa i identifikuar ata dhe pa dhënë referenca, kurse tre paragrafë më poshtë në Dosjen e Apelit, thotë se Trupi Gjykses “nuk i hodhi poshtë vërtetimet e tyre, përveç kur bëhej fjalë për faktin se këta persona nuk panë asnjëherë ndonjë vend ndalimi apo persona që mbaheshin të ndaluar”. Shih Dosjen e Apelit, para. 185-186, 189. Paneli vëren se asnjëra nga nënpikat e Apelit që diskutohen në këtë pjesë nuk mbështetet me citime nga dispozitat ligjore apo jurisprudenca. Paneli vëren gjithashtu se, bazuar në argumentet e paraqitura në Njoftimin për Apel, disa elemente që Mustafa i ngre në disa

ka vendosur që të bëjë përjashtim e t'i shqyrtojë ato për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.

2. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e dëshmitarëve nga Trupi Gjykues

228. Paneli i Apelit rikujton së pari se Trupi Gjykues ka diskrecion të gjerë për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre dhe se Paneli nuk i rrëzon lehtë konstatimet faktike të Trupit Gjykues në lidhje me këtë aspekt, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur ai nuk mund të pranoheshin nga asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh apo kur vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar.⁵⁸⁰ Paneli rikujton gjithashtu se e drejta e të akuzuarit për mendim të arsyetuar nuk kërkon analizë të hollësishme të besueshmërisë së dëshmitarëve, në qoftë se paneli përkatës jep arsyet për pranimin e dëshmisë së një dëshmitari pavarësisht nga ndonjë mospërputhje e pretenduar apo juridikisht thelbësore.⁵⁸¹

229. Paneli i Apelit rikujton më tej rregullën 139(4) e Rregullores sipas së cilës, gjatë përcaktimit të rëndësisë që do t'i kushtohet dëshmisë së një dëshmitari, trupi gjykues vlerëson besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e atij dëshmitari. Paneli i Apelit vëren se besueshmëria ka të bëjë me vërtetësinë e

nënpika të Apelit, duhej të ishin ngritur në kuadër të një nënpike tjetër, dhe se ai përsërit të njëjtat parashtrime në disa nënpika të Apelit. Për shembull, Paneli vëren se në nënpikën 2E Mustafa argumentoi se ishte "krejtësisht e pagjasë" që të gjithë dëshmitarët që dëshmuuan lidhur me kompleksin e ndalimit në Zllash dhe thanë se aty nuk u mbajt i ndaluar askush – konkretisht z. Fatmir Sopi, z. Humolli, z. Selatin Krasniqi, znj. Hadri dhe znj. Canolli-Kaçiu – t'i "kishin përshtatur dëshmitë" me njëri-tjetrin në lidhje me këtë aspekt, kur do të kishte qenë më mirë që ky argument të ishte përfshirë në nënpikën 2G. *Krahaso* Njoftimin për Apel, nënpika 2E, para. 5 dhe Dosjen e Apelit, para. 144-148 me Njoftimin për Apel, nënpika 2G, para. 5 dhe Dosjen e Apelit, para. 158-178. Paneli vëren gjithashtu se në Dosjen e Apelit, në veçanti në nënpikat 2G, 2I dhe 2M, Mustafa shtjellon të njëjtat argumente se Trupi Gjykues nuk mori parasysh dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes bazuar në një numër faktorësh që nuk kishin lidhje me ngjarjet dhe faktet për të cilat dëshmuuan dëshmitarët, dhe kundërshton vlerësimin e atyre dëshmitarëve (z. Selatin Krasniqi, z. Ajeti, znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu, z. Humolli) nga Trupi Gjykues. Shih gjithashtu nënpikat 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2H pjesërisht, dhe 2N.

⁵⁸⁰ Shih më lart, para. 23-24.

⁵⁸¹ Shih më lart, para. 35.

dëshmitarit (d.m.th. nëse dëshmitari thotë të vërtetën)⁵⁸² dhe shton se fakti që një dëshmitar e jep dëshminë me ndershmëri nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të përcaktuar mbështetshmërinë në atë dëshmi.⁵⁸³ Paneli vëren se mbështetshmëria ka të bëjë me atë nëse dëshmia, në rast se pranohet, vërteton faktin për të cilin paraqitet, ose nëse vihet në dyshim nga prova të tjera ose nga rrethana të lidhura me to.⁵⁸⁴

(a) Pretendimet për gabime në lidhje me zbatimin e standardit të njëjtë për dëshmitarët e ZPS-së dhe të Mbrojtjes nga Trupi Gjykses (nënpika 1J pjesërisht)

(i) Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve

230. Mustafa parashtron se, kur vlerësoi besueshmërinë e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, Trupi Gjykses i zbatoi kriteret përkatëse në mënyrë përzgjedhëse dhe, si rrjedhojë, nuk zbatoi “të njëjtat standarde të drejta dhe të paanshme” për të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve për arritjen e konstatimeve në Aktgjykim.⁵⁸⁵ Konkretisht, Mustafa pretendon se Trupi Gjykses u mbështet plotësisht ose në masë të madhe në dy “kriteret subjektive” nga dhjetë që identifikohen në Aktgjykim dhe i shpërfilli të gjithë faktorët e tjerë.⁵⁸⁶ Mustafa pretendon gjithashtu se në vlerësimin e dëshmitarëve të ZPS-së, Trupi Gjykses nuk mori parasysh [REDAKTUAR] dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe armiqësinë e shprehur të tyre ndaj të akuzuarit.⁵⁸⁷ Së fundi, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses nuk i peshoi në mënyrë

⁵⁸² *Lubanga Appeal Judgment*, para. 239; *Kunarac et al. Decision on Acquittal*, para. 7. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 34.

⁵⁸³ *Brđanin Trial Judgment*, para. 25. Shih gjithashtu *Lubanga Appeal Judgment*, para. 239; Aktgjykimin, para. 34.

⁵⁸⁴ *Kunarac et al. Decision on Acquittal*, para. 7; *Lubanga Appeal Judgment*, para. 239. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 34.

⁵⁸⁵ Dosja e Apelit, para. 63, 66; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 17-18, 21. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpika 1J, para. 4, që i referohet Aktgjykimit, para. 34-39.

⁵⁸⁶ Dosja e Apelit, para. 62; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 17-18.

⁵⁸⁷ Dosja e Apelit, para. 64-65.

të barabartë dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së kur ato ishin të favorshme për Mbrojtjen.⁵⁸⁸

231. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses ka diskrecion të gjerë në vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarëve.⁵⁸⁹ ZPS-ja parashton gjithashtu se argumentet e Mustafës se Trupi Gjykses nuk zbatoi të njëjtin standard për vlerësimin e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe të ZPS-së janë pretendime për gabim faktik e jo gabim juridik, dhe se Mustafa nuk përmbush standardin e duhur për rishikimin e gabimeve faktike, çka përlligj rrëzimin e pretendimit.⁵⁹⁰ Gjithsesi, ZPS-ja argumenton se faktorët e besueshmërisë janë joshterues dhe nuk duhet të trajtohen si një "listë kontrolli" dhe, rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ishte i detyruar të shqyrtonte secilin faktor në vlerësim.⁵⁹¹ Së fundi, ZPS-ja parashton se Trupi Gjykses nuk është i detyruar të shtjellojë me hollësi arsyet për mospranimin ose pranimin e dëshmisë së një dëshmitari.⁵⁹²

232. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se Mustafa shtrembëron dëshmitë e dëshmitarëve në sallën e gjyqit dhe se ai nuk i mbështet argumentet e tij me shembuj konkretë të "armiçësisë" ndaj të akuzuarit.⁵⁹³ Mbrojtësja e Viktimave parashton gjithashtu se Trupi Gjykses shqyrtoi saktë të gjithë faktorët relevantë kur bëri vlerësimin e dëshmisë së W03593-shit.⁵⁹⁴

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

233. Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses e shtjelloi saktë metodologjinë e vet lidhur me vlerësimin e provave në këtë çështje gjyqësore, veçanërisht lidhur me

⁵⁸⁸ Njoftimi për Apel, nënpika 1J, para. 4. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 63, 66; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 20-22.

⁵⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 71.

⁵⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 72.

⁵⁹¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 73.

⁵⁹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 73.

⁵⁹³ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 25-26.

⁵⁹⁴ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 27.

vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe të mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre, para se të mbështetej në dëshmitë e tyre.⁵⁹⁵ Paneli i Apelit rikujton gjithashtu se Trupi Gjykses evidentoi një listë faktorësh joshterues që i shqyrtoi gjatë vlerësimit të besueshmërisë së të gjithë dëshmitarëve dhe të mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre.⁵⁹⁶ Paneli vëren se, siç vë në dukje ZPS-ja, këta faktorë nuk funksionojnë si një “listë kontrolli” kriteresh dhe se relevanca e tyre duhet të vlerësohet rast pas rasti.⁵⁹⁷ Rrjedhimisht, shqyrtimi dhe zbatimi nga Trupi Gjykses i faktorëve që përcaktojnë besueshmërinë e dëshmitarëve ndryshojnë sipas dëshmisë së secilit dëshmitar.

234. Sa u përket parashtrimeve të tjera të Mustafës në nënpikën 1J⁵⁹⁸ lidhur me vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshmitarët e ZPS-së, Paneli i Apelit vëren se Mustafa u referohet vetëm [REDAKTUAR]⁵⁹⁹ dhe W03593-shit.⁶⁰⁰ Rrjedhimisht, Paneli do të shqyrtojë parashtrimet e Mustafës vetëm në lidhje me ata dëshmitarë.

235. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses vlerësoi me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve të ZPS-së, duke vënë në dukje çfarëdo mospërputhesh në dëshminë e një dëshmitari dhe arsyet për pranimin ose mospranimin e asaj dëshmie, në tërësi ose pjesërisht, duke mbajtur parasysh ato mospërputhje.⁶⁰¹ Në veçanti, sa u përket W04674-ës, W04676-ës, W04390-s dhe W04391-shit, gjatë vlerësimit, Trupi Gjykses shqyrtoi [REDAKTUAR] dëshmitarëve, por nuk konstatoi

⁵⁹⁵ Aktgjykimi, para. 31-46.

⁵⁹⁶ Shih më lart, para. 219, poshtëshënimi 562. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 35.

⁵⁹⁷ *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 132; *Nchamihigo* Appeal Judgement, para. 47.

⁵⁹⁸ Shih më lart, para. 230.

⁵⁹⁹ Megjithëse Mustafa nuk i identifikon dëshmitarët konkretë, sipas Panelit të Apelit, ai u referohet W04674-ës, W04676-ës, W04390-s dhe W04391-shit, të cilët dhanë dëshmi para Trupit Gjykses.

⁶⁰⁰ Shih Dosjen e Apelit, para. 64-65. Paneli vëren se në seancën e Apelit, Mustafa ngriti gjithashtu kundërshtime ndaj vlerësimit të Trupit Gjykses për dëshmitë e z. Fatmir Sopi dhe z. Veseli lidhur me nënpikën 1J të Apelit. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 18-20, 43. Megjithatë, Paneli gjykon se këto argumente në fakt kanë të bëjnë me argumentin e përgjithshëm të Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që u bazua në faktorë jorelevantë për të hedhur poshtë dëshmitë e dëshmitarëve të favorshëm për Mbrojtjen dhe i ka trajtuar ato në pjesën përkatëse më poshtë. Shih më poshtë, poshtëshënimin 656.

⁶⁰¹ Aktgjykimi, para. 58-137.

“ndonjë shenjë se ata ishin marrë vesh mes tyre” ose ndonjë “shtysë ose motiv për të gënjyer, fshehur, trilluar ose shtrembëruar informacionin”.⁶⁰²

236. Në vlerësimin e vet, Trupi Gjykses shqyrtoi gjithashtu ekzistencën e “disa mospërputhjeve në dëshmitë dhe/ose deklaratat e dëshmitarëve, veçanërisht [REDAKTUAR]”.⁶⁰³ Megjithatë, Trupi Gjykses konstatoi se “të gjitha dëshmitë [...] e dëshmitarëve janë në thelb përputhëse”, dhe se mospërputhjet e vërejtura nuk ndikuan në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarëve.⁶⁰⁴

237. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se nuk ka gabim në vlerësimin e dëshmitarëve W04674, W04676, W04390 dhe W04391 nga Trupi Gjykses, besueshmëria e të cilëve u vlerësua mbi bazën e faktorëve të njëjtë si për dëshmitarët e tjerë, përfshirë anshmërinë apo shtysën për të gënjyer, por nuk konstatoi të kishte prova që ndikonin në mbështetshmërinë në dëshminë e tyre.

238. Paneli i Apelit do të trajtojë tani parashtrimet e Mustafës se “W03593 as nuk donte ta shihte apo t’ia përmendte emrin” të akuzuarit, sjellje kjo që ai pretendon se tregon armiqësi ndaj të akuzuarit.⁶⁰⁵ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vëren së pari se Mustafa nuk e mbështet këtë pretendim me referenca të sakta në faqet e transkriptit të dëshmisë së dëshmitarit, as nuk demonstroi se si kjo shprehje përbën armiqësi ndaj të akuzuarit sa i përket përmbajtjes së dëshmisë së dëshmitarit.

239. Sidoqoftë, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses e mori parasysh mënyrën e sjelljes së W03593-shit kur dha dëshmi, përfshirë gatishmërinë dhe vullnetin e dëshmitarit për t’iu përgjigjur pyetjeve dhe ndonjë ndryshim në përgjigjet ose

⁶⁰² Aktgjykimi, para. 93.

⁶⁰³ Aktgjykimi, para. 96.

⁶⁰⁴ Aktgjykimi, para. 96.

⁶⁰⁵ Dosja e Apelit, para. 65. Megjithëse Mustafa nuk u referohet deklaratave konkrete të dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë, Paneli i Apelit vëren se në një rast, W03593 tha për të akuzuarin: “as kurrë inshallah nuk ja shoh sytë, në jetën time”. Shih Transkriptin (W03593), 20 shtator 2021, f. 420.

qëndrimin e tij kur u mor në pyetje Mbrojtja.⁶⁰⁶ Konkretisht, Trupi Gjykses konstatoi se W03593 ishte “përgjithësisht i hapur në dhënien e dëshmisë së tij, aspekte kritike të së cilës ishin përputhëse” dhe “nuk u lëkund” gjatë përgjigjeve.⁶⁰⁷ Në veçanti, Trupi Gjykses vuri në dukje se kur u pyet gjerësisht nga të dyja palët dhe nga Trupi Gjykses se si e identifikoi të akuzuarin, W03593 nuk u përpoq ta inkriminonte të akuzuarin me çdo kusht dhe pranoi menjëherë që nuk e kishte parë mirë, se nuk e njihte, dhe as sot nuk mund ta njihte.”⁶⁰⁸

240. Gjithashtu, Trupi Gjykses vuri në dukje se W03593 ndonjëherë ngurronte të përmendte emrat e individëve që i kishin dhënë informacion, por si përfundim konstatoi se, duke marrë parasysh “atmosferën e frikës dhe frikësimit të dëshmitarëve që mbizotëron në Kosovë”, “ngurrimi i W03593-shit bazohej në frikë dhe jo në synim për të mos i dhënë informacion Trupit Gjykses.”⁶⁰⁹ Sipas mendimit të Panelit të Apelit, Trupi Gjykses nuk gaboi në vlerësimin e sjelljes dhe përgjigjeve të W03593-shit ndaj të dyja palëve gjatë dhënies së dëshmisë, as në konstatimin përfundimtar se nuk kishte prova për anshmëri ose shtysë për të gënjer, të cilat do të ndikonin në besueshmërinë e W03593-shit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e tij.⁶¹⁰

241. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit rrëzon argumentin e Mustafës se Trupi Gjykses nuk vlerësoi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes kundrejt të njëjtit standard që zbatoi kur vlerësoi dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së. Gjithashtu, Mustafa nuk demonstroi se provat në të cilat është bazuar Trupi Gjykses për vlerësimin e vet, nuk do të ishin pranuar nga asnjë gjykses i arsyeshëm i fakteve, ose se gabimi i pretenduar në vlerësimin e Trupit Gjykses do të çonte në një

⁶⁰⁶ Aktgjykimi, para. 69-70.

⁶⁰⁷ Aktgjykimi, para. 69.

⁶⁰⁸ Aktgjykimi, para. 69.

⁶⁰⁹ Aktgjykimi, para. 73.

⁶¹⁰ *Contra* Dosja e Apelit, para. 65. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 35(viii).

rezultat tjetër. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon pjesën tjetër të nënpikës 1J të Apelit të Mustafës.

(b) Pretendimet për gabime në lidhje me njëanshmërinë e Trupit Gjykses në vlerësimin e dëshmitarëve (nënpikat 2G pjesërisht, 2I pjesërisht, 2J pjesërisht, 2M pjesërisht, 2N pjesërisht)

(i) Parashtrimet e palëve

242. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh dëshmitë e disa dëshmitarëve të Mbrojtjes, madje edhe të disa dëshmitarëve të ZPS-së, sepse ata patën “tendencë” për të dhënë dëshmi të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në.⁶¹¹

243. ZPS-ja përgjigjet se Mustafa paraqet argumente të pashtjelluara, të pabazuara, të paorganizuara dhe përsëritëse, dhe se nganjëherë devijon shumë nga pikat në Njoftimin për Apel.⁶¹² ZPS-ja parashtron se Mustafa thjesht nuk pajtohet me konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre.⁶¹³ ZPS-ja argumenton gjithashtu se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se si këto gabime të pretenduara shkaktuan gabim gjyqsor, se vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar, ose se provat e kundërshtuara nuk do të mund të ishin pranuar nga asnjë gjykses i arsyeshëm i fakteve.⁶¹⁴

244. Në përgjigje të argumentit të Mustafës se Trupi Gjykses ishte i njëanshëm ndaj tij gjatë vlerësimit të provave të dëshmitarëve, ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykses bëri analizë rrënjësore të dëshmive të dëshmitarëve të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, ku

⁶¹¹ Dosja e Apelit, para. 158-161, 166, 169, 172, 174, 178 (nënpika 2G), 181-182, 185-186 (nënpika 2I), 193, 199, 202 (nënpika 2J), 223-225, 227-229, 233, 235, 244-245, 247, 251-253, 259, 262, 276, 278, 284-285, 291, 295 (nënpika 2M), 303 (nënpika 2N). Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 18-21, 40-42.

⁶¹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 74. ZPS-ja parashtron se kjo është veçanërisht e vërtetë për nënpikat 2I, 2J, 2M dhe 2N të Apelit të Mustafës.

⁶¹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 74.

⁶¹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 71, 74.

trajtoi besueshmërinë e dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre.⁶¹⁵ ZPS-ja argumenton më tej se vendimi i Trupi Gjykses për të mos pranuar dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes nuk ishte për shkak të predispozitës së pretenduar të tij për të marrë parasysh dëshmitë e favorshme për Prokurorinë dhe për të hedhur poshtë dëshmitë e favorshme për Mbrojtjen, por pasojë e vendimit të Mustafës për të thirrur dëshmitarë me “mungesë të theksuar besueshmërie”.⁶¹⁶ Në veçanti, ZPS-ja thekson mangësitë “më të rëndësishme” që ndikuan në besueshmërinë e dëshmitarëve të Mbrojtjes, si për shembull shoqëria e kahershme ndërmjet një dëshmitari dhe të akuzuarit; treguesit se dëshmitarët ishin marrë vesh mes tyre ose me të akuzuarin; ngurrimi i disa dëshmitarëve që të konsideroheshin se kishin lidhje me UÇK-në ose BIA-n, apo që t’u përgjigjeshin pyetjeve; dhe fakti që disa dëshmitarë kishin përcjellë dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë para se të jepnin dëshmi vetë.⁶¹⁷ ZPS-ja parashtron më tej se Trupi Gjykses e mori parasysh si duhet atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë në të cilën dhanë dëshmi dëshmitarët e ZPS-së, ndonëse Mustafa e anashkaloi këtë fakt.⁶¹⁸

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

245. Pretendimin e Mustafës se Trupi Gjykses mori si të mirëqenë se dëshmitarët e Mbrojtjes do të jepnin dëshmi të favorshme për të akuzuarin⁶¹⁹, Paneli e interpreton se do të thotë që Trupi Gjykses tregoi njëanshmëri në vlerësimin e dëshmitarëve të Mbrojtjes.

⁶¹⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 76.

⁶¹⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 77.

⁶¹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 77.

⁶¹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 78.

⁶¹⁹ Shih për shembull Dosjen e Apelit, para. 161, 169, 172, 186, 189, 244, 262, 278, 285, 295, 297.

246. Paneli vëren se Mustafa nuk identifikoi asnjë provë në mbështetje të këtij pretendimi të përgjithshëm që mund të hedhë poshtë prezumimin e paanshmërisë së gjykatësve të Trupi Gjykues.⁶²⁰

247. Gjithsesi, Mustafa nuk dha asnjë provë që tregonte se Trupi Gjykues nuk shqyrtoi “në mënyrë objektive” dhe “siç duhet” dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes, ose më përgjithësisht, të dëshmitarëve që dhanë dëshmi të favorshme për Mbrojtjen.⁶²¹ Në fakt, sikurse u theksua më lart, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykues zbatoi të njëjtin standard për dëshmitarët e ZPS-së dhe të Mbrojtjes dhe për secilin dëshmitar identifikoi me kujdes mospërputhjet në dëshmitë e tyre, rrethanat personale dhe faktorë të tjerë që mund të ndikonin në besueshmërinë e dëshmitarit.⁶²² Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentin për njëanshmërinë e pretenduar të Trupit Gjykues në këtë aspekt.

248. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikat 2G pjesërisht, 2I pjesërisht, 2J pjesërisht, 2M pjesërisht dhe 2N pjesërisht të Apelit të Mustafës.

(c) Pretendimet për gabime në lidhje me zbatimin e faktorëve “jorelevantë” nga Trupi Gjykues për mosmarrjen parasysh të dëshmimeve të dëshmitarëve të favorshëm për Mbrojtjen (nënpikat 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2G pjesërisht, 2H pjesërisht, 2I pjesërisht, 2J pjesërisht, 2M pjesërisht, 2N pjesërisht)

(i) Parashtrimet e palëve

249. Mustafa parashtron se Trupi Gjykues gaboi që dëshmitë e dëshmitarëve të favorshme për Mbrojtjen nuk i mori parasysh për arsye jorelevante, si për shembull, rrethanat personale që nuk kishin lidhje me përmbajtjen e dëshmimeve të tyre.⁶²³ Mustafa

⁶²⁰ Shih më lart, para. 40.

⁶²¹ *Contra* Dosja e Apelit, para. 172, 229, 236, 240, 246, 249, 270, 279-281, 286-287, 294. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 229, 236, 279, 299.

⁶²² Shih më poshtë, para. 263-296; Aktgjykimin, para. 139-223. Shih gjithashtu më lart, para. 233, 241.

⁶²³ Dosja e Apelit, para. 161, 163, 165-168, 172, 174 (nënpika 2G), 182, 186, 188 (nënpika 2I), 199 (nënpika 2J), 220-222, 224, 227-228, 230, 234, 236-237, 243-244, 246-248, 251, 253, 259, 261-262, 276, 278,

parashtron gjithashtu se i vetmi faktor përcaktues i besueshmërisë së një dëshmitari ishte nëse ai ose ajo “është ose nuk është duke thënë të vërtetën”.⁶²⁴ Në këtë aspekt, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses dhe ZPS-ja nuk u tërhoqën vërejtjen disa dëshmitarëve se dëshmia e tyre ishte e pavërtetë, as nuk i ballafaquan ata me prova për të kundërtën dhe me faktorë që ndikonin në besueshmërinë e tyre, para se t’i hidhnin poshtë dëshmitë e tyre.⁶²⁵

250. Sa u përket dëshmitarëve që ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash në kohën përkatëse, ndër të cilët z. Selatin Krasniqi, z. Ajeti, znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu dhe z. Humolli, Mustafa pretendon se Trupi Gjykses nuk i mori parasysh dëshmitë e tyre “për arsye krejtësisht jorelevante”, ndërkohë që pranoi se këta dëshmitarë dhanë “përshkrime më të plota dhe mbase më të sakta” të vendit.⁶²⁶ Sipas Mustafës, këta dëshmitarë e njihnin kompleksin më mirë se kushdo dhe ishin në gjendje të vrojtonin ngjarjet aty.⁶²⁷ Ai argumenton se Trupi Gjykses gaboi që i konstatoi jobindëse “dëshmitë mohuese” të tyre – që aty nuk u mbajt i ndaluar askush – të cilat Trupi Gjykses i vlerësoi kundrejt (i) dëshmimeve të “vetëm tri viktimave” që

283, 286, 295-296, 298 (nënpika 2M). Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 40-45; Dosjen e Apelit, para. 82.

⁶²⁴ Dosja e Apelit, para. 248, 252, 260, 277. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 219.

⁶²⁵ Dosja e Apelit, para. 223 (z. Mehmetaj), 228, 231 (z. Jakup Ismaili (“z. Ismaili”)), 246 (z. Bislim Nreci (“z. Nreci”)), 252 (z. Kapllan Parduzy (“z. Parduzy”)), 260 (z. Nuredin Ibishi (“z. Ibishi”)), 277 (z. Musli Halimi (“z. Halimi”)) (nënpika 2M).

⁶²⁶ Dosja e Apelit, para. 158, 162-163, 169, 171, 175-177 (nënpika 2G), që i referohet Aktgjykimit, para. 369; Njoftimi për Apel, nënpikat 2G dhe 2N, para. 5. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 297-298 (nënpika 2M), 300-301 (nënpika 2N); Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 68, 72, 86; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 40-45. Mustafa parashtron më tej se nënpika 2G duhet të lexohet së bashku me nënpikën 2I në lidhje me “anshmërinë e supozuar të dëshmitarëve”. Shih Dosjen e Apelit, para. 178, 180-189; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 40. Gjithashtu, Paneli vëren se Mustafa paraqet argumente të ngjashme në nënpikat 2A, 2E dhe 2H, të cilat përkojnë me nënpikën 2G dhe, rrjedhimisht, i ka trajtuar ato së bashku. Shih më lart, para. 175, 199-202. Shih Dosjen e Apelit, para. 83(f)-(h) (nënpika 2A), 144-150, 179 (nënpikat 2E dhe 2H).

⁶²⁷ Dosja e Apelit, para. 164, 169, 171, 175 (nënpika 2G), 187-188 (nënpika 2I), 279, 282, 288, 291, 293, 297-298 (nënpika 2M). Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 144-149 (nënpika 2E); Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 18-21, 40-41, 45.

dhanë informacion të kufizuar për vendin ku u mbajtën të ndaluar,⁶²⁸ dhe (ii) dëshmisë së vetë Mustafës.⁶²⁹

251. Në veçanti, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses shtrembëroi dhe nuk shqyrtoi siç duhet dëshminë e z. Selatin Krasniqi sepse, ndër të tjera: (i) ndonëse z. Selatin Krasniqi pranoi se Mustafa ishte komandant i tij në BIA, ai nuk u pyet asnjëherë se “kush ishte në krye të bazës së BIA-s” në Zllash; (ii) çfarëdo “lidhje e ngushtë” ndërmjet z. Selatin Krasniqi dhe Mustafës nuk e ndryshonte faktin se ai nuk pa asnjë person të ndaluar në kompleks; dhe (iii) nuk ka mospërputhje midis dëshmisë së tij dhe asaj të të akuzuarit.⁶³⁰

252. Sa i përket z. Ajeti, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses nuk e mori parasysh dëshminë e tij mbi bazën e faktorëve jorelevantë, të cilët nuk e zhvlerësojnë përvojën e tij në kompleks.⁶³¹

253. Gjithashtu, sa u përket dëshmime të znj. Hadri dhe znj. Canolli-Kaçiu, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se, ndonëse ato kishin punuar në kompleks gjatë periudhës përkatëse, dëshmitë e tyre lidhur me ngjarjet për të cilat janë

⁶²⁸ Dosja e Apelit, para. 180-185, 189 (nënpika 2I). Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 220, 293 (nënpika 2M). Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 22, 40-42.

⁶²⁹ Dosja e Apelit, para. 182-184, 187 (nënpika 2I). Sipas Panelit, kur Mustafa i referohet “dëshmisë së apellesit”, ai e ka fjalën për deklaratën e tij si i dyshuar (P00111-P00118) (konfidenciale). Mustafa argumenton se Trupi Gjykses gaboi që e konstatoi “autentike dhe të besueshme” dëshminë e atij vetë se në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën të ndaluar ushtarë dhe ndoshta edhe civilë, bazuar në njohurinë e tij të drejtpërdrejtë dhe kontrollin e tij mbi bazën e BIA-s. Shih Dosjen e Apelit, para. 182-183. Ai parashtron se i akuzuari dëshmoi se kishte qenë vetëm për një kohë të shkurtër në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës së akuzave, kurse dëshmitarët e tjerë të Mbrojtjes kishin qenë atje për një periudhë më të gjatë dhe të vazhdueshme. Shih Dosjen e Apelit, para. 187.

⁶³⁰ Dosja e Apelit, para. 158-162 (nënpika 2G), 278-281 (nënpika 2M).

⁶³¹ Dosja e Apelit, para. 164-167 (nënpika 2G), 282-287 (nënpika 2M). Në nënpikën 2G, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses nuk e mori parasysh dëshminë e dëshmitarit për arsye që nuk kanë lidhje me çështjen, si vijon: kontaktet e dëshmitarit me telefon me të akuzuarin më 2020; një postim në Facebook; dhe faktin që ai në fillim nuk përmendi anëtarë të tjerë të BIA-s. Shih Dosjen e Apelit, para. 165-167. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 43-44. Në nënpikën 2M, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses la të kuptohej se z. Ajeti nuk dëshmoi me vërtetësi për shkak të “lidhjeve” të tij me të akuzuarin. Shih Dosjen e Apelit, para. 285-286.

ngritur akuzat bazoheshin në njohuri të kufizuara, sepse ato më së shumti rrinin në dhomat e tyre.⁶³²

254. Sa i përket z. Humolli, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses nuk bëri konstatim se pse vrojtmet dhe përvoja e tij në kompleks nuk mund të ishin të besueshme dhe të mbështetshme duke nënkuptuar se skepticizmi i dëshmitarit ndaj Dhomave të Specializuara ishte faktor vendimtar për mospranimin e dëshmisë së tij.⁶³³ Mustafa argumenton gjithashtu se Trupi Gjykses gaboi që nuk e pranoi dëshminë e z. Humolli në lidhje me pushtetin e BIA-s për të arrestuar ose mbajtur të ndaluar persona sepse, duke marrë parasysh rolin udhëheqës të tij në zonën operative të Llapit, ai ishte më mirë në gjendje të jepte hollësi për strukturën dhe autoritetin e njësiteve që vepronin aty.⁶³⁴

255. Mustafa argumenton më tej se Trupi Gjykses gaboi që nuk i mori parasysh dëshmitë e dëshmitarëve lidhur me mbrojtjen e Mustafës përmes alibisë ⁶³⁵ ndër të tjera, sepse: (i) bëri “konstatime tejet të gjera” bazuar në aktivitetin e dëshmitarëve në rrjete sociale;⁶³⁶ (ii) i keqinterpretoi përgjigjet e dëshmitarëve si synim për të distancuar veten dhe të akuzuarin nga çfarëdo përfshirje në ngjarjet, ose për të distancuar veten nga i akuzuari;⁶³⁷ (iii) nxori përfundimin se ata dhanë dëshmi të favorshme për të akuzuarin bazuar në lidhjet dhe kontaktet e dëshmitarëve me të

⁶³² Dosja e Apelit, para. 168-171 (nënpika 2G), 288-292, 297-299 (nënpika 2M). Mustafa argumenton gjithashtu se fakti që znj. Canolli-Kaçiu “pëlqeu” një postim në *Facebook*, me sa duket për t’i dhënë të akuzuarit mbështetje morale, nuk ndikon në ato që kishte vrojtuar kur ishte në kompleks. Shih Dosjen e Apelit, para. 168, 172 (nënpika 2G), 295, 298 (nënpika 2M). Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 147 (nënpika 2E); Aktgjykimin, para. 216, 222-223.

⁶³³ Dosja e Apelit, para. 173-175 (nënpika 2G), 300-301 (nënpika 2N). Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 145 (nënpika 2E); Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 20, 44.

⁶³⁴ Dosja e Apelit, para. 83(h) (nënpika 2A), 302-303 (nënpika 2N). Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 20.

⁶³⁵ Paneli vëren se disa nga argumentet e Mustafës në nënpikën 2M përkohë me ato në nënpikat 1L dhe 2O, ndaj edhe i ka trajtuar ato së bashku në pjesën ku trajtohet mbrojtja e Mustafës përmes alibisë. Shih Dosjen Apelit, para. 238-240. Shih gjithashtu më poshtë, Pjesën N, para. 310-324.

⁶³⁶ Dosja e Apelit, para. 223 (z. Mehmetaj), 227 (z. Ahmet Ademi (“z. Ademi")), 232, 234 (z. Hazir Borovci (“z. Borovci")), 244 (z. Nreci).

⁶³⁷ Dosja e Apelit, para. 224-226 (z. Mehmetaj), 276 (z. Halimi).

akuzuarin, të afërmit ose me dëshmitarë të tjerë,⁶³⁸ (iv) shtrembëroi llojin e lidhjes së pretenduar epror-vartës midis të akuzuarit dhe disa dëshmitarëve,⁶³⁹ (v) i cilësoi si harresë vështirësitë e disa dëshmitarëve për të kujtuar një datë konkrete,⁶⁴⁰ (vi) gjykoj se një dëshmitar ishte ndikuar nga të tjerë, sepse kishte kërkuar të rifreskonte kujtesën,⁶⁴¹ dhe (vii) e përshkroi kujtesën e një dëshmitari për ngjarjet si “konfuze dhe jobindëse”.⁶⁴²

256. Gjithashtu, Mustafa argumenton konkretisht se Trupi Gjykses gaboi që mori si të mirëqenë se dëshmitarët e Mbrojtjes, gjegjësisht z. Borovci dhe z. Gani Sopi, i bashkërenduan dëshmitë e tyre në lidhje me largimin nga Prishtina për në Butovc, që lidhet me mbrojtjen e Mustafës përmes alibisë.⁶⁴³ Në veçanti, Mustafa argumenton se, ndër të tjera, Trupi Gjykses gaboi në përcaktimin e periudhës së festës fetare të Kurban Bajramit (ose “Bajramit të Vogël”) më 1999.⁶⁴⁴

257. Sa i përket z. Halimi, i cili ishte komandant i qendrës së stërvitjes në Zllash dhe u thirr si dëshmitar në lidhje me akuzën e ndalimit arbitrar, Mustafa argumenton se në kundërshtim me konstatimet e Trupit Gjykses, ai do ta kishte ditur nëse W01679 do të ishte marrë prej atje.⁶⁴⁵

⁶³⁸ Dosja e Apelit, para. 228 (z. Ismaili), 232-233 (z. Borovci), 244 (z. Nreci). Mustafa argumenton gjithashtu se fakti që i akuzuari kishte numrin e telefonit të z. Halimi nuk është relevant për besueshmërinë e tij. Shih Dosjen e Apelit, para. 276.

⁶³⁹ Dosja e Apelit, para. 229-230 (z. Ismaili), 233 (z. Borovci), 243, 245 (z. Nreci).

⁶⁴⁰ Dosja e Apelit, para. 236-237 (z. Gani Sopi (“z. Gani Sopi")), 241-242 (z. Nreci).

⁶⁴¹ Dosja e Apelit, para. 247 (z. Nazmi Vrbovc (“z. Vrbovc”).

⁶⁴² Dosja e Apelit, para. 263-270 (z. Sheqir Rrahimi (“z. Rrahimi)). Sa i përket z. Ibishi, Mustafa parashtron përgjithësisht se faktorët për të cilët Trupit Gjykses konstatoi se ndikuan në besueshmërinë e dëshmitarit ishin të pabazë, sepse Trupi Gjykses asnjëherë nuk e kundërshtoi dëshminë e tij lidhur me këta faktorë, si edhe se Trupi Gjykses është i njëanshëm, sepse i përdor ose përjashtoi pjesë të dëshmisë së tij në mënyrë arbitrare. Shih Dosjen e Apelit, para. 258-262.

⁶⁴³ Njoftimi për Apel, nënpika 2J, para. 5; Dosja e Apelit, para. 190-203. Shih më poshtë, Pjesën N, para. 310-324.

⁶⁴⁴ Mustafa argumenton se Trupi Gjykses gaboi që u dha peshë datave specifike dhe se fakti që z. Borovci pyeti një person të tretë (hoxhën) për datën e “Bajramit të Vogël” është jorelevant. Shih Dosjen e Apelit, para. 194-195, 198-201. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 191-193, 196-197, 237.

⁶⁴⁵ Dosja e Apelit, para. 271-275, që i referohet Aktgjykimit, para. 196.

258. ZPS-ja përgjigjet se Mustafa ngatërron mbështetshmërinë me besueshmërinë dhe se, në kundërshtim me argumentet e tij, Trupi Gjykues i shqyrtoi siç duhet faktorët që lidheshin me besueshmërinë e dëshmitarëve të Mbrojtjes, përfshirë kundërthëniet dhe mospërputhjet e brendshme, mungesën e lidhjes logjike me dëshmi të tjera, marrëveshjet mes tyre, problemet me kujtesën, kohën që ka kaluar dhe qëndrimin shumë të njëanshëm në favor të Mustafës, BIA-s dhe UÇK-së.⁶⁴⁶

259. ZPS-ja përgjigjet më tej se Mustafa në mënyrë të përsëritur nuk i citon konstatimet e Trupit Gjykues që kundërshton në lidhje me pesë dëshmitarët që dëshmuuan për kompleksin e ndalimit në Zllash⁶⁴⁷ dhe në vend të tyre u referohet disa pjesëve të Vlerësimit të Përgjithshëm në Aktgjykim.⁶⁴⁸ Sipas ZPS-së, Mustafa nuk përmbush “standardin e lartë që kërkohet për të kundërshtuar me efektivitet diskrecionin gjyqësor”⁶⁴⁹ dhe Trupi Gjykues i shqyrtoi siç duhet faktorët relevantë që patën, ose mund të kishin pasur ndikim mbi mbështetshmërinë në dëshmitë e dëshmitarëve dhe, si rezultat, disa prej dëshmimeve i mori me rezervë.⁶⁵⁰ ZPS-ja argumenton gjithashtu se Mustafa thjesht shpreh mospajtim me konstatimet faktike dhe vlerësimin e provave nga Trupi Gjykues dhe parashtron se, në kundërshtim me pretendimet e Mustafës, Trupi Gjykues konstatoi se një numër i dëshmitarëve të Mbrojtjes ishin në gjendje të bënin “përshkrime më të plota dhe mbase më të sakta” të kompleksit të ndalimit në Zllash.⁶⁵¹

⁶⁴⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 79.

⁶⁴⁷ Z. Selatin Krasniqi, z. Ajeti, znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu, dhe z. Humolli.

⁶⁴⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 123.

⁶⁴⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 117.

⁶⁵⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 124. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 74-75, 85-86. ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykues “me të drejtë shqyrtoi disa faktorë relevantë”, si: lidhjet e ngushta me UÇK-në ose të akuzuarin; qëndrimin e njëanshëm kundër Dhomave të Specializuara dhe/ose ZPS-së; qasjen selektive ndaj fakteve; dhe ngurrimin për të folur për disa aspekte, veçanërisht ato që mund të fajësonin të akuzuarit. Shih Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 124.

⁶⁵¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 125, që i referohet Aktgjykimit, para. 369. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 85-86 (nënpika 2N), ku ZPS-ja vuri në dukje se parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me dëshminë z. Humolli për kompleksin e ndalimit në Zllash trajtohen në nënpikën 2G.

260. Konkretisht, sa i përket z. Humolli, ZPS-ja përgjigjet se ky dëshmitar kishte vetëm njohuri të përgjithshme dhe të bazuara në thëniet e të tjerëve lidhur me pushtetin e BIA-s për të arrestuar ose ndaluar persona dhe se, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e operacioneve të BIA-s dhe problemet me besueshmërinë në dëshminë e tij, Trupi Gjykses me të drejtë e hodhi poshtë dëshminë e tij për këtë aspekt.⁶⁵²

261. ZPS-ja përgjigjet më tej edhe se Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi se z. Borovci dhe z. Gani Sopi i bashkërenduan dëshmitë për datën e largimit të tyre nga Prishtina për në Butovc dhe arriti në këto konstatime në bazë të shqyrtimit të një numri faktorësh.⁶⁵³ ZPS-ja parashtron gjithashtu se argumenti i Mustafës se Trupi Gjykses i keqinterpretoi datat e Bajramit të Vogël më 1999 ishte i gabuar, sepse të dy dëshmitarët dëshmuuan, ndër të tjera, se Bajrami i Vogël filloi më 31 mars 1999, që bie ndesh me një tabelë e marrë nga një burim i hapur informacioni, sipas së cilës festa filloi më 28 mars 1999.⁶⁵⁴

262. Së fundi, ZPS-ja përgjigjet se argumentet e Mustafës se disa dëshmitarë të Mbrojtjes duhej të ishin “paralajmëruar ose t’u tërhiqej vëmendja” se dëshmia e tyre ishte e pavërtetë janë të pafaktuara dhe se, para se të jepnin dëshmi, të gjithë dëshmitarët e Mbrojtjes u paralajmëruan siç duhej për të thënë të vërtetën.⁶⁵⁵

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

- a. Pretendimet e përgjithshme për gabime në lidhje me vlerësimin e dëshmitarëve

263. Paneli vë në dukje se argumenti kryesor i Mustafës në nënpikat 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2G pjesërisht, 2H pjesërisht, 2I pjesërisht, 2J pjesërisht, 2M pjesërisht dhe 2N pjesërisht, është se Trupi Gjykses nuk i mori parasysh dëshmitë e dëshmitarëve që dhanë dëshmi të favorshme për Mbrojtjen mbi bazën e faktorëve jorelevantë dhe,

⁶⁵² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 87. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 85-86.

⁶⁵³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 80. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 83.

⁶⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 81-82.

⁶⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 84.

sidomos, sipas Mustafës, për arsye që nuk kishin të bënin me përmbajtjen e dëshmive të tyre.

264. Së pari, Paneli vëren se, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës,⁶⁵⁶ kur vlerësoi besueshmërinë e dëshmitarëve, Trupi Gjykses në fakt shqyrtoi dëshmitë e tyre duke u bazuar në faktet dhe ngjarjet për të cilat ishin thirrur të dëshmonin. Nga njëra anë, Trupi Gjykses vuri në dukje rastet kur dëshmitarët ishin të hapur dhe dhanë dëshmi të qartë dhe realiste lidhur me akuzat dhe, mbi atë bazë, i konstatoi dëshmitë e tyre të besueshme.⁶⁵⁷ Nga ana tjetër, Trupi Gjykses vuri në dukje rastet kur dëshmitarët: (i) ngurronin t'u përgjigjeshin, ose u bënin bisht pyetjeve lidhur me akuzat, në veçanti, në lidhje me ndalimin dhe keqtrajtimin e personave në Zllash dhe pyetjeve me gjasë inkriminuese për të akuzuarin;⁶⁵⁸ (ii) binin në kundërshtim me vetveten kur dëshmuuan për ngjarjet përkatëse;⁶⁵⁹ (iii) dhanë dëshmi kundërthënëse

⁶⁵⁶ Paneli vëren se Mustafa kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshmitë e këtyre dëshmitarëve: z. Selatin Krasniqi (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M), z. Ajeti (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M), znj. Hadri (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M), znj. Canolli-Kaçiu (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M), z. Humolli (nënpikat 2A, 2E, 2G, 2N), z. Mehmetaj (nënpikat 2I, 2M), z. Ademi (nënpika 2M), z. Ismaili (nënpika 2M), z. Borovci (nënpikat 2J, 2M), z. Gani Sopi (nënpikat 2J, 2M), z. Nreci (nënpika 2M), z. Vrbovci (nënpika 2M), z. Parduzi (nënpika 2M), z. Ibishi (nënpikat 2I, 2M), z. Rrahimi (nënpika 2M), z. Halimi (nënpika 2M). Paneli vëren se në Dosjen e Apelit, Mustafa kundërshton gjithashtu vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshmitarët e ZPS-së, z. Fatmir Sopi (nënpikat 2A, 2E, 2I) dhe z. Veseli (nënpikat 2A, 2E, 2I), por nuk i shtjellon, as nuk i mbështet me prova argumentet në këtë aspekt. Gjithashtu, argumentet lidhur me vlerësimin e dëshmive të z. Fatmir Sopi dhe z. Veseli, Mustafa i paraqiti vetëm shkurtimisht për herë të parë në seancën e apelit. Në këto rrethana, Paneli i Apelit nuk do t'i trajtojë veç e veç kundërshtimet konkrete të Mustafës lidhur me dëshmitë e z. Fatmir Sopi apo të z. Veseli, por do t'i referohet metodologjisë të Trupit Gjykses për vlerësimin e dëshmive të tyre më përgjithësisht gjatë trajtimit të kundërshtimeve të Mustafës më poshtë. Shih Dosjen e Apelit, para. 83(g), 144, 180; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 18-20, 43.

⁶⁵⁷ Shih, veçanërisht, Aktgjykimin, para. 115-117, 122 (z. Fatmir Sopi), 125-126, 130 (z. Veseli), 195 (z. Halimi), 207 (z. Selatin Krasniqi), 217 (z. Hadri). Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se disa dëshmitarë të Mbrojtjes bënë "përshkrime më të plota dhe mbase më të sakta" të kompleksit të ndalimit në Zllash. Shih Aktgjykimin, para. 369.

⁶⁵⁸ Shih, veçanërisht, Aktgjykimin, para. 118-121 (ku theksohet se "[Fatmir] Sopi ishte kundërshtues dhe i mjegullt kur iu përgjigj pyetjeve në lidhje me dijeninë e mundshme të tij për ndalimin dhe/ose keqtrajtimin e personave në Zllash"), 127, 129 (z. Veseli), 133 (z. Humolli), 141 (z. Mehmetaj), 148 (z. Ademi), 154 (z. Borovci), 160-162 (z. Gani Sopi), 168-169 (z. Nreci), 198-199 (z. Halimi), 202-203, 206 (z. Selatin Krasniqi), 212 (z. Ajeti). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 375-376.

⁶⁵⁹ Shih, veçanërisht, Aktgjykimin, para. 120 (z. Fatmir Sopi), 128 (z. Veseli), 133 (z. Humolli), 147 (z. Ademi), 154 (z. Borovci), 192 (z. Rrahimi), 196, 198 (z. Halimi), 202-203 (z. Selatin Krasniqi).

ose mospërputhëse me dëshmi të tjera;⁶⁶⁰ ose (iv) ndryshuan aspekte themelore të dëshmive të tyre në mënyrë shumë të dukshme e të ngjashme, që tregonte se dëshmitarët ishin marrë vesh mes tyre.⁶⁶¹

265. Së dyti, Paneli vëren se Trupi Gjykses mori parasysht edhe faktorë të tjerë, të cilët sipas Mustafës nuk “kishin lidhje me ngjarjet” dhe rrjedhimisht, ishin jorelevantë.⁶⁶² Konkretisht, në vlerësimin e dëshmitarëve, Trupi Gjykses konstatoi se u vërtetuan faktorët në vijim: (i) lidhjet e ngushta me UÇK-në dhe/ose me të akuzuarin dhe mbështetja e shprehur në rrjete sociale;⁶⁶³ (ii) njëanshmëria e shprehur ndaj Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së;⁶⁶⁴ (iii) tregues se dëshmitarët u morën vesh mes tyre ose me të akuzuarin;⁶⁶⁵ (iv) fakti që një dëshmitar i përcolli seancat dhe/ose dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë në gjykim;⁶⁶⁶ (v) harresat;⁶⁶⁷ ose (vi) njohuritë e kufizuara për të dëshmuar për ngjarjet që lidhen me akuzat.⁶⁶⁸ Paneli vëren se Mustafa nuk e mbështet me fakte pretendimin e tij të përgjithshëm se këta faktorë janë jorelevantë dhe për më tepër ai nuk pranon se faktorët e përmendur nga Trupi Gjykses mbështeten nga jurisprudenca.⁶⁶⁹

266. Paneli i Apelit rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se Trupi Gjykses shtjelloi saktë metodologjinë e vet lidhur me vlerësimin e provave në këtë çështje

⁶⁶⁰ Shih, veçanërisht, Aktgjykimin, para. 119 (z. Fatmir Sopi), 128 (z. Veseli), 133 (z. Humolli), 141 (z. Mehmetaj), 147 (z. Ademi), 161-162 (z. Gani Sopi).

⁶⁶¹ Shih, veçanërisht, Aktgjykimin, para. 156-157 (z. Borovci), 164 (z. Gani Sopi). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 279-281, 287.

⁶⁶² Njoftimi për Apel, nënpika 2M, para. 5. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpika 2G, para. 5; Dosjen e Apelit, para. 161, 163, 235, 246, 248, 259, 295.

⁶⁶³ Aktgjykimi, para. 135-136 (z. Humolli), 142-144 (z. Mehmetaj), 147 (z. Ademi), 151 (z. Ismaili), 155-158 (z. Borovci), 163, 165 (z. Gani Sopi), 169 (z. Nreci), 178 (z. Parduzy), 204, 206 (z. Selatin Krasniqi), 210-211, 213 (z. Ajeti), 220-223 (znj. Canolli-Kaçiu).

⁶⁶⁴ Aktgjykimi, para. 134 (z. Humolli), 143 (z. Mehmetaj), 179, 181 (z. Parduzy), 186-188 (z. Ibishi).

⁶⁶⁵ Aktgjykimi, para. 143-144 (z. Mehmetaj), 156-158 (z. Borovci), 164-165 (z. Gani Sopi), 170 (z. Nreci), 173-175 (z. Vrbovc). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 281, 286.

⁶⁶⁶ Aktgjykimi, para. 141 (z. Mehmetaj), 169 (z. Nreci), 175 (z. Vrbovc), 180 (z. Parduzy), 187 (z. Ibishi).

⁶⁶⁷ Aktgjykimi, para. 152 (z. Ismaili), 166 (z. Gani Sopi), 171 (z. Nreci), 176 (z. Vrbovc). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 264, 267, 275-276, 284.

⁶⁶⁸ Aktgjykimi, para. 197 (z. Halimi), 216 (znj. Hadri), 219 (znj. Canolli-Kaçiu).

⁶⁶⁹ Shih Aktgjykimin, para. 35 dhe referencat e cituara aty.

gjyqësore, veçanërisht lidhur me vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre.⁶⁷⁰ Sipas mendimit të Panelit të Apelit, Trupi Gjyqësor dha një arsytim të duhur dhe të hollësishëm për trajtimin me kujdes të dëshmitarëve të disa dëshmitarëve.⁶⁷¹ Ai nuk e vlerësoi besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve në mënyrë të shkëputur, por, pasi i dëgjoi të gjitha dëshmitë, mori parasysh pjesë të caktuara të dëshmitarëve të tyre, për shembull në lidhje me rolin e të akuzuarit dhe pushtetin e tij mbi BIA-n, por i konstatoi jo të besueshme disa përshkrime të të njëjtëve dëshmitarë, si për shembull ato që mohonin ndalimet ose keqtrajtimet në Zllash.⁶⁷² Në dallim nga kjo, Paneli gjykon se metodologjia e propozuar nga Mustafa për vlerësimin e dëshmitarëve të dëshmitarëve në mënyrë të shkëputur, pa marrë parasysh faktorët e tjerë, si rrethanat personale ose përputhshmërinë me dëshmi të tjera,⁶⁷³ është e pabazë.⁶⁷⁴

⁶⁷⁰ Shih më lart, para. 233.

⁶⁷¹ Shih, veçanërisht, Aktgjykimin, para. 133-137 (z. Humolli), 140-144 (z. Mehmetaj), 146-148 (z. Ademi), 151-152 (z. Ismaili), 154-158 (z. Borovci), 160-166 (z. Gani Sopi), 168-171 (z. Nreci), 173-176 (z. Vrbovci), 178-181 (z. Parduzi), 185-188 (z. Ibishi), 196-200 (z. Halimi), 202-207 (z. Selatin Krasniqi), 209-213 (z. Ajeti), 219-223 (znj. Canolli-Kaçiu). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 118-122 (z. Fatmir Sopi), 127-130 (z. Veseli), 192-193 (z. Rrahimi).

⁶⁷² Shih p.sh. Aktgjykimin, para. 115-122 (z. Fatmir Sopi), 125-130 (z. Veseli), në të cilin Trupi Gjyqësor i konstatoi përgjithësisht të besueshme përshkrimet e z. Fatmir Sopi dhe të z. Veseli në lidhje me strukturat dhe operacionet e UÇK-së në zonën e Zllashit dhe rolin e të akuzuarit, pushtetin e tij mbi njësitin BIA dhe praninë e tij në Zllash gjatë periudhës përkatëse, por jo të besueshme dëshmitë e tyre në lidhje me mbajtjen dhe keqtrajtimin e të ndaluarave në Zllash. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 195-200 (z. Halimi), ku Trupi Gjyqësor e konstatoi të besueshme dëshminë e z. Halimi lidhur me veprimtaritë dhe programin e stërvitjes ditore në shkollën e Zllashit, por konstatoi që pjesë të tjera të dëshmisë së tij ndikuan në besueshmërinë e tij; Aktgjykimin, para. 77-83 (W03594), ku Trupi Gjyqësor e konstatoi të besueshme dëshminë e W03594-ës lidhur me arrestimin e tij nga UÇK-ja, mbajtjen në kompleksin e ndalimit në Zllash, praninë e të ndaluarave të tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe rrethanat e lirim të tij, por jo të besueshme atë që dëshmoi në lidhje me trajtimin e tij dhe të personave të tjerë që u mbajtën në ndalim. Shih gjithashtu më poshtë, para. 271-296.

⁶⁷³ Mustafa sugjeron se Trupi Gjyqësor duhej të kishte marrë parasysh vetëm përmbajtjen e dëshmitarëve, dhe jo, për shembull, rrethanat personale. Shih p.sh. Dosjen e Apelit, para. 161, 166-167, 172-173.

⁶⁷⁴ Paneli i Apelit vëren se qasja e Mustafës nuk bazohet në kornizën ligjore dhe praktikën e Dhomave të Specializuara, as në jurisprudencën ndërkombëtare. Shih veçanërisht rregullën 139(2), (6) të Rregullores; Aktgjykimin në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 44; *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 132, 137, 1228; *Prlić et al.* Appeal Judgement, para. 200-201; *Kanyarukiga* Appeal Judgement, para. 121, 136; *Ongwen* Trial Judgement, para. 227, 239, 260.

267. Mustafa argumenton se “i vetmi faktor përcaktues për besueshmërinë e një personi është nëse dëshmitari është ose nuk është duke thënë të vërtetën” dhe se Trupi Gjykses duhej të kishte vërtetuar me fakte mosvërtetësinë e dëshmisë së një dëshmitari, para se ta hidhte poshtë dëshminë e tij apo të saj.⁶⁷⁵ Paneli i Apelit gjykon se, ndonëse deklaratat e dëshmitarëve në gjykim prezumohen se janë të besueshme dhe fakti që dëshmitarët japin dëshmi nën betim dhe mund të merren në pyetje nga pala kundërshtare është tregues i besueshmërisë, Trupi Gjykses ka kompetencë të plotë diskrecionale në lidhje me peshën dhe besueshmërinë e duhur që i akordohet një dëshmitari.⁶⁷⁶ Lidhur me këtë aspekt, Paneli vëren se përcaktimi i besueshmërisë jo domosdoshmërisht varet nga konstatimi gjyqësor se dëshmitari dha dëshmi të rreme.⁶⁷⁷

268. Paneli vëren se, para se të jepnin dëshmi, dëshmitarët bënë betimin dhe u paralajmëruan për pasojat në rast se nuk dëshmonin me vërtetësi dhe se Mustafa nuk e mbështet me fakte argumentin se dëshmitarët duhej të “paralajmëroheshin ose t’u tërhiqej vëmendja” përsëri se dëshmia e tyre mund të konsiderohej e pavërtetë.⁶⁷⁸

269. Gjithashtu, Paneli nuk bindet nga argumentet e pabazuara të Mustafës se Trupi Gjykses dhe ZPS-ja duhej t’i kishin ballafaquar disa dëshmitarë të Mbrojtjes me dëshmitë e viktimave që kundërshtonin dëshmitë e tyre⁶⁷⁹ ose t’u kishin bërë pyetje për faktorë që ndikonin në besueshmërinë e tyre.⁶⁸⁰ Paneli rikujton se, megjithëse Rregullorja i jep Trupit Gjykses kompetencë dhe diskrecion të marrë në pyetje

⁶⁷⁵ Shih Dosjen e Apelit, para. 222, 246, 248, 252, 260, 285.

⁶⁷⁶ *Ntagerura et al.* Appeal Judgement, para. 388; *Nahimana et al.* Appeal Judgement, para. 194. Shih gjithashtu më lart, para. 38.

⁶⁷⁷ *Bikindi* Appeal Judgement, para. 115; *Simba* Appeal Judgement, para. 31.

⁶⁷⁸ Dosja e Apelit, para. 223, 231, 277. Gjithsesi, Paneli vëren se Trupi Gjykses u rikujtoi disa dëshmitarëve që të thoshin të vërtetën gjatë dhënies së dëshmisë. Shih për shembull, Transkriptin (Brahim Mehmetaj), 23 mars 2022, f. 2682-2683; Transkriptin (Sheqir Rrahimi), 13 prill 2022, f. 3697-3699.

⁶⁷⁹ Dosja e Apelit, para. 223 (në lidhje me dëshminë e z. Mehmetaj).

⁶⁸⁰ Dosja e Apelit, para. 228, 252, 260, 277 (në lidhje me dëshmitë e z. Ismaili, z. Parduzi, z. Ibishi dhe z. Halimi).

dëshmitarë ose të kërkojë prova në lidhje me fakte ose aspekte që nuk janë diskutuar nga palët, ai nuk është i detyruar të bëjë këtë.⁶⁸¹ Për më tepër, Paneli vëren se ZPS-ja i pyeti gjerësisht dëshmitarët e Mbrojtjes për aspekte që ndikonin në besueshmërinë e tyre⁶⁸² si dhe i ballafaqoi me provat përkatëse të Prokurorisë që kundërshtonin dëshmitë e dhëna prej tyre.⁶⁸³ Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Trupi Gjykses nuk kishte detyrimin t'i ballafaqonte dëshmitarët me mospërputhjet ose kundërthëniet në dëshmitë të tyre, ose me faktorë që ndikonin në besueshmërinë e tyre.⁶⁸⁴ Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e pafaktuara të Mustafës në këtë aspekt.

270. Duke pasur parasysh argumentet specifike të Mustafës,⁶⁸⁵ Paneli në vijim do të analizojë vlerësimin e Trupit Gjykses për besueshmërinë e: (i) dëshmitarëve që dëshmuuan lidhur me kompleksin e ndalimit në Zllash dhe pretenduan se askush nuk u mbajt i ndaluar aty ("dëshmitë mohuese", në parashtrimet e Mustafës);⁶⁸⁶ (ii) dëshmitarëve që dëshmuuan lidhur me mbrojtjen e të akuzuarit përmes alibisë;⁶⁸⁷

⁶⁸¹ Vendimi i Apelit mbi Marrjen në Pyetje nga Gjykata në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 34.

⁶⁸² Shih, veçanërisht, Transkriptin (Jakup Ismaili), 29 mars 2022, f. 2923-2925, 2929-2930; Transkriptin (Kapllan Parduzi), 11 prill 2022, f. 3499-3500, 3503-3506; Transkriptin (Nuredin Ibishi), 12 prill 2022, f. 3634-3637, 3640-3645; Transkriptin (Musli Halimi), 20 prill 2022, f. 3815-3821.

⁶⁸³ Shih, veçanërisht, Transkriptin (Brahim Mehmetaj), 23 mars 2022, f. 2679-2681, 2688-2689. Shih gjithashtu rregullën 143(3) të Rregullores.

⁶⁸⁴ *Contra* Dosja e Apelit, para. 223, 228, 252, 260, 277.

⁶⁸⁵ Paneli vëren se Mustafa kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykses për 15 dëshmitarët e Mbrojtjes dhe një dëshmitar të ZPS-së (z. Humolli), i cili fillimisht u propozua si dëshmitar nga Mbrojtja. Shih Aktgjykimin, para. 131. Dëshmitarët në fjalë janë: z. Selatin Krasniqi (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M), z. Ajeti (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M), znj. Hadri (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M), znj. Canolli-Kaçiu (nënpikat 2E, 2G, 2I, 2M); z. Humolli (nënpikat 2A, 2E, 2G, 2N), z. Mehmetaj (nënpikat 2I, 2M); z. Ademi (nënpika 2M), z. Ismaili (nënpika 2M), z. Borovci (nënpikat 2J, 2M), z. Gani Sopi (nënpikat 2J, 2M), z. Nreci (nënpika 2M), z. Vrbovci (nënpika 2M), z. Parduzi (nënpika 2M), z. Ibishi (nënpikat 2I, 2M), z. Rrahimi (nënpika 2M), z. Halimi (nënpika 2M).

⁶⁸⁶ Z. Selatin Krasniqi, z. Ajeti, znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu, z. Humolli. Sikurse u tha më lart, Mustafa përmend edhe z. Fatmir Sopi (nënpikat 2A, 2E, 2I) dhe z. Veseli (nënpikat 2A, 2E, 2I), por nuk shtjellon argumente në lidhje me këta dëshmitarë. Paneli i Apelit nuk do t'i trajtojë z. Fatmir Sopi dhe z. Veseli veç e veç. Shih më lart, poshtëshënimin 656.

⁶⁸⁷ Konkretisht z. Mehmetaj, z. Ademi, z. Ismaili, z. Nreci, z. Vrbovci, z. Parduzi, z. Ibishi, z. Rrahimi, z. Borovci dhe z. Gani Sopi.

dhe (iii) dëshmitarit të Mbrojtjes, z. Halimi, i cili dëshmoi lidhur me akuzën e ndalimit arbitrar.⁶⁸⁸

- b. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykses të dëshmitarëve që dhanë dëshmi për kompleksin e ndalimit në Zllash (nënpikat 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2G pjesërisht, 2H pjesërisht, 2I pjesërisht, 2M pjesërisht, 2N pjesërisht)

271. Sa i përket z. Selatin Krasniqi, Paneli konstaton se nuk është bindës argumenti i Mustafës se Trupi Gjykses shtrembëroi dëshminë e tij.⁶⁸⁹ Paneli vë në dukje se, edhe pse është e vërtetë se z. Selatin Krasniqi nuk u pyet konkretisht se “kush ishte në krye të bazës së BIA-s”,⁶⁹⁰ ky ishte thelbi i pyetjeve që iu bënë.⁶⁹¹ Për më tepër, Paneli vë në dukje se gjatë dëshmisë së tij, z. Selatin Krasniqi nuk ishte i gatshëm të pranonte se Mustafa kishte qenë në Zllash dhe kishte pushtet mbi anëtarët e BIA-s në Zllash.⁶⁹²

272. Gjithashtu, Paneli vëren se Mustafa thjesht nuk pajtohet me vlerësimin dhe konstatimin e Trupit Gjykses se besueshmëria e z. Selatin Krasniqi u cenua nga “qëndrimi i mbajtur nga dëshmitari” në lidhje me përdorimin e kompleksit të shtëpive të familjes së vet si qendër ndalimi dhe nga “lidhja e tij e fortë me të akuzuarin”.⁶⁹³ Sidoqoftë, Paneli i Apelit gjykon se përfundimi i Trupit Gjykses mbështetet në disa konstatime faktike.⁶⁹⁴ Në kundërshtim me pretendimin e Mustafës, Trupi Gjykses nuk shpërfilli dëshminë e z. Selatin Krasniqi; përkundrazi, ai vuri në dukje “dëshminë e tij të hollësishme” por, për shkak se besueshmëria e tij ishte “cenuar rëndë”, Trupi

⁶⁸⁸ Paneli vëren se për secilin dëshmitar, Mustafa kundërshton vetëm një ose vetëm disa prej faktorëve relevantë që shqyrtoi Trupi Gjykses gjatë vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve, ndërsa shpërfilli faktorë të tjerë që u shqyrjuan nga Trupi Gjykses. Shih më poshtë, para. 271-296.

⁶⁸⁹ Aktgjykimi, para. 202-203. *Contra* Dosja e Apelit, para. 158-160.

⁶⁹⁰ Dosja e Apelit, para. 158-160.

⁶⁹¹ Shih Transkriptin (Selatin Krasniqi), 21 prill 2022, f. 3912-3913, 3988, 3994-3995.

⁶⁹² Shih p.sh. Transkriptin (Selatin Krasniqi), 21 prill 2022, f. 3995-3997.

⁶⁹³ Aktgjykimi, para. 206. Shih Dosjen e Apelit, para. 161, 278.

⁶⁹⁴ Paneli i Apelit vë në dukje se Trupi Gjykses mori parasysh “përgjigjet kundërthënëse, bishtnuese dhe të pagjasa” të dëshmitarëve dhënë ZPS-së, duke treguar “mungesën shumë të fortë të dëshirës nga ana e dëshmitarit për të dhënë ndonjë informacion të njëmendtë për BIA-n, apo për ta lidhur veten me atë njësit” dhe “lidhje të fortë emocionale” me të akuzuarin. Shih Aktgjykimin, para. 202, 204, 206.

Gjykues e vlerësoi atë me kujdes dhe “vetëm për disa aspekte shumë specifike”.⁶⁹⁵ Paneli konstaton se ky konstatim është në përputhje me diskrecionin e Trupit Gjykues që të pranojë disa aspekte të dëshmisë së dëshmitarit dhe të hedhë poshtë të tjerat.⁶⁹⁶

273. Sa i përket z. Ajeti, Paneli përsëri vë në dukje se Mustafa thjesht nuk pajtohet me vlerësimin e Trupit Gjykues të besueshmërisë së dëshmitarit.⁶⁹⁷ Në kundërshtim me pretendimin e z. Mustafa, faktorët që Trupi Gjykues i mori parasysh, përfshirë “lidhjet tejet të ngushta” midis dëshmitarit dhe të akuzuarit, shkëmbimin e mesazheve të shumta mes tyre dhe mungesën e dëshirës nga ana e dëshmitarit që t’u përgjigjej pyetjeve në lidhje me anëtarë të rangut të lartë të njësitit BIA, janë relevante për vlerësimin e besueshmërisë së tij.⁶⁹⁸ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

274. Sa i përket znj. Hadri dhe znj. Canolli-Kaçiu, Paneli konstaton se nuk është bindës argumenti i Mustafës se Trupi Gjykues shtrembëroi dëshmitë e tyre kur konstatoi se ato kishin njohuri të kufizuara për ngjarjet relevante që ndodhën në Zllash.⁶⁹⁹ Në fakt, Paneli vë në dukje se të dyja dëshmitaret deklaruan se kishin pasur shumë punë dhe nuk kishin pasur kohë të dilnin jashtë dhe të vizitonin ndërtesat e tjera.⁷⁰⁰ Sa i përket vlerësimin të besueshmërisë së znj. Canolli-Kaçiu, Paneli vëren se argumentet e Mustafës në lidhje me aktivitetet e saj në *Facebook* shtrembërojnë

⁶⁹⁵ Aktgjykimi, para. 207.

⁶⁹⁶ Rregulla 139(6) e Rregullores. Shih më poshtë, para. 307.

⁶⁹⁷ Dosja e Apelit, para. 283-286; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 43-44.

⁶⁹⁸ Aktgjykimi, para. 209-213. *Contra* Dosja e Apelit, para. 165-167, 283-286.

⁶⁹⁹ Dosja e Apelit, para. 168-172, 289, 291-292, 297. Shih Aktgjykimin, para. 216, 219.

⁷⁰⁰ Transkripti (Teuta Hadri), 11 maj 2022, f. 4235-4236; Transkripti (Ibadete Canolli-Kaçiu), 12 maj 2022, f. 4325-4326, 4378-4379, 4381. Paneli gjithashtu konstaton se argumenti i Mustafës se znj. Hadri “punoj aty gjatë periudhës që mbulon Aktakuza deri në momentin kur u liruan të ndaluarit e pretenduar” është çorientues, pasi znj. Hadri deklaroi në gjykatë se ajo kishte qëndruar në Zllash “3 net dhe i ka rënë 4 ditë me ditën e fundit që na kanë shpëtuar, na kanë nxjerrë me të 15 plagosur me civile, na kanë kaluar nga zona e Zllashit në zonë tjetër”. Shih Transkriptin (Teuta Hadri), 11 maj 2022, f. 4212, 4234-4235.

konstatimet e Trupit Gjykses dhe nuk marrin parasysh deklaratat e dëshmitares në gjykatë.⁷⁰¹ Rrjedhimisht Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

275. Sa i përket dëshmitarit të ZPS-së z. Humolli, Paneli vë në dukje se Mustafa nuk mbështet me prova pohimin e vet të përgjithshëm se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se z. Humolli nuk ishte i besueshëm ose që hodhi poshtë dëshminë e tij për arsye jorelevante.⁷⁰² Sipas mendimit të Panelit të Apelit, Trupi Gjykses e vlerësoi saktë njëanshmërinë e shprehur nga z. Humolli kundër Dhomave të Specializuara, mbështetjen personale për të akuzuarin dhe lidhjet personale me të,⁷⁰³ krahas kundërshtive dhe mospërputhjeve në dëshminë e tij,⁷⁰⁴ kur konstatoi se këta faktorë ndikuan shumë në besueshmërinë e dëshmitarit.⁷⁰⁵ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykses, pas dëgjimit të të gjithë dëshmitarëve, përfshirë viktimat që dëshmuan në lidhje me kushtet e mbajtjes të ndaluar në Zllash, dhe pas vlerësimit të provave në tërësi, nuk gaboi që konstatoi se nuk ishte bindëse dëshmia e Humollit se BIA nuk kishte kompetenca të arrestonte ose ndalonte askënd.⁷⁰⁶ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

276. Sa i përket vlerësimit të dëshmisë së Mustafës në deklaratën si i dyshuar, Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa nuk e kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykses në deklaratën si i dyshuar, por vetëm kundërshton interpretimin e dëshmisë që ai ka

⁷⁰¹ Paneli vë në dukje se, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës, Trupi Gjykses nuk mori parasysh vetëm përdorimin nga znj. Canolli-Kaçiu të "ikonës" apo "simbolit të pëlqimit" në *Facebook*, si shprehje e mbështetjes për të akuzuarin, por edhe shpjegimin e saj në gjykatë se dëshironte të shprehte mbështetje morale për të akuzuarin. Shih Aktgjykimin, para. 222, që i referohet Transkriptit (Ibadete Canolli-Kaçiu), 12 maj 2022, f. 4383-4385. *Contra* Dosja e Apelit, para. 172, 295.

⁷⁰² Dosja e Apelit, para. 173-176. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 163; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 20-21, 44.

⁷⁰³ Aktgjykimi, para. 134-135.

⁷⁰⁴ Aktgjykimi, para. 133.

⁷⁰⁵ Aktgjykimi, para. 136.

⁷⁰⁶ Aktgjykimi, para. 375-376. *Contra* Dosja e Apelit, para. 302-303.

dhënë aty.⁷⁰⁷ Sipas Panelit, Trupi Gjykues nuk gaboi në vlerësimin e dëshmisë që dha i akuzuari kur konstatoi se “vetë i akuzuari pranoi se në bazën e BIA-s u mbajtën të ndaluar ushtarë” dhe se i akuzuari kishte pranuar se “asht fol që janë ndalu edhe civilë”.⁷⁰⁸ Paneli më tutje nuk e konsideron bindës argumentin e Mustafës se, duke qenë se ai ishte i pranishëm për pak kohë në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës përkatëse, dëshmitarët e Mbrojtjes ishin në pozitë më të mirë se i akuzuari që të dëshmonin për praninë e të ndaluarve.⁷⁰⁹ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit rikujton se nuk konstatoi se kishte gabime në përfundimet e Trupit Gjykues në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarëve të Mbrojtjes⁷¹⁰ apo kur hodhi poshtë pretendimet e Mustafës për alibi.⁷¹¹ Së treti, Paneli konstaton se vlerësimi prej Trupit Gjykues i deklaratës si i dyshuar të të akuzuarit nuk ishte i paarsyeshëm, bazuar në provat në tërësi, dhe sidomos duke pasur parasysh rolin e Mustafës si komandant i BIA-s.⁷¹² Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentin e Mustafës në lidhje me interpretimin nga Trupi Gjykues të dëshmisë së tij në deklaratën e tij si i dyshuar.

277. Paneli në vijim shqyrton argumentin e Mustafës se Trupi Gjykues gaboi që u dha më shumë peshë dëshmive të tri viktimave,⁷¹³ - që sipas tij dhanë informacion të kufizuar për vendin ku ishin mbajtur të ndaluar - sesa dëshmive të dëshmitarëve të

⁷⁰⁷ Dosja e Apelit, para. 182-184, 187. Paneli vë në dukje se Mustafa kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykues në deklaratën e të dyshuarit në nënpikat 1B dhe 2B. Këto kundërshtime, të cilat bazohen në argumente të ndryshme, janë trajtuar në kuadër të këtyre nënpikave. Shih më lart, para. 83, 190.

⁷⁰⁸ Aktgjykimi, para. 374, që i referohet P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 2-8, 15, 18; P00118 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 1-4, 6. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 119, 141, 376, 654. Paneli vë në dukje gjithashtu se kur u pyet nëse “kishte parë civilë, ushtarë të mbajtur të ndaluar në atë vend”, Mustafa u përgjigj qartë në mënyrë pohuese. Shih P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 6. *Contra* Dosja e Apelit, para. 187.

⁷⁰⁹ Dosja e Apelit, para. 187.

⁷¹⁰ Shih më lart, para. 271-275. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 136-137, 207, 213, 223. Trupi Gjykues e konsideroi znj. Hadri përgjithësisht të besueshme por konstatoi se asaj i mungonte baza e duhur e njohurive vetjake që dëshmia e saj të përdorej si dëshmi në të cilën mund të mbështetesh. Shih Aktgjykimin, para. 216-217.

⁷¹¹ Shih më poshtë, para. 315-324. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 333.

⁷¹² Shih Aktgjykimin, para. 374, 376.

⁷¹³ Edhe pse Mustafa nuk i identifikon në Dosjen e Apelit “tri viktimat” dëshmitë e të cilëve i kundërshton me “dëshmitë mohuese” të dhëna nga dëshmitarë të tjerë, Paneli kupton se viktimat janë W01679, W03593 dhe W04669.

tjerë të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash, që dhanë “dëshmi mohuese”.⁷¹⁴ Paneli vë në dukje se Mustafa thjesht nuk pajtohet me konstatimet relevante të Trupit Gjykses dhe nuk artikulon asnjë gabim në ushtrimin e kompetencës diskrecionale nga Trupi Gjykses gjatë përcaktimit të besueshmërisë dhe peshës së duhur të dëshmive të dëshmitarëve.⁷¹⁵ Paneli rikujton konstatimin e vet më lart se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se asnjë gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të pranonte dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës që identifikojnë vendin e mbajtjes në ndalim.⁷¹⁶ Për më tepër, Paneli konstaton se Trupi Gjykses dha arsye të mjaftueshme se pse u dha më shumë peshë dëshmive të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës krahasuar me dëshmitë e dëshmitarëve që dhanë “dëshmi mohuese” në lidhje me praninë e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash.⁷¹⁷ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

278. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit hedh poshtë argumentet e Mustafës në nënpikat 2A pjesërisht, 2E pjesërisht, 2G pjesërisht, 2H pjesërisht, 2I pjesërisht, 2M pjesërisht, dhe 2N pjesërisht, se Trupi Gjykses gaboi që hodhi poshtë dëshmitë e dëshmitarëve që ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe dhanë “dëshmi mohuese”.

⁷¹⁴ Dosja e Apelit, para. 181, 189, 220. Dëshmitarët në fjalë janë z. Selatin Krasniqi, z. Ajeti, znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu, z. Humolli si dhe z. Fatmir Sopi dhe z. Veseli. Shih më lart, poshtëshënimin 656.

⁷¹⁵ Shih më lart, para. 24, 36, 38.

⁷¹⁶ Shih më lart, para. 212. Shih gjithashtu më poshtë, para. 406-408.

⁷¹⁷ Konkretisht, Trupi Gjykses shpjegoi se “dëshmitë mohuese” të dhëna nga këta dëshmitarë nuk ishin bindëse sepse Trupi Gjykses konstatoi se ata shfaqën tendencë të fortë për të dhënë dëshmi në favor të të akuzuarit, BIA-së ose UÇK-së. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se ky “mohim” është në kundërshtim të qartë me dëshminë e vetë të akuzuarit në lidhje me mbajtjen në ndalim të ushtarëve dhe, me gjasë, të civilëve, në kompleksin e ndalimit në Zllash, që konfirmohet nga dëshmitari i Mbrojtjes, z. Mehmetaj dhe nga dëshmitë e viktimave që dhanë dëshmi të besueshme për rrethanat e ndalimit të tyre. Shih, konkretisht, Aktgjykimin, para. 374-376. Për më tepër, siç vuri në dukje Trupi Gjykses, edhe një dëshmitar i Mbrojtjes, z. Mehmetaj, kishte dëgjuar për ekzistencën e një dhome që ndodhej në bazën e BIA-së, në Zllash, ku u mbajtën njerëz. Shih Aktgjykimin, para. 374, që i referohet Transkriptit (Brahim Mehmetaj), 23 mars 2022, f. 2683-2684.

- c. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykses të dëshmitarëve që dhanë dëshmi për pretendimet për alibi të të akuzuarit (nënpikat 2J pjesërisht, 2M pjesërisht)

279. Sa i përket z. Mehmetaj, Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa nuk jep prova në mbështetje të pretendimit se Trupi Gjykses mori parasysh faktorë që nuk janë relevantë për vlerësimin e dëshmisë së tij.⁷¹⁸ Paneli vë në dukje se i vetmi faktor që Mustafa kundërshton konkretisht është mungesa e dëshirës së dëshmitarit që t'u përgjigjej pyetjeve në lidhje me veprimet e UÇK-së kundër bashkëpunëtorëve dhe praktikat e ndalimit.⁷¹⁹ Duke pasur parasysh faktorët e tjerë që mori parasysh Trupi Gjykses, në veçanti lidhjen e tij të ngushtë me të akuzuarin, Paneli konstaton se, edhe nëse do të kishte qenë i suksesshëm, ky kundërshtim nuk do të ndikonte në përfundimin e Trupit Gjykses se besueshmëria e z. Mehmetaj ishte cenuar në masë të madhe dhe se dëshmia e tij duhej të konsiderohej me kujdesin më të madh.⁷²⁰ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

280. Sa i përket z. Ademi, Paneli vë në dukje se Mustafa kundërshton konstatimin e Trupit Gjykses se z. Ademi e njihte z. Mehmetaj në bazë të aktiviteteve në media sociale,⁷²¹ por anashkalon faktorët e tjerë të marrë parasysh nga Trupi Gjykses gjatë vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve.⁷²² Paneli konstaton se Mustafa nuk demonstroi se si një përfundim tjetër në lidhje me këtë marrëdhënie do të kishte

⁷¹⁸ Dosja e Apelit, para. 220-223. Faktorët që mori parasysh Trupi Gjykses përfshijnë lidhjen e ngushtë të z. Mehmetaj me të akuzuarin para dhe pas intervistës së z. Mehmetaj me ZPS-në. Shih Aktgjykimin, para. 140-144.

⁷¹⁹ Dosja e Apelit, para. 224-226.

⁷²⁰ Aktgjykimi, para. 144. Paneli vë në dukje, në veçanti, se përfundimi i Trupit Gjykses në lidhje me "bashkërendimin e mundshëm" midis tyre dhe tendencën e z. Mehmetaj për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në bazohet në "lidhje të forta dhe të ngushta midis z. Mehmetaj dhe të akuzuarit", "kontaktet e ngushta të z. Mehmetaj me të akuzuarin para dhe pas intervistës së z. Mehmetaj me ZPS-në", dhe "mosbesimin ndaj proceseve gjyqësore para Dhomave të Specializuara, veçanërisht ndaj procesit kundër të akuzuarit, që z. Mehmetaj e shprehu fuqishëm në rrjetet sociale".

⁷²¹ Dosja e Apelit, para. 227.

⁷²² Ndër këta faktorë përfshihen mungesa e dëshirës së dëshmitarit për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me UÇK-në, aktiviteti i tij në mediat sociale në mbështetje të të akuzuarit, dhe mospërputhje të tjera në dëshminë e tij. Shih Aktgjykimin, para 146-148.

ndonjë ndikim në konstatimin e Trupit Gjykses se dëshmia e z. Ademi duhej shqyrtuar me kujdes.⁷²³ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

281. Sa i përket z. Ismaili, Paneli vë në dukje se, kur kundërshton vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit prej Trupit Gjykses, Mustafa i referohet vetëm një aspekti të vlerësimit, i cili nuk u bazua vetëm në kontaktet midis dëshmitarit dhe të akuzuarit.⁷²⁴ Paneli vë në dukje më tej se Mustafa gjithashtu nuk përmend se dëshmitari kishte “vështirësi sistematike” në mbajtjen mend të datave, që Trupi Gjykses i mori parasysh në konstatimin e vet në lidhje me mbështetshmërinë në dëshminë e tij në lidhje me pretendimin e alibisë nga i akuzuari.⁷²⁵ Bazuar në këtë, Paneli konstaton se Mustafa nuk demonstroi asnjë gabim të Trupit Gjykses në vlerësimin e z. Ismaili dhe hedh poshtë argumentet e tij.

282. Sa i përket z. Nreci, Paneli konstaton se Mustafa nuk e mbështet me prova pretendimin e tij se faktorët e marrë parasysh nga Trupi Gjykses nuk janë relevantë, dhe, rrjedhimisht, konstaton se ai thjesht nuk pajtohet me vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit prej Trupit Gjykses.⁷²⁶ Për më tepër, Mustafa shpërfill kundërthëniet e

⁷²³ Aktgjykimi, para. 148. Paneli i Apelit vë në dukje, në veçanti, se përfundimi i Trupit Gjykses se z. Ademi duket se ka pasur “tendencë të theksuar të jepte dëshmi të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në” bazohet në “mungesën e dëshirës [...] për t’iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me UÇK-në dhe BIA-n”, së bashku me “përkrahjen aktive që tregoi për z. Mehmetaj dhe të akuzuarin”, jo vetëm në faktin se e njihte z. Mehmetaj.

⁷²⁴ Paneli vëren se Mustafa shtrembëron Aktgjykimin kur pretendon se, për shkak se dëshmitari kishte “kontakt me telefon” me të akuzuarin, Trupi Gjykses nxori përfundimin se z. Ismaili prirë të jepte (vetëm) dëshmi të përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Në fakt, Trupi Gjykses erdhi në përfundim, pasi vuri në dukje “kontaktet jashtëzakonisht të shumta midis tyre në periudhën para dhe pas arrestimit të të akuzuarit”, “lidhje të forta” midis tyre, dhe “pakënaqësinë e shprehur për akuzat e ngritura kundër të akuzuarit”. Shih Aktgjykimin, para. 151. *Contra* Dosja e Apelit, para. 228.

⁷²⁵ Aktgjykimi, para. 152.

⁷²⁶ Dosja e Apelit, para. 243-246. Ndër faktorët që shqyrtoi Trupi Gjykses përfshihen ngurrimi i dëshmitarit për ta lidhur veten me BIA-n dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve lidhur me të, postimet e tij në media sociale në përkrahje të të akuzuarit, marrëdhënia vartës-epror me të akuzuarin, dhe njohuritë e tij për dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Shih Aktgjykimin, para. 168-170. Argumenti i Mustafës në lidhje me shtrembërimin e karakterit të BIA-s u hodh poshtë menjëherë. Shih më lart, para. 226.

dëshmitarit gjatë dëshmisë dhe faktin që dëshmitari pranoi se “nuk mund ta përcaktoj datën”,⁷²⁷ që cenoi mbështetshmërinë në dëshminë e tij lidhur me pretendimin e alibisë. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

283. Sa i përket z. Vrbovci, Paneli konstaton se Mustafa thjesht nuk pajtohet me përfundimin e Trupit Gjykues se ndryshimi i dëshmisë së tij, pas dëshmive të z. Nreci dhe dëshmitarëve të tjerë, tregon se dëshmitari nuk dha dëshmi në mënyrë të pavarur, por ishte marrë vesh me të tjerë.⁷²⁸ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

284. Sa i përket z. Parduzi, Paneli vë në dukje se Mustafa nuk shpjegon se pse faktorët që mori parasysh Trupi Gjykues gjatë vlerësimit të besueshmërisë nuk janë as relevantë, as të saktë,⁷²⁹ dhe se ai shpërfill “frymën përgjithësisht armiqësore dhe mungesën e dëshirës” së dëshmitarit për t’iu përgjigjur pyetjeve të ZPS-së.⁷³⁰ Për më tepër, sa i përket konstatimit të Trupit Gjykues se besueshmëria e dëshmitarit është cenuar rëndë,⁷³¹ Paneli vë në dukje se Mustafa nuk diskuton shumë faktorë që Trupi Gjykues në fakt i mori parasysh, si gjendja e tij shëndetësore, barnat që mori, dhe

⁷²⁷ Aktgjykimi, para. 294. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 171. *Krahaso* Transkriptin (Bislim Nreci), 5 prill 2022, f. 3218, D00006 (konfidenciale), f. 6 *me* Transkriptin (Bislim Nreci), 5 prill 2022, f. 3236-3237.

⁷²⁸ Dosja e Apelit, para. 247-248. Shih Aktgjykimin, para. 174-175. Konkretisht, Paneli e konstaton jobindës sugjerimin e Mustafës se, përmes konsultimit me disa ish-anëtarë të UÇK-së, përfshirë një dëshmitar tjetër të Mbrojtjes, z. Nreci, lidhur me datën e takimeve të pretenduara të tij me të akuzuarin, z. Vrbovci thjesht u përpoq të “freskonte kujtesën”.

⁷²⁹ Paneli vë në dukje se Mustafa thjesht rendit faktorët që shqyrtoi Paneli, pa shtjelluar asnjë argument. Shih Dosjen e Apelit, para. 250-252. Faktorët të cilët, sipas Trupit Gjykues, cenojnë në masë të madhe besueshmërinë e z. Parduzi përfshijnë “është tejet i anshëm kundër Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së”, “deklarata e tij në mbështetje të të akuzuarit”, “mungesën e dëshirës për t’iu përgjigjur pyetjeve të ZPS-së” dhe “dijenja e përgjithshme e z. Parduzi për përmbajtjen e dëshmive të tjera, sepse ai i ndiqte seancat dhe i diskutonte ato dëshmi me bashkëshorten”. Shih Aktgjykimin, para. 181. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 178-180.

⁷³⁰ Aktgjykimi, para. 179. Shih gjithashtu Transkriptin (Kapllan Parduzi), 11 prill 2022, f. 3506, ku z. Parduzi deklaroi: “nuk ka bazë edhe nuk ka fakte. Ne mendojmë që janë të gjitha sajesa edhe me gënjeshtër të dëshmitarëve të rrejtshëm dhe të Prokurorisë së Serbisë, që fatkeqësisht ju edhe e keni dekorue. I keni dhënë edhe dekorata atyne bashkëpunëtorëve të tyne. Ata që na kanë vra, na kanë djegë edhe na kanë pjekë. Ju me ta keni bashkëpunue edhe ata i keni dekorue.”.

⁷³¹ Aktgjykimi, para. 182.

motin e keq gjatë periudhës përkatëse.⁷³² I vetmi faktor që kundërshton Mustafa është kujtimi i mjegullt i ngjarjes nga ana e z. Parduzi.⁷³³ Sidoqoftë Paneli gjykon se, duke qenë se Mbrojtja e thirri z. Parduzi të dëshmonte për *alibinë* e mundshme, Mustafa nuk mund të argumentojë në mënyrë të arsyeshme se koha dhe vendi ku dëshmitari pretendon se e pa të akuzuarin nuk janë relevante për mbështetshmërinë në dëshminë e tij.⁷³⁴ Gjithashtu, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa thjesht nuk pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se dëshmia e z. Parduzi për takimin me të akuzuarin në fund të prillit ose fillim të majit 1999 nuk është relevante.⁷³⁵ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës.

285. Sa i përket z. Ibishi, Paneli vëren se Mustafa thjesht përsërit të njëjtat argumente të përgjithshme që paraqiti në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykses të dëshmisë së z. Parduzi, pa mbështetur me prova asnjërin prej tyre,⁷³⁶ dhe konstaton se ai nuk identifikon asnjë gabim në vlerësimin e dëshmisë së z. Ibishi nga Trupi Gjykses.⁷³⁷ Rrjedhimisht, Paneli i hedh poshtë këto argumente.⁷³⁸

286. Sa i përket z. Rrahimi, Paneli vë në dukje konstatimin e Trupit Gjykses se dëshmia e tij është “kaq e paqartë saqë në thelb është e pamundur të nxirret ndonjë informacion me vlerë prej saj”.⁷³⁹ Për më tepër, Paneli konstaton se Mustafa nuk

⁷³² Mustafa vetëm rendit faktorët që shqyrtoi Paneli pa shtjelluar asnjë argument. Shih Dosjen e Apelit, para. 253.

⁷³³ Dosja e Apelit, para. 253-256.

⁷³⁴ Shih Aktgjykimin, para. 182. *Contra* Dosja e Apelit, para. 253.

⁷³⁵ Shih Dosjen e Apelit, para. 257; Aktgjykimi, para. 183.

⁷³⁶ *Krahaso* Dosjen e Apelit, para. 260 *me* Dosjen e Apelit, para. 252. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 258-259, 261-262. Paneli gjithashtu vëren se Mustafa argumenton se Trupi Gjykses “përdor ose lë mënjanë në mënyrë rastësore elemente që mbështesin alibinë e z. Mustafa”, por nuk përmend se cilin konstatim të Trupit Gjykses kundërshton faktikisht.

⁷³⁷ Aktgjykimi, para. 185-189.

⁷³⁸ Shih më lart, para. 284. Shih gjithashtu më lart, para. 29-30.

⁷³⁹ Aktgjykimi, para. 193. Paneli i Apelit vë në dukje se ZPS-ja dhe Trupi Gjykses i bënë pyetje z. Rrahimi për rrethanat në të cilat ai (i) dëgjoi një person duke e thirrur dikë tjetër “Cali”; dhe (ii) pati kontakt me të akuzuarin, dhe për arsyen pse gjatë marrjes kryesore në pyetje tha se nuk kishte pasur asnjë kontakt me të. Në të dy rastet, Paneli vëren se z. Rrahimi u përgjigj në mënyrë dredhuese dhe ngatërruese, duke mohuar atë që kishte deklaruar më parë në sallën e gjyqit. Shih Transkriptin (Sheqir Rrahimi), 13 prill 2022, f. 3686-3707.

identifikon asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykues se “periudha gjatë së cilës pretendohet se z. Rrahimi e pa të akuzuarin dhe kushtet në atë kolonë mjekësore ishin të tilla që e bëjnë mbështetjen në dëshminë e dhënë nga dëshmitari krejt të pamundshme”.⁷⁴⁰ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me këtë.

287. Sa i përket z. Borovci, Paneli konstaton se Mustafa thjesht nuk pajtohet me konstatimin në lidhje me marrëdhënien epror-vartës midis dëshmitarit dhe z. Mehmetaj dhe postimet në media sociale, por nuk kundërshton faktorë të tjerë që Trupi Gjykues i shqyrtoi dhe konstatoi se kishin më shumë ndikim në besueshmërinë e dëshmitarit.⁷⁴¹ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës.⁷⁴²

288. Sa i përket z. Gani Sopi, Paneli konstaton se Mustafa nuk evidenton asnjë gabim në vlerësimin e besueshmërisë nga Trupi Gjykues.⁷⁴³

289. Paneli i Apelit do të trajtojë tani argumentin e Mustafës se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se z. Borovci dhe z. Gani Sopi mund të jenë marrë vesh për dëshmitë e tyre lidhur me datën e largimit të tyre nga Prishtina për në Butovc, që është relevante

⁷⁴⁰ Aktgjykimi, para. 193. *Contra* Dosja e Apelit, para. 270. Paneli vë në dukje se Mustafa, megjithëse përmend konstatimet e Trupit Gjykues, nuk demonstroi asnjë gabim në konstatimin e tij se dëshmia e drejtpërdrejtë është “me rëndësi mjaft të kufizuar sa i takon mbrojtjes së të akuzuarit përmes alibisë”. Shih Aktgjykimin, para. 192. *Contra* Dosja e Apelit, para. 265.

⁷⁴¹ Dosja e Apelit, para. 232-234. Faktorët e tjerë që shqyrtoi Trupi Gjykues përfshijnë mungesën e dëshirës nga ana e tij që të fliste për BIA-n dhe lidhjet e veta me të, si dhe për shoqërinë e tij me të akuzuarin dhe dëshmitarët e tjerë të Mbrojtjes. Shih Aktgjykimin, para. 154-158.

⁷⁴² Shih gjithashtu më poshtë, para. 289-291.

⁷⁴³ Dosja e Apelit, para. 235-236. Mustafa argumenton se Trupi Gjykues “u përqendrua në aspektet që lidheshin me dëshmitarë jo-okularë, si një faktor që cenonte besueshmërinë”, por nuk e mbështet me fakte këtë pretendim. Në fakt, në nënpikën 2M Mustafa thjesht përsërit të njëjtat argumente që shtjellon në nënpikën 2J – argumente të cilat trajtohen më poshtë. Dosja e Apelit, para. 236-237. Shih më poshtë, para. 289-291. Shih gjithashtu më poshtë, para. 318-320, ku trajtohen argumentet e Mustafës në paragrafët 238 deri 240 të Dosjes së Apelit. Paneli i Apelit vë në dukje se, midis faktorëve që shqyrtoi Trupi Gjykues përfshihen: (i) mungesa e fortë e dëshirës së dëshmitarit për të pranuar lidhjen me BIA-n ose për t’iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve për të; (ii) lidhja e tij e fortë me Mustafën, përfshirë si afërm i tij dhe si epror në BIA; (iii) respekti i tij ndaj të akuzuarit; (iv) ndjenja e fuqishme e shoqërisë për anëtarë të tjerë të BIA-s, përfshirë z. Borovci; (v) harresat dhe vështirësia për të mbajtur mend data; dhe (vi) përputhja midis dëshmive të z. Borovci dhe z. Gani Sopi. Shih Aktgjykimin, para. 160-166.

për pretendimin e Mustafës për alibi.⁷⁴⁴ Paneli vë në dukje se për këtë konstatim, Trupi Gjykses shqyrtoi disa faktorë, përfshirë: (i) z. Borovci dhe z. Gani Sopi ndryshuan datën, në mënyrë tejet të ngjashme, nga 28 mars 1999 (që kishin deklaruar në deklaratat e mëparshme dhënë Mbrojtjes) më 31 mars 1999 (që deklaruan gjatë gjykimit); (ii) ata kanë shoqëri të fortë dhe të gjatë; (iii) z. Borovci kërkoi këshilla nga persona të tretë për dëshminë e tij; dhe (iv) të dy kanë lidhje të forta personale me të akuzuarin.⁷⁴⁵ Bazuar në këtë, Paneli konstaton se nuk ka asnjë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses.

290. Për më tepër, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës,⁷⁴⁶ Paneli gjykon se Trupi Gjykses nuk e keqkuptoi periudhën kohore të festës fetare të Bajramit të Vogël në vitin 1999. Paneli vë në dukje se Trupi Gjykses i verifikoi si duhet datat duke iu referuar tabelës që paraqiti ZPS-ja – material i marrë nga burime të hapura në internet ku jepen datat e Bajramit të Vogël për secilin vit – dhe konstatoi se Bajrami i Vogël kishte qenë më 28 mars 1999.⁷⁴⁷ Paneli gjithashtu vë në dukje se vetë Mbrojtja pranon se “dihet gjerësisht se Bajrami i Vogël në Kosovë festohet katër ditë”,⁷⁴⁸ që, bazuar në konstatimin e Trupit Gjykses lidhur me datën e 28 marsit 1999, do të thotë se festimet ndodhën nga 28 deri më 31 mars 1999. Paneli gjithashtu vë në dukje se z. Borovci dhe z. Gani Sopi dëshmuar se e takuan të akuzuarin gjatë festimit të Bajramit të Vogël.⁷⁴⁹

⁷⁴⁴ Shih Dosjen e Apelit, para. 190-203; Aktgjykimi, para. 157-158, 164-165, 281, 286.

⁷⁴⁵ Aktgjykimi, para. 155-158, 163-165, 279, 281, 286.

⁷⁴⁶ Shih Dosjen e Apelit, para. 193-199, 237.

⁷⁴⁷ Aktgjykimi, para. 280, 285, që i referohet P00255 (konfidenciale).

⁷⁴⁸ Dosja e Apelit, para. 195.

⁷⁴⁹ Panel i Apelit vë në dukje se Trupi Gjykses vërejti se të dy dëshmitarët “morën si pikë referimi festën e Bajramit të Vogël për të përcaktuar kohën e takimit të pretenduar me të akuzuarin në Butovc”. Shih Aktgjykimin, para. 279-280, 285. Paneli i Apelit vëren se është e vërtetë që në gjykim: (i) z. Borovci dëshmoi se u largua nga Prishtina për në Butovc më 31 mars 1999, që ai shpjegoi se ishte *dita e festimit të Bajramit të Vogël* dhe se, disa ditë më vonë, më 2 ose 3 prill 1999, e takoi të akuzuarin, i cili po festonte Bajramin; dhe (ii) z. Gani Sopi deklaroi se shkoi në Butovc në fund të marsit 1999 dhe takoi të akuzuarin në fillim të prillit *pasi ishte ende Bajram*, duke shtuar se nuk mbante mend nëse kjo ndodhi ditën e tretë, të katërt apo të pestë të Bajramit. Shih Transkriptin (Hazir Borovci), 30 mars 2022, f. 2958, 2963-2964, 3026-3027; Transkriptin (Gani Sopi), 4 prill 2022, f. 3079, 3084, 3089-3090, 3098-3099, 3165-3166. Në Dosjen e Apelit, Mustafa argumenton se z. Borovci dhe z. Gani Sopi “komunikuan me apellesin në fillim të festimit të Bajramit”. Shih Dosjen e Apelit, para. 197 (theksimet janë shtuar).

Mbi këtë bazë, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi që konstatoi se ky takim - nëse ka ndodhur - mund të ketë ndodhur në fund të marsit 1999,⁷⁵⁰ dhe jo më 2 ose 3 prill 1999 siç pretendon Mbrojtja.⁷⁵¹

291. Gjithsesi, Mustafa nuk arrin të demonstrojë se, në mungesë të konstatimit për marrëveshje midis z. Borovci dhe z. Gani Sopi, përfundimi i Trupit Gjykses në lidhje me praninë e të akuzuarit në Butovc do të ishte i ndryshëm.⁷⁵² Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Mustafa nuk ka vërtetuar se Trupi Gjykses bëri gabim faktik, që rezultoi në gabim gjyqësor. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit hedh poshtë argumentet e mbetura të Mustafës në nënpikën 2J të Apelit.

292. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit hedh poshtë pjesërisht argumentet e Mustafës në nënpikën 2J dhe pjesërisht në nënpikën 2M, se Trupi Gjykses gaboi që hodhi poshtë dëshmitë e dëshmitarëve në lidhje me pretendimin e të akuzuarit për alibi.

⁷⁵⁰ Aktgjykimi, para. 280. Paneli i Apelit vë në dukje se Trupi Gjykses nuk bëri konstatim konkret në lidhje me kohëzgjatjen e festimit të Eid al-Adha (Bajrami i Vogël), por nga gjuha e përdorur në paragrafin 280 të Aktgjykimit kuptohet se konsideroi që festa përfundoi më 31 mars 1999. Shih Aktgjykimin, para. 280, ku Trupi Gjykses deklaroi se “është i bindur se ky takim, nëse ka pasur një të tillë, mund të ketë ndodhur nga fundi i marsit 1999”.

⁷⁵¹ Dosja e Apelit, para. 190-191, 197. Paneli gjithashtu konstaton se Mustafa bie në kundërshtim me argumentin e vet në lidhje me kohëzgjatjen e Bajramit të Vogël kur parashtron se “rrjedhimisht, nuk ka rëndësi nëse Bajrami filloi më 28 apo 31 mars 1999”. Shih Dosjen e Apelit, para. 195.

⁷⁵² Trupi Gjykses vuri në dukje midis të tjerash se: (i) besueshmëria e dëshmitarëve që dëshmuan në lidhje me praninë e të akuzuarit në Butovc gjatë kohës së akuzave, konkretisht z. Borovci, z. Gani Sopi, z. Mehmetaj dhe z. Ismaili, cenohet nga shumë faktorë; dhe (ii) z. Borovci, z. Gani Sopi, z. Mehmetaj dhe z. Ismaili dhanë dëshmi të përgjithësuara që mbulonin periudha të gjata kohore, që përputhet me aftësinë e të akuzuarit për ta përshkuar distancën e shkurtër midis Butovcit dhe Zllashit brenda ditës, madje edhe disa herë nëse ishte e nevojshme. Shih Aktgjykimin, para. 140-144 (z. Mehmetaj), 150-152 (z. Ismaili), 154-156, 158 (z. Borovci), 160-163, 165-166 (z. Gani Sopi), 274-277, 282-284, 287-289. Shih gjithashtu më lart, para. 287-288. Paneli vë në dukje se ka hedhur poshtë argumentin e Mustafës se Trupi Gjykses “nuk vërtetoi faktikisht” lëvizjen e tij midis Butovcit dhe Zllashit, por përdori vetëm një konstatim të “mundësisë teorike”. Shih më poshtë, para. 318.

- d. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykses të dëshmitarit të Mbrojtjes që dha dëshmi në lidhje me akuzën e ndalimit arbitrar (nënpika 2M pjesërisht)

293. Së fundi, Paneli i kthehet argumentit të Mustafës në lidhje me z. Halimi, i cili ishte komandant i qendrës së stërvitjes për rekrutë në shkollën e Zllashit, dhe të cilin Mbrojtja e thirri që, midis të tjerash, të kundërshtonte pretendimin se W01679 u kap kur ishte në shkollë duke u stërvitur me UÇK-në dhe pastaj u dërgua në kompleksin e ndalimit në Zllash.⁷⁵³

294. Paneli konstaton se, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës,⁷⁵⁴ Trupi Gjykses nuk shtrembëroi dëshminë e dëshmitarit kur konstatoi se z. Halimi: (i) “ra pjesërisht në kundërshtim me veten gjatë pyetjeve të ZPS-së” kur në fillim tha se askush nuk mund të largohej para se ta përfundonte stërvitjen dhe pastaj deklaroi se rekrutët dërgoheshin në shtëpi për shkak të sëmundjes;⁷⁵⁵ dhe se ai (ii) “nuk ka bazën e duhur të njohurive” që të dëshmojë saktë për pjesëmarrjen e rekrutëve gjatë stërvitjeve të ndryshme.⁷⁵⁶ Rrjedhimisht, Paneli konstaton se nuk është bindës argumenti i Mustafës se z. Halimi do ta kishte ditur në rast se W01679 do të ishte marrë në shkollë.⁷⁵⁷ Gjithashtu, Paneli nuk identifikon asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se “mungesa e dukshme e dëshirës” nga ana e dëshmitarit për të pranuar se Mustafa e kishte numrin e tij të telefonit dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve për BIA-n dhe të akuzuarin, së bashku me qëndrimin e tij vetëjustifikues dhe antagonist gjatë pyetjeve të ZPS-së, treguan se kishte tendencë të jepte dëshmi

⁷⁵³ Shih, konkretisht, Aktgjykimin, para. 380-386.

⁷⁵⁴ Dosja e Apelit, para. 271-275.

⁷⁵⁵ Shih Aktgjykimin, para. 196. *Krahaso* Transkriptin (Musli Halimi), 20 prill 2022, f. 3758, 3761 *me* Transkriptin (Musli Halimi), 20 prill 2022, f. 3784, 3788.

⁷⁵⁶ Shih Aktgjykimin, para. 197. Z. Halimi deklaroi në gjykatë se ishte e pamundshme për të që të mbante mend emrat e të gjithëve, se i kujtohej vetëm “një përqindje e vogël” e atyre që vinin për stërvitje dhe se ishte i sigurt “100 për qind” se i raportohej gjithçka. Shih Transkriptin (Musli Halimi), 20 prill 2022, f. 3778, 3811. Shih gjithashtu Transkriptin (Musli Halimi), 20 prill 2022, f. 3756 (seancë private).

⁷⁵⁷ Shih Dosjen e Apelit, para. 275.

përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin.⁷⁵⁸ Për më tepër, Paneli nuk e konsideron bindës argumentin e Mustafës se fakti që numri i telefonit të z. Halimi ishte ruajtur në telefonin e të akuzuarit nuk është relevant për besueshmërinë e dëshmitarit.⁷⁵⁹ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në nënpikën 2M në lidhje me vlerësimin nga ana e Trupit Gjykses të dëshmisë së z. Halimi.

295. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit hedh poshtë argumentet e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që hodhi poshtë dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes apo të ZPS-së, që dhanë dëshmi në favor të Mbrojtjes.

296. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit hedh poshtë pjesën e mbetur të nënpikave 2A, 2E, 2G, 2H, 2I, 2J, dhe 2N të Mustafës dhe hedh poshtë nënpikën 2M të Apelit të Mustafës pjesërisht.⁷⁶⁰

M. PRETENDIMET PËR GABIME NË VLERËSIMIN E TRUPIT GJYKUES TË DËSHMISË SË
[REDAKTUAR] NË LIDHJE ME PRANINË E MUSTAFËS NË KOMPLEKSIN E NDALIMIT NË
ZLLASH (NËNPIKA 2P)

297. Trupi Gjykses u bazua në dëshminë e [REDAKTUAR] për nxjerrjen e konstatimeve të veta në lidhje me ndalimin e viktimës së vrasjes së paligjshme në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe praninë e Mustafës në kompleks në kohën kur [REDAKTUAR].⁷⁶¹ Mustafa kundërshton vlerësimin dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në dëshminë e [REDAKTUAR] në lidhje me [REDAKTUAR],⁷⁶² ndërsa ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës janë të gabuara nga ana faktike dhe, gjithsesi, Mustafa nuk arrin të provojë asnjë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje

⁷⁵⁸ Shih Aktgjykimin, para. 198-200.

⁷⁵⁹ Shih Dosjen e Apelit, para. 276. Shih gjithashtu Transkriptin (Musli Halimi), 20 prill 2022, f. 3818-3820.

⁷⁶⁰ Pjesa e mbetur e nënpikës 2M është trajtuar në pjesën në lidhje me pretendimin e Mustafës për alibi. Shih më poshtë, Pjesën N, para. 310-324.

⁷⁶¹ Aktgjykimi, para. 468-475.

⁷⁶² Dosja e Apelit, para. 316-322; Njoftimi për Apel, nënpika 2P, para. 5; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 87.

me praninë e Mustafës në kompleksin e ndalimit në Zllash më [REDAKTUAR] prill 1999.⁷⁶³

1. Parashtrimet e palëve

298. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi në konstatimet faktike në lidhje me [REDAKTUAR]⁷⁶⁴ dhe që konstatoi se dëshmia e [REDAKTUAR] ishte e besueshme për vërtetimin e pranisë së Mustafës në kompleksin e ndalimit më [REDAKTUAR] prill 1999.⁷⁶⁵ Konkretisht, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se [REDAKTUAR], duke pretenduar se [REDAKTUAR] deklaroi “vazhdimisht” gjatë dëshmisë se [REDAKTUAR].⁷⁶⁶ Bazuar në këtë, Mustafa pretendon se [REDAKTUAR].⁷⁶⁷ Mustafa gjithashtu argumenton se interpretimi i gabuar nga ana e Trupit Gjykses i dëshmisë së [REDAKTUAR] në lidhje me këtë përbënte “pikën fillestare” për vërtetimin e pranisë së Mustafës në kompleksin e ndalimit në kohën përkatëse, që përbën “gabim gjyqësor”.⁷⁶⁸

299. Mustafa gjithashtu parashtron se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh mospërputhjet në dëshminë e [REDAKTUAR], gjatë vlerësimit të besueshmërisë së [REDAKTUAR] dhe mbështetshmërisë në dëshminë [REDAKTUAR].⁷⁶⁹ Konkretisht, Mustafa argumenton se [REDAKTUAR] kishte mospërputhje kur dëshmoi se [REDAKTUAR] diku në prill 1999, por se, kur e ballafaqoi [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] u përgjigj se nuk e dinte [REDAKTUAR].⁷⁷⁰ Mustafa pretendon se kjo

⁷⁶³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 127-129.

⁷⁶⁴ Dosja e Apelit, para. 316-317.

⁷⁶⁵ Dosja e Apelit, para. 320-322.

⁷⁶⁶ Dosja e Apelit, para. 316-317, 320.

⁷⁶⁷ Dosja e Apelit, para. 318.

⁷⁶⁸ Dosja e Apelit, para. 320.

⁷⁶⁹ Dosja e Apelit, para. 321-322.

⁷⁷⁰ Dosja e Apelit, para. 321. Paneli vëren se në seancën e apelit, Mustafa gjithashtu argumentoi për herë të parë gjatë procesit të apelit se dëshmia e [REDAKTUAR] nuk përputhet [REDAKTUAR]. Paneli i Apelit nuk do ta trajtojë këtë argument të ri. Shih Transkriptin, 27 tetor 2023, f. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].

mospërputhje e bën dëshminë [REDAKTUAR] jo të besueshme dhe se Trupi Gjykes gaboi që nuk e mori këtë parasysh në vlerësimin e vet.⁷⁷¹

300. ZPS-ja përgjigjet se prania e Mustafës në kompleksin e ndalimit në Zllash më [REDAKTUAR] prill 1999 [REDAKTUAR] është e pakundërshtueshme.⁷⁷² ZPS-ja gjithashtu parashtron se Mustafa paraqiti të njëjtat argumente gjatë gjykimit, duke pretenduar se [REDAKTUAR] dhe, rrjedhimisht, [REDAKTUAR], të cilat Trupi Gjykes i hodhi poshtë dhe, mbi këtë bazë, duhet të hidhen poshtë.⁷⁷³ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se pretendimet e Mustafës janë faktikisht të pasakta, sepse [REDAKTUAR] deklaroi qartë gjatë dëshmisë [REDAKTUAR] se [REDAKTUAR] pas kësaj [REDAKTUAR].⁷⁷⁴ Gjithsesi, ZPS-ja parashtron se pretendimet e Mustafës nuk mohojnë as praninë e tij në kompleksin e ndalimit në Zllash në momentin kyç, as [REDAKTUAR].⁷⁷⁵

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

301. Paneli i Apelit rikujton se Trupi Gjykes u mbështet, midis të tjerash, në dëshminë e [REDAKTUAR], kur konstatoi se viktimi e vrasjes së paligjshme ishte mbajtur i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës përkatëse, duke vënë në dukje se dëshmia e [REDAKTUAR] konfirmoi dëshmitë dhe provat dokumentare të tjera në lidhje me praninë e viktimës së vrasjes së paligjshme në kompleks në prill 1999.⁷⁷⁶ Trupi Gjykes gjithashtu u bazua në dëshminë e [REDAKTUAR] në mbështetje të konstatimit të vet se Mustafa ishte i pranishëm në

⁷⁷¹ Dosja e Apelit, para. 321-322. Paneli vë në dukje se, në mbështetje të pretendimit të tij se “asnjë gjykatë e arsyeshme nuk do t’i jepte besueshmëri të njëmendtë dëshmisë [REDAKTUAR]”, Mustafa përmend transkriptin e përgjigjeve të [REDAKTUAR] ndaj pyetjeve të Trupit Gjykes, ku sqaroi dëshminë e [REDAKTUAR] mëhershme për një aspekt tjetër. Sidoqoftë, Paneli vë në dukje se Mustafa nuk bën asnjë parashtrim në lidhje me atë pjesë konkrete të dëshmisë së tij. Shih Dosjen e Apelit, poshtëshënimin 119, që i referohet [REDAKTUAR].

⁷⁷² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 127.

⁷⁷³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 127.

⁷⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 128-129.

⁷⁷⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. [REDAKTUAR].

⁷⁷⁶ Aktgjykimi, para. 475.

kompleksin e ndalimit në Zllash kur [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] prill 1999, ose rreth [REDAKTUAR].⁷⁷⁷ Në arritjen e këtij përfundimi, Trupi Gjykses mori parasysh kundërshtimin e Mustafës gjatë gjykimit se [REDAKTUAR].⁷⁷⁸ Megjithatë, Trupi Gjykses konstatoi se [REDAKTUAR] dhe, duke pasur parasysh provat fotografike të kompleksit të ndalimit në Zllash, konstatoi se [REDAKTUAR].⁷⁷⁹

302. Mustafa kundërshton vlerësimin prej Trupit Gjykses të dëshmisë së [REDAKTUAR], duke argumentuar se: (i) konstatimi i Trupit Gjykses në lidhje me [REDAKTUAR] nuk përputhet me dëshminë [REDAKTUAR]; dhe (ii) Trupi Gjykses nuk mori parasysh mospërputhjet në dëshminë e [REDAKTUAR] gjatë vlerësimit të besueshmërisë së [REDAKTUAR] dhe mbështetshmërisë në dëshminë [REDAKTUAR].⁷⁸⁰

303. Paneli vë në dukje se parashtrimet e Mustafës në lidhje me [REDAKTUAR] thjesht përsërisin argumentet e trajtuara nga Trupi Gjykses, pa demonstruar se hedhja poshtë e tyre nga Trupi Gjykses përbën gabim që kërkon ndërhyrjen e Panelit të Apelit.⁷⁸¹ Mangësi të tilla përlligjin rrëzim të menjëhershëm.⁷⁸² Gjithsesi, Paneli nuk konstaton asnjë gabim në përfundimin e Trupit Gjykses se [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], që sipas mendimit të Panelit të Apelit pasqyron saktë dëshminë e [REDAKTUAR] se [REDAKTUAR], pastaj [REDAKTUAR] përcolli dhe [REDAKTUAR].⁷⁸³

304. Sa u takon argumenteve të Mustafës në lidhje me vlerësimin prej Trupit Gjykses të besueshmërisë së [REDAKTUAR] dhe mbështetshmërisë në dëshminë

⁷⁷⁷ Aktgjykimi, para. 472-473.

⁷⁷⁸ Aktgjykimi, para. 469-473, konkretisht para. 472.

⁷⁷⁹ Aktgjykimi, para. 469-473, konkretisht para. 472.

⁷⁸⁰ Dosja e Apelit, para. 316, 320, 322.

⁷⁸¹ *Krahaso* Dosjen e Apelit, para. 316-317 me Aktgjykimin, para. 469-473. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 318-319, ku Mustafa pranon se të njëjtat argumente, konkretisht se [REDAKTUAR], mbrojtësi i kishte ngritur gjatë deklaratave përmbyllëse.

⁷⁸² Shih më lart, para. 30.

⁷⁸³ [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR], Paneli i Apelit rikujton se një trup gjykues është në pozitën më të mirë për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit dhe ka kompetenca të gjera diskrecionale për të vlerësuar mbështetshmërinë në dëshminë e dëshmitarit.⁷⁸⁴

305. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit së pari rikujton se Trupi Gjykues evidentoi një listë joshteruese të faktorëve që kishte marrë parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë së të gjithë dëshmitarëve dhe mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre.⁷⁸⁵ Paneli thekson se Trupi Gjykues i mori parasysh këta faktorë kur vlerësoi besueshmërinë e [REDAKTUAR] dhe mbështetshmërinë në dëshminë [REDAKTUAR], duke vënë në dukje mospërputhjet midis dëshmisë së [REDAKTUAR] dhe të dëshmitarëve të tjerë, dhe arsyet për pranimin apo hedhjen poshtë të dëshmisë, plotësisht apo pjesërisht, për shkak të mospërputhjeve.⁷⁸⁶ Konkretisht, Trupi Gjykues konstatoi se nganjëherë dëshmia e [REDAKTUAR] ishte e pagjasë sa i përket [REDAKTUAR], si edhe se [REDAKTUAR] i minimizoi rrethanat e [REDAKTUAR].⁷⁸⁷ Duke pasur parasysh këto shqetësime, Trupi Gjykues u mbështet në këto aspekte të dëshmisë së [REDAKTUAR] vetëm kur konfirmoheshin nga dëshmi të tjera.⁷⁸⁸

306. Sa i përket dëshmisë së [REDAKTUAR] se [REDAKTUAR], Paneli i Apelit vë në dukje se gjatë vlerësimit, Trupi Gjykues mori parasysh përputhjet midis [REDAKTUAR] Mustafës të shtëpisë ku kishte qëndruar në kompleksin e ndalimit në Zllash, dhe konstatoi se dëshmia e [REDAKTUAR] ishte e besueshme dhe e bazuar në njohuri personale.⁷⁸⁹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk konstaton asnjë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykues në këtë aspekt.

⁷⁸⁴ Shih më lart, para. 38.

⁷⁸⁵ Aktgjykimi, para. 35. Shih gjithashtu më lart, para. 219, poshtëshënimi 562.

⁷⁸⁶ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

⁷⁸⁷ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

⁷⁸⁸ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

⁷⁸⁹ Aktgjykimi, para. 472.

307. Paneli i Apelit do të shqyrtojë tani argumentin e Mustafës se në dëshminë e [REDAKTUAR] kishte mospërputhje sa i takon [REDAKTUAR], duke e bërë dëshminë jo të besueshme, dhe se Trupi Gjykses gaboi që nuk i mori parasysh këto mospërputhje në vlerësimin e vet.⁷⁹⁰ Fillimisht, megjithëse Mustafa nuk e shpreh drejtpërdrejt dhe qartë, argumentin e tij, sipas Panelit ai do të thotë që, për shkak të një mospërputhjeje në dëshminë e [REDAKTUAR], e tërë dëshmia [REDAKTUAR] duhet të hidhet poshtë si jo e besueshme. Paneli rikujton në këtë aspekt se, në pajtim me rregullën 139(6) të Rregullores, mospërputhjet në dëshminë e një dëshmitari, si të tilla, nuk e detyrojnë panelin të hedhë poshtë të gjithë dëshminë e atij dëshmitari, dhe paneli mund të mbështetet në disa aspekte të dëshmisë së dëshmitarit, por jo në aspekte të tjera.⁷⁹¹

308. Gjithsesi, Paneli i Apelit konstaton se përshkrimi nga ana e Mustafës i deklaratave të [REDAKTUAR] nuk është bindës. Sipas mendimit të Panelit, [REDAKTUAR] dha dëshmi përputhëse se nuk kishte njohuri për rrethanat e [REDAKTUAR] dhe nuk e dinte çfarë i kishte ndodhur [REDAKTUAR] pasi [REDAKTUAR].⁷⁹² Edhe pse [REDAKTUAR] dëshmoi se [REDAKTUAR] në fund të prillit 1999, Paneli vë në dukje se Mustafa i referohet një bisede midis [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që ndodhi disa vite pas luftës,⁷⁹³ ku [REDAKTUAR] u përpoq të mësonte “se çka ka ndodh dhe si ka ndodh” me [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] informoi se nuk i dinte *rrethanat* e [REDAKTUAR].⁷⁹⁴ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se nuk ka mospërputhje në dëshminë e [REDAKTUAR] dhe rrjedhimisht nuk ka gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses për besueshmërinë e [REDAKTUAR].

⁷⁹⁰ Shih Dosjen e Apelit, para. 321-322.

⁷⁹¹ Shih më lart, para. 272.

⁷⁹² Shih [REDAKTUAR].

⁷⁹³ Dosja e Apelit, para. 321, që i referohet [REDAKTUAR].

⁷⁹⁴ [REDAKTUAR]. Shih gjithashtu [REDAKTUAR].

309. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka demonstruar asnjë gabim në vlerësimin e dëshmisë së [REDAKTUAR] prej Trupit Gjykues, dhe rrjedhimisht hedh poshtë nënpikën 2P të Apelit të Mustafës.

N. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME SHQYRTIMIN NGA TRUPI GJYKUES TË PRETENDIMIT TË MUSTAFËS PËR ALIBI (NËNPIKAT 1L, 1M, 2M PJESËRISHT, 2O)

310. Trupi Gjykues hodhi poshtë pretendimin e Mustafës për alibi, duke konstatuar se ai “nuk mund të krijojë dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në vendin e krimit në kohët përkatëse sipas Aktakuzës së Konfirmuar”.⁷⁹⁵ Mustafa kundërshton këtë konstatim për arsye juridike dhe faktike,⁷⁹⁶ ndërsa ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk ka vërtetuar asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykues.⁷⁹⁷

1. Parashtrimet e palëve

311. Mustafa parashtron se Trupi Gjykues bëri gabim juridik kur i hodhi poshtë “padrejtësisht” dëshmitë për alibi si jorelevante, kur duhej t’i kishte konsideruar se janë relevante për të treguar se “nuk kishte të ngjarë që ai të kishte qenë në vendin ku pretendohet se kishin ndodhur veprat penale në kohën e kryerjes, edhe nëse mbetej si mundësi”.⁷⁹⁸ Ai argumenton se, edhe pse Trupi Gjykues u shpreh se ZPS-ja “duhej ta kishte eliminuar” alibinë jashtë dyshimit të arsyeshëm, dëshmitë e dëshmitarëve “provojnë të kundërtën”.⁷⁹⁹ Mustafa gjithashtu argumenton se, duke hedhur poshtë

⁷⁹⁵ Aktgjykimi, para. 333. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 46, 240-332.

⁷⁹⁶ Njoftimi për Apel, nënpikat 1L-1M, 2O, para. 4-5; Dosja e Apelit, para. 70-77, 238-240, 304-315; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 81-82. Paneli vë në dukje se në nënpikën 1M të Dosjes së Apelit, Mustafa thjesht përmend nënpikën 1L dhe nuk bën asnjë parashtrim të mëtejshëm. Paneli gjykon se nënpika 1M tani përfshihet në nënpikën 1L.

⁷⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 98-105.

⁷⁹⁸ Dosja e Apelit, para. 74, 76-77. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpika 1L, para. 4; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 81.

⁷⁹⁹ Dosja e Apelit, para. 70.

dëshmitë për alibi të dhëna nga dëshmitarët, Trupi Gjykses “përmbysi detyrimin” dhe “e detyro[i] [atë] që të provojë alibinë jashtë dyshimit të arsyeshëm”.⁸⁰⁰

312. Gjithashtu, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim faktik që gjykoi se, në rrethanat që mbizotëronin në prill 1999, ishte “realisht” e mundshme që ai të ketë qenë në shumë vende më të njëjtën ditë.⁸⁰¹ Në mbështetje të këtij kundërshtimi, ai argumenton se faktorët e lidhur me lëvizjen, që Trupi Gjykses i shqyrtoi gjatë vlerësimit të alibisë, shpërfillën provat në lidhje me “vështirësitë e skajshme të lëvizjes” midis vendeve të ndryshme dhe, në vend të kësaj, bëri “supozim dëmtues” ose u bazua në “mundësinë teorike” se i akuzuari ishte në gjendje të udhëtonte midis vendeve.⁸⁰² Mustafa gjithashtu argumenton se “kohëzgjatja e udhëtimit e zgjedhur nga Trupi Gjykses] [...] nuk mund të përgjithësohet për periudhën e Aktakuzës” dhe se Trupi Gjykses nuk përcaktoi se kur faktikisht Mustafa përdori mjete të ndryshme transporti.⁸⁰³

313. ZPS-ja përgjigjet se argumentet e Mustafës nuk arrijnë të demonstrojnë gabim dhe shtrembërojnë Aktgjykimin, ku Trupi Gjykses përmbloodhi saktë parimet që zbatohen lidhur me provat e alibisë dhe konstatoi saktë se alibia e pretenduar e Mustafës nuk krijoi dyshim të arsyeshëm në argumentet e ZPS-së.⁸⁰⁴ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Mustafa shtrembëron llojin e provave të alibisë, të cilat në rastin e tij nuk vërtetojnë *prima facie* aktivitetet e tij në kohën përkatëse, sepse vetëm atëherë ZPS-

⁸⁰⁰ Dosja e Apelit, para. 75, 77. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpika 1M, para. 4.

⁸⁰¹ Dosja e Apelit, para. 304, 315; Njoftimi për Apel, nënpika 2O, para. 5; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 82.

⁸⁰² Dosja e Apelit, para. 71-73, 238-240, 305-307. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 19. Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa i cilëson argumentet në paragrafët 71 deri 73 të Dosjes së Apelit si pretendime për gabim juridik. Shih Njoftimin për Apel, nënpikat 1L-1M, para. 4. Megjithatë, është e qartë që argumentet kundërshtojnë konstatimet faktike të Trupit Gjykses dhe kanë ngjashmëri në masë të madhe me parashtrimet e bëra në paragrafët 305 deri 307 të Dosjes së Apelit, ku pretendohen gabime faktike. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit i ka vlerësuar argumentet në paragrafët 71 deri 73 të Dosjes së Apelit si pretendime për gabime faktike. Shih më lart, para. 25.

⁸⁰³ Dosja e Apelit, para. 308-314.

⁸⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 98.

së do t'i lindte detyrimi të vërtetonte jashtë dyshimit të arsyeshëm se provat për alibi duhej të hidheshin poshtë.⁸⁰⁵

314. ZPS-ja gjithashtu përgjigjet se Mustafa nuk demonstroi se asnjë gjykyes i arsyeshëm i fakteve nuk do të arrinte në përfundimin e Trupit Gjykyes në lidhje me aftësinë e tij për të lëvizur në zonën përkatëse gjatë prillit 1999.⁸⁰⁶ ZPS-ja parashtron se Mustafa shtrembëron Aktgjykimin, ku pranohen vështirësitë e udhëtimit, por konstatohet se megjithatë Mustafa ishte në gjendje të lëvizte shpejt midis Zllashit dhe vendeve të ndryshme për shkak të: (i) distancave relativisht të shkurtra; (ii) disponueshmërisë së mjeteve të ndryshme të transportit dhe përdorimit të tyre; (iii) sigurisë relative në zonë; (iv) njohjes së terrenit dhe përvojës së tij në të; dhe (v) llojit të detyrave të tij, të cilat i kërkonin të lëvizte me lehtësi dhe rregullisht.⁸⁰⁷ Sipas ZPS-së, Mustafa gjithashtu nuk arrin të vërtetojë se asnjë gjykyes i arsyeshëm i fakteve nuk do të mund: (i) të kishte hedhur poshtë dëshmitë e dëshmitarëve të nënvizuar në Dosjen e Apelit; ose (ii) të kishte arritur në të njëjtin përfundim si Trupi Gjykyes.⁸⁰⁸ Së fundi, ZPS-ja argumenton se, në kundërshtim me parashtrimin e Mustafës, Trupi Gjykyes u mbështet në prova të shumta që provojnë përdorimin e automjeteve nga Mustafa.⁸⁰⁹

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

315. Fillimisht, Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa nuk ofron asgjë në mbështetje të pretendimit të vet se Trupi Gjykyes: (i) në aspektin juridik, duhej të kishte shqyrtuar provat për alibi si relevante për cenimin e "gjasës" së pranisë së tij në vendin dhe kohën e veprave penale të pretenduara, edhe nëse prania e tij mbetej si mundësi; dhe (ii) duke mos e bërë këtë, gabimisht e detyroi Mustafën të provonte alibinë e tij jashtë

⁸⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 99-100.

⁸⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 105.

⁸⁰⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 101-102.

⁸⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 103, 105.

⁸⁰⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 104.

dyshimit të arsyeshëm.⁸¹⁰ Këto mangësi përlligjin rrëzimin e menjëhershëm të argumenteve të tij.⁸¹¹ Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij aspekti për argumentet e Mustafës, Paneli i Apelit vendos që të bëjë përjashtim e ta shqyrtojë për të qenë i drejtë me të akuzuarin dhe në interes të drejtësisë.

316. Paneli i Apelit konstaton se nuk ka asnjë gabim në kriterin për vlerësimin e pretendimit për alibi, siç e ka përcaktuar Trupi Gjykses, që mbështetet më së miri nga jurisprudenca e cituar.⁸¹² Konkretisht, Trupi Gjykses deklaroi saktë se: (i) në pretendimin për alibi, Mustafa duhej të paraqiste më shumë prova që do të kishin gjasa të krijonin dyshim të arsyeshëm në argumentet e ZPS-së, dhe se këto prova duhej të vërtetonin *prima facie* aktivitetet e tij në kohën e kryerjes së krimit; dhe (ii) vetëm atëherë ZPS-ja do të detyrohej të eliminonte mundësinë e arsyeshme se alibia është e vërtetë dhe të vërtetonte jashtë dyshimit të arsyeshëm se, pavarësisht nga alibia, faktet e pretenduara janë të vërteta.⁸¹³ Gjithashtu, Trupi Gjykses deklaroi konkretisht se, “për sa i përket vërtetimit të alibisë, i akuzuari nuk ka detyrimin e vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm”, dhe shqyrtoi nëse ekzistonte mundësi e arsyeshme që alibia të ishte e vërtetë.⁸¹⁴

317. Për më tepër, Trupi Gjykses shqyrtoi në mënyrë të përsëritur nëse provat e alibisë “mund të vërtetojnë *prima facie* se i akuzuari ishte gjetiu dhe jo në Zllash, çka

⁸¹⁰ Dosja e Apelit, para. 74-76. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpika 1L, para. 4; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 81.

⁸¹¹ Shih më lart, para. 29.

⁸¹² Aktgjykimi, para. 46, 245, ku citohen poshtëshënimet 76-78, 463, *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 343; *Delalić et al.* Appeal Judgement, para. 581; *Nchamihigo* Appeal Judgement, para. 92; *Zigiranyirazo* Appeal Judgement, para. 17; *Ongwen* Trial Judgment, para. 2449; *Setako* Appeal Judgement, para. 224; *Munyakazi* Appeal Judgement, para. 24; *Nahimana et al.* Appeal Judgement, para. 417. Shih gjithashtu p.sh. *Renzaho* Appeal Judgement, para. 303.

⁸¹³ Aktgjykimi, para. 46, 241, ku citohen poshtëshënimet 77-78, *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 343; *Setako* Appeal Judgement, para. 224; *Munyakazi* Appeal Judgement, para. 24; *Nahimana et al.* Appeal Judgement, para. 417.

⁸¹⁴ Aktgjykimi, para. 46, 245, ku citohen poshtëshënimet 77, 463, *Popović et al.* Appeal Judgement, para. 343; *Setako* Appeal Judgement, para. 224; *Munyakazi* Appeal Judgement, para. 24.

do të krijonte dyshim të arsyeshëm lidhur me argumentet e ZPS-së”,⁸¹⁵ por konstatoi se ato “nuk çojnë në dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në vendin e krimit në kohët përkatëse”.⁸¹⁶ Paneli i Apelit vë në dukje se, meqenëse provat nuk vërtetuan *prima facie* vendndodhjen e të akuzuarit tjetërkund përveç Zllashit në kohën përkatëse, ZPS-ja nuk ishte e detyruar të vërtetonte jashtë dyshimit të arsyeshëm se, me gjithë alibinë, faktet e pretenduara ishin të vërteta. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykon se qasja e Trupit Gjykues nuk ishte e gabuar. Pasi nuk ka vërtetuar asnjë gabim juridik në konstatimet e Trupit Gjykues, Paneli i Apelit hedh poshtë argumentet e Mustafës.

318. Për të njëjtat arsye, Paneli i Apelit hedh poshtë gjithashtu argumentin e Mustafës se Trupi Gjykues “nuk vërtetoi me fakte” lëvizjen e tij midis Butovcit dhe Zllashit duke u bazuar në dëshminë e z. Gani Sopi, por thjesht u bazua në “mundësinë teorike”.⁸¹⁷ Në pajtim me kriteret e përcaktuara pak më lart, Paneli i Apelit thekson se, për rrëzimin e pretendimit për alibi, Trupi Gjykues nuk ishte i detyruar të konstatonte se i akuzuari faktikisht kishte udhëtuar nga Butovci në Zllash. Paneli i Apelit nuk sheh gabim në konstatimin e Trupit Gjykues se, duke pasur parasysh distancën e vogël midis dy vendeve – edhe duke supozuar se dëshmia e z. Gani Sopi për ngjarjet ishte deri diku e saktë – “i akuzuari mund ta ketë përshkuar atë distancë brenda së njëjtës ditë, madje edhe disa herë po të ishte nevoja”.⁸¹⁸

319. Duke kaluar në pretendimet e mbetura të Mustafës për gabime faktike, Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa nuk shpjegon se pse, sipas mendimit të tij, Trupi Gjykues bëri gabim që nuk përcaktoi se kur konkretisht i akuzuari përdori automjet

⁸¹⁵ Aktgjykimi, para. 274 (cituar në tekst), 276, 287, 290, 301, 311, 320, 331.

⁸¹⁶ Aktgjykimi, para. 299, 315, 333 (cituar në tekst).

⁸¹⁷ Dosja e Apelit, para. 239-240.

⁸¹⁸ Shih Aktgjykimin, para. 289. Paneli i Apelit rikujton konstatimin e vet më lart se Mustafa nuk demonstroi asnjë gabim në vlerësimin e besueshmërisë së z. Gani Sopi nga Trupi Gjykues apo në konstatimin e Trupit Gjykues se z. Gani Sopi dhe z. Borovci mund të ishin marrë vesh për dëshmitë e tyre në lidhje me datën e largimit nga Prishtina për në Butovc, që është relevante për pretendimin e të akuzuarit për alibi. Shih më lart, para. 288-291.

dhe kur udhëtoi në këmbë.⁸¹⁹ Paneli gjithashtu vë në dukje se Trupi Gjykses bëri konstatime konkrete mbi mundësinë e Mustafës për të përdorur automjete dhe përdorimin e tyre në kohën përkatëse, duke u bazuar në dëshminë e tij dhe në dëshmitë e shumë dëshmitarëve të ZPS-së dhe të Mbrojtjes.⁸²⁰ Paneli i Apelit nuk sheh mangësi apo gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se aftësia e Mustafës për të lëvizur në zonën përkatëse ishte faktor në përcaktimin nëse provat për alibi mund të vërtetonin *prima facie* vendndodhjen e tij në një vend tjetër dhe jo në Zllash, duke krijuar kështu dyshim të arsyeshëm në argumentet e ZPS-së.⁸²¹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e hedh poshtë këtë argument.

320. Për më tepër, Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa shtrembëron Aktgjykimin duke deklaruar se Trupi Gjykses “shpërfilli tërësisht” provat në lidhje me vështirësitë e lëvizjes në zonën përkatëse gjatë periudhës që mbulon Aktakuza.⁸²² Në fakt, Trupi Gjykses shprehimisht i mori parasysh në krejt vlerësimin e vet vështirësitë e lëvizjes dhe kushtet e ndryshueshme në zonë, përfshirë ofensivën serbe, bombardimet e NATO-s, eksodin e civilëve nëpër Prishtinë, dhe motin e keq.⁸²³ Trupi Gjykses gjithashtu shqyrtoi konkretisht një mori provash në lidhje me kohën që duhej për të bërë udhëtime të ndryshme në zonën relevante për vendet e alibisë dhe kryerjen e krimeve, duke përdorur mjete të ndryshme transporti, rreth kohës përkatëse.⁸²⁴

⁸¹⁹ Dosja e Apelit, para. 313-314.

⁸²⁰ Shih Aktgjykimin, para. 254-257, 274, 293, 319, 332, ku citohen dëshmitë e Mustafës, të z. Nreci, z. Vrbovci, z. Humolli, z. Mehmetaj, z. Borovci, z. Selatin Krasniqi, z. Ibishi, W04600, W03593, W03594 dhe [REDAKTUAR].

⁸²¹ Shih Aktgjykimin, para. 254-257, 261-262, 274, 282, 288, 297, 299, 310, 315, 319, 332-333.

⁸²² Dosja e Apelit, para. 72, 238. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 19, 305.

⁸²³ Shih Aktgjykimin, para. 241, 249, 251, 254, 257, 260-261, 303, 305, 308-310, 317-318, ku citohen dëshmi nga Mustafa, z. Mehmetaj, z. Borovci, z. Gani Sopi, z. Halimi, z. Fatmir Sopi, z. Ismaili, z. Parduzy, z. Ibishi, z. Humolli, z. Veseli, dhe prova dokumentare P00292 (konfidenciale), P00293 (konfidenciale), P00294 (konfidenciale), P00298 (konfidenciale), P00299 (konfidenciale), P00302 (konfidenciale), P00303ET (konfidenciale). *Contra* Dosja e Apelit, para. 72-73, 305. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 19.

⁸²⁴ Shih Aktgjykimin, para. 245, 247, 258-261, 289, 302, 304, ku citohen dëshmi nga z. Gani Sopi, z. Veseli, [REDAKTUAR], z. Humolli, [REDAKTUAR], z. Halimi, z. Selatin Krasniqi, z. Parduzy, z. Nreci dhe z. Ajeti, në lidhje me distancat e udhëtimeve nga Butovci në Zllash, Prishtina në Zllash, Zllashi në

Mustafa kundërshton vetëm katër aspekte të këtyre provave,⁸²⁵ secilën prej të cilave Paneli i Apelit e hedh poshtë për arsye se Mustafa:

- (i) shtrembëron Aktgjykimin kur deklaron se Trupi Gjykses nuk mori parasysh dëshminë e z. Selatin Krasniqi në lidhje me udhëtimin e tij nga Zllashi në Prishtinë dhe anasjelltas;⁸²⁶
- (ii) nuk jep fakte për pretendimin e vet se dëshmia e z. Halimi nuk është relevante për përcaktimin e kohëzgjatjes së udhëtimit nga qendra stërvitore në Zllash deri në Prapashticë, sepse këto vende gjendeshin në “zonën e Gollakut, që ishte relativisht e lirë”;⁸²⁷
- (iii) nuk shpjegon se pse fakti që z. Ajeti nuk u kthye në Prishtinë pas udhëtimit të tij më 1 prill 1999 do të thotë se vlerësimi i tij i kohëzgjatjes së udhëtimit nga Zllashi në Prishtinë nuk është relevant;⁸²⁸ dhe
- (iv) nuk shpjegon se pse, sipas mendimit të tij, fakti që W03593 nuk ishte në gjendje të tregonte nëse informacioni lidhur me udhëtimin nga Zllashi në Prishtinë ishte brenda periudhës që mbulon

[REDAKTUAR], Prishtina në Barilevë, [REDAKTUAR] në Zllash (baza e BIA-s), Zllashi (qendra stërvitore) në Prapashticë, Bradashi në Zllash, Barileva në Radashec, Butovci i Poshtëm në Prishtinë.

⁸²⁵ Shih Dosjen e Apelit, para. 306-312.

⁸²⁶ Shih Dosjen e Apelit, para. 308, 310; Aktgjykimin, para. 256, 260. Krahas kësaj, Paneli i Apelit vë në dukje se Mustafa gjithashtu duket se shtrembëron përmbajtjen e dëshmisë së z. Selatin Krasniqi: (i) sepse provat sugjerojnë që 12-13 orë zgjaste *udhëtimi vajtje-ardhje*, dhe jo vetëm udhëtimi për të shkuar në Prishtinë; dhe (ii) sepse deklaron që udhëtimi u bë me traktor, ndërkohë që provat nuk janë të qarta në lidhje me këtë aspekt dhe tregojnë se udhëtim u bë herë në këmbë e herë me traktor. Shih Dosjen e Apelit, para. 308, 310; Transkriptin (Selatin Krasniqi), 21 prill 2022, f. 3909; Transkriptin (Selatin Krasniqi), 22 prill 2022, f. 4041.

⁸²⁷ Shih Dosjen e Apelit, para. 312; Aktgjykimin, para. 260, që i referohet Transkriptit, 20 prill 2022, f. 3803-3805.

⁸²⁸ Shih Dosjen e Apelit, para. 309; Aktgjykimin, para. 260.

Aktakuza, do të thotë se dëshmia e tij nuk ishte relevante për analizën e Trupit Gjykues.⁸²⁹

321. Gjithashtu, Mustafa nënvizon konkretisht disa dëshmi mbi kushtet dhe kohëzgjatjen e udhëtimit midis vendeve të ndryshme,⁸³⁰ por nuk jep fakte në mbështetje të pretendimit të vet se Trupi Gjykues gaboi që nuk u mbështet në këto dëshmi⁸³¹ as nuk demonstroi se si gabimi i pretenduar cenon përfundimin e Trupit Gjykues se “nuk bindet që i akuzuari nuk ishte i pranishëm në Zllash në kohët që lidhen me akuzat”.⁸³² Konkretisht, Paneli i Apelit konstaton se:

- (i) Trupi Gjykues iu referua shprehimisht dëshmisë së z. Parduzi në lidhje me udhëtimin nga Bradashi në Zllash, përfshirë dëshminë e tij se udhëtimi mund të zgjaste deri në 24 orë me makinë, dhe dëshmisë së z. Nreci për udhëtimin nga Barileva në Radashec, përfshirë faktin se udhëtimi vajtje-ardhje ishte bërë brenda një nate,⁸³³ dhe
- (ii) Mustafa nuk shpjegon se pse, sipas mendimit të tij,⁸³⁴ Trupi Gjykues bëri gabim që nuk iu referua dëshmive në lidhje me kohëzgjatjen e udhëtimit dhe me kushtet midis: (i) Potokut dhe Turuçicës, pasi që të dy gjenden në veri të të gjitha vendeve që janë relevante për pretendimin e alibisë,⁸³⁵ dhe

⁸²⁹ Shih Dosjen e Apelit, para. 311; Aktgjykimin, para. 260.

⁸³⁰ Dosja e Apelit, para. 73, 306.

⁸³¹ Dosja e Apelit, para. 74.

⁸³² Aktgjykimi, para. 332.

⁸³³ Aktgjykimi, para. 260. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 73, ku citohet, në pjesën përkatëse, Transkripti (Kapllan Parduzy), 11 prill 2022, f. 3422-3423, 3481, dhe Transkripti (Bislim Nreci), 5 prill 2022, f. 3199-3201, 3228, 3275.

⁸³⁴ Shih Dosjen e Apelit, para. 73, 306, ku citohet, në pjesët përkatëse, Transkripti (Kapllan Parduzy), 11 prill 2022, f. 3429, 3469, Transkripti (Nuredin Ibishi), 12 prill 2022, f. 3559 (shih gjithashtu f. 3560), dhe Transkripti (Sheqir Rrahimi), 13 prill 2022, f. 3666 (shih gjithashtu f. 3665).

⁸³⁵ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vëren gjithashtu se Mustafa shtrembëron dëshminë e z. Parduzy, i cili në vend që të diskutonte udhëtimin nga Orllani në Potok, faktikisht diskutoi udhëtimin nga Potoku në Turuçicë, siç u theksua më lart, dhe në vend që të thoshte se udhëtimi zgjati gati tri ditë, tha në fakt se ai zgjati dy ditë, ose më shumë se 48 orë. Shih Transkriptin (Kapllan Parduzy), 11 prill 2022, f. 3429, 3469; P00108. Shih gjithashtu P00257 (konfidencial), f. 11, 13. *Contra* Dosja e Apelit, para. 73(c).

(ii) Turuçicës dhe Rimanishtës (nëpërmes, midis të tjerash, Rakinicës, Kalaticës dhe Sharbanit), duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e këtij udhëtimi u bë në masë të konsiderueshme në veriperëndim të të gjitha vendeve relevante për pretendimin e alibisë.⁸³⁶

322. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se dëshmitë në të cilat u mbështet Trupi Gjykes nuk do të ishin pranuar nga asnjë gjykes i arsyeshëm i fakteve, ose se vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar, dhe rrjedhimisht i hedh poshtë argumentet e tij.⁸³⁷

323. Për më tepër, Paneli i Apelit vë në dukje se rrëzimi nga Trupi Gjykes i pretendimit për alibi në lidhje me praninë e pretenduar të Mustafës në Butovc, Barilevë, Rimanishtë, Bellopojë, dhe në Prishtinë – që Mustafa e kundërshton në apel – nuk u bazua vetëm në konstatimin e Trupit Gjykes se i akuzuari ishte në gjendje të udhëtonte midis këtyre vendeve dhe Zllashit dhe të ishte i pranishëm në dy vendndodhje më të njëjtën ditë. Çka është e rëndësishme, rrëzimi nga Trupi Gjykes i pretendimit për alibi u bazua gjithashtu në faktin se, para së gjithash, Trupi Gjykes nuk u bind se Mustafa kishte qenë i pranishëm në vendndodhje të tjera, bazuar në konstatimet e veta për: (i) mungesën e besueshmërisë dhe/ose mbështetshmërisë në dëshmitë e dëshmitarëve përkatës; (ii) ndikimin e personave të tjerë në këta dëshmitarë ose njëanshmërinë e tyre kundër Dhomave të Specializuara; ose (iii) kohët kur u pa Mustafa ishin jashtë periudhës që përfshin Aktakuza, ose ishin tepër të mjegullta ose të paqarta.⁸³⁸ Rrjedhimisht, edhe nëse kundërshtimet e Mustafës ndaj konstatimeve të Trupit Gjykes se ai mund të ishte i pranishëm në dy vendndodhje brenda ditës do të kishin qenë të suksesshme, i akuzuari nuk ka arritur të demonstrojë se si gabimi i pretenduar do të çonte në rezultat tjetër, duke pasur parasysh se ai nuk

⁸³⁶ Shih Transkriptin (Sheqir Rrahimi), 13 prill 2022, f. 3665-3666; P00108; Dosjen e Apelit, para. 73(d).

⁸³⁷ Neni 46(5) i Ligjit. Shih gjithashtu më lart, para. 23.

⁸³⁸ Shih Aktgjykimin, para. 273-290, 296-301, 307-311, 314-320.

që në gjendje ta bindte Trupin Gjykses se vërtet kishte qenë i pranishëm në këto vendndodhje të tjera. Rrjedhimisht, Paneli i rrëzon këto argumente.

324. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit hedh poshtë nënpikat 1L, 1M, 2O dhe pjesën e mbetur të nënpikës 2M të Apelit të Mustafës.

O. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES PËR KRIMIN E LUFTËS TË VRASJES SË PALIGJSHME (PIKAT 3, 4, 5)

325. Kur gjykoi se ekzistonte dyshimi i arsyeshëm nëse vrimat e plumbave në trupin e viktimës së vrasjes së paligjshme mund t'i atribuoheshin Mustafës dhe forcave të tij,⁸³⁹ Trupi Gjykses konstatoi se ishin përmbushur elementet e veprimit të fajshëm të krimit të luftës së vrasjes së paligjshme.⁸⁴⁰ Ai gjithashtu konstatoi se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në provat për veprimet dhe mosveprimet që mund t'i atribuohen Mustafës dhe vartësve të tij në BIA, ishte se "ata synonin të vrisnin viktimën e vrasjes së paligjshme", duke vërtetuar kështu synimin e fajshëm të nevojshëm për vrasjen e paligjshme si krim lufte.⁸⁴¹

326. Në Pikat 3, 4 dhe 5 të Apelit, Mustafa kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të vrasjes së paligjshme si krim lufte, i ndëshkueshëm sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, mbi të cilët u bazua shpallja e tij fajtor sipas Pikës 4 të Aktakuzës.⁸⁴² ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se parashtrimet e Mustafës duhet të hidhen poshtë.⁸⁴³

⁸³⁹ Aktgjykimi, para. 637.

⁸⁴⁰ Aktgjykimi, para. 690.

⁸⁴¹ Aktgjykimi, para. 695.

⁸⁴² Dosja e Apelit, para. 324-378; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 22-26, 34, 88-97.

⁸⁴³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 35-44, 130-186; Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 67-80.

1. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme si krim lufte (Pikat 3, 4)

327. Trupi Gjykses konstatoi se “kufoma e dytë, e gjetur në varrin [REDAKTUAR] në fillim të korrikut 1999, ishte viktima e vrasjes së paligjshme”.⁸⁴⁴ Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se viktima e vrasjes së paligjshme u vra midis 19 prillit 1999 ose rreth kësaj date dhe rreth fundit të prillit 1999.⁸⁴⁵ Trupi Gjykses gjykoi se vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme ishte rezultat i: (i) keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga anëtarë të BIA-s të cilët e mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, duke i shkaktuar dëmtime të rënda fizike; (ii) refuzimit të ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s që e mbajtën të ndaluar; dhe (iii) plagës me armë zjarri, në lidhje me të cilën Trupi Gjykses konstatoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm se kujt mund t’i atribuohet (anëtarëve të BIA-s apo forcave serbe).⁸⁴⁶ Trupi Gjykses konstatoi se shkaqet (i) dhe (ii) ishin shkaqe të konsiderueshme të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, dhe mund t’i atribuoheshin Mustafës në kontekstin e vendimit të tij për të mos liruar dhe për të mos e evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme, dhe “pavarësisht nëse viktima e vrasjes së paligjshme u godit nga një ose më shumë plumba serbë”.⁸⁴⁷ Këto veprime dhe mosveprime përbënë bazën për konstatimin nga ana e Trupit Gjykses të veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme si krim lufte.⁸⁴⁸

328. Mustafa pretendon pesë gabime juridike dhe katër gabime faktike në lidhje me përfundimin e Trupit Gjykses se ishte përmbushur elementi i veprimit të fajshëm për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme.⁸⁴⁹ Ai parashtron se, në bazë të këtyre gabimeve të renditura, veç e veç ose bashkërisht, shpallja e tij fajtor për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme duhet të prapësohet.⁸⁵⁰

⁸⁴⁴ Aktgjykimi, para. 618.

⁸⁴⁵ Aktgjykimi, para. 639, 689.

⁸⁴⁶ Aktgjykimi, para. 624, 637, 689.

⁸⁴⁷ Aktgjykimi, para. 638, 689.

⁸⁴⁸ Aktgjykimi, para. 689-690.

⁸⁴⁹ Dosja e Apelit, para. 324-367.

⁸⁵⁰ Njoftimi për Apel, Pika 3, para. 6 dhe Pika 4, para. 7; Dosja e Apelit, para. 341, 367.

(a) Pretendimet për gabime juridike në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme

(i) Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

329. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik kur nuk mori parasysh parimin *novus actus interveniens*.⁸⁵¹ Konkretisht, ai argumenton se Trupi Gjykses nuk shqyrtoi nëse, në rrethanat që mbizotëronin kur forcat serbe ndërmorën ofensivë në atë zonë, vrasja e vullnetshme, e qëllimshme dhe me vetëdije e viktimës së vrasjes së paligjshme nga një person tjetër duke përdorur armë zjarri, ishte ngjarje e re që shërbeu për të ndërprerë zinxhirin e shkakësisë, duke e liruar si rrjedhojë Mustafën nga çdo fajësi për rezultatin përfundimtar.⁸⁵² Në lidhje me këtë, Mustafa parashtron se ekziston një periudhë e gjatë midis momentit kur viktima e vrasjes së paligjshme ishte parë i gjallë dhe zbulimit të kufomës së viktimës, dhe se nuk mund të vërtetohet asnjë lidhje shkakësore midis veprimit të pretenduar të Mustafës dhe vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.⁸⁵³

330. Mustafa argumenton më tej se Trupi Gjykses bëri gabim juridik sepse: (i) mund të ekzistojë vetëm një shkak i vdekjes;⁸⁵⁴ (ii) vdekja për shkak të keqtrajtimit ose refuzimit të ndihmës mjekësore nuk përbën vepër penale të vrasjes së paligjshme;⁸⁵⁵ (iii) në përputhje me rregullën 40 të Rregullores, ZPS-ja nuk kërkoi autorizim dhe Trupi Gjykses nuk ushtroi kompetencën për të autorizuar zhvarrosjen dhe autopsinë e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme;⁸⁵⁶ dhe (iv) pa zhvarrosjen dhe autopsinë e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme, Trupi Gjykses nuk vërtetoi

⁸⁵¹ Dosja e Apelit, para. 358-362; Njoftimi për Apel, nënpika 4C, para. 7. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 367.

⁸⁵² Dosja e Apelit, para. 358-362; Njoftimi për Apel, nënpika 4C, para. 7; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 56-57.

⁸⁵³ Dosja e Apelit, para. 358.

⁸⁵⁴ Dosja e Apelit, para. 354; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 89, 132. Shih Njoftimin për Apel, nënpika 4B, para. 7; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 55. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 367.

⁸⁵⁵ Dosja e Apelit, para. 345. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 367.

⁸⁵⁶ Njoftimi për Apel, Pika 3, para. 6; Dosja e Apelit, para. 324-326, 341; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 22-26, 34, 88, 130-131; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 46-47.

llojin e lëndimeve të tij, shkakun e vdekjes dhe kohën e vdekjes.⁸⁵⁷ Sa i përket llojit të lëndimeve dhe shkakut të vdekjes, Mustafa parashtron se [REDAKTUAR], nuk janë ekspertë dhe se disa prova tregojnë se në kufomë ishte konstatuar vetëm një vrimë hyrëse.⁸⁵⁸ Sa i përket kohës së vdekjes, Mustafa argumenton se, për të shmangur “shkeljen e dispozitave të procedurës penale”, konstatimi për kohën e vdekjes është “i domosdoshëm”.⁸⁵⁹

331. ZPS-ja përgjigjet se shumica e pretendimeve të Mustafës janë ose të paqarta, enigmatike, të pafaktuara, ose qartësisht të pasakta.⁸⁶⁰ Në lidhje me argumentin *novus actus interveniens* të Mustafës, ZPS-ja përgjigjet se ai duhet të hidhet poshtë *in limine* sepse ngrihet për herë të parë në apel dhe Mustafa as nuk përpiqet të demonstrojë ndonjë gabim juridik.⁸⁶¹ Në lidhje me themelësinë, ZPS-ja parashtron se, edhe po të anashkaloheshin këto mangësi, Trupi Gjykses zbatoi standardin e duhur të shkakësisë sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare⁸⁶² dhe çdo mëdyshje në lidhje me interpretimin duhet të zgjidhet në pajtim me hierarkinë e burimeve sipas nenit 3 të Ligjit, përfshirë jurisprudencën e tribunalëve *ad hoc*.⁸⁶³ ZPS-ja parashtron se kjo jurisprudencë zbaton kriterin e kontributit të konsiderueshëm për shkakësinë, që ajo vë në dukje se është më i rreptë se kriteret që zbatohen në shumë juridiksione shtetërore.⁸⁶⁴ ZPS-ja shton se, ndërsa juridiksionet shtetërore e trajtojnë shkakësinë në

⁸⁵⁷ Dosja e Apelit, para. 327-341, 352-353; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 23-26, 34; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 47-50. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 367. Paneli i Apelit vë në dukje se, gjatë fazës së apelit, argumentin që Trupi Gjykses nuk trajtoi vendin e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, Mustafa e artikuloi për herë të parë në seancën e apelit. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 49-50. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk do ta shqyrtojë këtë argument.

⁸⁵⁸ Dosja e Apelit, para. 329-332; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 23; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 47. Mustafa gjithashtu shton se personat që ishin ndaluar bashkë me viktimën e vrasjes së paligjshme të cilët dhanë dëshmi, nuk ishin në gjendje të jepnin prova mjekësore bindëse për gjendjen mjekësore të viktimës së vrasjes së paligjshme. Shih Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 23. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 50.

⁸⁵⁹ Dosja e Apelit, para. 334-335, 340; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 47-50, 55-56.

⁸⁶⁰ Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 134-139.

⁸⁶¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 161; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 75, 89.

⁸⁶² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 162-163.

⁸⁶³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 163.

⁸⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 163; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 81-84, 87-88.

mënyra të ndryshme, pikënisja në shumicën e juridiksioneve anglosaksone dhe të së drejtës civile është përcaktimi i shkakësisë faktike përmes kriterit *conditio sine qua non*, dhe shumica e juridiksioneve pastaj kalon në vlerësimin e shkakësisë juridike përmes një kushti normativ shtesë.⁸⁶⁵ ZPS-ja parashtron se, ndonëse ky kusht normativ merr forma të ndryshme në juridiksione shtetërore të ndryshme, qëllimi për të atribuuar përgjegjësinë penale në mënyrë të drejtë është i njëjtë.⁸⁶⁶ ZPS-ja më tej shton se, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, ky qëllim arrihet përmes kriterit të shkakut të konsiderueshëm.⁸⁶⁷ ZPS-ja gjithashtu vëren se nuk duket se Mustafa kundërshton saktësinë e kriterit të shkakut të konsiderueshëm, por vetëm zbatimin e tij nga ana e Trupit Gjykses.⁸⁶⁸

332. Sa i përket konkretisht *novus actus interveniens*, ZPS-ja parashtron se ky parim është përjashtim prej parimit të zakonshëm të shkakësisë, ai është unik për juridiksionet anglosaksone, dhe nuk pasqyron të drejtën zakonore ndërkombëtare.⁸⁶⁹ ZPS-ja parashtron më tej se nuk ekziston “rrugë legjitime për përfshirjen e këtij parimi në të drejtën materiale të zbatueshme për Pikën 4” të Aktakuzës.⁸⁷⁰ ZPS-ja paralajmëron që një koncept juridik shtetëror nuk duhet të importohet drejtpërdrejt në të drejtën penale ndërkombëtare, duke vënë në dukje se standardi në fuqi për përdorimin e një rregulle të së drejtës shtetërore për interpretimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare është që rregulla shtetërore duhet të jetë “e përbashkët për sistemet juridike kryesore të botës”.⁸⁷¹ ZPS-ja parashtron se parimi *novus actus interveniens* nuk e përmbush këtë standard.⁸⁷² Pavarësisht nga sa më sipër, ZPS-ja

⁸⁶⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 164; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 84.

⁸⁶⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 164-166.

⁸⁶⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 166; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 84.

⁸⁶⁸ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 99.

⁸⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 162, 168-170; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 91-95, 97, 102-104.

⁸⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 162.

⁸⁷¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 171; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 91-92, 104.

⁸⁷² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 171. ZPS-ja shton se, nuk ka asnjë argument bindës moral apo të politikës juridike për përfshirjen e parimit *novus actus interveniens* në të drejtën zakonore ndërkombëtare. Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 172.

parashtron se, në juridiksionet shtetërore, ky parim nuk i ndryshon ndjeshëm parimet e zakonshme të shkakësisë, sepse në shumicën e rasteve që është konstatuar se një veprim kriminal i vullnetshëm ndërpriste zinxhirin e shkakësisë, vepra nuk ishte logjiksht e parashikueshme.⁸⁷³

333. Për më tepër, ZPS-ja parashtron se, edhe nëse *novus actus interveniens* do të zbatohet në të drejtën zakonore ndërkombëtare, kjo nuk e përjashton Mustafën nga përgjegjësia penale, si kryes i drejtpërdrejtë, për mosveprimet e tij, si mosevakuimi i viktimës së vrasjes së paligjshme dhe mosdhënia e ndihmës mjekësore.⁸⁷⁴ ZPS-ja shton se, mbi të njëjtën bazë do të provohej përgjegjësia penale e Mustafës për ndihmë dhe inkurajim.⁸⁷⁵ Megjithatë, ZPS-ja vë në dukje se Panelit të Apelit do t'i duhej të shqyrtonte përgjegjësinë penale për ndihmë dhe inkurajim vetëm në rast se do t'i duhej të zbatonte ndonjë parim tjetër të jashtëzakonshëm dhe jo kriterin e shkakut të konsiderueshëm.⁸⁷⁶

334. Si përgjigje ndaj pyetjeve të ngritura nga Paneli i Apelit në lidhje me standardin e zbatueshëm të shkakësisë, ZPS-ja shton: (i) Trupi Gjykses bëri konstatim të shkakësisë bazuar në standardin “sikur të mos ishte” dhe se, pavarësisht nëse standardi i zbatueshëm për shkakësinë sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare e përfshin shkakësinë “sikur të mos ishte”, kjo nuk do ta ndryshonte konstatimin e përgjithshëm të Trupit Gjykses në lidhje me shkakësinë për vrasje të paligjshme;⁸⁷⁷ (ii) një Panel i Apelit ka konstatuar më parë se jurisprudenca e tribunalëve *ad hoc* është mënyra më e përshtatshme për të dalluar ekzistencën e së drejtës zakonore ndërkombëtare;⁸⁷⁸ (iii) zbatimi i kriterit të shkakut të konsiderueshëm është në

⁸⁷³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 168; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 90-91, 97.

⁸⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 162, 168, 173-175; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 98; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 155.

⁸⁷⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 162, 168, 176; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 100, 106-107.

⁸⁷⁶ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 107-108; 27 tetor 2023, f. 154-155.

⁸⁷⁷ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 78-80.

⁸⁷⁸ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 81.

përputhje me konstatimet faktike të dhomës gjyqësore të TPNJ-së në çështjen *Limaj dhe të tjerët* dhe të Dhomës së Apelit të TPNJ-së në çështjen *Llukiq dhe Llukiq*, ku të akuzuarit u shpallën fajtorë si kryes të drejtpërdrejtë edhe pse veprimet e të tjerëve kishin pasoja më të drejtpërdrejta për vdekjen e viktimave;⁸⁷⁹ (iv) në jurisprudencën ndërkombëtare ka një mori çështjesh me fakte të ngjashme që ofrojnë orientim për zbatimin e kriterit të shkakut të konsiderueshëm në kontekstin e ndihmës dhe inkurajimit dhe ilustrojnë arsyeshmërinë e konstatimeve të Trupit Gjyqësor;⁸⁸⁰ dhe (v) në qoftë se Paneli do të zëvendësonte kriterin e kontributit të konsiderueshëm me cilindo standard shkakësie sipas të drejtës shtetërore, kjo nuk do të ndryshonte konstatimin përfundimtar të Trupit Gjyqësor që ia atribuon vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme Mustafës dhe vartësve të tij në BIA.⁸⁸¹ Së fundi, ZPS-ja iu referua një aktgjykimi të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku u shpjegua se, kur konstatohet se një person në ndalim të ligjshëm është viktimë e vrasjes së paligjshme, përgjegjësia për atë vdekje mund t'i atribuohet përgjegjësve për ndalimin në qoftë se ndalimi ose kushtet e lirit i mundësojnë një pale të tretë të kryejë vrasjen e paligjshme, me kushtin që të përmbushen standardet e lidhjes shkakësore dhe të veprimit të fajshëm.⁸⁸²

335. Në lidhje me argumentin e Mustafës se mund të ekzistojë vetëm një shkak i vdekjes, ZPS-ja përgjigjet se ai ngatërron shkakun mjekësor (ose patologjik) të vdekjes me shkakësinë juridike dhe, edhe pse përdorimi i zakonshëm i fjalës “shkak” mund të nënkuptojë se veprimet e një të akuzuari duhet të jenë i vetmi shkak i rezultatit në fjalë, shkakësia nuk është përkufizuar kështu në ligj.⁸⁸³ ZPS-ja parashtroi se Trupi Gjyqësor e përcaktoi saktë standardin juridik për shkakësi për vrasjen e paligjshme si krim lufte, duke argumentuar se nuk ka nevojë që sjellja e kryesit të jetë shkak i

⁸⁷⁹ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 81-82.

⁸⁸⁰ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 82-83.

⁸⁸¹ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 83-89.

⁸⁸² Transkripti, 26 tetor 2023, f. 95-96.

⁸⁸³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 140-143; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 77-78.

vetëm i vdekjes së viktimës, por duhet, më së paku, të ketë kontribuar në masë të konsiderueshme.⁸⁸⁴ Në këtë rast, ZPS-ja parashtron se veprimet dhe mosveprimet e Mustafës dhe vartësve të tij patën efekt të konsiderueshëm në vrasjen me armë zjarri të viktimës së vrasjes së paligjshme, që në vijim u bë shkak mjekësor i vdekjes së tij.⁸⁸⁵ Sa i përket argumentit të mëtejshëm të Mustafës se vdekja për shkak të keqtrajtimit apo refuzimit të ndihmës mjekësore nuk mund të përbëjë bazë për shpallje fajtor për vrasje, ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk paraqet asnjë burim ligjor për këtë argument.⁸⁸⁶

336. Në lidhje me argumentin e Mustafës sipas rregullës 40 të Rregullores, ZPS-ja përgjigjet se Mustafa e paraqet këtë argument për herë të parë në apel edhe pse pati mundësi konkrete ta bënte këtë para deklaratave hyrëse⁸⁸⁷ dhe, rrjedhimisht, duhet të hidhet poshtë.⁸⁸⁸ Megjithatë, ZPS-ja parashtron se argumenti i Mustafës bazohet në keqkuptimin thelbësor të kësaj rregulle,⁸⁸⁹ sepse kjo rregull nuk e detyron ZPS-në të kryejë zhvarrosje apo autopsi⁸⁹⁰ dhe formulimi i qartë i saj nuk i jep kompetencë Trupit Gjykues që të urdhërojë masa të tilla pa kërkesën e ZPS-së.⁸⁹¹ Gjithashtu, ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se moskryerja e zhvarrosjes dhe autopsisë së kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme rezultoi në pasojën që Trupi Gjykues nuk identifikoi kufomën, shkakun dhe kohën e vdekjes, dhe llojin e lëndimeve.⁸⁹² Konkretisht, ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykues: (i) pranoi se nuk kishte aktautopsi; (ii) shpjegoi në hollësi se në cilat prova u mbështet; dhe (iii) nuk kërkoi

⁸⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 140; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 78.

⁸⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 142.

⁸⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 134.

⁸⁸⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 36.

⁸⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 36.

⁸⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 37.

⁸⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 37-38.

⁸⁹¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 39. ZPS-ja parashtron më tej se Mustafa nuk demonstroi se zhvarrosja dhe autopsia e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme do të ishte e përligjtur. Shih Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 40-41.

⁸⁹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 42-43. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 137.

konfirmim.⁸⁹³ Për më tepër, ZPS-ja argumenton se është më se e vërtetuar se elementet e vrasjes së paligjshme mund të provohen edhe në mungesë të kufomës.⁸⁹⁴

337. Në lidhje me argumentin *novus actus interveniens* të Mustafës, Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se veprimi i ri që ndërpret zinxhirin e shkakësisë duhet të përbëjë “faktor kontribuues të qenësishëm” në vdekjen e viktimës.⁸⁹⁵ Mbrojtësja e Viktimave më tej përgjigjet se parashtrimet e Mustafës në këtë aspekt janë hipotetike, duke pretenduar vetëm se “shumë faktorë të rinj mund të kenë shkaktuar vdekjen e viktimës”.⁸⁹⁶ Mbrojtësja e Viktimave shton se, në të drejtën zakonore ndërkombëtare, sistemet juridike kryesore në botë, si dhe në të drejtën penale të Kosovës, kërkohet qartë lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit të të akuzuarit dhe vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, dhe se ngarkimi me përgjegjësi është objekt i korrigjimit normativ duke u bazuar mbi çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme.⁸⁹⁷ Duke theksuar se sulmi serb nuk ishte ngjarje tërësisht e re dhe autonome që do të ndërpriste zinxhirin e shkakësisë, Mbrojtësja e Viktimave parashtron se është e drejtë dhe e arsyeshme të konfirmohet fajësia e Mustafës për vrasje të paligjshme bazuar në faktet që Trupi Gjykses konstatoi se janë të sakta jashtë dyshimit të arsyeshëm.⁸⁹⁸ Mbrojtësja e Viktimave parashtron se është e mundshme të ekzistojnë dy kryes të ndryshëm që kryejnë të njëjtin krim, por njëri nuk e tejkalon tjetrin, duke ndërprerë zinxhirin e shkakësisë.⁸⁹⁹ Sipas mendimit të saj, ndërprerja e shkakësisë ndodh vetëm kur ekziston një ngjarje krejtësisht e re.⁹⁰⁰

338. Në lidhje me argumentet e Mustafës se mund të ekzistojë vetëm një shkak i vdekjes dhe vdekja për shkak të keqtrajtimit ose refuzimit të ndihmës mjekësore nuk

⁸⁹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 43.

⁸⁹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 43.

⁸⁹⁵ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 78.

⁸⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 79, ku citohet Dosja e Apelit, para. 359.

⁸⁹⁷ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 122.

⁸⁹⁸ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 122-125.

⁸⁹⁹ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 131-132.

⁹⁰⁰ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 133-134.

mund të përbëjë bazë për vendim fajësie për vrasje të paligjshme, Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se Mustafa nuk pranon se, sipas Ligjit, vrasja e paligjshme si krim lufte në konflikt të armatosur jondërkombëtar mund të kryhet në mënyra të ndryshme me veprime ose mosveprime.⁹⁰¹ Mbrojtësja e Viktimave shton se ajo që kërkohet është që sjellja e kryesit të kontribuojë konsiderueshëm për vdekjen, që mund të provohet përmes provave rrethore, siç janë prova për incidente ose praktika të keqtrajtimit.⁹⁰² Rrjedhimisht, Mbrojtja e Viktimave parashtron se Trupi Gjykses gjykoi saktë se nuk është e domosdoshme që veprimet e BIA-s të jenë i vetmi shkak i vdekjes.⁹⁰³

339. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet më tej në lidhje me argumentin e Mustafës sipas rregullës 40 të Rregullores se: (i) kjo dispozitë përcakton detyrim të ZPS-së dhe jo të Trupit Gjykses;⁹⁰⁴ (ii) nuk kishte nevojë për identifikim për shkak të provave në dispozicion në lidhje me këtë aspekt;⁹⁰⁵ dhe (iii) Trupi Gjykses kishte të drejtë kur nuk konsideroi zhvarrosjen, duke pasur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara të veprojnë në një mënyrë që respekton interesat e viktimave dhe të drejtat e tyre për jetë familjare dhe dinjitet njerëzor.⁹⁰⁶

340. Mustafa kundërpërgjigjet në lidhje me *novus actus interveniens*, se parashtrimet e ZPS-së janë ose të pavend ose të pabaza.⁹⁰⁷ Konkretisht, ai parashtron se: (i) ai nuk duhet të mbajë përgjegjësi penale në rast se viktimat e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri nga forcat serbe, sepse ai nuk mund të kishte vepruar ndryshe në përpjekje për të shpëtuar civilët kur serbët po i afroreshin Zllashit;⁹⁰⁸ (ii) është i

⁹⁰¹ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 75. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së Viktimave, para. 74.

⁹⁰² Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 75. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së Viktimave, para. 74.

⁹⁰³ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 77.

⁹⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 68.

⁹⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 69, 71.

⁹⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 67, 70-71.

⁹⁰⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 94.

⁹⁰⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 91, 93. Paneli i Apelit vë në dukje se në paragrafin 91 të Dosjes së Kundërpërgjigjes, Mustafa deklaroi: "bazuar në këtë deklaratë, Mustafa duhet të jetë përgjegjës penalisht dhe të mbajë përgjegjësi penale për çdo vrasje të paligjshme që ka ndodhur në zonën e

paarsyeshëm qëndrimi i ZPS-së në lidhje me sulmin serb se Mustafa në çdo sistem juridik do të ishte përgjegjës për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme;⁹⁰⁹ dhe (iii) nuk janë relevante argumentet e ZPS-së në lidhje me pazbatueshmërinë e parimit *novus actus interveniens*, sepse ato merren me aspekte që janë jashtë kuadrit të apelit.⁹¹⁰ Pyetjes së Panelit të Apelit në lidhje me nëse një ngjarje e re që rezultoi në mungesë të shkakësisë do të kishte pasoja për format e tjera të përgjegjësisë penale të përfshira në Aktakuzë, Mustafa iu përgjigj se “Kur nuk ka vrasje të paligjshme, atëherë nuk ka edhe përgjegjësi penale për vrasje të paligjshme në asnjë formë [...], të paktën jo nga i akuzuari”.⁹¹¹

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

341. Paneli i Apelit vë në dukje përkufizimin në vijim të veprimit të fajshëm për vrasje të paligjshme të përcaktuar nga Trupi Gjykses:

Krimi i vrasjes së paligjshme si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që çon në vdekjen e një personi, duke përfshirë, për shembull, shkaktimin e një dëmtimi të rëndë fizik ose mosdhënien/refuzimin e ndihmës mjekësore një të ndaluar. Nuk është e nevojshme që sjellja e kryesit të jetë shkak i vetëm i vdekjes së viktimës, por ajo së paku duhet të ketë kontribuar në mënyrë të qenësishme për të.⁹¹²

342. Mustafa ngre disa kundërshtime të ndërlidhura në lidhje me aspektin e shkakësisë, përfshirë dhe nocionin *novus actus interveniens*, sepse ka të bëjë me pyetjen nëse sjellja e tij përmbush veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme. Ky është njëherazi aspekt faktik dhe juridik.

Zllashit.” Sipas Panelit të Apelit, se Mustafa ka dashur të thotë se ai “nuk duhet” të jetë penalisht përgjegjës.

⁹⁰⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 93.

⁹¹⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 90, 92.

⁹¹¹ Transkripti, 26 tetor 2023, f. 57-58.

⁹¹² Aktgjykimi, para. 686-687. Paneli i Apelit vë në dukje se Trupi Gjykses dhe palët përdorin nganjëherë terminologji të ndryshme kur i referohen standardit të shkakësisë të përcaktuar në përkufizim. Referencat ndaj kriterit të “shkakut të konsiderueshëm” ose kriterit të “kontributit të konsiderueshëm” duhet të kuptohen se i referohen këtij standardi të shkakësisë.

343. Sa i përket shkakësisë faktike, Paneli i Apelit vë në dukje se Trupi Gjykses konstatoi se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq si rezultat i përbashkët i: (i) keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga anëtarë të BIA-s që e mbajtën të ndaluar, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore; (ii) refuzimit të ndihmës mjekësore nga anëtarë të BIA-s; dhe (iii) plagëve me armë zjarri. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ishte në gjendje të përcaktonte një shkak faktik të vetëm të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.

344. Sa i përket shkakësisë juridike, pyetja para Trupit Gjykses ishte se si t'i atribuonte në mënyrë të drejtë përgjegjësi Mustafës për sjelljen e tij në lidhje me vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, duke pasur parasysh se kishte një numër shkaqesh faktike të vdekjes. Sipas mendimit të Panelit të Apelit, për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, Trupi Gjykses zbatoi drejt kriterin e "kontributit të konsiderueshëm" që është i pranuar gjerësisht në jurisprudencën e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë⁹¹³ dhe të cilin Mustafa nuk e ka kundërshtuar si të tillë.

345. Trupi Gjykses konstatoi se, duke u bazuar në konstatimet faktike të veta, ishte "e padiskutueshme"⁹¹⁴ se shkaqet e keqtrajtimit të rëndë dhe refuzimit të ndihmës mjekësore mund t'i "atribuoheshin vetëm" Mustafës dhe vartësve të tij në BIA⁹¹⁵ dhe se këto ishin shkaqe të konsiderueshme të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.⁹¹⁶ Sa i përket shkakut të vrimave të plumbave në trupin viktimës së vrasjes së paligjshme, Trupi Gjykses konstatoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm nëse ato mund t'i atribuoheshin anëtarëve të BIA-s apo forcave serbe.⁹¹⁷ Për këtë arsye dhe duke mbajtur parasysh parimin *in dubio pro reo*, gjatë pjesës së mbetur të analizës të

⁹¹³ Shih p.sh. *Delalić et al.* Trial Judgement, para. 424; *Karadžić* Trial Judgement, para. 446; *Popović et al.* Trial Judgement, para. 788; *Milutinović et al.* Trial Judgement (Vol. I), para. 137; *Brđanin* Trial Judgement, para. 382; *Kupreškić et al.* Trial Judgement, para. 818; *Duch* Trial Judgement, para. 331; *Katanga and Ngudjolo* Confirmation Decision, para. 296; *Brima et al.* Trial Judgement, para. 689.

⁹¹⁴ Aktgjykimi, para. 625.

⁹¹⁵ Aktgjykimi, para. 625.

⁹¹⁶ Aktgjykimi, para. 626.

⁹¹⁷ Aktgjykimi, para. 637.

shkakësisë juridike, Trupi Gjykues duhej të supozonte, dhe faktikisht supozoi, skenarin faktik më të favorshëm për Mustafën – konkretisht se forcat serbe e qëlluan me armë zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme.⁹¹⁸ Duke pranuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe duke pasur parasysh atribuimin e drejtë të përgjegjësive për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykues gjithashtu duhej të trajtonte pyetjen nëse të shtënat me armë zjarri nga forcat serbe përbënin ndërhyrje nga pala e tretë që ndërpreu zinxhirin e shkakësisë, që është pyetja e ngritur në apel.⁹¹⁹

346. Paneli i Apelit vë në dukje në këtë aspekt se, as palët, as Mbrojtësja e Viktimave nuk qenë në gjendje t'i referonin Panelit çështje të ndonjë gjykate apo tribunali ndërkombëtar ku ekzistonte ngjarje e re e krijuar nga një palë e tretë ndërhyrëse e krahasueshme me atë në këtë çështje.⁹²⁰ Rrjedhimisht, nuk duket se jurisprudenca e

⁹¹⁸ Aktgjykimi, para. 637-638.

⁹¹⁹ Për parimin *novus actus interveniens*, në përgjithësi, shih Colvin, E., "Causation in Criminal Law" (1989) 1 *Bond Law Review* 2, f. 266; Simester, A. P. *Fundamentals of Criminal Law: Responsibility, Culpability, and Wrongdoing*, Oxford University Press: Oxford, 2021, f. 112-113, 129.

⁹²⁰ Në parashtrimet e veta, ZPS-ja iu referua dy çështjeve të TPNJ-së si "shembuj të zbatimit të kriterit të shkakut të konsiderueshëm përcaktuar nga dhoma gjyqësore në këtë çështje", duke vënë në dukje se i akuzuari në secilën çështje u shpall fajtor për vrasje të paligjshme si kryes i drejtpërdrejtë për "kontribut të konsiderueshëm, edhe pse kontributet e të tjerëve patën efekt më të drejtpërdrejtë në vdekje". Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 81-82, që i referohet Aktgjykimit të Apelit *Limaj dhe të tjerë*, *Lukić and Lukić Trial Judgement* dhe *Lukić and Lukić Appeal Judgement*. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 146-150. Megjithatë Paneli vë në dukje se këto çështje përfshinin veprimet e personave të tjerë (ushtarë të tjerë që i përkisnin së njëjtës palë) të cilët "bashkërisht" dhe "duke vepruar së bashku" me të akuzuarin morën pjesë në të njëjtën kohë në qëllimin e viktimave me armë zjarri – ndryshe nga çështja aktuale, ku "shkaku tjetër i mundshëm" i vdekjes është veprimi i mëvonshëm, i dallueshëm, i palës së tretë. Gjithashtu, edhe në çështjen *Limaj dhe të tjerët* dhe në çështjen *Llukiq dhe Llukiq*, provat mbështesnin përfundimin se të akuzuarit kishin qëlluar dhe vrarë drejtpërdrejtë së paku një prej viktimave dhe se të akuzuarit ishin gjithashtu të pranishëm dhe/ose të përfshirë në ngjarjet që çuan në të shtënat, përfshirë edhe vetë të shtënat. Duke u bazuar në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të të akuzuarve në të shtënat, dhomat gjyqësore u atribuuan atyre përgjegjësi si kryes të drejtpërdrejtë për vdekjen e të gjitha viktimave, pavarësisht nëse kishin shtënë personalisht plumbin fatal. Shih Aktgjykimin *Limaj dhe të tjerë*, para. 454; Aktgjykimin e Apelit *Limaj dhe të tjerë*, para. 47-50; *Lukić and Lukić Trial Judgement*, para. 908; *Lukić and Lukić Appeal Judgement*, para. 155-162. Sipas mendimit të Panelit, këto rrethana nuk përbëjnë *novus actus* dhe nuk janë të krahasueshme nga pikëpamja faktike me këtë çështje. Në tri çështje të tjera të TPNJ-së të identifikuar nga ZPS-ja, dhomat gjyqësore i shpallën fajtorë të akuzuarit për vrasje të kryera nga një palë e tretë, duke konstatuar se veprimet e të akuzuarve (vendimi për të tërhequr rojet ose për të çarmatosur civilët duke i lënë të ndaluarit dhe civilët të cenueshëm ndaj forcave të tjera paraushtarake) dhe mosveprimet (mosdhënia e ndihmës mjekësore ose

gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë ofron orientim të qartë në lidhje me rrethanat në të cilat një ngjarje e re e krijuar nga një palë e tretë ndërhyrëse ndikon në mënyrë relevante në shkakësinë juridike sipas kriterit të kontributit të konsiderueshëm për kryesin e drejtpërdrejtë. Si pasojë, nuk ka bazë të dukshme prej së cilës të nxirret (nga burime dytësore) a drejta zakonore ndërkombëtare nga jurisprudenca ndërkombëtare në lidhje me këtë aspekt.

347. Sidoqoftë, një vështrim më i kujdesshëm i juridiksioneve kryesore mundëson të kuptohet trajtimi i duhur i situatës ku pala e tretë ndërhyrëse në rrjedhën shkakësore të ngjarjeve. Në juridiksionet e së drejtës anglosaksone ky problem trajtohet nën titullin *novus actus interveniens*. Me fjalë të tjera, gjykatat gjykojnë se zinxhiri i shkakësisë ndërpritet kur, për shembull, ngjarja e re e shkaktuar nga pala e tretë ndërhyrëse është e pavarur nga sjellja e të akuzuarit dhe e tejkalon atë, ose sepse: (i) nuk është “logjikisht e parashikueshme”, apo është e “jashtëzakonshme” (Shtetet e Bashkuara të Amerikës);⁹²¹ ose (ii) “është e vullnetshme, e qëllimshme, dhe me

mosmbrojtja e të ndaluarve) kishin kontribuar konsiderueshëm në vrasjet e mëvonshme. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 83, i referohet *Mrkšić et al. Trial Judgement* dhe *Popović et al. Trial Judgement*; Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 152-153, 156, që i referohet *Mrkšić et al. Trial Judgement*, para. 621; *Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgement*, para. 97; *Popović et al. Trial Judgement*, para. 1988; *Brđanin Trial Judgement*, para. 369. Megjithatë, Paneli vë në dukje se këto çështje nuk janë të krahasueshme, bazuar në faktin se të akuzuarit u shpallën fajtorë për ndihmë dhe inkurajim përmes mosveprimit, sepse kishin ndihmuar dhe i kishin kontribuar qenësishëm vrasjeve të mëvonshme nga kryesit kryesorë, sjellja e të cilëve nuk përbënte *novus actus* në lidhje me ndihmësin dhe inkurajuesin. Në ndryshim nga ato çështje, Trupi Gjykoësues i shpalli fajtor Mustafën si kryes kryesor, si anëtar t] NKP-së, duke konstatuar se sjellja e tij (përfshirë keqtrajtimin e rëndë të viktimës së vrasjes së paligjshme dhe refuzimin e ndihmës mjekësore) përmbushte elementin e veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme, pavarësisht nga konstatimi i mëtejshëm se plaga nga plumbi ishte shkak shtesë i vdekjes që mund të ishte shkaktuar nga pala e tretë (forcat serbe) gjatë një ngjarjeje të re.

⁹²¹ Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veprimet e reja të palës së tretë e lirojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale kur këto veprime “tejkalojnë” sjelljen e të akuzuarit. Shkaku zëvendësues është ngjarje e pavarur që është e parashikueshme dhe “e jashtëzakonshme” (gjithashtu e përshkruar edhe si “anormale” dhe “e papritur”) dhe që shkakton lëndime të llojit dhe shkallës që nuk mund të parashikoheshin logjikisht. Shih p.sh. United States, Supreme Court of California, *People v. Carney*, 532 P.3d 696, 20 July 2023, f. 702; United States, Supreme Court of Washington, *State v. Frahm*, 444 P.3d 595, 11 July 2019, f. 600; United States, Supreme Court of California, *People v. Cervantes*, 29 P.3d 225, 27 August 2001, f. 232-233; United States, Supreme Court of Arizona, *State v. Bass*, 12 P.3d 796, 9 November 2000, f. 801; United States, Supreme Court of Kansas, *State v. Anderson*, 12 P.3d 883, 27 October 2000, f. 889.

vetëdije⁹²² apo “e paarsyeshme ose e jashtme”,⁹²³ duke qenë “aq e pavarur nga veprimet [e të akuzuarit], dhe në vetvete aq e fuqishme në shkaktimin e vdekjes, sa që kontributi i veprimeve të [të akuzuarit], vlerësohet i paqenësishëm⁹²⁴ ose, thënë ndryshe, “aq madhore sa që e bën plagën fillestare thjesht pjesë të historikut”(Angli dhe Uells).⁹²⁵ Në juridiksionet e së drejtës civile, gjykatat mund të gjykojnë se zinxhiri i shkakësisë ndërpritet nga një ngjarje e re e shkaktuar nga pala e tretë ndërhyrëse, kur është, për shembull: (i) “ekstreme” (Itali);⁹²⁶ (ii) “[jashtë] kufijve të së parashikueshmes” dhe përligj “vlerësim të ndryshëm të veprës penale” (Gjermani);⁹²⁷

⁹²² England and Wales, House of Lords, *R v. Kennedy*, [2007] UKHL 38, Report, 17 October 2007, f. 3, ku citohet Hart and Honoré, *Causation in the Law* (2nd edition), Oxford University Press 1985, ch. XII, dhe ku thuhet se “parimi është themelor dhe jo kundërthënës” dhe se “deklarata u citua nga Dhoma [e Lordëve] me miratim” në Angli dhe Uells, House of Lords, *R v. Latif*, [1996] 1 WLR 104, 18 January 1996, f. 10. Shih gjithashtu England and Wales, Court of Appeal, *R v. Pagett*, [1983] WL 215490, 3 February 1983, f. 7, që i referohet “një studimi shumë të njohur e të çmuar me autorë profesorët Hart dhe Honore [...] në Kreun XII”.

⁹²³ England and Wales, Court of Appeal, *R v. Smith*, [1959] 2 QB 35, 25 March 1959, f. 43, ku citohet England and Wales, Court of Appeal, *The Oropesa*, [1943] 1 All ER 211, 17 December 1942.

⁹²⁴ England and Wales, Court of Appeal, *R v. Cheshire*, [1991] 1 WLR 844, 22 April 1991, f. 852.

⁹²⁵ England and Wales, Court of Appeal, *R v. Smith*, [1959] 2 QB 35, 25 March 1959, f. 43 (që citohet edhe në England and Wales, Court of Appeal, *R v. Cheshire*, [1991] 1 WLR 844, 22 April 1991, f. 850).

⁹²⁶ Italy, Supreme Court of Cassation (*Corte suprema di cassazione*), United Sections, *Espenhahn and others*, 38343/14, Judgment, 24 April 2014, f. 105 (“[Shkaku ndërhyrës] është ‘ndërprerës’ [për lidhjen shkakësore] [...] jo sepse është ‘i jashtëzakonshëm’ po sepse është i tepruar krahasuar me rrezikun që duhej trajtuar prej shkakut të parë.” “[Un comportamento sopravvenuto] è ‘interruttivo’ [...] non perché ‘eccezionale’ ma perché eccentrico rispetto al rischio [...] che [il primo agente] è chiamato a governare.”). Italy, Supreme Court of Cassation (*Corte suprema di cassazione*), Section IV, *Dascalu*, 11536/20, Judgment, 7 April 2020, f. 5 (“[...] shkaku ndërhyrës në gjendje të përjashtojë lidhjen shkakësore [...] duhet të shkaktojë rrezik të ri ose, në çdo rast, rrezik tejet ekstrem krahasuar me rrezikun që buron prej shkakut të parë.” “[...] la causa sopravvenuta idonea ad escludere il nesso causale [...] deve inescare un rischio nuovo o comunque radicalmente esorbitante rispetto a quello determinato dall’agente.”). Shih gjithashtu Supreme Court of Cassation (*Corte suprema di cassazione*), Section IV, *Sorrentino and others*, 33329/15, Judgment, 28 July 2015, f. 22 (“Sjellja e paligjshme e palës së tretë nuk përjashton atribuimin e ngjarjes kryesit të parë, e cila mund të ndodhë deri në momentin që, në kuadër të tërë zhvillimit shkakësor që nga sjellja fillestare deri te ngjarja, ndërhyrja e palës së tretë e tejkalon rrezikun fillestar.” “[Il fatto illecito altrui non esclude in radice l’imputazione dell’evento al primo agente, che avrà luogo fino a quando l’intervento del terzo, in relazione all’intero concreto decorso causale dalla condotta iniziale all’evento, non abbia soppiantato il rischio originario.”). Të gjitha përkthimet [në anglishte] në këtë poshtëshënim dhe në poshtëshënimet e mëposhtme janë të Panelit.

⁹²⁷ Germany, Federal Court of Justice (*Bundesgerichtshof*), 2 StR, 204/00, Judgment, 30 August 2000, 2 StR, 204/00, Aktgjykim, 30 gusht 2000, f. 30 (“Veprimet e kryesit të veprës penale mbeten shkakësore edhe nëse pala e tretë që vepron më vonë kontribuon qëllimshëm në arritjen e të njëjtit rezultat përmes një veprimi që synon të njëjtën pasojë, me kusht që ai të lidhet me veprimet e kryesit, d.m.th. këto të fundit

(iii) “krejtësisht e paparashikueshme dhe anormale” (Portugali);⁹²⁸ (iv) shkak i drejtpërdrejtë i vdekjes së viktimës⁹²⁹ dhe jo pjesë e një skene të vetme të dhunës (*scène unique de violence*) (Francë);⁹³⁰ (v) “krejtësisht anormale, e paparashikueshme dhe e

janë kusht për ndërhyrjen e vet. [...] Shmangiet nga rrjedha shkakësore e imagjinuar janë juridikisht të paqenësishme në qoftë se mbeten brenda kufijve të asaj që ishte e parashikueshme sipas përvojës së përgjithshme jetësore dhe nuk përlligjin vlerësim të ndryshëm të veprës penale.” [“Ursächlich bleibt das Täterhandeln selbst dann, wenn ein später handelnder Dritter durch ein auf denselben Erfolg gerichtetes Tun vorsätzlich zu dessen Herbeiführung beiträgt, sofern er nur dabei an das Handeln des Täters anknüpft, dieses also die Bedingung seines eigenen Eingreifens ist. [...] Abweichungen vom vorgestellten Kausalverlauf sind jedoch rechtlich bedeutungslos, wenn sie sich innerhalb der Grenzen des nach allgemeiner Lebenserfahrung Voraussehbaren halten und keine andere Bewertung der Tat rechtfertigen.”].

⁹²⁸ Portugal, Supreme Court of Justice (*Supremo Tribunal de Justiça*), Section V, 2275/15.1JAPRT.P2.S1, Judgment, 9 July 2020 (“[...] ‘sipas teorive të ndërprerjes së lidhjes shkakësore, kërkohet që rezultati të ndodhë në mënyrë krejtësisht të paparashikueshme dhe anormale në lidhje me sjelljen e të pandehurit.’” [“As teorias da interrupção do nexo de causalidade determinariam que o resultado morte acontecesse de modo totalmente imprevisível e anómalo face à conduta do arguido.”]). Shih gjithashtu Portugal, Coimbra Court of Appeals (*Tribunal da Relação de Coimbra*), Criminal Section V, 174/13.0GAVZL.C1, Judgment, 7 October 2015 (“[Për të ndërprerë lidhjen shkakësore, ngjarja e re duhet të jetë rrethanë plotësisht anormale dhe e paparashikueshme.” [“[...] uma circunstância completamente anómala e imprevisível, por forma a sustentar a interrupção do nexo causal.”]).

⁹²⁹ France, Court of Cassation (*Cour de Cassation*), Criminal Chamber, 19-84.315, 1 October 2019, para. 11-13 (“[...] vdekja [e viktimës] nuk është rezultat i shkakut jashtë dhunës që ai pranon se e kreu në kohën që i parapriu vdekjes [së viktimës] [...]. Vdekja e saj është pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj dhune, që ndodhi në kontekstin e mëhershëm të një presioni të vazhdueshëm të kryer me armë, në këtë rast thikë, dhe shoqëruar me veprime që synonin të mos e linin gruan e re të ikte, që rezultoi në përpjekjen e saj të dëshpëruar dhe vdekjeprurëse për t’i ikur agresorit të saj.” [“[...] le décès d’R... T... ne serait pas dû à une cause extérieure aux violences qu’il reconnaît avoir commises sur cette dernière dans les instants ayant précédé ce décès [...], ce décès en serait la conséquence directe, ces violences inscrites dans un contexte antérieur de pressions permanentes, exercées avec une arme, en l’occurrence un couteau, et accompagnées de manœuvres destinées à couper court à toute fuite de la jeune femme ayant eu pour conséquence le choix d’une tentative désespérée et qui fut fatale à l’intéressée d’échapper à l’emprise de son agresseur.”]). Shih gjithashtu France, Court of Cassation (*Cour de Cassation*), Criminal Chamber, 02-83.329, 7 January 2003 (“Është e pakundërshtueshme se rrëmbimi i viktimës [...] dhe dhuna e kryer nga i akuzuari janë arsyeja e tentimit për arratisje nga pala civile, e cila iu dorëzua këtij impulsi për t’i ikur sjelljes së dhunshme [të akuzuarit], dhe se dhuna që u ushtrua brenda apartamentit dhe vazhdoi në ballkon – ngaqë i akuzuari donte ta ndalonte viktimën të ikte – ishte e vullnetshme dhe ishte shkak i drejtpërdrejtë i lëndimeve të shkaktuara nga rënia nga ballkoni.” [“[L]a séquestration dont Muriel Y... a été victime et les violences exercées par le prévenu sont incontestablement à l’origine de la tentative de fuite de la partie civile qui a cédé à cette pulsion pour échapper au comportement violent de Patrick X..., que les violences commises à l’intérieur de l’appartement et poursuivies sur le balcon - le prévenu voulant empêcher la victime de s’enfuir - ont un caractère volontaire et sont directement à l’origine des blessures occasionnées par la chute au balcon.”]).

⁹³⁰ Shih France, Court of Cassation (*Cour de Cassation*), Criminal Chamber, 21-82.958, 23 March 2022, para. 24 (“kur dhuna kryhet në mënyrë të vullnetshme dhe të njëkohshme, me synim vrasës, nga disa të akuzuar gjatë një skene të vetme, vepra penale mund të vlerësohet në tërësi, pa qenë e domosdoshme që gjykatësit të saktësojnë llojin e dhunës së kryer nga secili i akuzuar kundër secilës viktimë.”

huaj për sjelljen e të pandehurit [...] [dhe jo] brenda të njëjtës sferë të rrezikut të krijuar ose të shtuar nga sjellja e vetë të pandehurit” (Spanjë);⁹³¹ ose (vi) “autonome” dhe “krijon marrëdhënien e vet shkakësore” (Argjentinë).⁹³² Rrjedhimisht, Paneli përmbledh në vijim konceptet kyçe të nxjerra nga ky shqyrtim i shkurtër i qasjes në juridiksione të ndryshme si vijon: për të pasur pasoja për zinxhirin e shkakësisë të nisur nga sjellja fillestare, ngjarja e re ndërhyrëse nuk duhet të jetë e parashikueshme,

[“[L]orsque des violences ont été exercées volontairement et simultanément, dans une intention homicide, par plusieurs accusés, au cours d’une scène unique, l’infraction peut être appréciée dans son ensemble, sans qu’il soit nécessaire pour les juges du fond de préciser la nature des violences exercées par chacun des accusés sur chacune des victimes.”]; France, Court of Cassation (*Cour de Cassation*), Criminal Chamber, 21-90.043, 16 February 2022, para. 6-8 (“Shpallja fajtor e të pandehurit për dhunë, në zbatim të [jurisprudencës *scène unique de violence*], nënkupton konstatimin, nga ana e gjykatësve [...] se ai mori pjesë personalisht në dhunën e pandashme të shkaktuar nga disa kryes. [...] Kjo jurisprudencë e bën të mundshëm ndëshkimin e dhunës, duke mos lejuar që një pjesëmarrës të fshihet pas pjesëmarrjes së të tjerëve për të përjashtuar pasojat për veten.” [“La déclaration de culpabilité d’un prévenu pour violences, en application de cette jurisprudence [à propos des scènes uniques de violences], implique la constatation, par les juges du fond, [...] qu’il a pris une part personnelle aux violences indivisibles causées par plusieurs auteurs. [...] [C]ette jurisprudence permet de réprimer des violences sans qu’un de leurs auteurs s’abrite derrière la participation des autres pour s’exonérer des conséquences de la sienne propre.”]). Paneli vëren se në Francë ka një farë mospërputhjeje në mënyrën se si janë trajtuar nga jurisprudenca ndërprerjet në zinxhirin e shkakësisë. Shih Mayaud, Y., Répertoire de droit pénal et de procédure pénale, Violences volontaires, Dalloz, 2023, para. 59-61.

⁹³¹ Spain, Supreme Court (*Tribunal Supremo*), Chamber II – Criminal, 266/2006, Judgment, 7 March 2006, Section (2) of the Third Legal Basis (“[...] Kur ndodhin rrjedha shkakësore komplekse, me fjalë të tjera, kur sjellja e të akuzuarit dhe një ose më shumë shkaqe të tjera – që mund t’i atribuohen një personi tjetër apo një ngjarjeje të rastësishme – i kontribuojnë një rezultati tipik, zakonisht vlerësohet se [...] në qoftë se ndodh [pas sjelljes së të akuzuarit], ky atribuim mund të mos bëhet kur shkaku ndërhyrës është krejtësisht anormal, i paparashikueshëm dhe sjellje e huaj për të akuzuarin [...] por jo në ato raste ku ngjarja e mëvonshme është brenda së njëjtës sferë të rrezikut të krijuar apo të shtuar nga vetë i akuzuari me sjelljen e tij.” [“[...] Cuando se producen cursos causales complejos, esto es, cuando contribuyen a un resultado típico la conducta del acusado y además otra u otras causas atribuibles a persona distinta o a un suceso fortuito, suele estimarse que, [si es posterior a la conducta del acusado], puede impedir tal imputación cuando esta causa sobrevenida sea algo totalmente anómalo, imprevisible y extraño al comportamiento del inculpado [...] pero no en aquellos supuestos en que el suceso posterior se encuentra dentro de la misma esfera del riesgo creado o aumentado por el propio acusado con su comportamiento.”]).

⁹³² Argentina, Federal Criminal Court of Cassation (*Camara Federal de Casacion Penal*), Chamber III, 786/2013, *Lizarraga, Luis Miguel et al s/*, Judgment, 17 November 2014, f. 21 (“[...] që vdekja si rezultat të mos mund t’i atribuohet [kryesit të parë], do të ishte e domosdoshme që lëndimet që çuan në [vdekjen e viktimës] të shkaktohen nga një ngjarje autonome që krijon marrëdhënien e vet shkakësore, të pavarur nga sjellja e të pandehurit [...]” [“[...] para que el resultado muerte no sea imputable [al primer autor] sería necesario que las lesiones que llevaron al deceso [de la víctima] reconozcan por causa un acontecimiento autónomo que genere su propia relación causal, independiente de la conducta llevada a cabo por los encausados [...]”]).

ose nuk duhet të jetë pjesë e sferës fillestare të rrezikut që i përket të akuzuarit dhe duhet të krijojë rrezik krejtësisht të ri që është aq i fuqishëm sa që ta bëjë rrezikun fillestar të paqenësishëm.

348. Megjithëse do të kishte qenë mirë që Trupi Gjykses të kishte pranuar drejtpërdrejt dhe të përcaktonte metodologjinë e vet për vlerësimin e ngjarjes së re të shkaktuar nga pala e tretë në lidhje me kriterin e kontributit të konsiderueshëm, Paneli i Apelit sidoqoftë mendon se Trupi Gjykses e ka trajtuar këtë aspekt, së paku në mënyrë të tërthortë, duke ardhur në përfundim:

[E]dhe nëse të shtënat me armë do t'u atribuoheshin vetëm forcave serbe, [...] kjo nuk do ta lironte të akuzuarin nga përgjegjësia, [sepse] [...] qëllimi i drejtpërdrejtë i viktimës së vrasjes së paligjshme me armë zjarri ose lënia e tij në një situatë që mund të qëllohej nga forcat serbe që po afroreshin [...] çon saktësisht në të njëjtin përfundim, pra që lidhja shkakësore që kërkohet ndërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të të akuzuarit dhe vdekjes së viktimës, mbetet e pandryshuar.⁹³³

Për më tepër, duke zbatuar thelbin e standardeve të përmendura më lart për *novus actus interveniens*, Paneli i Apelit vëren se konstatimet e Trupi Gjykses mbështesin përfundimin se rreziku që paraqisnin forcat serbe për jetën e viktimës së vrasjes së paligjshme ishte *i parashikueshëm*. Trupi Gjykses konstatoi se Mustafa shkoi personalisht në Zllash më 20 deri 21 prill 1999, ose rreth këtyre datave, për të evakuuar personat e plagosur “për shkak të një ndryshimi kritik të rrethanave — ofensivës serbe”.⁹³⁴ Me fjalë të tjera, Mustafa e dinte se forcat serbe po afroreshin dhe u shqetësua aq sa e largoi personelin e vet nga rreziku. Konstatimet e Trupit Gjykses gjithashtu mbështesin përfundimin se rreziku që paraqisnin forcat serbe për jetën e viktimës së vrasjes së paligjshme ishte *pjesë e sferës fillestare të rrezikut* që buronte nga sjellja e Mustafës. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses konstatoi se në kontekst të dijenisë së tij për forcat serbe që po afroreshin, vendimi i Mustafës për mos ta liruar apo

⁹³³ Aktgjykimi, para. 638.

⁹³⁴ Aktgjykimi, para. 254, 634, 658.

evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme – që ishte “gati i vdekur” kur u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë – “i hoqi viktimës së vrasjes së paligjshme çdo mundësi për të mbetur gjallë”.⁹³⁵ Së fundi, konstatimet e Trupit Gjykses mbështesin përfundimin se rreziku që paraqisnin forcat serbe që po afroreshin për jetën e viktimës së vrasjes së paligjshme nuk ishte aq i fuqishëm sa ta bënte rrezikun fillestar të paqenësishëm. Trupi Gjykses konstatoi në lidhje me këtë se “nëse i akuzuari dhe vartësit e tij të BIA-s do ta kishin ndaluar një keqtrajtim të tillë të skajshëm, ose do t’i kishin dhënë ndihmë mjekësore viktimës së vrasjes së paligjshme, ai nuk do të kishte vdekur”.⁹³⁶

349. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se, edhe pse Trupi Gjykses nuk trajtoi shprehimisht parimin *novus actus interveniens*, Mustafa nuk ka arritur të provojë se asnjë trup gjykses i arsyeshëm nuk do të kishte konstatuar se Mustafa përmbushi kriterin e veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e hedh poshtë këtë argument.

350. Duke iu kthyer argumentit të Mustafës se mund të ekzistojë vetëm një shkak i vdekjes, Paneli i Apelit gjykon se Mustafa duket se ngatërron shkakun mjekësor të vdekjes me shkakësinë juridike. Paneli është i mendimit se, duke u bazuar në parimin e vlerësimit të lirë të provave, nuk është e domosdoshme që një trup gjykses të bindet jashtë dyshimit të arsyeshëm për shkakun mjekësor të vdekjes (dhe as që të gjendet kufoma e viktimës).⁹³⁷ Sa i përket shkakësisë juridike, mund të ketë, dhe shpesh ka, më shumë se një shkak që çon në rezultat të dëmshëm dhe më shumë se një person të

⁹³⁵ Aktgjykimi, para. 571, 625, 635-636.

⁹³⁶ Aktgjykimi, para. 626.

⁹³⁷ Shih rregullat 137(2), 139(2), 140(3) dhe 158(3) të Rregullores. Lidhur me mungesën e kriterit lidhur me gjetjen e kufomës së vrasjes së paligjshme shih *Lukić and Lukić Appeal Judgement*, para. 149; *Martić Trial Judgement*, para. 59

cilit ligji ia atribuon atë rezultat.⁹³⁸ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e hedh poshtë këtë argument.

351. Sa i përket argumentit të Mustafës se vdekja për shkak të keqtrajtimit ose refuzimit të ndihmës mjekësore nuk përbën “vepër penale të vrasjes së paligjshme”, Paneli i Apelit vë në dukje se në jurisprudencën e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë është pranuar gjerësisht se edhe veprimet edhe mosveprimet që rezultojnë në vdekjen e një personi mund të cilësohen si vrasje e paligjshme.⁹³⁹ Keqtrajtimi dhe refuzimi i ndihmës mjekësore nuk dallojnë nga çfarëdo veprimi apo mosveprimi tjetër. Ajo që kërkohet është që sjellja e kryesit të kontribuojë konsiderueshëm në vdekjen e viktimës,⁹⁴⁰ pa ekzistencën e një ngjarjeje ndërhyrëse që tejkalon këtë kontribut shkakësor të konsiderueshëm. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e hedh poshtë këtë argument.

352. Sa i përket argumentit të Mustafës se ZPS-ja nuk kërkoi autorizim dhe Trupi Gjykses nuk ushtroi kompetencën që të autorizonte – në përputhje me rregullën 40 të Rregullores – zhvarrosjen dhe autopsinë në varrin që besohej se ishte i viktimës së vrasjes së paligjshme, Paneli i Apelit vëren se Mustafa e paraqet këtë argument për herë të parë në apel, megjithëse kishte mundësi të shumta ta paraqiste në shkallën e parë.⁹⁴¹ Për këtë arsye, Paneli i Apelit gjykon se Mustafa ka humbur të drejtën për të

⁹³⁸ Shih p.sh. *Karadžić* Trial Judgement, para. 446; *Lukić and Lukić* Trial Judgement, para. 903; Aktgjykimin *Milutinović dhe të tjerë* (Vëll. I), para. 137.

⁹³⁹ Shih p.sh. *Kvočka et al.* Appeal Judgement, para. 261; Aktgjykimi *Milutinović dhe të tjerë*. (Vëll. I), para. 137; *Krstić* Trial Judgement, para. 485; *Katanga* Trial Judgment, para. 786; *Duch* Trial Judgement, para. 331; *Brima et al.* Trial Judgement, para. 688-689. Paneli i Apelit vë në dukje, si shembull të fakteve të ngjashme, se një dhomë gjyqësore në ECCC [Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias] shpalli një të akuzuar fajtor për vrasje të qëllimshme si shkelje e rëndë, me arsyetimin se të ndaluarit vdiqën në një qendër ndalimi “si rezultat i mosveprimeve që dihej se me gjasë mund të rezultonin në vdekje, si edhe si pasojë e kushteve të mbajtjes së tyre në ndalim”. *Duch* Trial Judgement, para. 437.

⁹⁴⁰ Shih më lart, para. 344. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 686-687.

⁹⁴¹ Vlen të theksohet se Mustafa nuk e paraqiti këtë argument para fillimit të gjyimit, kur ZPS-ja iu përgjigj kërkesës së Trupit Gjykses për informacion nëse ishte kryer ekzaminim mjekoligjor i kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme. Shih Përgjigjen e ZPS-së ndaj Kërkesës për Parashtrime, para. 12-14.

kundërshtuar këtë aspekt në apel.⁹⁴² Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e hedh poshtë këtë argument.

353. Sa i përket argumentit të Mustafës që pretendon gabim në lidhje me shkakun e vdekjes, Paneli i Apelit hedh poshtë pretendimin e Mustafës se Trupi Gjykses bëri gabim që u mbështet në dëshmitë e personave që nuk janë ekspertë, sepse ai nuk ka artikuluar asnjë bazë ligjore për gabimin e pretenduar.⁹⁴³ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë këtë argument të pabazuar. Gjithashtu, Mustafa parashtron se disa prova konfirmojnë njëra-tjetrën se në kufomën e viktimës së vrasjes së paligjshme u konstatua një vrimë hyrëse plumbi.⁹⁴⁴ Megjithatë, Mustafa nuk shpjegon relevancën e përcaktimit të numrit të vrimave hyrëse në trup.⁹⁴⁵ Në këtë aspekt, Paneli i Apelit vëren se shpallja fajtor e Mustafës për krimin e luftës së vrasjes së paligjshme nuk u bazua në faktin nëse vrima e plumbit iu atribuua atij apo vartësve në BIA, pasi Trupi Gjykses konstatoi se ekziston dyshim i arsyeshëm në lidhje me këtë atribuim. Përkundrazi, fajësia u bazua në atribuimin e keqtrajtimit të rëndë të viktimës së vrasjes së paligjshme dhe refuzimit të ndihmës mjekësore.⁹⁴⁶ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Mustafës në këtë aspekt.⁹⁴⁷

354. Paneli tani shqyrton argumentin e Mustafës se, për të shmangur “shkeljen e dispozitave të procedurës penale”, konstatimi në lidhje me kohën e vdekjes ishte “i domosdoshëm”⁹⁴⁸ dhe “më se i nevojshëm”.⁹⁴⁹ Në këtë aspekt, Paneli vë në dukje se

⁹⁴² Shih më lart, para. 30.

⁹⁴³ Dosja e Apelit, para. 330.

⁹⁴⁴ Dosja e Apelit, para. 331, që i referohet [REDAKTUAR] dhe dëshmisë së [REDAKTUAR].

⁹⁴⁵ Dosja e Apelit, para. 331.

⁹⁴⁶ Shih më lart, para. 327, që i referohet, ndër të tjera, Aktgjykimit, para. 637. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 638, 689.

⁹⁴⁷ Paneli i Apelit vë në dukje argumentin e Mustafës se, meqenëse shkakun e vdekjes nuk u provua, synimi për të vlarë nuk mund t'i atribuohet atij. Shih Dosjen e Apelit, para. 374. Duke qenë se Paneli i Apelit i ka hedhur poshtë të gjitha argumentet e Mustafës ku pretendon se Trupi Gjykses bëri gabim në lidhje me konstatimet për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, ky argument lidhur me konstatimet e Trupit Gjykses për synimin është i tejkualuar dhe nuk do të shqyrtohet.

⁹⁴⁸ Dosja e Apelit, para. 340.

⁹⁴⁹ Dosja e Apelit, para. 334-335.

koha e përfaqësuesit të vdekjes ishte fakt material i paraqitur në Aktakuzë, konkretisht, ZPS-ja pretendoi se Mustafa mbante përgjegjësi penale individuale për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme përfaqësuesit midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.⁹⁵⁰ Trupi Gjyqësor konstatoi se: (i) viktimat e vrasjes së paligjshme ishin parë gjallë për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash, në gjendje në prag të vdekjes, më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date,⁹⁵¹ kur i ishte refuzuar ndihma mjekësore pasi kishte pësuar keqtrajtim të skajshëm nga anëtarë të BIA-s për rreth [REDAKTUAR] ditë në ndalim, përfshirë me një objekt potencialisht vdekjeprurës;⁹⁵² (ii) viktimat e vrasjes së paligjshme nuk u liruan nga kompleksi i ndalimit në Zllash më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date kur u liruan të ndaluarit e tjerë;⁹⁵³ (iii) në një kohë të mëvonshme, para se disa anëtarë të BIA-s të ktheheshin në Zllash, më 20 deri 21 prill 1999 ose rreth këtyre datave,⁹⁵⁴ forcat serbe granatuan dhe qëlluan me armë zjarri kompleksin e ndalimit në Zllash, së paku nga distanca, duke i shkaktuar dëmtim infrastrukturës;⁹⁵⁵ dhe (iv) viktimat e vrasjes së paligjshme u gjetën të vdekur afërsisht më 3 deri 6 korrik 1999, i varrosur [REDAKTUAR].⁹⁵⁶ Në bazë të këtyre konstatimeve, Trupi Gjyqësor erdhi në përfundimin se viktimat e vrasjes së paligjshme vdiqën midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, ose rreth këtyre datave.⁹⁵⁷ Paneli i Apelit gjykon se, varësisht nga faktet e çështjes, përcaktimi i saktë i kohës së vdekjes mund të jetë i domosdoshëm për t'i atribuuar përgjegjësi një të akuzuari. Megjithatë, në këtë çështje, përcaktimi më i saktë i kohës së vdekjes nuk ishte i domosdoshëm për këtë qëllim. Mustafa nuk demonstroi se pse kjo duhej të ishte e domosdoshme dhe se asnjë trup gjyqësor i arsyeshëm nuk do të mund të konstatonte se sjellja e Mustafës nuk

⁹⁵⁰ Aktakuza, para. 35.

⁹⁵¹ Aktgjykimi, para. 625.

⁹⁵² Aktgjykimi, para. 626, 635. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 521-522, 569-574, 584-588.

⁹⁵³ Aktgjykimi, para. 477-481, 589, 636.

⁹⁵⁴ Aktgjykimi, para. 634.

⁹⁵⁵ Aktgjykimi, para. 633.

⁹⁵⁶ Aktgjykimi, para. 611, 618.

⁹⁵⁷ Aktgjykimi, para. 639.

përmbushte elementin e veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme në mungesë të një konstatimi të tillë. Rrjedhimisht, Paneli e hedh poshtë këtë argument.

355. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që konstatoi se sjellja e Mustafës përmbush elementin e veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit hedh poshtë argumentet e Mustafës që pretendojnë gabim juridik në Pikat 3 dhe 4 të Apelit.

(b) Pretendimet për gabime faktike në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses për veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme

(i) Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

356. Sa u përket gabimeve faktike, Mustafa së pari pretendon se, në kundërshtim me konstatimet e Trupit Gjykses, ishte e arsyeshme të deduktohej se viktimja e vrasjes së paligjshme vdiq vetëm si rezultat i plagës (plagëve) me armë zjarri.⁹⁵⁸ Për këtë qëllim, ai parashtron se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se keqtrajtimi në kompleksin e ndalimit në Zllash para 19 prillit 1999 ishte shkak i konsiderueshëm i vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.⁹⁵⁹ Në mbështetje të kësaj, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses nuk e vërtetoi “pa mëdyshje” faktin se viktimja e vrasjes së paligjshme nuk ishte në gjendje të lëvizte kur ishin liruar të ndaluarit e tjerë.⁹⁶⁰

357. Së dyti, Mustafa pretendon se, në kundërshtim me konstatimet e Trupit Gjykses, ekzistojnë gjasa të arsyeshme që viktimja e vrasjes së paligjshme të ketë vdekur “pas periudhës që mbulon Aktakuza”.⁹⁶¹

⁹⁵⁸ Njoftimi për Apel, nënpika 4B, para. 7; Dosja e Apelit, para. 354. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 367.

⁹⁵⁹ Njoftimi për Apel, nënpika 4A, para. 7. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 342-344, 347; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 89.

⁹⁶⁰ Dosja e Apelit, para. 343. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 342.

⁹⁶¹ Dosja e Apelit, para. 336-339; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 47-50, 55-56.

358. Së treti, Mustafa pretendon se Trupi Gjykses bëri gabim sepse nuk kishte prova se viktima e vrasjes së paligjshme: (i) vdiq nga keqtrajtimi nga anëtarë të BIA-s;⁹⁶² (ii) vdiq nga refuzimi i ndihmës mjekësore nga anëtarë të BIA-s;⁹⁶³ (iii) nuk u evakuua;⁹⁶⁴ ose (iv) u qëllua me plumba.⁹⁶⁵

359. Së katërti, Mustafa pretendon se Trupi Gjykses bëri gabim sepse nuk kishte prova, ose kishte prova të pamjaftueshme, për të mbështetur konstatimin e Trupit Gjykses se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të tij.⁹⁶⁶ Ai paraqet dy argumente për këtë qëllim. Mustafa së pari pretendon se Trupi Gjykses erdhi në përfundim të gabuar se, në cilësinë e tij si komandant i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, ai ishte përgjegjës për vendimin për të mos e liruar ose evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme.⁹⁶⁷ Në mbështetje të këtij argumenti, ai parashtron se vendimi për të mos liruar viktimën e vrasjes së paligjshme ishte marrë nga z. Mehmetaj “me nofkën Bimi” dhe se midis Mustafës dhe “Bimit” nuk ekzistonte më marrëdhënie epror-vartës.⁹⁶⁸ Përkundrazi, Mustafa pretendon se në atë kohë zëvendëskomandant ishte z. Isa Kastrati.⁹⁶⁹ Gjithashtu, Mustafa parashtron se nuk ka prova se ai kishte vendosur që viktima e vrasjes së paligjshme nuk duhej të evakuohej.⁹⁷⁰ Së dyti, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses gaboi që nxori përfundimin se të shtënat e pretenduara me armë zjarri mund

⁹⁶² Dosja e Apelit, para. 347. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 344-345, 367.

⁹⁶³ Dosja e Apelit, para. 347. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 344-345, 352-353, 367.

⁹⁶⁴ Dosja e Apelit, para. 357; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 52-54. Paneli vë në dukje se Mustafa nuk faktonte këtë argument në Dosjen e Apelit ose në Dosjen e Kundërpërgjigjes. Gjatë seancës së apelit, ai shtjelloi shkurtimisht atë. Sidoqoftë, Paneli i Apelit nuk do ta trajtojë këtë argument i cili u paraqit vetëm në fazën e vonë të seancës së apelit. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 367.

⁹⁶⁵ Dosja e Apelit, para. 346. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 355, 367.

⁹⁶⁶ Njoftimi për Apel, nënpika 4D, para. 7; Dosja e Apelit, para. 347-351, 356-357, 363-366; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 95, 132; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 53-54. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 367.

⁹⁶⁷ Dosja e Apelit, para. 363-364; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 53-54.

⁹⁶⁸ Dosja e Apelit, para. 364-365, 373; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 53-54.

⁹⁶⁹ Dosja e Apelit, para. 364-365.

⁹⁷⁰ Dosja e Apelit, para. 357, 366; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 35. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 363.

t'i atribuoheshin atij ose vartësve të tij, kur nuk kishte prova në mbështetje të këtij konstatimi.⁹⁷¹

360. ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk ofron asgjë në mbështetje të argumentit të tij se ishte deduksion i arsyeshëm që viktima e vrasjes së paligjshme vdiq vetëm si rezultat i plagës (plagëve) me armë zjarri, përtej pretendimit të tij të përgjithshëm se Trupi Gjykses nuk vërtetoi “pa mëdyshje” konstatimin se viktima e vrasjes së paligjshme nuk ishte në gjendje të lëvizte.⁹⁷²

361. ZPS-ja më tej përgjigjet se argumenti i Mustafës me të cilin pretendon konkretisht se koha e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme mund të ketë qenë pas periudhës së Aktakuzës është faktikisht i pabazuar dhe bie në kundërshtim me provat në të cilat u bazua Trupi Gjykses.⁹⁷³

362. Sa i përket argumentit të Mustafës se disa konstatime të Trupit Gjykses nuk mbështeten në asnjë provë, ZPS-ja përgjigjet se ky parashtrim bazohet në supozimin e gabuar se vendimi i fajësisë nuk mund të mbështetet në prova rrethore.⁹⁷⁴ ZPS-ja shton se Trupi Gjykses deklaroi qartë se disa konstatime i kishte deduktuar dhe se Mustafa thjesht nuk pajtohet me këto konstatime, duke mos artikuluar asnjë gabim.⁹⁷⁵ Sa i përket pretendimit konkret të Mustafës se nuk kishte prova se viktima e vrasjes së paligjshme nuk ishte evakuuar prej kompleksit të ndalimit në Zllash, ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses deklaroi qartë se kishte ardhur deri te ky konstatim duke u mbështetur në prova rrethore, përfshirë: (i) dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W03594-ës; (ii) provat se Mustafa kishte komandën në kompleksin e ndalimit në Zllash; dhe (iii) pranimin prej tij të rolit që luajti në evakuimin e të plagosurve.⁹⁷⁶ Sa i

⁹⁷¹ Dosja e Apelit, para. 348; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 31-32. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 351.

⁹⁷² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 134, 136-137.

⁹⁷³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 130-132; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 98. [REDAKTUAR].

⁹⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 138.

⁹⁷⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 138.

⁹⁷⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 138.

përket pretendimit tjetër të Mustafës se nuk ka prova që mbështesin konstatimin se viktimja e vrasjes së paligjshme ishte qëlluar me plumba, ZPS-ja përgjigjet se, siç është e qartë nga referenca e vetë Mustafës në Aktgjykim, ky konstatim bazohet në dëshmitë e disa dëshmitarëve të cilët e zhvarrosën kufomën e viktimës së vrasjes së paligjshme disa muaj pas vdekjes dhe i panë vetë vrimat në kufomën e tij.⁹⁷⁷

363. Sa i përket argumentit të Mustafës se nuk ka prova, ose se ka prova të pamjaftueshme, që viktimja e vrasjes së paligjshme vdiq si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tij, ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses shpjegoi në mënyrë të qartë dhe shteruese bazën e fortë provuese të konstatimeve të veta në lidhje me përgjegjësinë e Mustafës për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, dhe se një gabim i pretenduar lidhur me pozitën zyrtare të një ushtari të UÇK-së nuk i zhvlerëson ato.⁹⁷⁸ Për këtë qëllim, ZPS-ja parashtron se në prill 1999, z. Mehmetaj ende ishte anëtar i BIA-s, dhe rrjedhimisht vartës i Mustafës, edhe kur kryente funksione nga distanca për komandën e Zonës Operative të Llapit.⁹⁷⁹ Për më tepër, ZPS-ja përgjigjet se konstatimi i Trupit Gjykses në lidhje me përgjegjësinë e Mustafës për vendimin për të mos liruar viktimën e vrasjes së paligjshme u bazua në “provat në tërësi”, përfshirë, midis të tjerash, rolin e Mustafës si komandant i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe përgjegjësinë e tij për evakuimin e të plagosurve prej Zllashit.⁹⁸⁰

364. Sa i përket argumentit të Mustafës se nuk ka prova për t’ia atribuuar atij të shtënë me armë, ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses mori parasysh edhe mundësinë që anëtarë të BIA-s e qëlluan me plumba viktimën e vrasjes së paligjshme para se të largoheshin prej kompleksit të ndalimit në Zllash, edhe atë që plagët nga armë zjarri

⁹⁷⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 134.

⁹⁷⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 177-178. Në lidhje me refuzimin e ndihmës mjekësore, ZPS-ja shton se Trupi Gjykses konstatoi se trajtimi mjekësor ishte përgjithësisht i disponueshëm në kompleksin e ndalimit në Zllash. Transkripti, 26 tetor 2023, f. 99.

⁹⁷⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 178.

⁹⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 178.

u shkaktuan nga forcat serbe.⁹⁸¹ ZPS-ja parashtron se, duke u mbështetur në konstatimet faktike të bazuara mirë, Trupi Gjykses erdhi në përfundimin se, edhe në skenarin e dytë, veprimet dhe mosveprimet e Mustafës dhe të anëtarëve të BIA-s kontribuuan konsiderueshëm në vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme duke e vënë në një situatë ku nuk ishte në gjendje t'i ikte ofensivës ushtarake serbe.⁹⁸² Sipas ZPS-së, Paneli i Apelit duhet ta zëvendësojë përfundimin e Trupit Gjykses me të vetin vetëm në qoftë se përfundimi i Trupit Gjykses është tërësisht i gabuar ose asnjë gjykses i arsyeshëm i fakteve nuk do të arrinte në atë përfundim.⁹⁸³ Për më tepër, ZPS-ja përgjigjet se çdo shqyrtim i tillë duhet të bëhet në kontekst të dy fakteve të vërtetuara qartë nga ana e Trupit Gjykses, konkretisht se: (i) Mustafa synonte të vriste viktimën e vrasjes së paligjshme; dhe (ii) po të mos ishin veprimet dhe mosveprimet e Mustafës (dhe të vartësve të tij), viktima e vrasjes së paligjshme do të ishte gjallë.⁹⁸⁴

365. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se Trupi Gjykses vlerësoi tërësinë e provave në dispozicion për të faktuar konstatimet e veta në lidhje me lëndimet e viktimës së vrasjes së paligjshme.⁹⁸⁵ Mbrojtësja e Viktimave shton se Mustafa shtrembëron qëllimin e procedurës së apelit kur pretendon se provat në tërësi ishin vlerësuar gabim.⁹⁸⁶

366. Mustafa kundërpërgjigjet se parashtrimet e ZPS-së përmbajnë supozime e jo pohime të bazuara në prova dhe se këto janë të njëjtat supozime të bëra nga Trupi Gjykses.⁹⁸⁷

⁹⁸¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 141.

⁹⁸² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 141-142, 144; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 105-106. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 88-89.

⁹⁸³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 144. Shih gjithashtu Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 99.

⁹⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 144. ZPS-ja jep shembuj nga jurisprudenca e tribunalëve ndërkombëtarë, që, sipas saj, shërbejnë si orientim në lidhje me zbatimin e standardit të kontributit të konsiderueshëm si një element i krimin të luftës së vrasjes së paligjshme. Shih Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 145-160.

⁹⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 76.

⁹⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 80.

⁹⁸⁷ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 139-142, 156.

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

367. Sa u përket pretendimeve të Mustafës për gabime faktike,⁹⁸⁸ Paneli i Apelit rikujton konstatimin e Trupit Gjykues se keqtrajtimi i rëndë që pësoi viktimja e vrasjes së paligjshme nga anëtarët e BIA-s që e mbajtën të ndaluar, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, si dhe refuzimi i ndihmës mjekësore nga këta anëtarë të BIA-s, ishin shkaqe të konsiderueshme të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.⁹⁸⁹ Për të arritur në këtë konstatim, Trupi Gjykues “e gjykoi të rëndësishme”⁹⁹⁰ se, kur viktimja e vrasjes së paligjshme u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë, pasi kishte pësuar keqtrajtim të rëndë çdo ditë për gati tri javë, ai ishte pothuaj i vdekur dhe nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë apo të ecte.⁹⁹¹

368. Paneli i Apelit kupton se argumenti i Mustafës se Trupi Gjykues duhej të vërtetonte “pa mëdyshje” se viktimja e vrasjes së paligjshme nuk ishte në gjendje të lëvizte, do të thotë se kjo duhej të vërtetohej jashtë dyshimit të arsyeshëm.⁹⁹² Paneli i Apelit gjykon se standardi *jashtë dyshimit të arsyeshëm* vlen për ato fakte që janë të

⁹⁸⁸ Paneli i Apelit vë në dukje se Dosja e Kundërpërgjigjes, në Pikën 3, përmban një numër parashtrimesh që nuk i kundërpërgjigjen Pikës 3 në Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së. Duke rikujtuar se sipas nenit 50(1) të Udhëzuesit të Punës për Parashtrimet, dosja e kundërpërgjigjes duhet të kufizohet vetëm në argumentet e paraqitura në kundërpërgjigje ndaj dosjes së përgjigjes, Paneli i Apelit nuk do t'i trajtojë drejtpërdrejt këto argumente. Shih Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 27-33, 35-37. Disa nga këto argumente u ngritën përsëri gjatë seancës së apelit dhe Paneli i Apelit nuk do t'i trajtojë për të njëjtën arsye. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 50-52.

⁹⁸⁹ Aktgjykimi, para. 689. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 499-500 dhe provat e cituara aty (që çuan në konstatimin se individët që krijuan dhe mbajtën kushtet e ndalimit në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe ata që keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht të ndaluarit, përfshirë viktimën e vrasjes së paligjshme, ishin anëtarë të UÇK-së që i përkisnin njësitit BIA), 520-522 (që çoi në konstatimin se të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash u ishte refuzuar ndihma mjekësore), 528, 569-574, 589 (që çoi në konstatimin se, gjatë kohës që ishte i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, viktimja e vrasjes së paligjshme u akuzua se ishte hajdut dhe për bashkëpunim me serbët, dhe u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të BIA-s), 619 (që çoi në konstatimin se lëndimet e rënda të vërejtura në duart dhe këmbët e viktimës së vrasjes së paligjshme përputhen me keqtrajtimin e egër të pësuar nga viktimja e vrasjes së paligjshme gjatë mbajtjes në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe faktin që, në fund të periudhës së ndalimit, ai nuk ishte më në gjendje të qëndronte në këmbë ose të ecte).

⁹⁹⁰ Aktgjykimi, para. 621 (theksimi i shtuar).

⁹⁹¹ Aktgjykimi, para. 621.

⁹⁹² Dosja e Apelit, para. 343. Neni 21(3) i Ligjit dhe rregulla 140(1) e Rregullores përcaktojnë se standardi i vërtetimit që zbatohet është vërtetimi jashtë dyshimit të arsyeshëm.

domosdoshme për shpallje fajësie, konkretisht, për ato që përbëjnë elementet e krimit (krimeve) në Aktakuzë, përfshirë lidhjen shkakësore dhe format e pretenduara të përgjegjesisë penale.⁹⁹³ Mustafa nuk ka demonstruar se Trupi Gjykes nuk vërtetoi jashtë dyshimit të arsyeshëm se viktima e vrasjes së paligjshme nuk ishte në gjendje të ecte apo të qëndronte në këmbë, as se kishte mangësi në provat në të cilat u mbështet Trupi Gjykes.⁹⁹⁴ Për më tepër, Mustafa nuk demonstroi se për shpalljen e tij fajtor është i domosdoshëm konstatimi se viktima e vrasjes së paligjshme nuk ishte në gjendje të ecte apo të qëndronte në këmbë. Me fjalë të tjera, ai nuk ka demonstruar se, pa bërë konstatim se viktima e vrasjes së paligjshme nuk ishte në gjendje të ecte ose të qëndronte në këmbë, bazuar në pjesën tjetër të provave,⁹⁹⁵ asnjë trup gjykues i arsyeshëm nuk do arrinte në përfundimin e Trupit Gjykes se keqtrajtimi i viktimës së vrasjes së paligjshme në kompleksin e ndalimit në Zllash para 19 prillit 1999 ishte shkak i konsiderueshëm i vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme dhe përfundimisht, se sjellja e Mustafës e përmbushte elementin e veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e hedh poshtë këtë argument.

369. Paneli vë në dukje se Mustafa i referohet një dëshmie të vetme në mbështetje të argumentit të tij se vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme mund të ketë ndodhur në “çfarëdo date pas periudhës së aktakuzës”, që ai e përcakton si pas datës 11 qershor 1999,⁹⁹⁶ konkretisht një deklaratë të W04648-ës marrë në kuadër të një hetimi [REDAKTUAR].⁹⁹⁷ Mustafa parashtroi se në deklaratë dëshmitari tregon se vendi i varrosjes ishte “grumbull dheu i sapolëvizur”, “[REDAKTUAR]”.⁹⁹⁸ Duke pasur

⁹⁹³ *Ongwen Appeal Judgment*, para. 338; *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 126, 169; *Mrkšić and Šljivoančanin Appeal Judgment*, para. 217.

⁹⁹⁴ Shih Aktgjykimin, para. 570-571, që i referohet konkretisht Transkriptit (W03593), 20 shtator 2021, f. 403-405; Transkriptit (W01679), 4 tetor 2021, f. 906; Transkriptit (W04669), 10 nëntor 2021, f. 1438.

⁹⁹⁵ Shih Aktgjykimin, para. 569-574, 625-626.

⁹⁹⁶ Dosja e Apelit, para. 337-339, që i referohet P00001 (W04648) (konfidenciale). Mustafa parashtroi se luftimet midis palëve në konflikt përfunduan më 11 qershor 1999, kur hynë forcat e NATO-s në Kosovë. Shih Dosjen e Apelit, para. 336.

⁹⁹⁷ Shih P00001 (W04648) (konfidenciale).

⁹⁹⁸ Dosja e Apelit, para. 337-338. Shih gjithashtu P00001 (W04648) (konfidenciale), f. 1.

parasysh provat në të cilat u mbështet Trupi Gjykses për të konstatuar kohën e përafërt të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme,⁹⁹⁹ përfshirë provat se kufoma kishte filluar të kalbej kur u zhvarros,¹⁰⁰⁰ Paneli konstaton se Mustafa nuk vërteton se asnjë trup gjykses i arsyeshëm nuk do të kishte arritur në të njëjtin përfundim. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit hedh poshtë argumentet e Mustafës në lidhje me kohën e vdekjes.

370. Sa i përket argumentit të Mustafës se nuk kishte prova që viktimja e vrasjes së paligjshme vdiq nga keqtrajtimi prej anëtarëve të BIA-s ose nga refuzimi i ndihmës mjekësore prej anëtarëve të BIA-s,¹⁰⁰¹ Dhoma e Apelit thekson se Mustafa shpërfill provat e përmendura me hollësi në Aktgjykim, të cilat mbështesin këto përfundime të Trupit Gjykses.¹⁰⁰² E njëjta vlen edhe për argumentin e Mustafës se nuk kishte prova në mbështetje të përfundimit se viktimja e vrasjes së paligjshme nuk u evakuua,¹⁰⁰³ apo se viktimja e vrasjes së paligjshme u qëllua me plumba.¹⁰⁰⁴ Për këto arsye, Paneli i rrëzon këto argumente.

371. Në lidhje me argumentin e Mustafës se nuk kishte asnjë provë, apo se nuk kishte prova të mjaftueshme, në mbështetje të konstatimit të Trupit Gjykses se viktimja e vrasjes së paligjshme vdiq si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të Mustafës,

⁹⁹⁹ Shih p.sh. Aktgjykimin, para. 619-639.

¹⁰⁰⁰ Shih Aktgjykimin, para. 614, poshtëshënimi 1323.

¹⁰⁰¹ Dosja Apelit, para. 347.

¹⁰⁰² Shih më lart poshtëshënimin 989.

¹⁰⁰³ Shih, p.sh., Aktgjykimin, para. 636, 658 dhe provat e cituara aty (që çuan në konstatimin se, për shkak të afrimit të ofensivës serbe, më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, personat që kishin qenë të ndaluar bashkë me viktimën e vrasjes së paligjshme (W01679, W03593 and W03594) u liruan papritur nga kompleksi i ndalimit në Zllash, kurse dy të ndaluarit më të keqtrajtuar, një prej të cilëve ishte viktimja e vrasjes së paligjshme, nuk u liruan), 571, 621 (që çuan në konstatimin se “kur u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë, viktimja e vrasjes së paligjshme, i cili u keqtrajtua rëndë çdo ditë për gati tri javë, ishte pothuajse i vdekur dhe nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë ose të ecte”), 254 (ku Trupi Gjykses i referohet dëshmisë së Mustafës se, më 20 prill 1999, ai u kthye në Zllash për të evakuuar disa të plagosur), 611, 618 (që çuan në konstatimin se varri i viktimës së vrasjes së paligjshme u gjet afërsisht midis 3 korrikut dhe 6 korrikut 1999 dhe ishte [REDAKTUAR]).

¹⁰⁰⁴ Aktgjykimin, para. 620-623 dhe provat e cituara aty (që çuan në konstatimin se provat përputhen me situatën se individët e gjetur në varr – njëri prej të cilëve ishte viktimja e vrasjes së paligjshme – ishin goditur me plumba).

sipas Panelit të Apelit Mustafa kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses se: (i) “vendimi për të mos liruar viktimën e vrasjes së paligjshme mund të merrej vetëm nga i akuzuari, si komandant i përgjithshëm i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash”;¹⁰⁰⁵ dhe (ii) “viktima e vrasjes së paligjshme nuk u evakuua nga Zllashi, një vendim ky që gjithashtu duhet të jetë marrë nga i akuzuari, pasi ai ishte përgjegjësi i evakuimit të të plagosurve nga Zllashi”.¹⁰⁰⁶

372. Sa i përket konstatimit të Trupit Gjykses lidhur me lirim, Paneli i Apelit vëren se ky përfundim u bazua në provat të marra në tërësi dhe duke mbajtur parasysh pozitën e Mustafës si komandant i përgjithshëm i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash.¹⁰⁰⁷ Konkretisht, Trupi Gjykses theksoi se dëshmitë, përfshirë edhe ajo e të akuzuarit, tregonin se Mustafa: (i) ishte komandanti i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë të gjithë ekzistencës së BIA-s, përfshirë në prill 1999;¹⁰⁰⁸ dhe (ii) kishte kompetencën t’u jepte urdhra vartësve të tij, ndër të tjera në lidhje me vëzhgimin e lëvizjeve të forcave serbe dhe dërgimin e furnizimeve mjekësore.¹⁰⁰⁹ Për më tepër, Trupi Gjykses vuri në dukje se Mustafa deklaroi që ai merrte informacion për shkeljet e kryera nga ushtarët e BIA-s dhe kishte kompetencën t’i disiplinonte.¹⁰¹⁰ Sa i përket pozitës së Mustafës, Paneli i Apelit vëren rrëzimin më lart të argumentit të Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se BIA kontrollonte kompleksin e ndalimit në

¹⁰⁰⁵ Aktgjykimi, para. 636.

¹⁰⁰⁶ Aktgjykimi, para. 636.

¹⁰⁰⁷ Aktgjykimi, para. 636.

¹⁰⁰⁸ Aktgjykimi, para. 338, poshtëshënimi 670, që i referohet P00111 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 29, 31-32; P00112 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 14-15; Transkripti (Fatmir Humolli), 2 shkurt 2022, f. 2418, 2443. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 353.

¹⁰⁰⁹ Aktgjykimi, para. 339, poshtëshënimi 678, që i referohet P00112 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 3-4, 8; Transkripti (Brahim Mehmetaj), 23 mars 2022, f. 2621, 2665-2666, 2668; Transkripti (Brahim Mehmetaj), 24 mars 2022, f. 2741; Transkripti (Ibadete Canolli-Kaçiu), 12 maj 2022, f. 4355-4356; Transkripti (W03593), 20 shtator 2021, f. 414.

¹⁰¹⁰ Aktgjykimi, para. 339, poshtëshënimi 679, që i referohet P00112 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 2 dhe P00112 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 2-3, 5-6.

Zllash, si edhe parashtrimin e tij se nuk kishte deklaruar asnjëherë që ai vetë apo BIA kishin kontroll mbi kompleksin e ndalimit në Zllash.¹⁰¹¹

373. Si konfirmim shtesë se vendimi për të mos liruar viktimën e vrasjes së paligjshme mund të merrej vetëm nga Mustafa, Trupi Gjykues nënvizoi se provat treguan se “lirimi i të ndaluarve të tjerë u zbatua nga vartësit e të akuzuarit në BIA, ndër të cilët edhe zëvendësi i tij, z. Mehmetaj (me pseudonimin Bimi)”.¹⁰¹² Mustafa pretendon se konstatimi lidhur me lirimimin është i gabuar, për arsye se z. Mehmetaj nuk ishte më vartës i Mustafës në kohën kur u mor ai vendim.¹⁰¹³ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykues konstatoi që disa të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash u liruan papritmas më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date¹⁰¹⁴ dhe se, në këtë kontekst, Trupi Gjykues iu referua z. Mehmetaj si zëvendës i Mustafës.¹⁰¹⁵ Paneli i Apelit njëkohësisht vëren se Trupi Gjykues ishte i vetëdijshëm se në prill 1999, kur u liruan disa nga të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, z. Mehmetaj nuk ishte më zëvendës i Mustafës.¹⁰¹⁶ Paneli i Apelit gjithashtu vëren se statusi i z. Mehmetaj si dikush që nuk ishte më zëvendës i Mustafës nuk përjashton që ai megjithatë vazhdoi të ishte vartës i Mustafës. Mustafa nuk paraqet asnjë provë që tregon se z. Mehmetaj nuk ishte më vartës i Mustafës. Për më tepër, Paneli i Apelit vëren se z. Mehmetaj deklaroi se, edhe pas emërimit të tij në postin e ri si përgjegjës për moral dhe politikë në nivel të Zonës Operative të Llapit në shkurt 1999,¹⁰¹⁷ “dy punë i bëjsha”, një në BIA dhe një në shtab.¹⁰¹⁸ Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë se asnjë trup gjykues i arsyeshëm

¹⁰¹¹ Shih më lart, para. 184-191.

¹⁰¹² Aktgjykimi, para. 636, që i referohet Aktgjykimit, para. [REDAKTUAR].

¹⁰¹³ Dosja Apelit, para. 364-365, 373.

¹⁰¹⁴ Aktgjykimi, para. 403-406, 422-426, 440-441, 636.

¹⁰¹⁵ Aktgjykimi, para. 636.

¹⁰¹⁶ Aktgjykimi, para. 338.

¹⁰¹⁷ Transkripti (Brahim Mehmetaj), 23 mars 2022, f. 2657.

¹⁰¹⁸ Transkripti (Brahim Mehmetaj), 23 mars 2022, f. 2658.

nuk do të mund të nxirrte të njëjtin përfundim lidhur me lirim dhe e rrëzon këtë argument.

374. Sa i përket konstatimit të Trupit Gjykses lidhur me evakuimin, Paneli i Apelit nuk pajtohet me pretendimin e Mustafës se nuk ka asnjë provë në mbështetje të këtij konstatimi. Paneli i Apelit sërish thekson konstatimin e Trupit Gjykses se Mustafa ishte komandanti i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë të gjithë ekzistencës së BIA-s, përfshirë në prill 1999.¹⁰¹⁹ Trupi Gjykses më tej konstatoi se kompleksi i ndalimit në Zllash u evakuua për shkak të ofensivës serbe,¹⁰²⁰ dhe se Mustafa deklaroi më se një herë se më 20 prill 1999, ai personalisht u kthye në Zllash për të evakuuar disa të plagosur.¹⁰²¹ Sidoqoftë, Paneli i Apelit vëren gjithashtu se kur nxori konstatimin lidhur me evakuimin, Trupi Gjykses nuk iu referua këtyre konstatimeve të mëhershme apo provave përkatëse.¹⁰²² Me gjithë këtë mangësi, dhe mbi bazën e një leximi të Aktgjykimit në tërësi, Paneli i Apelit nuk gjykon se Trupi Gjykses nuk përmbushi detyrimin për të dhënë mendim të arsyetuar në lidhje me konstatimin mbi evakuimin. Rrjedhimisht, Paneli e rrëzon argumentin e Mustafës.

375. Në lidhje me argumentin e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se plagët e shkaktuara nga armë zjarri, të gjetura në kufomën e viktimës së vrasjes së paligjshme, mund t'i atribuoheshin Mustafës ose vartësve të tij,¹⁰²³ Paneli i Apelit vëren se Mustafa nuk ka identifikuar konstatimin konkret që kundërshton. Një mangësi e tillë për ligj rrëzim të menjëhershëm të këtij parashtrimi.¹⁰²⁴ Pavarësisht nga kjo, Paneli i Apelit thekson se shpallja e fajësisë së Mustafës për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme nuk u bazua në këtë konstatim. Përkundrazi, Trupi Gjykses

¹⁰¹⁹ Aktgjykimi, para. 338. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 353.

¹⁰²⁰ Aktgjykimi, para. 423, 634.

¹⁰²¹ Aktgjykimi, para. 254, poshtëshënimi 474, që i referohet P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 22-23. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 636.

¹⁰²² Aktgjykimi, para. 636.

¹⁰²³ Dosja Apelit, para. 343-348.

¹⁰²⁴ Shih më lart, para. 29, 33.

konstatoi se ekzistonte dyshim i arsyeshëm se kujt mund t'i atribuoheshin vrimat e plumbave të gjetura në trupin e viktimës së vrasjes së paligjshme.¹⁰²⁵ Rrjedhimisht, Paneli e rrëzon këtë argument.

376. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë se Trupi Gjykses bëri gabim faktik kur konstatoi se sjellja e Mustafës përmbushte veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon të gjitha argumentet faktike që paraqet Mustafa në Pikat 3 dhe 4 të Apelit.

2. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të krimit të luftës të vrasjes së paligjshme (nënpikat 5A, 5B të Apelit)

377. Trupi Gjykses konstatoi se ishin përmbushur elementet e synimit kriminal të krimit të luftës të vrasjes së paligjshme, duke qenë se Mustafa, ndër të tjera: (i) e dinte se më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], viktimja e vrasjes së paligjshme iu dorëzua BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash;¹⁰²⁶ (ii) pranoi se disa nga të ndaluarit që ai mbante aty mund të vdisnin si pasojë e keqtrajtimit në kompleksin e ndalimit në Zllash;¹⁰²⁷ dhe (iii) si komandant i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, ushtroi pushtetin e tij, me afrimin e ofensivës serbe, për ta mbajtur të ndaluar viktimën e vrasjes së paligjshme – që ishte në gjendje në prag të vdekjes kur u pa për të fundit herë nga të ndaluar të tjerë – kur mbi bazën e të njëjtit pushtet, të tjerët u liruan,¹⁰²⁸ vendim ky për të cilin Trupi Gjykses konstatoi se ishte faktikisht barabar me një vendim për ta vrarë viktimën e vrasjes së paligjshme.¹⁰²⁹ Duke mbajtur parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses konstatoi se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se, “përmes veprimeve dhe mosveprimeve që u atribuohen të akuzuarit dhe vartësve të tij në BIA, ata synonin të vrisnin viktimën e vrasjes së

¹⁰²⁵ Aktgjykimi, para. 637, 689.

¹⁰²⁶ Aktgjykimi, para. 691.

¹⁰²⁷ Aktgjykimi, para. 691.

¹⁰²⁸ Aktgjykimi, para. 571, 625, 635-636, 692. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 638.

¹⁰²⁹ Aktgjykimi, para. 636, 692.

paligjshme, çka rrjedhimisht vërteton ekzistencën e elementit të nevojshëm mendor për vrasjen si krim lufte”.¹⁰³⁰

378. Mustafa pretendon një numër gabimesh juridike dhe faktike në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses se ishte përmbushur synimi kriminal për vrasjen e paligjshme. Ai parashtron se në bazë të gabimeve të përmendura, të marra individualisht ose bashkërisht, vendimi i fajësisë së tij për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme duhet të prapësohet.¹⁰³¹ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se parashtrimet e Mustafës duhet të rrëzohen.¹⁰³²

(a) Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

379. Sipas Panelit të Apelit, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses zbatoi standardin e gabuar të synimit kriminal të krimit të luftës të vrasjes së paligjshme. Në mbështetje të këtij argumenti, Mustafa parashtron se standardi i synimit kriminal që përcaktoi Trupi Gjykses përfshin përgjegjësinë kur i akuzuari “qëllimisht nuk i dha ose i refuzoi ndihmën mjekësore [një të ndaluarit]” çka i akuzuari “logjikisht duhej ta kishte ditur se mund të çonte në vdekje” kur, për mendimin e tij, standardi i duhur kërkon së paku “synimin për të shkakuar qëllimisht lëndim të rëndë fizik me [...] dijeninë se me gjasë do të kishte si pasojë vdekjen/vdekja do të ishte pasojë e rrjedhës normale të ngjarjeve”.¹⁰³³ Mustafa gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se ai kishte synimin kriminal të nevojshëm për krimin e luftës të vrasjes së

¹⁰³⁰ Aktgjykimi, para. 695.

¹⁰³¹ Dosja e Apelit, para. 368-378; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 96-97, 134. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, nënpikat 5A dhe B, para. 8. Paneli thekson se në Dosjen e Apelit, në nënpikën 5B, Mustafa u referohet parashtrimeve në nënpikën 5A dhe nuk paraqet parashtrime të mëtejshme. Shih Dosjen e Apelit, para. 377. Për këtë arsye, Paneli e konsideron nënpikën 5B të përfshirë në nënpikën 5A, dhe do t'u referohet atyre bashkërisht si “Pika 5 e Apelit”.

¹⁰³² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 179-186; Dosja e Përgjigjes së Mbrojtësës së Viktimave, para. 72, 75.

¹⁰³³ Njoftimi për Apel, nënpika 5B, para. 8. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 368, 374-376. Krahas kësaj, në Njoftimin për Apel, Mustafa parashtron gjithashtu se për ngarkimin me përgjegjësi penale në bazë të NKP I për vrasje të paligjshme duhet që, më së paku, të gjithë pjesëmarrësit në NKP të kenë synimin për të vrarë. Shih Njoftimin për Apel, nënpika 5B, para. 8. Paneli i Apelit vëren se kjo deklaratë e Mustafës nuk shtjellohet më tej në një argument. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e rrëzon atë menjëherë.

paligjshme. Në këtë kontekst, sipas interpretimit të Panelit të Apelit, në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses se vendimi për të mos liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme ishte barabar me një vendim për ta vrarë atë,¹⁰³⁴ Mustafa së pari parashtron se nuk u vërtetua që ai: (i) e dinte gjendjen e viktimës së vrasjes së paligjshme,¹⁰³⁵ ose (ii) kishte dëshirën për t'i refuzuar ndihmën mjekësore.¹⁰³⁶ Së dyti, në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses se Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s që e keqtrajtuuan viktimën e vrasjes së paligjshme nuk mund të lejonin që ai të mbetej i gjallë, duke pasur parasysh se viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], Mustafa argumenton se provat nuk kanë vërtetuar që viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR].¹⁰³⁷ Konkretisht, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses u mbështet në dëshminë e [REDAKTUAR], sipas Mustafës, nuk kishte njohuri personale nëse [REDAKTUAR].¹⁰³⁸ Mustafa më tej argumenton se, [REDAKTUAR].¹⁰³⁹ Sipas tij, kjo vërtetohet nga fakti që kryesit liruan të ndaluar të tjerë, [REDAKTUAR].¹⁰⁴⁰

380. Pyetjes së Panelit të Apelit nëse në dispozitat ligjore përkatëse përfshihen forma më të lehta të synimit krahasuar me synimin e drejtpërdrejtë, Mustafa i përgjigjet se synimi eventual (*dolus eventualis*) i parashikuar në nenin 21 të KPK-së nuk mund të jetë i zbatueshëm sepse *dolus eventualis* nuk është pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare.¹⁰⁴¹

381. ZPS-ja parashtron se Mustafa kundërshton standardin e synimit kriminal në Njoftimin për Apel, por faktikisht heq dorë nga ky argument në Dosjen e Apelit dhe se, rrjedhimisht, ky argument duhet të rrëzohet *in limine*.¹⁰⁴² Sidoqoftë, ZPS-ja

¹⁰³⁴ Shih Aktgjykimin, para. 636, 692.

¹⁰³⁵ Dosja e Apelit, para. 369; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 52.

¹⁰³⁶ Dosja e Apelit, para. 369; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 51-52.

¹⁰³⁷ Dosja e Apelit, para. 370.

¹⁰³⁸ Dosja e Apelit, para. 371.

¹⁰³⁹ Dosja e Apelit, para. 372.

¹⁰⁴⁰ Dosja e Apelit, para. 372.

¹⁰⁴¹ Parashtrimet e Mëtejshme të Mbrojtjes mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme, para. 2-12, 18-19.

¹⁰⁴² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 183.

parashtron se përgjegjësia për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme mund të lindë si nga veprimet e qëllimshme, ashtu edhe nga mosveprimet e qëllimshme, në rastet kur kryesi logjikisht duhej ta kishte ditur se veprimi ose mosveprimi mund të çonte në vdekje.¹⁰⁴³ ZPS-ja parashtrroi se në të dy rastet, standardet përkatëse mbështeten nga shembuj të shumtë të jurisprudencës ndërkombëtare.¹⁰⁴⁴ ZPS-ja shton se konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me synimin e Mustafës u bazuan në elemente të shumta që përforcojnë njëri-tjetrin, dhe se, sidoqoftë, ka prova të shumta se Mustafa dhe vartësit e tij kishin së paku synimin për të shkaktuar lëndim të rëndë fizik.¹⁰⁴⁵ Në lidhje me këtë të fundit, ZPS-ja shton se pretendimi i Mustafës se “standardi i duhur i synimit kriminal kërkon më së paku synimin për të shkaktuar qëllimisht lëndim të rëndë fizik” nuk do të mund të ndryshonte rezultatin e Aktgjykimit.¹⁰⁴⁶

382. Në lidhje me pretendimin e Mustafës se nuk ka prova të mjaftueshme në mbështetje të konstatimit të Trupit Gjykses mbi synimin e tij për të vrarë, ZPS-ja përgjigjet se Mustafa: (i) nuk citon burime ligjore relevante; (ii) paraqet disa fakte në mënyrë përzgjedhëse, duke shpërfillur faktet e tjera; (iii) ngatërron synimin me motivin; dhe (iv) u referohet fakteve dhe rrethanave të cilat, në vetvete, kanë të bëjnë shumë pak ose nuk kanë të bëjnë aspak me synimin.¹⁰⁴⁷ Në lidhje me argumentin e Mustafës se konstatimet e Trupit Gjykses bazohen në motivin për ta asgjësuar viktimën e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], ZPS-ja përgjigjet se ky “faktor i bazuar mirë” ishte vetëm një prej disa elementeve ku u mbështet Trupi Gjykses kur nxori konstatimin e vet mbi synimin.¹⁰⁴⁸ Në fund, ZPS-ja parashtron se Mustafa nuk

¹⁰⁴³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 184.

¹⁰⁴⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 184.

¹⁰⁴⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 185.

¹⁰⁴⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 185.

¹⁰⁴⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 179. Sa i përket argumentit të Mustafës lidhur me konstatimin e Trupit Gjykses se vendimi për të mos liruuar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme ishte barabar me një vendim për ta vrarë atë – se nuk ishte vërtetuar që ai kishte dëshirën për t'i refuzuar ndihmën mjekësore viktimës – ZPS-ja shton se në paragrafin 621, poshtëshënimi 1346, Trupi Gjykses konstatoi se në kompleksin e ndalimit në Zllash në përgjithësi kishte ndihmë mjekësore. Transkripti, 26 tetor 2023, f. 98-99.

¹⁰⁴⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 180.

ka arritur të vërtetojë se asnjë trup gjykues i arsyeshëm nuk do të mund të konstatonte synimin për të vrarë mbi bazën e këtyre elementeve të shumta që përforcojnë njëri-tjetrin.¹⁰⁴⁹

383. Si përgjigje ndaj pyetjes së Panelit të Apelit nëse dijenia e Mustafës për gjendjen e viktimës së vrasjes së paligjshme logjikisht mund të deduktohej në bazë të konstatimeve faktike të Trupit Gjykues, ZPS-ja parashtron se dijenia e Mustafës mund të deduktohet nga këta faktorë: (i) prania e Mustafës në periudha kyçe të ndalimit të viktimës së vrasjes së paligjshme; (ii) duke mbajtur parasysh planimetrinë e kompleksit të vogël, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se Mustafa duhet të ketë pasur dijeni për ndalimin e një burri të cilit, sipas fjalëve të Trupit Gjykues, iu bë “keqtrajtim vdekjeprurës”; dhe (iii) konstatimi i Trupit Gjykues se vendimi për të mos liruar dhe evakuuar, si dhe për t’i refuzuar ndihmën mjekësore viktimës së vrasjes së paligjshme, mund të merrej vetëm nga Mustafa, dhe duhet të jetë bazuar në dijeninë e tij për ndalimin e viktimës së vrasjes së paligjshme.¹⁰⁵⁰

384. Si përgjigje ndaj pyetjeve të Panelit të Apelit në lidhje me standardin e synimit kriminal për vrasjen e paligjshme, ZPS-ja shton se standardi është i përcaktuar dhe se nuk ka nevojë që Paneli t’i përgjigjet pyetjes se si do të përkufizohet synimi i zbatueshëm në këtë çështje gjyqësore, meqenëse Trupi Gjykues nxori përfundimin e arsyeshëm se Mustafa dhe vartësit e tij në BIA e vranë qëllimisht viktimën e vrasjes së paligjshme.¹⁰⁵¹ Sipas ZPS-së, pyetja se si duhet të përkufizohet synimi ngrihet vetëm nëse Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykues nuk ka mundur të deduktojë synimin e Mustafës mbi bazën e cilitdo prej dy kriterëve alternative të standardit të synimit kriminal.¹⁰⁵² Sipas parashtrimit të ZPS-së, provat vërtetojnë pa mëdyshje se Mustafa kishte më së paku synimin e shkaktimit të qëllimshëm të lëndimeve të rënda fizike,

¹⁰⁴⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 181-182.

¹⁰⁵⁰ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 114-115.

¹⁰⁵¹ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 110.

¹⁰⁵² Transkripti, 27 tetor 2023, f. 110-111.

me dijeninë se kjo mund të çonte në vdekje.¹⁰⁵³ ZPS-ja shton se, edhe bazuar në versionin e ngjarjeve më të favorshëm për të akuzuarin, që Mustafa e braktisi një njeri të mbajtur prej tij “në një gjendje që nuk mund të ecte dhe në prag të vdekjes”, duhet të deduktohet se ai më së paku kishte synimin e shkaktimit të qëllimshëm të lëndimeve të rënda fizike, të cilat logjikisht duhej ta kishte ditur se mund të çonin në vdekje.¹⁰⁵⁴

385. Pyetjes së mëtejshme të Panelit të Apelit nëse në dispozitat ligjore përkatëse përfshihen forma më të lehta të synimit krahasuar me synimin e drejtpërdrejtë, ZPS-ja i përgjigjet se ka disa burime ligjore që mbështesin tezën se synimi për vrasje përfshin standardin e neglizhencës së qëllimshme.¹⁰⁵⁵ Sipas ZPS-së, duke qenë se Trupi Gjykues zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare, bazuar në nenin 3 të Ligjit lidhur me interpretimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare, e drejta penale materiale e Kosovës, përfshirë neni 21 i KPK-së mbi synimin,¹⁰⁵⁶ nuk ka ndikim më të madh në përkufizimin e synimit kriminal për vrasjen e paligjshme sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare krahasuar me cilindo legjislacion shtetëror tjetër.¹⁰⁵⁷ ZPS-ja shton se përmendja në mënyrë të përgjithshme e nenit 12 të Ligjit në lidhje me zbatueshmërinë e së drejtës penale materiale të Kosovës duhet lexuar së bashku me nenet 13, 14 dhe 15 të Ligjit, dhe se një lexim i tillë tregon qartë se e drejta penale materiale e Kosovës

¹⁰⁵³ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 111, 115.

¹⁰⁵⁴ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 112.

¹⁰⁵⁵ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 112-113 (që i referohet *Karadžić Judgment*, para. 447-448 dhe *Nuon and Khieu Supreme Court Appeal Judgment*, para. 390-410). ZPS-ja i referohet paragrafit 659 të *Ntagerura et al. Judgment* dhe shton se standardi i synimit kriminal për mosveprimin është që: “[...] i akuzuari nuk veptoi, duke i synuar pasojat kriminale të ndëshkueshme me ligj, ose me dijeninë dhe pajtimin që ato pasoja të ndodhnin”. Shih Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 155. Shih gjithashtu Parashtrimet e Mëtejshme të ZPS-së mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme, para. 4 (ku përmenden shembuj të tjerë nga jurisprudenca ndërkombëtare).

¹⁰⁵⁶ Parashtrimet e Mëtejshme të ZPS-së mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme, para. 1, poshtëshënimi 2.

¹⁰⁵⁷ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 113. Shih gjithashtu Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 156.

është e zbatueshme vetëm në lidhje me ligjet e përmendura në nenin 15 të Ligjit dhe akuzat kundër Mustafës nuk janë ngritur mbi bazën e tyre.¹⁰⁵⁸

386. Në përgjigjen e vet, Mbrojtësja e Viktimave i referohet standardit të synimit kriminal të përcaktuar nga TPNJ-ja në çështjen *Martiq*, i cili, sipas saj, përfshin synimin për të vrarë, si edhe dijeninë se vdekja e viktimës ishte me gjasë pasojë e veprimit ose mosveprimit.¹⁰⁵⁹ Mbrojtësja e Viktimave shton se provat vërtetuan keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe se, edhe në qoftë se asnjë provë e drejtpërdrejtë nuk vërteton aktin përfundimtar të vrasjes nga ana e Mustafës ose anëtarëve të tjerë të BIA-s, “i vetmi version sadopak i mundshëm ishte se ata e lanë një njeri të torturuar rëndë dhe gjysmë të vdekur pa mbrojtje në mëshirë të forcave të armikut që po afroreshin”.¹⁰⁶⁰ Mbrojtësja e Viktimave parashtron se vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme ishte me gjasë pasojë e kësaj praktike veprimi.¹⁰⁶¹

387. Si përgjigje ndaj pyetjeve të Panelit të Apelit në lidhje me standardin e synimit kriminal për vrasjen e paligjshme, Mbrojtësja e Viktimave shton se neni 21 i KPK-së përcakton qartë një synim të nivelit më të ulët se synimi i drejtpërdrejtë¹⁰⁶² dhe se, për mendimin e saj, synimi kriminal sipas legjislacionit të Kosovës nuk është edhe “aq kundër” përkufizimit sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹⁰⁶³

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

388. Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykues përcaktoi këtë përkufizim të synimit kriminal për vrasjen e paligjshme:

¹⁰⁵⁸ Parashtrimet e Mëtejshme të ZPS-së mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme, para. 3-4. ZPS-ja shton se nuk është i zbatueshëm as neni 21 i KPK-së, sepse nuk ishte në fuqi në kohën kur u kryen krimet, sikurse kërkohet sipas nenit 12 të Ligjit. Shih Parashtrimet e Mëtejshme të ZPS-së mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme, para. 2.

¹⁰⁵⁹ Dosja e Përgjigjes së Mbrojtëses së Viktimave, para. 75.

¹⁰⁶⁰ Dosja e Përgjigjes së Mbrojtëses së Viktimave, para. 75.

¹⁰⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Mbrojtëses së Viktimave, para. 75.

¹⁰⁶² Transkripti, 27 tetor 2023, f. 127-128.

¹⁰⁶³ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 135-136.

Kryesi duhet ta ketë vrarë personin në mënyrë të qëllimshme ose t'i ketë shkaktuar qëllimisht dëmtim të rëndë fizik ose qëllimisht të mos t'i ketë dhënë ose t'i ketë refuzuar ndihmën mjekësore një të ndaluar, çka kryesi logjikisht duhej ta kishte ditur se mund të çonte në vdekje.¹⁰⁶⁴

Ky përkufizim është zbatuar gjerësisht dhe në mënyrë përputhëse në të drejtën penale ndërkombëtare¹⁰⁶⁵ dhe disa panele gjyqësore janë shprehur se krahas synimit të drejtpërdrejtë, ai përfshin edhe formën e synimit të tërthortë të njohur si *dolus eventualis* (synim eventual).¹⁰⁶⁶

389. Në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykes mbi synimin e Mustafës, Paneli paraprakisht rikujton se, sikurse u konstatua më lart,¹⁰⁶⁷ skenari faktik mbi bazën e të cilit Trupi Gjykes shqyrtoi përgjegjësinë penale të Mustafës, përfshirë synimin e tij, ishte ai më i favorshmi për Mustafën – gjegjësisht se forcat serbe shtinë ndaj viktimës së vrasjes së paligjshme. Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykes konstatoi se Mustafa “synonte të vriste” viktimën e vrasjes së paligjshme.¹⁰⁶⁸ Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykes mund ta kishte shprehur më qartë llojin e synimit që kishte z. Mustafa sipas Trupit Gjykes, si edhe përkufizimin e saktë të atij synimi, duke mbajtur parasysh kombinimin e veprimeve dhe mosveprimeve dhe vargun e rrethanave nga të cilat u deduktua synimi. Megjithatë, sido që të jetë, Paneli mendon se Trupi Gjykes konstatoi se Mustafa kishte synimin e drejtpërdrejtë.

¹⁰⁶⁴ Aktgjykimi, para. 688.

¹⁰⁶⁵ Shih. p.sh., *Mladić* Judgement, para. 3050; *Karadžić* Judgement, para. 447; *Dragomir Milošević* Appeal Judgement, para. 108; *Delić* Judgement, para. 46; *Dragomir Milošević* Judgement, para. 931; *Halilović* Judgement, para. 35; *Kvočka et al.* Appeal Judgement, para. 261; *Krstić* Judgement, para. 485; *Karemera et al.* Appeal Judgement, para. 670; *Setako* Appeal Judgement, para. 257. Në lidhje me refuzimin e qëllimshëm të ndihmës mjekësore për një të ndaluar, shih *Kvočka et al.* Appeal Judgement, para. 270; *Nuon and Khieu* Judgement, para. 556-559.

¹⁰⁶⁶ *Karadžić* Judgement, para. 448; *Hadžihasanović and Kubura* Judgement, para. 31; *Stakić* Judgement, para. 587; *Brđanin* Judgement, para. 386; *Nuon and Khieu* Supreme Court Appeal Judgement, para. 409. Shih gjithashtu, *Perišić* Judgement, para. 104; *Delić* Judgement, para. 48; *Strugar* Judgement, para. 235; *Martić* Judgement, para. 60.

¹⁰⁶⁷ Shih më lart, para. 345.

¹⁰⁶⁸ Shih Aktgjykimin, para. 693-695.

390. Paneli i Apelit gjykon se për synimin e drejtpërdrejtë për vrasje të paligjshme kërkohet që kryesi të ketë dëshiruar që vdekja e individit të ishte rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij.¹⁰⁶⁹ Për nxjerrjen e përfundimit se Trupi Gjykses konstatoi se Mustafa dëshiroi që vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme të ishte rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij, Paneli i Apelit mban parasysh një numër faktorësh. Së pari, Trupi Gjykses në mënyrë të përsëritur iu referua synimit të Mustafës për të vrarë.¹⁰⁷⁰ Kuptimi i drejtpërdrejtë i kësaj fraze nënkupton synimin e drejtpërdrejtë. Së dyti, Trupi Gjykses konstatoi se “është e padiskutueshme që keqtrajtimi që iu bë [viktimës së vrasjes së paligjshme] dhe refuzimi i ndihmës mjekësore i atribuohen vetëm veprimeve dhe mosveprimeve të [Mustafës]”.¹⁰⁷¹ Së treti, Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se Mustafa:

- (i) e dinte, më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], se viktima e vrasjes së paligjshme ishte në duart e BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash;¹⁰⁷²
- (ii) pranoi se disa nga të ndaluarit që ai mbante në kompleksin e ndalimit në Zllash mund të vdisnin si pasojë e keqtrajtimit;¹⁰⁷³
- (iii) vendosi t’u refuzonte ndihmën mjekësore të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash;¹⁰⁷⁴
- (iv) e dinte se forcat serbe po i afroreshin Zllashit;¹⁰⁷⁵

¹⁰⁶⁹ *Karadžić* Judgement, para. 448; *Perišić* Judgement, para. 104; *Delić* Judgement, para. 48.

¹⁰⁷⁰ Shih Aktgjykimin, para. 693-695.

¹⁰⁷¹ Aktgjykimi, para. 625.

¹⁰⁷² Aktgjykimi, para. 473, 654, 691, 754, 818.

¹⁰⁷³ Aktgjykimi, para. 691.

¹⁰⁷⁴ Aktgjykimi, para. 621, 750, 816.

¹⁰⁷⁵ Aktgjykimi, para. 423-424, 636, 638, 654, 658, 692, 746, 750, 753, 816.

- (v) shkoi në Zllash personalisht, më 20-21 prill 1999, ose rreth këtyre datave, për të evakuuar anëtarët e plagosur të personelit të tij për shkak të afrimit të forcave serbe,¹⁰⁷⁶ dhe
- (vi) vendosi, në bazë të kompetencës së tij si komandant i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, të mbante të ndaluar viktimën e vrasjes së paligjshme, kur, mbi të njëjtën bazë, të ndaluar të tjerë u liruan.¹⁰⁷⁷

391. Në fund, në bazë të tërësisë së provave, Trupi Gjykses nxori përfundimin se vendimi për të mos liruuar ose evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme – që Trupi Gjykses konstatoi se mund të merrej vetëm nga Mustafa – ishte “barabar me një vendim për ta vrarë” viktimën e vrasjes së paligjshme.¹⁰⁷⁸ Paneli i Apelit do t’i shqyrtojë argumentet e Mustafës të paraqitura në pikën e apelit lidhur me synimin kriminal për vrasje të paligjshme në kontekstin e këtyre konstatimeve të Trupit Gjykses. Meqenëse gjykon se Trupi Gjykses konstatoi se Mustafa kishte synimin e drejtpërdrejtë për vrasje, Paneli i Apelit nuk do t’i trajtojë parashtrimet e palëve për zbatueshmërinë e nenit 21 të KPK-së në lidhje me synimin eventual.¹⁰⁷⁹

392. Sa i përket argumentit të Mustafës se Trupi Gjykses zbatoi standardin e gabuar të synimit kriminal për vrasje të paligjshme duke qenë se standardi i duhur kërkon, më së paku, synimin për të shkaktuar qëllimisht dëmtim të rëndë fizik, dhe jo synimin

¹⁰⁷⁶ Aktgjykimi, para. 254, ku i referohet P00117 (Salih Mustafa) (konfidenciale), f. 22-23), 634.

¹⁰⁷⁷ Aktgjykimi, para. 636, 654, 658, 692.

¹⁰⁷⁸ Aktgjykimi, para. 692. Përfundimi se Trupi Gjykses konstatoi që Mustafa kishte synim të drejtpërdrejtë mbështetet edhe nga fakti se ekziston vetëm një konstatim i tij që mund të konsiderohet se nënkupton një formë të synimit jo të drejtpërdrejtë, duke qenë se përmend pranimin e rrezikut të vdekjes si rezultat i sjelljes së Mustafës. Trupi Gjykses konstatoi se “[k]ëta faktorë, ndonëse nuk lidhen drejtpërdrejt me viktimën e vrasjes së paligjshme, tregojnë se i akuzuari pranoi se disa nga të ndaluarit që ai mbante aty mund të vdisnin si pasojë e keqtrajtimit”. Shih Aktgjykimin, para. 691. Megjithatë, Paneli i Apelit thekson se ky konstatim ka të bëjë me të ndaluarit që u mbajtën në ndalim nga Mustafa në përgjithësi dhe jo në veçanti me viktimën e vrasjes së paligjshme.

¹⁰⁷⁹ Parashtrimet e Mëtejshme të Mbrojtjes mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme; Parashtrimet e Mëtejshme të ZPS-së mbi Synimin Kriminal për Vrasje të Paligjshme.

për mosdhënien/refuzimin e qëllimshëm të ndihmës mjekësore,¹⁰⁸⁰ Paneli i Apelit rithekson përkufizimin e veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme që përcaktoi Trupi Gjykses.¹⁰⁸¹ Në të thuhet qartë se një i akuzuar mund të kryejë vrasje të paligjshme përmes një veprimi ose mosveprimi. Përkufizimi jep dy shembuj të sjelljes që mund të përmbushë kriterin e veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme: (i) shkaktimin e dëmtimit të rëndë fizik që ka për pasojë vdekjen; ose (ii) mosdhënien/refuzimin e ndihmës mjekësore që ka për pasojë vdekjen. Synimi kriminal përkatës është i njëjti, pavarësisht nëse krimi kryhet përmes një veprimi apo mosveprimi. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e rrëzon këtë argument.

393. Në lidhje me argumentin e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se vendimi për të mos liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme ishte barabar me një vendim për ta vrarë atë, duke qenë se nuk u vërtetua se ai ishte në dijeni të gjendjes së viktimës së vrasjes së paligjshme,¹⁰⁸² Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses nuk konstatoi shprehimisht se Mustafa ishte në dijeni të gjendjes së viktimës së vrasjes së paligjshme. Megjithëse gjykon se dijenia për gjendjen shëndetësore të viktimës së vrasjes së paligjshme është një rrethanë relevante që Mustafa do të duhej ta kishte ditur në mënyrë që të kishte synimin, Paneli i Apelit vlerëson se dijenia dhe synimi logjikisht mund të deduktohen nga faktet dhe rrethanat përkatëse, të vërtetuara nga Trupi Gjykses.¹⁰⁸³

394. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit thekson se konstatimet e Trupit Gjykses se Mustafa e dinte se viktimja e vrasjes së paligjshme iu dorëzua BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash¹⁰⁸⁴ dhe se ai ishte i pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash

¹⁰⁸⁰ Njoftimi për Apel, Nën-pika 5B, para. 8.

¹⁰⁸¹ Shih më lart, para. 341. Shih Aktgjykimin, para. 686.

¹⁰⁸² Dosja e Apelit, para. 369; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 52.

¹⁰⁸³ Shih *Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment*, para. 159; ICC Elements of Crimes, General introduction, p. 1, para. 3.

¹⁰⁸⁴ Aktgjykimi, para. 691.

në disa periudha gjatë mbajtjes së viktimës së vrasjes së paligjshme në ndalim,¹⁰⁸⁵ duke përfshirë edhe më [REDAKTUAR], ose rreth [REDAKTUAR].¹⁰⁸⁶ Paneli i Apelit gjithashtu thekson konstatimin e Trupit Gjykses se Mustafa pranoi se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash mund të vdisnin si pasojë e keqtrajtimit të pësuar atje.¹⁰⁸⁷ Në lidhje me këtë aspekt, Paneli i Apelit vëren se ishte pjesëmarrja personale e Mustafës në keqtrajtimin e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash (kur përdori armë zjarri gjatë marrjes në pyetje të një të ndaluarit dhe kur urdhëroi vartësit “mbyteni krejt” një të ndaluar tjetër),¹⁰⁸⁸ dhe si rrjedhojë logjike, dijenia e tij për keqtrajtimin në kompleksin e ndalimit në Zllash, që e bënë Trupin Gjykses të arrinte në përfundimin se ai pranoi që të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash mund të vdisnin si pasojë e keqtrajtimit.¹⁰⁸⁹ Gjithashtu, Paneli i Apelit është i vetëdijshëm se Trupi Gjykses mbajti parasysh që numri i të ndaluarve nën pushtetin e Mustafës në kompleksin e ndalimit në Zllash ishte relativisht i vogël gjatë kohës që viktima e vrasjes së paligjshme u mbajt i ndaluar atje. Konkretisht, Trupi Gjykses konstatoi se ishin “të paktën gjashtë persona”,¹⁰⁹⁰ ndër të cilët viktima e vrasjes së paligjshme, që u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës kohore përkatëse.¹⁰⁹¹ Në fund, Paneli i Apelit thekson konstatimin e Trupit Gjykses se vendimi për të mos liruar ose evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme kur të ndaluar të tjerë u liruan ose evakuuan për shkak të afrimit të ofensivës serbe, ishte një

¹⁰⁸⁵ Aktgjykimi, para. 541, 546.

¹⁰⁸⁶ Aktgjykimi, para. 468, 472-473.

¹⁰⁸⁷ Shih më lart, para. 377. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 691.

¹⁰⁸⁸ Aktgjykimi, para. 691.

¹⁰⁸⁹ Aktgjykimi, para. 691.

¹⁰⁹⁰ Aktgjykimi, para. 493. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 485, 494-495. Paneli vëren se lidhur me numrin e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës përkatëse, Trupi Gjykses vuri në dukje se dëshmitë treguan se: (i) në ahuret që përdorëshin për qëllime ndalimi sillëshin e merreshin shumë të ndaluar (shih Aktgjykimin, para. 488); (ii) është krejt e mundshme që në të njëjtën kohë e në të njëjtin ahur të jenë mbajtur deri në 17 të ndaluar (shih Aktgjykimin, para. 488); (iii) në Listën e të Burgosurve evidentohet arrestimi i 19 personave në prill 1999 (shih Aktgjykimin, para. 491); (iv) një numër i madh të ndaluarish u mbajtën në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999 (shih Aktgjykimin, para. 493); dhe se (v) të paktën gjashtë persona u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë kuadrit kohor të akuzave (shih Aktgjykimin, para. 493).

¹⁰⁹¹ Aktgjykimi, para. 494-495.

vendim që mund të merrej vetëm nga Mustafa.¹⁰⁹² Në bazë të sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se, megjithëse do të kishte qenë e preferueshme që Trupi Gjykses të kishte konstatuar shprehimisht se Mustafa ishte në dijeni të gjendjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë se, në mungesë të këtij konstatimi të qartë, asnjë trup gjykses i arsyeshëm nuk do të mund të arrinte në përfundimin e Trupit Gjykses se vendimi për të mos liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme ishte faktikisht barabar me një vendim për ta vrarë atë. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e rrëzon këtë argument.

395. Në lidhje me argumentin e Mustafës se nuk u vërtetua që ai kishte dëshirën për refuzimin e ndihmës mjekësore, Paneli i Apelit vëren se konstatimi i Trupit Gjykses se vendimi për të mos liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme ishte barabar me një vendim për ta vrarë atë, nuk u bazua në refuzimin prej Mustafës të ndihmës mjekësore për viktimën e vrasjes së paligjshme. Kur bëri këtë konstatim, Trupi Gjykses iu referua konkretisht dhe vetëm vendimit të Mustafës për të mos liruar ose evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme.¹⁰⁹³ Për këtë arsye, ky argument rrëzohet.

396. Paneli i Apelit do të trajtojë tani parashtrimin e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] dhe se, rrjedhimisht, ata nuk mund të lejonin që viktima e vrasjes së paligjshme të mbetej i gjallë [REDAKTUAR].¹⁰⁹⁴ Në këtë kontekst, Mustafa së pari kundërshton konstatimin e Trupit Gjykses se viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], duke argumentuar se dëshmia e [REDAKTUAR] – tek e cila Trupi Gjykses gaboi që u mbështet – tregon se ishte ZPS-ja që dha emrat e kryesve [REDAKTUAR], dhe jo [REDAKTUAR].¹⁰⁹⁵ Për rrjedhojë, Mustafa parashtron se [REDAKTUAR] nuk kishte

¹⁰⁹² Aktgjykimi, para. 636.

¹⁰⁹³ Aktgjykimi, para. 636.

¹⁰⁹⁴ Dosja e Apelit, para. 370.

¹⁰⁹⁵ Dosja e Apelit, para. 371.

dijeni personale nëse viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR].¹⁰⁹⁶ Paneli i Apelit vëren se – sikurse theksoi edhe Trupi Gjykses¹⁰⁹⁷ – [REDAKTUAR] faktikisht tha që viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR].¹⁰⁹⁸ Për më tepër, në kundërshtim me pretendimin e Mustafës, [REDAKTUAR] viktima e vrasjes së paligjshme u përmendën së pari nga [REDAKTUAR], jo nga ZPS-ja, në kontekstin e identifikimit të atyre që e keqtrajtuat.¹⁰⁹⁹ Rrjedhimisht, Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë gabim në trajtimin e kësaj dëshmie prej Trupit Gjykses. Për këtë arsye, Paneli i Apelit e rrëzon këtë argument.

397. Në lidhje me pretendimin e Mustafës se Trupi Gjykses gaboi që supozoi se kryesit vepruan kundër viktimës së vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], sepse edhe të ndaluarit e tjerë mund të [REDAKTUAR], por megjithatë u liruan,¹¹⁰⁰ Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses nuk u referohet provave në mbështetje të këtij konstatimi.¹¹⁰¹ Për këtë arsye, Paneli i Apelit gjykon se ky konstatim është faktikisht supozim dhe, rrjedhimisht, Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në të për konstatimin e vet. Sidoqoftë, Mustafa nuk ka demonstruar se ky gabim rezultoi në gabim gjyqësor. Në këtë kontekst, Paneli i Apelit vëren karakterin plotësues të këtij konstatimi, meqenëse Trupi Gjykses vuri në dukje se ai “konfirmon” konstatimin mbi synimin e Mustafës për të vrarë.¹¹⁰² Mustafa nuk ka demonstruar se asnjë trup gjykses i arsyeshëm nuk mund të arrinte në përfundimin e Trupit Gjykses se ishte përmbushur elementi i synimit kriminal të krimit të luftës të vrasjes së paligjshme në mungesë të konstatimit se Mustafa dhe vartësit e tij nuk mund të lejonin që viktima e vrasjes së paligjshme të mbetej i gjallë [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e rrëzon këtë argument.

¹⁰⁹⁶ Dosja e Apelit, para. 371.

¹⁰⁹⁷ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

¹⁰⁹⁸ Transkripti (W01679), 4 tetor 2021, f. 892-893 (redaktuar).

¹⁰⁹⁹ Aktgjykimi, para. 543. Shih [REDAKTUAR].

¹¹⁰⁰ Dosja e Apelit, para. 372.

¹¹⁰¹ Shih Aktgjykimin, para. 693.

¹¹⁰² Aktgjykimi, para. 693.

398. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me synimin kriminal të krimit të luftës të vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikat 5A dhe 5B të Apelit të Mustafës.

P. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES MBI KRIMIN E LUFTËS TË TORTURËS (PIKAT 6, 7 TË APELIT)

399. Trupi Gjykses arriti në përfundimin se sjellja e të akuzuarit përmbushte elementet e veprimit të fajshëm dhe synimit kriminal të krimit të luftës të torturës, duke konstatuar se Mustafa dhe anëtarë të tjerë të BIA-s u shkaktuan qëllimisht dhimbje ose vuajtje të rënda fizike dhe mendore të paktën gjashtë personave të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, duke i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar ose duke i diskriminuar të ndaluarit.¹¹⁰³ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit, Mustafa kreu drejtpërdrejt krimin e luftës të torturës kundër W01679-ës dhe W03593-shit, dhe kreu, si pjesë e NKP I, krimin e luftës të torturës kundër së paku gjashtë personave, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].¹¹⁰⁴

400. Mustafa kundërshton përfundimet e Trupit Gjykses në lidhje me: (i) veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të luftës të torturës sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit; dhe (ii) NKP I si një nga format e përgjegjesisë penale mbi të cilat u bazua verdikti i fajësisë së tij për Pikën 3 të Aktakuzës, e ndëshkueshme sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit.¹¹⁰⁵ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave përgjigjen se Mustafa nuk ka arritur të provojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses të torturës sipas Pikës 3 të Aktakuzës.¹¹⁰⁶

¹¹⁰³ Aktgjykimi, para. 678, 685. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 674-677, 679-684.

¹¹⁰⁴ Aktgjykimi, para. 758-759. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 729-733, 742-757.

¹¹⁰⁵ Dosja e Apelit, para. 379-390; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 98-99.

¹¹⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 187-191; Dosja e Përgjigjes së Mbrojtësës së Viktimave, para. 82-86.

1. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të luftës të torturës (Pika 6 e Apelit)

(a) Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve

401. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim faktik që konstatoi se kishte prova të mjaftueshme që vërtetuan veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të luftës të torturës.¹¹⁰⁷ Në lidhje me veprimin e fajshëm, Mustafa argumenton se “asnjëherë nuk pati dëshmitarë të keqtrajtimit fizik” sepse viktimat u keqtrajtuan një nga një dhe jo në grup.¹¹⁰⁸ Konkretisht, Mustafa argumenton se dëshmitari i vetëm okular i keqtrajtimit të një personi tjetër asnjëherë nuk tha se viktimat u keqtrajtuan nga i akuzuari ose anëtarë të tjerë të BIA-s.¹¹⁰⁹ Sa i përket synimit kriminal, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses nuk vërtetoi, por vetëm supozoi qëllimin e nevojshëm të keqtrajtimit, në veçanti sepse kryesit asnjëherë nuk pranuan apo bënë deklaratat, në lidhje me shkaktimin e dhimbjes apo qëllimin e saj.¹¹¹⁰

402. ZPS-ja përgjigjet se argumentet e Mustafës janë përzgjedhëse dhe të pashtjelluara, dhe se kishte prova të mjaftueshme që vërtetuan veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të luftës të torturës.¹¹¹¹ Sa u përket argumenteve të Mustafës në lidhje me veprimin e fajshëm, ZPS-ja parashtron se Mustafa niset prej “premisës së gabuar” se dëshmia e një dëshmitari duhet të konfirmohet nga prova të tjera.¹¹¹² Sipas ZPS-së, Mustafa gjithashtu “shtrembëron Aktgjykimin”, ku u konstatua

¹¹⁰⁷ Dosja e Apelit, para. 379-380, 382, që i referohet Aktgjykimit, para. 678, 685. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 390; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 98.

¹¹⁰⁸ Dosja e Apelit, para. 381.

¹¹⁰⁹ Dosja e Apelit, para. 381.

¹¹¹⁰ Dosja e Apelit, para. 383-385. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 57, ku në nënpikën 1I Mustafa parashtron se “në [as]një prej paragrafëve në Aktgjykim nuk pasqyrohet një synim kriminal konkret i apellesit për të kryer ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme kundër viktimave.”

¹¹¹¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 187.

¹¹¹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 188, që i referohet gjithashtu Dosjes së Përgjigjes së ZPS-së, para. 66-68, në lidhje me argumente të ngjashme të Mustafës në nënpikat 1H dhe 1I, konkretisht se dëshmia e një dëshmitari duhet të konfirmohet nga prova të tjera.

se viktimat që dëshmuar jo vetëm që konfirmuan se ishin keqtrajtuar vetë, por dëshmuar edhe për keqtrajtimin fizik të të tjerëve dhe për forma të tjera të torturës.¹¹¹³ Në lidhje me synimin kriminal të krimit të luftës të torturës, ZPS-ja përgjigjet se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë ndonjë gabim faktik që do të shkaktonte gabim gjyqësor, duke qenë se Trupi Gjyqësor u mbështet në prova të tjera dhe jo në deklaratat e kryesve (në të cilat Mustafa mbështet pretendimin e vet) kur konstatoi se dhimbja u shkaktua me një qëllim konkret.¹¹¹⁴

403. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se Trupi Gjyqësor i përkufizoi siç duhet elementet që përbëjnë krimin e luftës të torturës dhe konstatoi saktë, mbi bazën e tërësisë së provave, se ishin përmbushur elementet mendore.¹¹¹⁵ Konkretisht, Mbrojtësja e Viktimave parashtroi se “dëshmitë e të gjitha viktimave të drejtpërdrejta të dhëna në sallë të gjyqit” mbështesin këtë përfundim.¹¹¹⁶

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

404. Paneli fillimisht vëren se Mustafa nuk kundërshton vetë përkufizimin e kriterëve juridike të torturës si krim lufte, të përcaktuar nga Trupi Gjyqësor. Në këtë aspekt, Paneli pajtohet me konstatimet e Trupit Gjyqësor se: (i) veprimi i fajshëm i krimit të luftës të torturës përbëhet nga një veprim ose mosveprim që shkakton dhimbje ose vuajtje të rëndë, fizike apo mendore, mbi një person tjetër;¹¹¹⁷ dhe (ii) për

¹¹¹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 188, që i referohet Aktgjykimit, para. 530-531, 585, 675. Në seancën e apelit, ZPS-ja gjithashtu parashtroi se Trupi Gjyqësor “përcakttoi saktë ekzistencën e elementeve ligjore të veprimit të fajshëm”. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 69.

¹¹¹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 189, që i referohet Aktgjykimit, para. 679-685. Në seancën e apelit, ZPS-ja shtjelloi më tej se, sipas Trupit Gjyqësor, ekzistenca e synimit kriminal u bazua, ndër të tjera, në: pjesëmarrjen personale të Mustafës në keqtrajtimin e W01679-ës dhe W03593-shit; marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e institucionalizuar të të ndaluarve nga ana e vartësve të Mustafës në BIA; refuzimin e ushqimit, ujit dhe kujdesit mjekësor të mjaftueshëm dhe të përdorimit të nevojshëm të pajisjeve sanitare; dhe dijeninë për gjendjen e të ndaluarve dhe objektin e ndalimit. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 69-70.

¹¹¹⁵ Dosja e Përgjigjes së Mbrojtësës së Viktimave, para. 82-84.

¹¹¹⁶ Dosja e Përgjigjes së Mbrojtësës së Viktimave, para. 85, që u referohet dëshmimeve të disa “viktimave të drejtpërdrejta”.

¹¹¹⁷ Aktgjykimi, para. 668. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 290; *Kunarac et al.* Appeal Judgment, para. 142, 149; *Furundžija* Appeal Judgment, para. 111; Aktgjykimin *Limaj dhe*

elementin e synimit kriminal duhet që kryesi ta ketë pasur synim shkaktimin e dhimbjes dhe vuajtjes, me qëllim marrjen e informacionit ose deklaratave pranuese, ose ndëshkimin, frikësimin, shtrëngimin ose diskriminimin, për çfarëdo arsyeje, të viktimës ose një personi të tretë.¹¹¹⁸

405. Fillimisht, në lidhje me argumentin e Mustafës se elementet e veprimit të fajshëm të torturës nuk janë vërtetuar, sepse të tjerët “nuk ishin asnjëherë dëshmitarë të keqtrajtimit fizik”,¹¹¹⁹ Paneli vëren se pretendimi i Mustafës se dëshmia e një dëshmitari duhet të konfirmohet nga prova të tjera përsëritet edhe gjetkë në Dosjen e Apelit.¹¹²⁰ Paneli edhe një herë thekson se nuk ka një kriter të përgjithshëm që dëshmia e një dëshmitari duhet të konfirmohet nga prova të tjera, në rast se gjykohet e besueshme.¹¹²¹

406. Sidoqoftë, Paneli vëren se Mustafa keqinterpretonte Aktgjykimin e Trupit Gjykses dhe shpërfill faktin se të gjithë dëshmitarët për të cilët pretendohesh se ishin keqtrajtuar, gjithashtu dëshmuuan për keqtrajtimin që pësuan të tjerët, ndër të tjera edhe në praninë e tyre. Për shembull, Trupi Gjykses konstatoi se “W01679 dhe W03593 dhanë dëshmi reciprokisht konfirmuese në lidhje me keqtrajtimin fizik që të ndaluarit pësuan çdo ditë në ahurin ku u mbajtën.”¹¹²² Megjithëse në konstatimet e

të tjerët, para. 235-237; *Kvočka et al.* Judgement, para. 141-151; *Ongwen* Judgement, para. 2700; *Duch* Judgement, para. 354-355; Torture Convention, neni 1; Rome Statute, neni 7(2)(e); ICC Elements of Crimes, neni 8(2)(c)(i)-4. Gjithashtu, ndryshe nga ajo që thuhet në nenin 1 të Torture Convention, përfshirja e një zyrtari nuk është kusht që një vepër të përbëjë torturë. Shih *Kunarac et al.* Appeal Judgement, para. 148; *Kvočka et al.* Appeal Judgement, para. 284; Aktgjykimin *Limaj dhe të tjerët* Aktgjykimin, para. 240; *Duch* Judgement, para. 357; Aktgjykimin, para. 671.

¹¹¹⁸ Aktgjykimi, para. 672. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 290; *Kunarac et al.* Appeal Judgement, para. 142, 153; *Furundžija* Appeal Judgement, para. 111; Aktgjykimin *Limaj dhe të tjerët*, para. 235, 238-239; *Ongwen* Judgement, para. 2705-2706; *Duch* Judgement, para. 356; Torture Convention, neni 1; Rome Statute, neni 7(2)(e); ICC Elements of Crime, neni 8(2)(c)(i)-4.

¹¹¹⁹ Dosja e Apelit, para. 381.

¹¹²⁰ Shih, p.sh., Dosjen e Apelit, para. 53-61. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 90, 180-185, 217, 220, 279, 329.

¹¹²¹ Shih më lart, para. 38.

¹¹²² Aktgjykimi, para. 529. Për shembull, W01679 dha dëshmi të hollësishme në lidhje me keqtrajtimin që pësuan të ndaluarit në ahur, ndër të cilët W03593, viktimat e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Shih Transkriptin (W01679), 4 tetor 2021, f. 885-886, 888-890 (redaktuar), 894-896

Trupit Gjykues përcaktohet se dëshmitarët u çuan dhe keqtrajtuat në dhomën e marrjes në pyetje një nga një, Trupi Gjykues konstatoi gjithashtu se ata panë edhe të ndaluar të tjerë që u çuan lart në atë dhomë¹¹²³ dhe dëgjuan, nga ahuri, britmat e të ndaluarve të tjerë teksa keqtrajtoheshin.¹¹²⁴ Për më tepër, Trupi Gjykues theksoi se dëshmitarët dëshmuar për gjendjen në të cilën ishin të ndaluarit e tjerë kur i kthenin nga dhoma e marrjes në pyetje dhe përshkruan rraskapitjen, lëndimet dhe shenjat nga rrahjet¹¹²⁵ – gjendje kjo që për disa të ndaluar konfirmohet më tej nga raporte mjekësore¹¹²⁶ dhe dëshmi të dëshmitarëve që i panë ditën kur u liruan.¹¹²⁷

407. Së dyti, argumenti i Mustafës në lidhje me kriterin e veprimit të fajshëm shpërfill gjithashtu faktin që Trupi Gjykues nuk konstatoi se keqtrajtimi fizik ishte forma e vetme e torturës që pësuan të ndaluarit. Krahas keqtrajtimit fizik, Trupi Gjykues përshkroi me hollësi edhe keqtrajtimin psikologjik që pësuan të ndaluarit kur, për shembull, “panë keqtrajtimin brutal që iu bë të ndaluarve të tjerë [...] dhe si

(redaktuar), 900-901 (redaktuar); Transkriptin (W01679), 5 tetor 2021, f. 983. W03593 dëshmoi se çdo natë anëtarë të BIA-s hynin në ahur dhe godisnin me shuplaka e shkelma të gjithë të ndaluarit, përfshirë [REDAKTUAR] dhe viktimën e vrasjes së paligjshme. Shih Transkriptin (W03593), 20 shtator 2021, f. 441-445 (redaktuar); Transkriptin (W03593), 22 shtator 2021, f. 575-577 (redaktuar). Krahas kësaj, W03593 dëshmoi se W03594 u keqtrajtua në ahur njësoj si të gjithë të ndaluarit e tjerë. Shih Transkriptin (W03593), 20 shtator 2021, f. 453 (redaktuar); Transkriptin (W03593), 22 shtator 2021, f. 576-577 (redaktuar). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 559.

¹¹²³ Aktgjykimi, para. 548 (që i referohet Transkriptit (W01679), 4 tetor 2021, f. 895-896 (redaktuar)), 562 (që i referohet Transkriptit (W01679), 4 tetor 2021, f. 894 (redaktuar)), 575 (që i referohet Transkriptit (W01679), 4 tetor 2021, f. 889, 894-895 (redaktuar)), 577 (që i referohet Transkriptit (W01679), 4 tetor 2021, f. 900-901 (redaktuar); Transkriptin (W03593), 20 shtator 2021, f. 444-445 (redaktuar)).

¹¹²⁴ Aktgjykimi, para. 530, që i referohet Transkriptit (W03593), 20 shtator 2021, f. 476-477; Transkriptit (W01679), 4 tetor 2021, f. 890-891, 896 (redaktuar).

¹¹²⁵ Aktgjykimi, para. 531, 548 (që i referohet dëshmisë së W01679-ës në lidhje me keqtrajtimin e W03593-shit), 562 (që i referohet dëshmisë së W01679-ës në lidhje me keqtrajtimin e W03594-ës), 569-574 (që i referohet dëshmise të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës në lidhje me keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme), 575 (që i referohet dëshmisë së W01679-ës në lidhje me keqtrajtimin e [REDAKTUAR]), 577 (që i referohet dëshmise të W01679-ës dhe W03593-shit në lidhje me keqtrajtimin e [REDAKTUAR]).

¹¹²⁶ Aktgjykimi, para. 531, 567, poshtëshënimi 1199 (që i referohet [REDAKTUAR]), 540 (që i referohet [REDAKTUAR]), 550 (që i referohet P00021 (konfidenciale), f. 1-2 (dokumentacioni mjekësor i W03593-shit)).

¹¹²⁷ Aktgjykimi, para. 548 (që i referohet dëshmisë së W04391-shit në lidhje me W03593-shin), 575 (që i referohet dëshmisë së W04391-shit në lidhje me [REDAKTUAR]). Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 512, që u referohet dëshmise të W04390-s dhe W04391-shit për të ndaluarit që panë ditën kur u liruan.

pasojë [...] jetonin në frikë të vazhdueshme se mund të ishin në radhë për t'u keqtrajtuar".¹¹²⁸ Mustafa gjithashtu shpërfill konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me kushtet çnjerëzore në të cilat u mbajtën të ndaluarit gjatë të gjithë kohës që u mbajtën në kompleksin e ndalimit në Zllash, në veçanti kushtet e mjerueshme të jetesës dhe fjetjes të cilat ishin "të papërshtatshme për qenie njerëzore", sasi të pamjaftueshme të ushqimit dhe ujit, mundësinë e kufizuar apo pamundësinë për të përdorur pajisjet sanitare, refuzimin e ndihmës mjekësore, dhe ndalimin e komunikimit me njëritjetrin.¹¹²⁹ Sikurse theksoi Trupi Gjykses, dëshmitarët përkatës – në veçanti W01679, W03593 dhe W04669 – dhanë dëshmi reciprokisht konfirmuese dhe të besueshme në lidhje me këto kushte, ose aspekte kyçe të tyre.¹¹³⁰ Për këto arsye, Mustafa nuk arrin të demonstrojë gabim në vlerësimin dhe konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me keqtrajtimin fizik dhe psikologjik që pësuan të ndaluarit dhe kushtet e ndalimit të tyre.

408. Paneli tani do të shqyrtojë pretendimin e Mustafës se W04669, si dëshmitari i vetëm okular i keqtrajtimin të një personi tjetër, asnjëherë nuk deklaroi se viktima u keqtrajtua "nga apeluesi dhe anëtarë të tjerë të BIA-s në kompleksin [e ndalimit në Zllash]".¹¹³¹ Paneli para së gjithash thekson se Trupi Gjykses u mbështet në dëshmitë e disa dëshmitarëve okularë gjatë gjykimit, ndër të cilët W04669, kur konstatoi se ata që keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash ishin anëtarë të UÇK-së që i përkisnin njësitit BIA, ndër të cilët edhe i akuzuari.¹¹³² Paneli gjithashtu thekson se mbështetja e Mustafës në një pjesë të

¹¹²⁸ Aktgjykimi, para. 530-533, 548.

¹¹²⁹ Aktgjykimi, para. 501-527.

¹¹³⁰ Aktgjykimi, para. 503-508, 511-513, 516-518, 521, 523-524 dhe referencat e cituara aty. Sa u përket argumenteve të Mustafës që kundërshtojnë besueshmërinë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës, Paneli i Apelit u referohet konstatimeve të veta në lidhje me nënpikën 2E, ku konstatoi se Mustafa nuk demonstroi se asnjë gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të pranonte dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës për identifikimin e vendit të ndalimit, apo se konstatimet e Trupit Gjykses ishin tërësisht të gabuara. Shih më lart, para. 212.

¹¹³¹ Dosja e Apelit, para. 381.

¹¹³² Shih, veçanërisht, Aktgjykimin, para. 498-500, 541-545, 551-556, 567-568, që mbështeten në dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës. Shih gjithashtu pjesën mbi vlerësimin e përgjithshëm të dëshmitarëve të ZPS-së, veçanërisht Aktgjykimin, para. 58-65 (W01679), 66-74 (W03593), 75-83

përzgjedhur të dëshmisë së W04669-ës kur argumenton se W04669 “asnjëherë nuk deklaroi se ata që keqtrajtuuan atë person ishin i akuzuari dhe anëtarët e BIA-s”, është çorientuese.¹¹³³ Përkundrazi, nga dëshmia e W04669-ës, marrë në tërësi, Trupi Gjykses vërejti se: (i) ai i përshkroi kryesit në mënyrë të ngjashme si dëshmitarët e tjerë; (ii) ai u mbajt në kompleksin e ndalimit në Zllash që kontrollohej nga BIA dhe ishte nën kontrollin dhe pushtetin e të akzuarit; dhe (iii) kryesit përdorën të njëjtën mënyrë veprimi në keqtrajtimin e të ndaluarve.¹¹³⁴ Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me këtë aspekt. Për pasojë, argumentet e Mustafës në lidhje me veprimin e fajshëm të torturës si krim lufte, rrëzohen.

409. Sa i përket kriterit të synimit kriminal, Paneli vëren se Mustafa thjesht pohon, pa shtjellim të mëtejshëm, se Trupi Gjykses “vetëm supozoi” qëllimin e nevojshëm të shkakimit të dhimbjes ose vuajtjes dhe se kryesit asnjëherë nuk pranuan ose deklaruan se shkaktimi i dhimbjes u bë me një qëllim konkret.¹¹³⁵

(W03594), 84-90 (W04669). Në lidhje me W01679-ën, Paneli rithekson konstatimet e veta se Trupi Gjykses nuk i dha peshë të tepruar identifikimit fotografik të Mustafës nga W01679 në sallën e gjyqit dhe, në veçanti, peshoi me kujdes mbështetshmërinë në dëshminë e W01679-ës duke mbajtur parasysh prova të tjera në dokumentacionin e çështjes gjyqësore, dhe trajtoi me kujdes identifikimin e të akzuarit prej W01679-ës. Shih më lart, para. 91-92. Në lidhje me W03593-shin, Paneli vëren se nuk konstatoi asnjë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses të besueshmërisë së W03593-shit, i cili e identifikoi të akzuarin si personi që bëri sikur do ta ekzekutonte duke i vënë revolen në kokë, dhe që e rrahu dhe e mori në pyetje gjatë një incidenti të dytë. Shih më lart, para. [REDAKTUAR]. Sa i përket W03594-ës, Paneli i Apelit u referohet konstatimeve të veta në lidhje me nënpikën 1F, ku konstatoi se W03594 dëshmoi në një mënyrë që nuk përputhej me deklaratat e mëparshme të tij dhe se Trupi Gjykses nuk gaboi që e lejoi ZPS-në ta ballafaqonte W03594-ën me deklaratat e mëparshme të tij dhe t'i bënte pyetje sugjeruese. Shih më lart, para. 135.

¹¹³³ Dosja e Apelit, para. 381.

¹¹³⁴ Aktgjykimi, para. 499-500, 567-568. Trupi Gjykses në veçanti theksoi se “W01679, W03593, W04669 dhe W03594 dëshmuuan se individët të cilët i keqtrajtuuan ose i morën në pyetje të ndaluarit, bënë rojë tek ahuret dhe/ose i shoqëronin ata brenda territorit të kompleksit të ndalimit në Zllash, mbanin (pjesërisht) uniforma – disa me emblemën e BIA-s ose të UÇK-së – ishin të armatosur dhe flisnin shqip”. Shih Aktgjykimin, para. 499. Shih gjithashtu Transkriptin (W04669), 10 nëntor 2021, f. 1437-1438, 1442.

¹¹³⁵ Dosja e Apelit, para. 383-385.

410. Paneli rikujton elementin e synimit kriminal të krimit të luftës të torturës të përshkruar me hollësi më lart¹¹³⁶ dhe vëren se Trupi Gjykses nuk pranoi argumentet përmyllëse të Mbrojtjes se keqtrajtimi u krye pa asnjë qëllim ose objektiv të veçantë por, përkundrazi, konstatoi se qëllimi i nevojshëm u vërtetua “qartësisht” në bazë të provave.¹¹³⁷ Konkretisht, Trupi Gjykses u mbështet në dëshmitë e disa të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash (W01679, W03593, W03594 dhe W04669) kur konstatoi se anëtarë të BIA-s, ndër të cilët edhe i akuzuari, synonin: (i) të merrnin informacion nga të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash;¹¹³⁸ (ii) t’i detyronin të pranonin se ishin spiunë, tradhtarë, hajdutë, gënjeshtarë, ose bashkëpunëtorë të serbëve;¹¹³⁹ (iii) t’i frikësonin nëpërmjet ekzekutimeve të simuluar, t’i kërcënonin me vdekje, ose t’i detyronin të shihnin keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë;¹¹⁴⁰ dhe (iv) t’i diskriminonin dhe keqtrajtonin për shkak të bindjeve të tyre politike, sepse disa prej tyre ishin anëtarë ose përkrahës të partive politike që konsideroheshin si kundërshtarë të UÇK-së.¹¹⁴¹

411. Duke mbajtur parasysh këto konstatime, Paneli i Apelit gjykon se përfundimi i Trupit Gjykses se qëllimi konkret i keqtrajtimit u vërtetua, mbështetet nga provat dhe është arsyetuar në masë të mjaftueshme.¹¹⁴²

412. Në bazë të sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses të kriterëve të veprimit të fajshëm dhe synimit kriminal të krimit të luftës të torturës, dhe rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 6 të Apelit të Mustafës.

¹¹³⁶ Shih më lart, para. 404.

¹¹³⁷ Aktgjykimi, para. 582.

¹¹³⁸ Aktgjykimi, para. 582-583. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 579 (që i referohet Aktgjykimit, para. 534-535, 545, 547, 556, 567-568), 680, 682-683.

¹¹³⁹ Aktgjykimi, para. 582-583. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 579 (që i referohet Aktgjykimit, para. 534-535, 545, 556, 566-568, 572, 574-576), 679, 683.

¹¹⁴⁰ Aktgjykimi, para. 582-583. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 579 (që i referohet Aktgjykimit, para. 523-525, 530-532, 546-547, 556), 679-680, 682-683.

¹¹⁴¹ Aktgjykimi, para. 582-583, 683. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 580.

¹¹⁴² Trupi Gjykses, para. 684-685. *Contra* Dosja e Apelit, para. 384-385.

2. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi fajësinë e të akuzuarit për krimin e luftës të torturës në bazë të NKP I (Pika 7 e Apelit)

(a) Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

413. Mustafa argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe faktik që e shpalli fajtor për torturimin e së paku gjashtë personave, kur Trupi Gjykses konstatoi vetëm se ai mori pjesë personalisht në torturimin e dy personave.¹¹⁴³ Mustafa argumenton se nuk mund të mbahet përgjegjës për krime që pretendohet se u kryen nga të tjerë kundër “së paku pesë personave”, dhe se për rrjedhojë, ishte e gabuar që u shpall fajtor në bazë të NKP I.¹¹⁴⁴

414. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses përcaktoi saktë elementet e përgjegjësisë penale në bazë të NKP I.¹¹⁴⁵ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave parashtrojnë gjithashtu se Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi se Mustafa dha kontribut të qenësishëm në realizimin e qëllimit të përbashkët, që “tejkaloj ndjeshëm kriterin për përmbushjen e këtij elementi”.¹¹⁴⁶

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

415. Sipas Panelit, kundërshtimi i Mustafës – sikurse është paraqitur në Dosjen e Apelit – ka të bëjë me verdiktin e fajësisë së tij në bazë të NKP I për aktet e torturës të kryera nga anëtarë të tjerë të BIA-s, me të cilin ai pretendon se Trupi Gjykses gaboi

¹¹⁴³ Dosja e Apelit, para. 386-387. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 390; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 99.

¹¹⁴⁴ Dosja e Apelit, para. 388-389. Në lidhje me numrin e viktimave, shih më lart poshtëshënimin 5, që i referohet poshtëshënimin 703 të Aktgjykimit.

¹¹⁴⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 191. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 190.

¹¹⁴⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 191, citon Aktgjykimin, para. 749; Dosja e Përgjigjes së Mbrojtësës së Viktimave, para. 86.

që e shpalli fajtor për “torturimin e së paku gjashtë personave” kur, sipas tij, Trupit Gjykses konstatoi se ai “mori pjesë në torturimin e vetëm dy personave”.¹¹⁴⁷

416. Fillimisht, Paneli i Apelit vëren se, në Dosjen e Apelit, Mustafa paraqet kundërshtime në lidhje me konstatimet për fajësinë e tij në bazë të NKP I, të cilat nuk i paraqiti në Njoftimin për Apel.¹¹⁴⁸ Një mangësi e tillë në parim do të përlligjite rrëzimin e menjëhershëm të këtyre argumenteve.¹¹⁴⁹ Sidoqoftë, për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë, Paneli i Apelit vendos të bëjë përjashtim dhe t'i shqyrtojë argumentet e Mustafës të paraqitura në Pikën 7 të Apelit, duke mbajtur parasysh rëndësinë e këtij aspekti për verdiktin e fajësisë së Mustafës për torturimin e së paku gjashtë personave sipas paragrafëve 29-30 dhe 34-35 të Aktakuzës.

417. Së pari, Paneli vëren se, megjithëse pretendon gabim juridik në konstatimet e Trupit Gjykses,¹¹⁵⁰ Mustafa nuk kundërshton përkufizimin e Trupit Gjykses të elementeve objektive dhe subjektive të përgjegjësisë penale në bazë të NKP I, përfshirë edhe nivelin e kontributit të nevojshëm.¹¹⁵¹ Mustafa e bazon këtë pikë të apelit thjesht në pretendimin e vet se “u konstatua dhe përcaktua gabimisht se qëllimi i përbashkët i supozuar i tij dhe/ose i të tjerëve ishte ndërmarrje e përbashkët kriminale”.¹¹⁵²

418. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit thekson konstatimet e Trupit Gjykses se Mustafa dhe anëtarë të BIA-s, si dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së kishin qëllimin e përbashkët për të ndaluar dhe torturuar të ndaluarit për shkak të dyshimeve të pretenduara ndaj tyre, si dhe – në rastin e viktimës së vrasjes së paligjshme – për ta

¹¹⁴⁷ Shih Dosjen e Apelit, para. 386-389. Paneli vëren se në paragrafin 389 të Dosjes së Apelit, Mustafa përmend jo vetëm Pikën 3 të Aktakuzës (torturë), por edhe Pikat 1 dhe 4 të aktakuzës (përkatësisht, ndalim arbitrar dhe vrasje e paligjshme) të Aktakuzës. Paneli vëren se në Pikën 7 të Apelit, Mustafa nuk paraqet argumente në lidhje me verdiktin e fajësisë për Pikat 1 dhe 4 të Aktakuzës në bazë të NKP I, dhe rrjedhimisht nuk do ta shqyrtojë këtë më tej.

¹¹⁴⁸ *Krahaso* Njoftimin për Apel, para. 10, që i referohet Aktgjykimit, para. 685, 733, *me* Dosjen e Apelit, para. 386-389, që i referohet gjithashtu, ndër të tjera, Aktgjykimit, para. 674-684, 748, 753-754, 757, 759.

¹¹⁴⁹ Shih më lart, para. 31.

¹¹⁵⁰ Dosja e Apelit, para. 386.

¹¹⁵¹ Aktgjykimi, para. 737-741. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 191.

¹¹⁵² Dosja e Apelit, para. 389.

ndaluar, torturuar dhe përfundimisht për ta vrarë atë.¹¹⁵³ Për më tepër, Trupi Gjykses konstatoi se Mustafa jo vetëm që dha “kontribut të qenësishëm” në realizimin e qëllimit të përbashkët, por gjithashtu se kontributi i tij “tejkaloj ndjeshëm kriterin për përmbushjen e këtij elementi”.¹¹⁵⁴

419. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me fajësinë e tij për krimin e luftës të torturës në bazë të NKP I. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 7 të Apelit të Mustafës.

Q. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES MBI BAZËN LIGJORE TË KRIMIT TË LUFTËS TË NDALIMIT ARBITRAR (PIKA 8 E APELIT)

420. Trupi Gjykses hodhi poshtë argumentin e Mbrojtjes se ndalimi arbitrar si krim lufte i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk ka bazë ligjore në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.¹¹⁵⁵ Pasi arriti në përfundimin se ishin përmbushur elementet e veprimit të fajshëm dhe synimit kriminal,¹¹⁵⁶ Trupi Gjykses e shpalli Mustafën fajtor për krimin e luftës të ndalimit arbitrar.¹¹⁵⁷

421. Mustafa kundërshton konstatimin e Trupit Gjykses se ndalimi arbitrar i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, përbën krim lufte në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit.¹¹⁵⁸ ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mustafës duhen rrëzuar

¹¹⁵³ Aktgjykimi, para. 745-747. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 742-744.

¹¹⁵⁴ Aktgjykimi, para. 749-751.

¹¹⁵⁵ Aktgjykimi, para. 640-645.

¹¹⁵⁶ Aktgjykimi, para. 652-659.

¹¹⁵⁷ Aktgjykimi, para. 831. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 759.

¹¹⁵⁸ Dosja e Apelit, para. 391, 399, që i referohet Aktgjykimit, para. 645. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 392-398, 400; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 100.

menjëherë.¹¹⁵⁹ ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave gjithashtu argumentojnë se ai nuk ka arritur të demonstrojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykues.¹¹⁶⁰

1. Parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve

422. Mustafa parashtron se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se ndalimi arbitrar i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar përbën krim lufte brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara¹¹⁶¹ dhe argumenton se ky gabim e bën të pavlefshëm verdiktin e fajësisë për Pikën 1 të Aktakuzës.¹¹⁶² Konkretisht, Mustafa kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykues në dy vendime të apelit në të cilat Dhoma e Gjykatës së Apelit shqyrtoi këtë aspekt që “ende nuk është shqyrtuar [nga] Gjykata Supreme [e Dhomave të Specializuara]”.¹¹⁶³

423. Sipas Mustafës, megjithëse konstatoi se lista e krimeve të renditura në nenin 14(1)(c) të Ligjit nuk është shteruese, Dhoma e Gjykatës së Apelit nuk e autorizoi Trupin Gjykues që të përfshinte në listë edhe ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.¹¹⁶⁴ Mustafa argumenton se Trupi Gjykues nuk shpjegoi se si krimi i luftës i ndalimit arbitrar i kryer gjatë një konflikti të armatosur jondërkombëtar përfshihej sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në juridiksionin kohor të Dhomave të Specializuara.¹¹⁶⁵

424. Mustafa kërkon që Paneli i Apelit të pezullojë procedurën e apelit dhe t’ia referojë këtë aspekt Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit

¹¹⁵⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 192-194.

¹¹⁶⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 192-194; Dosja e Përgjigjes së Mbrojtësës së Viktimave, para. 88-91.

¹¹⁶¹ Dosja e Apelit, para. 391, 399, që i referohet Aktgjykimit, para. 645. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 100.

¹¹⁶² Dosja e Apelit, para. 399-400.

¹¹⁶³ Dosja e Apelit, para. 391, 396.

¹¹⁶⁴ Dosja e Apelit, para. 396. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 392-395.

¹¹⁶⁵ Dosja e Apelit, para. 394-396. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 392. Paneli vëren se në paragrafin 394 të Dosjes së Apelit Mustafa i referohet gabimisht paragrafit 612, në vend të paragrafit 642, të Aktgjykimit.

113(8) të Kushtetutës së Kosovës, si aspekt i përputhshmërisë kushtetuese të Ligjit me Kushtetutën e Kosovës.¹¹⁶⁶

425. Së fundi, Mustafa kundërshton interpretimin e Dhomës së Gjykatës së Apelit të shprehjeve “në lidhje me” në nenin 162(1) të Kushtetutës së Kosovës dhe “që kanë të bëjnë me” në nenin 6(1) të Ligjit, dhe konstatimin e Gjykatës së Apelit se juridiksioni i Dhomave të Specializuara nuk kufizohet vetëm në akuzat e përfshira në Raportin e Këshillit të Evropës.¹¹⁶⁷

426. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses ishte i detyruar të bazohej në jurisprudencën e Dhomës së Gjykatës së Apelit dhe në precedentë gjyqësorë se ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar përbën krim lufte brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.¹¹⁶⁸ Në këtë kontekst, ZPS-ja parashtrohet se Mustafa nuk ka dhënë asnjë arsye bindëse se pse Paneli i Apelit duhet të devijojë nga vendimet e veta të mëparshme.¹¹⁶⁹ ZPS-ja gjithashtu parashtrohet se kërkesa e Mustafës për referimin e këtij aspekti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese bie ndesh me paralajmërimin e shprehur qartë të kësaj të fundit që së pari të shfrytëzohen të gjitha mjetet juridike efektive.¹¹⁷⁰ Së fundi, ZPS-ja argumenton se kundërshtimi i Mustafës në lidhje me interpretimin e nenit 1 të Ligjit nga Dhoma e Gjykatës së Apelit duhet hedhur poshtë menjëherë sepse (i) Mustafa nuk kundërshtoi juridiksionin e Dhomave të Specializuara në fazën e duhur të procesit; dhe (ii) parashttrimet e tij dalin jashtë kuadrit të Njoftimit për Apel.¹¹⁷¹

¹¹⁶⁶ Dosja e Apelit, para. 397. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 393.

¹¹⁶⁷ Dosja e Apelit, para. 398.

¹¹⁶⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 192.

¹¹⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 192.

¹¹⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 193, që i referohet Vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi Kërkesat Referuese të Krasniqit dhe Veselit në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 56.

¹¹⁷¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 194. Në seancën e apelit, ZPS-ja theksoi më tej se Trupi Gjykses konstatoi ekzistencën si të elementeve materiale, ashtu edhe të elementeve mendore, të krimit të ndalimit arbitrar, dhe rikujtoi faktorët e ndryshëm që kanë lidhje me synimin kriminal të Mustafës. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 68-69.

427. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se: (i) Dhoma e Gjykatës së Apelit tashmë e ka shprehur qartë faktin se lista e krimeve të luftës në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk është shteruese;¹¹⁷² dhe se (ii) në të drejtën zakonore ndërkombëtare, statusi i krimit të luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur, përfshirë konfliktin e armatosur jondërkombëtar, është më se i përcaktuar.¹¹⁷³

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

428. Fillimisht, Paneli thekson se Mustafa paraqiti mocion paraprak sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores, ku ngriti kundërshtimin që tani është përfshirë në këtë Pikë të Apelit.¹¹⁷⁴ Trupi Gjykues e hodhi poshtë mocionin për arsye procedurale, pasi ishte paraqitur pas afatit përkatës i cili synon të sigurojë që, në parim, aspektet lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara të zgjidhen, përfshirë edhe në shkallë të apelit, përpara se çështja t'i kalohet Trupit Gjykues.¹¹⁷⁵ Edhe pse Mustafa nuk e paraqiti brenda afatit kundërshtimin në lidhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar, për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë, Paneli vendos të bëjë përjashtim dhe t'i shqyrtojë argumentet e tij, duke qenë se ky aspekt i ngritur ndikon drejtpërdrejt në verdiktin e fajësisë së Mustafës për krimin e luftës të ndalimit arbitrar.

429. Paneli i Apelit vëren se në Pikën 8 të Apelit, Mustafa në fakt kundërshton dy vendime të mëparshme të Dhomës së Gjykatës së Apelit mbi të cilat Trupi Gjykues i bazoi konstatimet e veta për të arritur në përfundimin se ndalimi arbitrar i kryer në

¹¹⁷² Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 88.

¹¹⁷³ Dosja e Përgjigjes së Viktimave, para. 89-90.

¹¹⁷⁴ Mocioni Paraprak i Mbrojtjes mbi Juridiksionin, para. 130-149.

¹¹⁷⁵ Vendimi që Hedh Poshtë Mocionin e Mbrojtjes për Kundërshtimin e Juridiksionit, para. 6-10. Shih gjithashtu nenet 33(1)(b), 39(1), 40(1), 45(2) të Ligjit; rregullat 97, 98(1) të Rregullores.

një konflikt të armatosur jondërkombëtar përbënte krim lufte sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.¹¹⁷⁶

430. Në lidhje me sa më lart, Paneli i Apelit rithekson konstatimin e mëparshëm të Dhomës së Gjykatës së Apelit se: (i) formulimi i nenit 14(1)(c) të Ligjit lë të kuptohet se lista nuk është shteruese dhe se juridiksioni i Dhomave të Specializuara nuk përfshin vetëm veprat e renditura shprehimisht në këtë dispozitë;¹¹⁷⁷ (ii) formulimi joshterues i dispozitës nuk shkel parimin e sigurisë juridike (*lex certa*) meqenëse, që një vepër të përfshihet në Ligj dhe rrjedhimisht të jetë brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, duhet që ajo të ketë ekzistuar sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara dhe duhet të përbëjë shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3;¹¹⁷⁸ (iii) ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3 dhe ndalimi bëhet arbitrar dhe përbën shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3 kur shkelet parimi i trajtimit njerëzor, pavarësisht nëse ka bazë ligjore për ndalimin e një personi;¹¹⁷⁹ dhe (iv) ndalimi arbitrar gjatë një konflikti të armatosur jondërkombëtar përbënte vepër penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë periudhës që ka lidhje me akuzat, dhe ky penalizim ishte i disponueshëm dhe i parashikueshëm për të akuzuarin në periudhën përkatëse.¹¹⁸⁰

¹¹⁷⁶ Aktgjykimi, para. 642-645, që i referohet Vendimit të Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 87, 89, 97, 99, 102, 106-111; Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 44-46.

¹¹⁷⁷ Vendimi i Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 87; Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 44.

¹¹⁷⁸ Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 44, 46. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 89.

¹¹⁷⁹ Vendimi i Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 96-97, 102; Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 45.

¹¹⁸⁰ Vendimi i Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 109, 111; Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 46. Rrjedhimisht, ky penalizim është në përputhje me parimin *nullum crimen sine lege praevia*, që do të thotë se nuk ka krim në qoftë se vepra penale përkatëse nuk ekzistonte si e tillë në kohën e kryerjes së saj.

431. Paneli thekson se Mustafa nuk arrin të shpjegojë se si Trupi Gjykses gaboi që iu përmbajt vendimeve të Dhomës së Gjykatës së Apelit.¹¹⁸¹ Paneli rikujton se një panel i apelit pritet që t'u përmbahet vendimeve të mëparshme të Dhomës së Gjykatës së Apelit dhe devijon prej tyre vetëm për arsye bindëse në interes të drejtësisë.¹¹⁸² Duke qenë se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë (i) gabim juridik në vendimet e Dhomës së Gjykatës së Apelit; dhe, rrjedhimisht, (ii) ekzistencën e arsyeve bindëse në interes të drejtësisë për të devijuar nga vendimet e lartpërmendura, Paneli i Apelit rrëzon argumentet e tij në lidhje me këtë pikë.

432. Sa i përket kërkesës së Mustafës që ky aspekt t'i referohet Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Paneli rithekson se, në përputhje me nenin 113(8) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 49(4) të Ligjit, një panel mund t'i referojë Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese pyetje për kushtetutshmërinë e një ligji nëse, midis të tjerash, nuk është i sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën e Kosovës.¹¹⁸³ Sikurse demonstron në vlerësimin e mësipërm, nuk ekziston pasiguri. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon kërkesën e Mustafës për t'ia referuar aspekt Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

433. Së fundi, sa i përket kundërshtimit të Mustafës në lidhje me interpretimin e nenit 162(1) të Kushtetutës së Kosovës dhe të nenit 6(1) të Ligjit nga Dhoma e Gjykatës së Apelit, ku argumenton se juridiksioni i Dhomave të Specializuara kufizohet rreptësisht vetëm tek krimet "që lidhen me përfundimet e Raportit të Këshillit të Evropës",¹¹⁸⁴ Paneli thekson se këto argumente janë qartësisht jashtë kuadrit të

¹¹⁸¹ Dosja e Apelit, para. 394-396; Aktgjykimi, para. 642-644, që i referohet Vendimit të Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 87, 89, 97, 99, 102, 106-11; Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 44-46.

¹¹⁸² Shih më lart, para. 41.

¹¹⁸³ Shih, për ngjashmëri, Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet ndaj Ligjshmërisë në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 71.

¹¹⁸⁴ Dosja e Apelit, para. 398.

Njoftimit për Apel dhe nuk u paraqitën në përputhje me rregullën 97 të Rregullores.¹¹⁸⁵

Për këtë arsye, Paneli i Apelit rrëzon argumentet e Mustafës në lidhje me këtë aspekt.¹¹⁸⁶

434. Në përputhje me sa më lart, Paneli konstaton se Mustafa nuk arrin të provojë se Trupi Gjykses bëri gabim juridik në lidhje me bazën ligjore të krimit të luftës të ndalimit arbitrar. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 8 të Apelit të Mustafës.

R. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES MBI PËRCAKTIMIN E DËNIMIT (NËNPIKAT 9A, 9B, 9C, 9D, 9E, 9F, 9G, 9H, 9I, 9J, 9K TË APELIT)

435. Në Aktgjykim, Trupi Gjykses përcaktoi qëllimet e dënimit dhe dispozitat ligjore përkatëse të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara.¹¹⁸⁷ Trupi Gjykses konstatoi se duhej të merrte parasysh dënimet e përcaktuara në legjislacionin që ishte në fuqi në Kosovë në kohën e kryerjes së krimeve, si edhe çdo dënim më të butë të mëvonshëm, por përfundimisht konstatoi se “aspekte të tilla nuk kanë fuqi detyruese” mbi të.¹¹⁸⁸ Trupi Gjykses më tej evidentoi faktorët që do të merrte parasysh dhe si do t’i balanconte ata, si dhe identifikoi dispozitat në lidhje me përcaktimin e një dënimi të gjithsejtë të njësuar.¹¹⁸⁹ Në përcaktimin e dënimit për të akuzuarin, Trupi Gjykses mori parasysh posaçërisht: (i) peshën dhe pasojat e veprave penale, përfshirë faktorët

¹¹⁸⁵ Shih Njoftimin për Apel, Pika 8, para. 11. Paneli vëren se Mustafa nuk e paraqiti këtë argument në mocionin paraprak që dorëzoi në bazë të rregullës 97(1)(a) të Rregullores. Shih Mocionin Paraprak të Mbrojtjes mbi Juridiksionin, para. 130-149. Sido që të jetë, Paneli rithekson se kundërshtimet e tij në lidhje me juridiksionin u ngritën jashtë afatit. Shih Vendimin që Hedh Poshtë Mocionin e Mbrojtjes për Kundërshtimin e Juridiksionit, para. 10.

¹¹⁸⁶ Shih më lart, para. 31. Sido që të jetë, sipas Dhomës së Gjykatës së Apelit, edhe vetëm “lidhja” midis akuzave dhe Raportit të Këshillit të Evropës do të mjaftonte për të përmbushur kriterin juridiksional të nenit 6(1) të Ligjit. Shih Vendimin e Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 66. Për më tepër, DHSGJK-ja e ka miratuar qasjen e Dhomës së Gjykatës së Apelit. Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese mbi Kërkesën Referuese të Thaçit në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 82-83.

¹¹⁸⁷ Aktgjykimi, para. 772-779.

¹¹⁸⁸ Aktgjykimi, para. 780-781.

¹¹⁸⁹ Aktgjykimi, para. 782-795.

rëndues të kryerjes së torturës në një mënyrë veçanërisht mizore dhe kundër viktimave veçanërisht të cenueshme apo të pambrojtura; (ii) kontributin personal të Mustafës në krimet; dhe, *proprio motu*, (iii) rrethanat personale të Mustafës si faktorë lehtësues të mundshëm.¹¹⁹⁰

436. Në bazë të faktorëve të lartpërmendur, Trupi Gjykses shqiptoi dënimet individuale në vijim për të akuzuarin:

- (i) për Pikën 1 të Aktakuzës (krimi i luftës i ndalimit arbitrar, i kryer kundër së paku gjashtë personave) – dhjetë vjet burgim;
- (ii) për Pikën 3 të Aktakuzës (krimi i luftës i torturës, i kryer kundër së paku gjashtë personave) – 22 vjet burgim; dhe
- (iii) për Pikën 4 të Aktakuzës (krimi i luftës i vrasjes së paligjshme, i kryer kundër një personi) – 25 vjet burgim.¹¹⁹¹

Në fund, mbi bazën e këtyre dënimeve individuale, Trupi Gjykses dha një dënim të njësuar me 26 vjet burgim, që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit, dhe zbriti nga dënimi i dhënë kohën e kaluar në paraburgim që nga arrestimi i tij më 24 shtator 2020.¹¹⁹²

437. Mustafa parashton se Trupi Gjykses bëri gabime të dallueshme në përcaktimin e dënimit, në lidhje me: qëllimet e dënimit, parimin *lex mitior*, numrin e viktimave në kuadër të dënimit të tij për krimin e luftës të torturës, peshimin e rrethanave individuale, dhe kohëzgjatjen e gjithsejtë të dënimit.¹¹⁹³ ZPS-ja përgjigjet se

¹¹⁹⁰ Aktgjykimi, para. 796-826.

¹¹⁹¹ Aktgjykimi, para. 827-828, 831.

¹¹⁹² Aktgjykimi, para. 827, 829-830.

¹¹⁹³ Dosja e Apelit, para. 401-445; Njoftimi për Apel, nën-pikat 9A-9K, para. 12; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 101-112.

kundërshtimet e Mustafës lidhur me dënimin duhen hedhur poshtë meqenëse nuk arrijnë të provojnë asnjë gabim.¹¹⁹⁴

1. Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve

438. Mustafa parashtron se Trupi Gjykses bëri gabime të dallueshme në përcaktimin e dënimit, për shkak të të cilave nuk duhej të ishte dhënë dënim, apo të paktën duhej të ishte dhënë dënim më i butë.¹¹⁹⁵ Konkretisht, së pari ai argumenton se Trupi Gjykses gaboi që nuk zbatoi qëllimet e dënimit të përcaktuara në nenin 38 të KPK-së, dhe se Trupi Gjykses u mbështet në “argumente jashtëligjore” të cilat nuk kanë lidhje me legjislacionin e Kosovës dhe të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹¹⁹⁶ Mustafa gjithashtu argumenton se mbështetja e Trupit Gjykses në jurisprudencën e TPNJ-së është e gabuar, duke qenë se ai nuk ka mbajtur asnjëherë poste politike.¹¹⁹⁷

439. Në vijim, Mustafa argumenton se Trupi Gjykses gaboi që zbatoi në mënyrë jo të saktë, ose që nuk zbatoi parimin *lex mitior*, kur konstatoi se, në bazë të nenit 44(2) të Ligjit, dënimet e përcaktuara në legjislacionin e Kosovës që ishin në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve apo dënimet më të buta të mëvonshme, nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses.¹¹⁹⁸ Ai parashtron se ky interpretim shkel parimet *in dubio pro reo* dhe *lex mitior*, ky i fundit i mishëruar në nenin 33(2) dhe (4) të Kushtetutës së Kosovës, “në përputhje me të cilën gjykojnë dhe funksionojnë Dhomat e Specializuara”, në bazë të nenit 3(2) të Ligjit.¹¹⁹⁹ Për këto arsye, Mustafa kërkon që Paneli i Apelit t’ia referojë

¹¹⁹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 195-238.

¹¹⁹⁵ Dosja e Apelit, para. 401, 442, 445; Njoftimi për Apel, para. 12; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 17.

¹¹⁹⁶ Dosja e Apelit, para. 402-407; Njoftimi për Apel, nënpikat 9A-9B, para. 12.

¹¹⁹⁷ Shih Njoftimin për Apel, nënpika 9B, para. 12; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 151-152.

¹¹⁹⁸ Dosja e Apelit, para. 408, 410-416, 429-431, që i referohet Aktgjykimit, para. 780, 828; Njoftimi për Apel, nënpikat 9C-9E, para. 12; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 104, 108; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 58-62.

¹¹⁹⁹ Dosja e Apelit, para. 409, 411, 415; Njoftimi për Apel, nënpikat 9D-9E, para. 12; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 104, 108; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 58-63; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 145-146. Mustafa gjithashtu argumenton se parimi *lex mitior* pasqyrohet në nenin 7 të KEDNJ-së dhe se ky parim është *jus cogens* dhe, rrjedhimisht, prej tij nuk mund të devijohet. Shih Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 59-61.

këtë aspekt Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për “rishikim”, në bazë të nenit 113(8) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 49(4) të Ligjit.¹²⁰⁰ Mustafa gjithashtu argumenton se, sipas parimeve *lex mitior* dhe *nullum crimen, nulla poena sine lege*, në përcaktimin e dënimit Trupi Gjykues nuk duhej të kishte zbatuar KPK-në, por Kodin Penal të RSFJ-së që ishte në fuqi në kohën e kryerjes, të ndryshuar me Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut.¹²⁰¹ Në mbështetje të këtij argumenti, Mustafa i referohet një aktgjykimi të Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me një “situatë penale të njëjtë”, ku u konstatua se dënimi nuk mund të ishte më shumë se 15 vjet burgim.¹²⁰² Mustafa më tej parashtron se Trupi Gjykues gaboi që nuk mori parasysh: (i) praktikën e përcaktimit të dënimeve për vepra penale të ngjashme në Kosovë apo në TPNJ ose TPNR; dhe (ii) praktikën e përcaktimit të dënimeve në ish-Jugosllavi në kohën e kryerjes së krimeve, si edhe që nuk dha arsytet pse nuk i mori parasysh.¹²⁰³

440. Krahas kësaj, Mustafa argumenton se Trupi Gjykues gaboi që e dënoi në bazë të Pikës 3 të Aktakuzës për torturimin e së paku gjashtë personave, pavarësisht nga konstatimi se kishte marrë pjesë në torturimin, dhe se kishte synimin kriminal të

¹²⁰⁰ Dosja e Apelit, para. 409, 415; Njoftimi për Apel, nënpika 9E, para. 12; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 108; Transkripti, 26 tetor 2023, f. 61-63; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 145-146.

¹²⁰¹ Dosja e Apelit, para. 412-413, 419-427; Njoftimi për Apel, nënpika 9G, para. 12; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 105. Në veçanti, Mustafa argumenton se KPK-ja lejonte dënim me deri në 40 vjet burgim, kurse Kodi Penal i RSFJ-së u ndryshua me Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut, e cila hoqi dënimin me vdekje dhe la në fuqi dënimin me deri në 15 vjet burgim sipas Kodit Penal të RSFJ-së. Ai argumenton se ndryshimi i mëvonshëm i Rregullores 1999/24 së UNMIK-ut nuk është i zbatueshëm, sepse në të përcaktohej se ndryshimi përkatës vlente vetëm për vepra penale të kryera pas 27 tetorit 2000. Mustafa gjithashtu argumenton se Trupi Gjykues gaboi që nuk dha arsytet pse devijoi nga dispozitat e Kodit Penal të RSFJ-së. Gjithashtu, Mustafa kundërshton deklaratën e Trupit Gjykues se ligjet e miratuara pas Rregullores 1999/24 së UNMIK-ut përcaktojnë shkallëzime dënimesh “të njëjta ose më të rënda” me argumentin se këto ligje të mëvonshme nuk janë relevante, si edhe kundërshton gjithashtu mospërmendjen prej Trupit Gjykues të Rregullores 2000/59 së UNMIK-ut. Shih Dosjen e Apelit, para. 419, 432; Njoftimi për Apel, nënpika 9G, para. 12; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 142-148.

¹²⁰² Dosja e Apelit, para. 414, 428, që i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Kosovë, 20 mars 2023; Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 108; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 143, 148. Shih gjithashtu Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 148-149, që i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Kosovë, 31 mars 2022.

¹²⁰³ Dosja e Apelit, para. 417-418, 430, 432-433; Njoftimi për Apel, nënpikat 9F, 9G, 9H, para. 12. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 444(d). Paneli vëren se në Dosjen e Apelit, në nënpikën 9H, Mustafa vetëm i referohet nënpikës 9F, por nuk bën parashtrime të mëtejshme. Për këtë arsye, Paneli konsideron që nënpika 9H tani është përfshirë në nënpikën 9F.

nevojshëm për torturë, vetëm në lidhje me dy persona.¹²⁰⁴ Për më tepër, sipas Mustafës, Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se rrethanave personale të z. Mustafa – të cilat i shqyrtoi *proprio motu* – nuk mund t’u jepej peshë e konsiderueshme, duke pasur parasysh llojin dhe peshën e krimeve dhe kontributin e tij në to.¹²⁰⁵ Konkretisht, Mustafa pretendon se ky konstatim bie ndesh me konstatimin e mëparshëm të Trupit Gjykses se faktorët në lidhje me peshën e krimit nuk mund të konsiderohen si rrethana rënduese më vete, dhe anasjelltas, dhe se mungesa e rrethanave lehtësuese nuk mund të shërbejë si rrethanë rënduese.¹²⁰⁶

441. Në fund, Mustafa parashtron se Trupi Gjykses gaboi që dha dënim “kapriçioz dhe qartësisht të tepruar”, sepse: (i) duke pasur parasysh moshën e tij, dënimi është si të jetë burgim i përjetshëm; (ii) nuk ka mundësi rehabilitimi, duke pasur parasysh jetëgjatësinë e pritshme në Kosovë; (iii) nuk do të ketë “asnjë mundësi për jetë familjare” në përputhje me standardet e KEDNJ-së; dhe (iv) tribunalët ndërkombëtarë nuk kanë dhënë dënime me kohëzgjatje të ngjashme për këto lloje veprash penale.¹²⁰⁷

442. ZPS-ja përgjigjet se dënimi nuk duhet të ndryshohet, sepse Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses.¹²⁰⁸ Konkretisht, ZPS-ja argumenton se vetëm përmendja nga Trupi Gjykses e qëllimeve kryesore të dënimit është në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, jurisprudencën dhe nenin 38 të KPK-së, megjithëse kjo e fundit nuk është dispozitë detyruese për Trupin Gjykses pasi

¹²⁰⁴ Dosja e Apelit, para. 434-438; Njoftimi për Apel, Nën-pika 9I, para. 12. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 109.

¹²⁰⁵ Dosja e Apelit, para. 439, 441; Njoftimi për Apel, Nën-pika 9J, para. 12.

¹²⁰⁶ Dosja e Apelit, para. 440-441, që i referohet Aktgjykimit, para. 789, ku Trupi Gjykses konstatoi se “[f]aktorët që merren parasysh si elemente të peshës së krimit nuk mund të merren parasysh edhe si rrethana rënduese më vete dhe anasjelltas.”

¹²⁰⁷ Njoftimi për Apel, nën-pika 9K, para. 12; Dosja e Apelit, para. 443-444. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 112; Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 149-151, që i referohet përkatësisht *Kupreškić et al.* Judgment; *Kvočka et al.* Judgment. Shih gjithashtu Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 153.

¹²⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 195-196, 199, 202, 204, 222, 224, 229, 238; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 116.

nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj.¹²⁰⁹ Sido që të jetë, ZPS-ja parashtron se Mustafa nuk arrin të faktojë pretendimin e vet në lidhje me këtë aspekt.¹²¹⁰ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se argumenti i Mustafës se jurisprudenca përkatëse e TPNJ-së është e pavend duhet hedhur poshtë si i pashtjelluar, por shton se, megjithatë, jurisprudenca në fjalë është relevante, pavarësisht nëse Mustafa ka mbajtur ose jo poste politike.¹²¹¹

443. ZPS-ja më tej parashtron se konstatimi i Trupit Gjykses se, sipas nenit 44(2) të Ligjit, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh faktorët e renditur aty, sikurse bëri Trupi Gjykses, por që ata nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses, është në përputhje me formulimin e qartë të këtij neni dhe me jurisprudencën e TPNJ-së që interpreton një dispozitë të ngjashme.¹²¹² Sipas ZPS-së, Mustafa thjesht përsërit argumente që ishin të pasuksesshme gjatë gjykimit, pa demonstruar se rrëzimi i tyre përbënte gabim.¹²¹³ ZPS-ja gjithashtu argumenton se parimi *lex mitior* zbatohet vetëm në lidhje me legjislacion që ka fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses, përkatësisht kur legjislacioni i Kosovës është i përfshirë shprehimisht në Ligj.¹²¹⁴ Për më tepër, ZPS-ja parashtron se, meqenëse neni 44(1) i Ligjit autorizon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm, dënimet më të rënda me burgim të zbatueshme në Kosovë nuk janë detyruese për Trupin Gjykses.¹²¹⁵ ZPS-ja gjithashtu argumenton se dënimi në fuqi

¹²⁰⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 197-202. Në veçanti, ZPS-ja argumenton se në paragrafët 772 deri në 777 të Aktgjykimit nuk “zbatohen qëllimet e dënimit”, por “thjesht përmenden”. Krahas kësaj, ZPS-ja veçanërisht parashtron se paragrafi 775 është *obiter dictum* dhe se në paragrafin 776 pasqyrohet parimi i mishëruar, ndër të tjera, në nenin 38 të KPK-së. Shih Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 201 (theksimi në origjinal).

¹²¹⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 199-200.

¹²¹¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 203.

¹²¹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 205-207, 214; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 119-120.

¹²¹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 208.

¹²¹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 209-210. ZPS-ja gjithashtu u referohet: (i) parashtrimeve të mëhershme të paraqitura prej saj në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-06 lidhur me zbatueshmërinë e parimit *lex mitior* në kuadër të Ligjit, ku trajtohen krimet sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare; dhe (ii) konstatimeve të mëpasshme të Panelit të Apelit në atë çështje. Shih Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 115-116, iu referohet Parashtrimeve të ZPS-së në lidhje me Mocionin Paraprak në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 32-33; Vendimi i Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39, 56-57.

¹²¹⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 211; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 117.

gjatë periudhës përkatëse për vepra penale të ngjashme ishte dënimi me vdekje, që nuk ishte dënim më i butë, dhe se, sipas Kodit Penal të RSFJ-së, dënimet me jo më shumë se 20 vjet burgim mund të jepeshin vetëm në bazë të diskrecionit dhe dënimi me vdekje vazhdonte të ishte pjesë e shkallëzimit të dënimeve.¹²¹⁶ ZPS-ja më tej parashtron se çdo interpretim tjetër cenon qëllimin legjislativ të Kodit Penal të RSFJ-së dhe të Ligjit, gjegjësisht se dënimet më të rënda duhet të shërbejnë për vepra penale të rënda.¹²¹⁷ Rrjedhimisht, ZPS-ja parashtron se mbështetja e Mustafës në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të 20 marsit 2023, është e pavend.¹²¹⁸

444. ZPS-ja gjithashtu argumenton se Mustafa: (i) nuk arrin të demonstrojë se Trupi Gjykses duhej të kishte ndjekur praktikën e përcaktimit të dënimeve në Kosovë, në TPNJ ose TPNR, apo në kohën e kryerjes së krimeve; dhe (ii) nuk ka paraqitur çështje gjyqësore të krahasueshme në mbështetje të pretendimit se dënimi që iu dha ishte shproporcional në krahasim me dënimet në ato çështje gjyqësore.¹²¹⁹ Gjithashtu, ZPS-ja thekson se Trupi Gjykses faktikisht u mbështet në jurisprudencë kur shqyrtoi faktorët relevantë për dënimin.¹²²⁰ Pavarësisht nga kjo, ZPS-ja parashtron se dënimet lidhen ngushtësisht me rrethanat konkrete të çështjeve gjyqësore dhe krahasime të tilla nuk ndihmojnë shumë dhe se, sido që të jetë, dënimi i dhënë ishte “në segmentin me vlera më të ulëta të mesit të shkallëzimit të dënimeve” në dispozicion të Trupit Gjykses.¹²²¹ ZPS-ja më tej argumenton se këto krahasime duhet të përfshijnë edhe praktikën shtetërore të dënimeve në lidhje me krimet ndërkombëtare, me kushtin se nuk mund të bëhet krahasim faktik i drejtpërdrejtë.¹²²² Gjithashtu, ZPS-ja parashtron

¹²¹⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 212; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 117.

¹²¹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 212.

¹²¹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 213.

¹²¹⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 215, 217, 220, 236; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 116-117.

¹²²⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 219.

¹²²¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 216-218, 236-237; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 116-117.

¹²²² Transkripti, 27 tetor 2023, f. 117-118. ZPS-ja më pas dorëzoi kopje të shembujve nga jurisprudenca vendore. Shih mesazhin elektronik të 9 nëntorit 2023 nga ZPS-ja.

se referimi i këtij aspekti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese nuk është i përligjur.¹²²³

445. ZPS-ja në vijim argumenton se, meqenëse Mustafa nuk ka demonstruar gabim në lidhje me numrin e viktimave të torturës, argumentet e tij për dënimin sipas Pikës 3 të Aktakuzës duhen hedhur poshtë.¹²²⁴ Për më tepër, ZPS-ja i kundërshton si të pabaza pretendimet e Mustafës se Trupi Gjykses: (i) përdori llojin dhe peshën e krimit si rrethanë rënduese kur vendosi të mos u jepte peshë të konsiderueshme rrethanave personale të Mustafës; dhe (ii) konstatoi se mungesa e rrethanave lehtësuese përbënte rrethanë rënduese.¹²²⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se argumentet e Mustafës se dënimi është qartësisht i tepruar duhen hedhur poshtë menjëherë si të pashtjelluara, si dhe për arsye se moshën dhe faktorë të tjerë ai i paraqet si rrethana lehtësuese për herë të parë në apel.¹²²⁶ Sipas ZPS-së, argumentet e Mustafës në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit të njësuar krahasuar me jetëgjatësinë e pritshme të tij, mundësinë për rehabilitim dhe mohimin e jetës familjare, janë hamendësuese dhe të pambështetura, dhe konstatimi i Trupit Gjykses lidhur me këta faktorë ishte i saktë si juridikisht, ashtu edhe faktikisht.¹²²⁷

446. Së fundi, ZPS-ja parashtron se, në përputhje me jurisprudencën ndërkombëtare, dënimi i Mustafës nuk duhet të ulet – aspak e as konsiderueshëm – edhe nëse do të shfuqizohej verdikti i fajësisë së tij për një nga akuzat, sepse kjo nuk do të ndikonte nga ana juridike në konstatimet faktike të Trupit Gjykses mbi peshën e veprimtarisë kriminale, rrethanat personale dhe faktorët lehtësues e rëndues.¹²²⁸

¹²²³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 221.

¹²²⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 223. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 190-191.

¹²²⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 225-228.

¹²²⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 230-231; Transkripti, 27 tetor 2023, f. 116-117.

¹²²⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 232-235.

¹²²⁸ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 119. Shih gjithashtu Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 196.

447. Mbrojtësja e Viktimave përgjigjet se kërkesa e Mustafës për referim Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese është përpjekje për të krijuar vonesa të procesit dhe është në kundërshtim me interesat e viktimave pjesëmarrëse, meqenëse nuk është pikë që për ligj një rishikim të tillë.¹²²⁹

448. Mustafa kundërpërgjigjet ndër të tjera se mbështetja e ZPS-së në Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj* për sa u përket qëllimeve të dënimit është e pavend, dhe se argumentet e tjera të ZPS-së në lidhje me këtë përbëjnë “apel *de novo*” dhe janë “të pavend” ose “të pabaza”.¹²³⁰ Mustafa gjithashtu kundërshton formulimin e disa prej argumenteve të ZPS-së dhe argumenton se nuk mund të kishte bërë parashtrime në lidhje me dënimin gjatë vetë gjyqimit, pasi nuk e dinte që do të shpallej fajtor dhe dënohej.¹²³¹ Në fund, Mustafa e kundërshton si të palogjikshëm argumentin e ZPS-së se ekzistenca e faktorëve lehtësues jo domosdoshmërisht ndikon në dënimin e dhënë.¹²³²

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

449. Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton se në bazë të nenit 44(1) të Ligjit, Dhomat e Specializuara mund të shqiptojnë dënim maksimal me burgim të përjetshëm. Sipas nenit 44(2)(a) deri (c) të Ligjit, në përcaktimin e dënimit që do të shqiptojë për një krim ndërkombëtar sipas Ligjit, Dhomat e Specializuara marrin parasysh:

- (a) shkallëzimin e dënimit për atë krim, të përcaktuar sipas legjislacionit të Kosovës në kohën e kryerjes së krimit,
- (b) çfarëdo shkallëzimi të dënimit më të butë të mëvonshëm për atë krim, të përcaktuar në legjislacionin e Kosovës, dhe
- (c) nenin 7(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe nenin 15(2) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike si të përfshira dhe të mbrojtura nga nenet 22(2), 22(3) dhe 33(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe masën në të cilën

¹²²⁹ Transkripti, 27 tetor 2023, f. 129-130.

¹²³⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 101-103.

¹²³¹ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 106-107, 111.

¹²³² Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 110.

ndëshkimi i një veprimi ose mosveprimi që cilësohet kriminal sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara, do të paragjykohej me zbatimin e paragrafit 2 (a) dhe (b).

Gjithashtu, sipas nenit 44(5) të Ligjit, Dhomat e Specializuara marrin parasysh faktorë rëndues dhe lehtësues, përfshirë peshën e veprës penale dhe pasojat e saj, si dhe rrethanat personale të personit të shpallur fajtor.¹²³³ Rregulla 163(1) e Rregullores përcakton se Trupi Gjykses balancon faktorët rëndues dhe lehtësues të përmendur në nenin 44(5) të Ligjit.¹²³⁴

450. Sipas rregullës 163(4) të Rregullores, DHSK-ja:

përcakton dënim në lidhje me çdo akuzë të aktakuzës për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe jep një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit [...].Dënimi i njësuar nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë.

Rrjedhimisht, dënimi i njësuar duhet të jetë më së paku i barabartë me dënimin më të rëndë individual të dhënë në këtë çështje, dhe, meqenëse në rregullën 163(4) të Rregullores nuk përcaktohet një kufi i sipërm për dënimin e njësuar, dënimi maksimal i njësuar mund të shkojë edhe deri në burgim të përjetshëm sipas nenit 44(1) të Ligjit.

451. Paneli gjithashtu rikujton se, sipas jurisprudencës penale ndërkombëtare, qëllimet parësore të dënimit janë parandalimi dhe ndëshkimi dhe, megjithëse rehabilitimi është i rëndësishëm, ai nuk duhet të luajë rol mbizotërues.¹²³⁵ Pësha e veprës penale është faktori kryesor në përcaktimin e dënimit, dhe një dënim proporcional me peshën e sjelljes kriminale përmban domosdoshmërisht në vetvete ndëshkimin dhe parandalimin e mjaftueshëm.¹²³⁶ Gjithashtu, Paneli thekson se neni

¹²³³ Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 409.

¹²³⁴ Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 409.

¹²³⁵ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 410, dhe jurisprudenca e cituar në poshtëshënimin 904.

¹²³⁶ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 410, dhe jurisprudenca e cituar në poshtëshënimet 905-906.

38(1) i KPK-së përqendrohet më tepër në rehabilitimin dhe parandalimin, jo shprehimisht në ndëshkimin.¹²³⁷

452. Paneli gjithashtu thekson se, dënimi duhet të jetë i tillë që të shkurajojë përsëritjen e krimit nga personi i dënuar (parandalimi individual), si dhe të synojë të shkurajojë kryes të tjerë të mundshëm nga kryerja e krimeve të njëjta apo të ngjashme (parandalimi i përgjithshëm).¹²³⁸ Gjithashtu, ndëshkimi duhet kuptuar si dhënie e dënimit të duhur që pasqyron fajësinë e personit të dënuar, por nuk duhet të shprehë hakmarrje apo shpagim, kurse rehabilitimi përqendrohet në riintegrimin e personit të dënuar në shoqëri.¹²³⁹

453. Së fundi, Paneli i Apelit thekson se apelet kundër dënimit janë apele *stricto sensu*, që do të thotë se ato janë korrigjuese.¹²⁴⁰ Paneli i Apelit rikujton se një trup gjykues ka kompetencë të gjerë diskrecionale në përcaktimin e dënimit të duhur, ndër të tjera, edhe në përshtatjen e dënimit me qëllim që të pasqyrojë peshën e krimeve, shkallën e përfshirjes së të akuzuarve në kryerjen e veprave penale, si dhe rrethanat e tyre individuale.¹²⁴¹ Për këtë arsye, Paneli i Apelit nuk e zëvendëson dënimin e dhënë nga Trupi Gjykues me një dënim të vetin, përveç nëse apeluesi demonstroi se Trupi Gjykues ka kryer gabim të dallueshëm në ushtrimin e diskrecionit, ose nuk ka respektuar dispozitat ligjore përkatëse.¹²⁴² Rrjedhimisht, Paneli i Apelit ndërhyr në ushtrimin e kompetencës diskrecionale të një trupi gjykues vetëm kur dënimi i

¹²³⁷ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 410, 437.

¹²³⁸ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 411, dhe jurisprudenca e cituar në poshtëshënimin 908.

¹²³⁹ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 410, dhe jurisprudenca e cituar në poshtëshënimet 909-910.

¹²⁴⁰ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 413; *Mladić Appeal Judgement*, para. 539; *Krajišnik Appeal Judgement*, para. 734; *Hadžihasanović and Kubura Appeal Judgement*, para. 302; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 749.

¹²⁴¹ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 413; *Lubanga Sentencing Appeal Judgement*, para. 34, 40; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*, para. 3349; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 127; *Dragomir Milošević Appeal Judgement*, para. 297.

¹²⁴² Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 414; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*, para. 3349; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 749; *Prlić et al. Appeal Judgement*, para. 3204.

shqiptuar: (i) është bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi; (ii) është bazuar në një përfundim faktik qartësisht të pasaktë; ose (iii) është kaq i padrejtë apo i paarsyeshëm sa që përbën shpërdorim të kompetencës diskrecionale. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit gjithashtu do të shqyrtojë nëse, gjatë marrjes së vendimit për dënimin, trupi gjykues u ka dhënë peshë aspekteve të jashtme ose jorelevante, ose nuk u ka dhënë peshë apo u ka dhënë peshë të pamjaftueshme faktorëve relevantë.¹²⁴³

454. Paneli i Apelit tani do të shqyrtojë argumentet konkrete të Mustafës. Së pari, Paneli thekson se mbështetja e Trupit Gjykues në nenin 38 të KPK-së si bazë e vetme e parashtrimit se qëllimet kryesore të dënimit “janë ndëshkimi, parandalimi (konkret dhe i përgjithshëm) dhe – në një masë më të vogël – rehabilitimi i kryesit” është në fakt i pasaktë.¹²⁴⁴ Megjithatë, ndonëse neni 38(1) i KPK-së përqendrohet në parandalimin dhe rehabilitimin, dhe jo shprehimisht në ndëshkimin,¹²⁴⁵ shpjegimi i Trupit Gjykues i qëllimeve kryesore të dënimit është gjithsesi në përputhje me konstatimet e mëparshme të Dhomës së Gjykatës së Apelit mbi qëllimet e dënimit, në bazë të jurisprudencës ndërkombëtare.¹²⁴⁶ Për më tepër, Paneli vëren se, megjithëse Trupi Gjykues mund të ishte mbështetur për orientim në nenin 38 të KPK-së, kjo dispozitë nuk kishte fuqi detyruese për Trupin Gjykues sepse nuk është e përfshirë shprehimisht në Ligj.¹²⁴⁷ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në interpretimin e Trupit Gjykues të qëllimeve kryesore të dënimit, dhe rrëzon nënpikën 9A të Apelit të Mustafës.

¹²⁴³ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 414; *Mladić Appeal Judgment*, para. 539; *Ngirabatware Appeal Judgment*, para. 255; *Krajišnik Appeal Judgment*, para. 735; *Lubanga Sentencing Appeal Judgment*, para. 44.

¹²⁴⁴ Shih Aktgjykimin, para. 772, poshtëshënimi 1623.

¹²⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 410, 437.

¹²⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 410, dhe jurisprudenca e cituar në poshtëshënimin 904. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit rrëzon si të pabazë argumentin e Mustafës se Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj* “nuk ndikon aspak në këtë çështje”. Shih Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 101.

¹²⁴⁷ Neni 3(2)(c), (4) i Ligjit; Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 149; Vendimi i Apelit mbi Hetimin në Çështjen *Lajçi*, para. 22.

455. Mustafa gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses u mbështet në “argumente jashtëligjore” në secilin prej paragrafëve 774 deri në 777 të Aktgjykimit.¹²⁴⁸ Paneli gjykon se kundërshtimet e Mustafës në lidhje me dy nga këta paragrafë, përkatësisht paragrafët 774 dhe 777 të Aktgjykimit, janë të pafaktuara dhe rrjedhimisht i rrëzon. Konkretisht, këto argumente përmenden vetëm në Njoftimin për Apel dhe Mustafa nuk i shtjellon në Dosjen e Apelit, gjë që përlligj rrëzimin e menjëhershëm të tyre.¹²⁴⁹ Sidoqoftë, Paneli thekson se Trupi Gjykses citon qartësisht nenin 38(1)(1.3) të KPK-së dhe jurisprudencën e TPNJ-së në mbështetje të konstatimeve të veta në këta paragrafë të Aktgjykimit.¹²⁵⁰ Paneli i Apelit gjithashtu nuk e gjykon bindës pretendimin e mjegullt dhe të pambështetur të Mustafës se jurisprudenca e cituar në poshtëshënimin 1626 në mbështetje të paragrafit 777 është “e pavend” për arsye se Mustafa nuk ka mbajtur asnjëherë post politik, dhe rrjedhimisht e rrëzon këtë argument.¹²⁵¹

456. Sa u përket dy paragrafëve të tjerë të kundërshtuar, Paneli i Apelit konstaton se, megjithëse i përfshirë në pjesën “Qëllimet e Dënimit”, paragrafi 775 i Aktgjykimit trajton përgjithësisht qëllimin e Aktgjykimit për zbulimin e së vërtetës, dhe nuk ka të bëjë në *vetvete* me përcaktimin e dënimit. Për më tepër, ndonëse paragrafi 776 i Aktgjykimit nuk i referohet shprehimisht jurisprudencës, konstatimet e Trupit Gjykses gjithsesi janë në përputhje me jurisprudencën e TPNJ-së dhe TPNR-së.¹²⁵² Për këto arsye, Paneli konstaton se Mustafa nuk ka arritur të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses në këta paragrafë, dhe rrjedhimisht rrëzon nënpikën 9B të Apelit të Mustafës.

¹²⁴⁸ Njoftimi për Apel, nënpika 9B, para. 12; Dosja e Apelit, para. 406-407.

¹²⁴⁹ Shih më lart, para. 32.

¹²⁵⁰ Shih Aktgjykimin, poshtëshënimet 1625-1626.

¹²⁵¹ Shih Njoftimin për Apel, nënpika 9B, para. 12; Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 151-152. Paneli i Apelit vëren se ky argument u përmend vetëm kalimthi, pa argumente mbështetëse, në Njoftimin për Apel, dhe parashtrimet gojore plotësuese në përgjigje të një pyetjeje të Panelit të Apelit ishin përsëri të mjegullta dhe të pambështetura.

¹²⁵² Shih, p.sh., *Aleksovski Appeal Judgement*, para. 185; *Prlić et al. Judgement* (Vol. IV), para. 1276; *Kambanda Judgement*, para. 28.

457. Paneli i Apelit gjithashtu rrezon nën pikën 9I të Apelit të Mustafës lidhur me numrin e viktimave mbi bazën e të cilit Trupi Gjykses bëri konstatim kundër të akuzuarit për krimin e luftës të torturës, meqenëse mbështetet tërësisht në argumentet e paraqitura në Pikën 7 të Apelit, të cilën Paneli e rrezoi më lart.¹²⁵³

458. Sa i përket argumentit të Mustafës se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që i peshoi rrethanat personale të tij kundrejt llojit dhe peshës së veprave penale për të cilat u shpall fajtor dhe kontributit të tij në kryerjen e tyre, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses kishte detyrimin ta bënte këtë në bazë të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara. Konkretisht, sipas rregullës 163(1) të Rregullores, Trupi Gjykses *peshon* faktorët e përmendur në nenin 44(5) të Ligjit, përkatësisht faktorët rëndues dhe lehtësues, përfshirë peshën e veprës penale dhe pasojat e saj, dhe rrethanat personale të personit të shpallur fajtor.

459. Gjithashtu, Paneli i Apelit konstaton se Mustafa nuk ka arritur të faktojë pretendimin e vet se, kur balançoi faktorët përkatës, Trupi Gjykses: (i) e gjykoi mungesën e rrethanave lehtësuese si faktor rëndues; ose (ii) u mbështet në peshën e veprës penale si faktor rëndues më vete.¹²⁵⁴ Përkundrazi, Trupi Gjykses konstatoi se “rrethanave personale të Mustafës nuk mund t’u jepet ndonjë peshë e konsiderueshme duke pasur parasysh llojin dhe peshën e krimeve të vërtetuara dhe kontributin e tij në to”.¹²⁵⁵ Nga kjo del qartë se Trupi Gjykses nuk e gjykoi mungesën e rrethanave lehtësuese si faktor rëndues, as e përdori peshën e veprave penale si rrethanë rënduese. Faktikisht, Trupi Gjykses balançoi peshën e veprave penale dhe kontributin e Mustafës që i kishte vërtetuar paraprakisht, kundrejt rrethanave lehtësuese, dhe konstatoi se rrethanave lehtësuese nuk mund t’u jepej ndonjë peshë e konsiderueshme. Në këtë kontekst, Paneli i Apelit rikujton kompetencën e gjerë

¹²⁵³ Shih më lart, para. 415-419.

¹²⁵⁴ Shih Dosjen e Apelit, para. 439-441; Aktgjykimi, para. 789, 826.

¹²⁵⁵ Aktgjykimi, para. 826.

diskrecionale të Trupit Gjykses për të përcaktuar se çfarë përbën rrethanë lehtësuese dhe sa peshë – nëse ka – do t'i jepet asaj rrethane lehtësuese; dhe, rrjedhimisht, se ekzistenca e rrethanave lehtësuese nuk nënkupton automatikisht që dënimi duhet të ulet.¹²⁵⁶ Në bazë të sa më lart, Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në refuzimin e Trupit Gjykses për t'iu dhënë peshë të konsiderueshme rrethanave personale të Mustafës, dhe rrjedhimisht rrëzon nënpikën 9J të Apelit të Mustafës.

460. Në vijim, Paneli i Apelit do të trajtojë argumentet e tjera të Mustafës në lidhje me rrethanat personale të tij.¹²⁵⁷ Fillimisht, Paneli i Apelit thekson se këto argumente janë shtjelluar pamjaftueshëm dhe janë të pambështetura, çka përlligj rrëzimin e menjëhershëm të tyre.¹²⁵⁸ Sidoqoftë, duke mbajtur parasysh rëndësinë e këtij aspekti për provat dhe argumentet e Mustafës, Paneli i Apelit vendos të bëjë përjashtim dhe do t'i shqyrtojë këto argumente për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe në interes të drejtësisë.¹²⁵⁹

461. Para se të shqyrtojë përmbajtjen e këtyre argumenteve, Paneli rrëzon argumentin e Mustafës se këta faktorë nuk i paraqiti gjatë gjykimit për arsye se në atë fazë nuk kishte si të dinte vendimin e Trupit Gjykses për dënimin e tij.¹²⁶⁰ Paneli i Apelit thekson se Trupi Gjykses shprehimisht vendosi që dënimin, nëse do të jepej, do ta përcaktonte në Aktgjykimin që do të shqiptohej, në përputhje me rregullën 159(6) të Rregullores, dhe dha udhëzime të hollësishme për paraqitjen e parashtrimeve me gojë ose me shkrim në lidhje me dënimin dhe për dorëzimin e provave mbështetëse.¹²⁶¹

¹²⁵⁶ Shih, p.sh., *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgement, para. 3394 dhe jurisprudencën e cituar aty. *Contra* Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 110. Shih gjithashtu më lart, para. 453.

¹²⁵⁷ Njoftimi për Apel, nënpika 9K, para. 12; Dosja e Apelit, para. 443-444.

¹²⁵⁸ Shih më lart, para. 29.

¹²⁵⁹ Shih më lart, para. 29.

¹²⁶⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes, para. 111.

¹²⁶¹ Shih Vendimin për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Çështje në lidhje me To, para. 13, 15-17, 22-23, 25; Vendimi mbi Deklaratat Përmbyllëse dhe Çështje në lidhje me To, para. 7-8, 11-14; Aktgjykimi, poshtëshënimi 1690.

462. Sa i përket përmbajtjes së argumenteve të Mustafës, Paneli i Apelit vëren së pari se, edhe nëse do ta pranonte pretendimin faktik të pambështetur të Mustafës se për shkak të moshës, dënimi i dhënë tejkalon jetëgjatësinë e pritshme të tij duke pasur parasysh jetëgjatësinë e pritshme në Kosovë, i akuzuari nuk arrin të demonstrojë se kjo do të ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore apo jurisprudencën përkatëse. Sipas Panelit, dhënia e një dënimi, duke përfshirë edhe dënimin me burgim të përjetshëm, jo vetëm që lejohet shprehimisht në nenin 44(1) të Ligjit, por edhe jurisprudenca ndërkombëtare përkatëse në mënyrë konstante ka hedhur poshtë pretendimin se një dënim që mund të tejkalojë jetëgjatësinë e pritshme të personit të dënuar përbën gabim në dhënien e dënimit.¹²⁶² Krahas kësaj, Paneli thekson se Trupi Gjykues faktikisht mori parasysh, *proprio motu*, moshën e Mustafës kur analizoi rrethanat personale të tij.¹²⁶³ Paneli i Apelit nuk konstaton asnjë gabim në këtë qasje. Për më tepër, Paneli gjykon se argumenti i Mustafës në lidhje me mundësinë për rehabilitim¹²⁶⁴ mbështetet tërësisht në mundësinë që dënimi të tejkalojë jetëgjatësinë e pritshme të tij duke pasur parasysh jetëgjatësinë e pritshme në Kosovë, dhe rrjedhimisht duhet të rrëzohet për arsyet e dhëna më lart.

463. Së dyti, Mustafa argumenton se dënimi nuk do t'i lërë "faktikisht [...] kurrfarë mundësie për jetë familjare".¹²⁶⁵ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit thekson se, meqenëse procesi ende nuk ka arritur në fazën e kryerjes së dënimit, argumentet e Mustafës lidhur me ushtrimin e të drejtës për jetë familjare gjatë vuajtjes së dënimit, janë të parakohshme. Paneli i Apelit sidoqoftë thekson se që duket se paraqet Mustafa, se dënimi që iu dha është i gabuar thjesht ngaqë kufizon jetën e tij familjare, është i

¹²⁶² Shih, p.sh., *Ntawukulilyayo* Appeal Judgement, para. 238-241; *Nahimana et al.* Appeal Judgement, para. 1094-1095; *Simba* Appeal Judgement, para. 287; *Gacumbitsi* Appeal Judgement, para. 109-111; *Plavšić* Sentencing Judgement, para. 97-105.

¹²⁶³ Aktgjykimi, para. 821.

¹²⁶⁴ Shih Dosjen e Apelit, para. 444.

¹²⁶⁵ Dosja e Apelit, para. 438.

pambështetur. Konkretisht, Paneli vë në dukje se GJEDNJ-ja ka konstatuar vazhdimisht se:

[...] ndalimi, si çdo masë tjetër që i heq lirinë një personi, përfshin kufizime të vetvetishme të jetës private dhe familjare të atij personi. Megjithatë, është pjesë thelbësore e të drejtës së një burgosuri për respektimin e jetës familjare që autoritetet t'i mundësojnë, nëse është e nevojshme, ose ta ndihmojnë të mbajë kontaktet me familjen e ngushtë [...].¹²⁶⁶

464. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se nuk ka asnjë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me rrethanat personale të Mustafës dhe rrëzon, pjesërisht, nënpikën 9K të Apelit të Mustafës.

465. Paneli i Apelit në vijim do të shqyrtojë argumentet e Mustafës në lidhje me parimin *lex mitior*. Në këtë kontekst, Paneli vë në dukje se:

Kuptimi i parimit *lex mitior* është se, në qoftë se ligji që lidhet me veprën penale të të akuzuarit ndryshohet, duhet të zbatohet ligji më pak i ashpër. Element i brendaqenësishëm i këtij parimi është që ligji përkatës të ketë fuqi detyruese për gjykatën. Të akuzuarve mund t'u jepet dënim më i butë vetëm nëse ligji ka fuqi detyruese, sepse kanë pozitë të mbrojtur juridike vetëm kur shkallëzimi i dënimeve duhet të zbatohet në lidhje me ta. Rrjedhimisht, parimi *lex mitior* është i zbatueshëm vetëm kur një ligj me fuqi detyruese për tribunalin ndërkombëtar përkatës më pas ndryshohet me një ligj më të favorshëm, të cilin tribunali penal ka gjithashtu detyrimin ta zbatojë.¹²⁶⁷

466. Së pari, Paneli thekson se Mustafa nuk ka demonstruar asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se shprehja "marrin parasysh" në nenin 44(2) të Ligjit kërkon që Trupi Gjykses të marrë parasysh faktorët e renditur në atë dispozitë, por se ata nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses.¹²⁶⁸ Megjithëse Mbrojtja me të drejtë pretendon se fjala *shall* [në anglishte] nënkupton detyrim, Paneli konstaton se kjo i

¹²⁶⁶ Shih *Guimon* Judgment, para. 37, citon *Messina* Judgment, para. 61; *Khoroshenko* Judgment, para. 106.

¹²⁶⁷ Vendimi i Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 57, citon *Nikolić Sentencing Appeal Judgment*, para. 81.

¹²⁶⁸ Aktgjykimi, para. 780.

referohet detyrimit për të “marrë parasysh [faktorët]” dhe jo, për shembull, për t’i zbatuar ata si burime ligjore me fuqi detyruese. Ky interpretim del qartë prej formulimit të drejtpërdrejtë të kësaj dispozite, si dhe prej jurisprudencës ndërkombëtare.¹²⁶⁹ Në këtë kontekst, Paneli i Apelit thekson se Trupi Gjykses gjithashtu krahasoi formulimin e nenit 44(2) të Ligjit me atë të nenit 44(4) të Ligjit (“janë në përputhje me”), kur bëri interpretimin e vet të nenit 44(2) të Ligjit.¹²⁷⁰ Paneli i Apelit nuk e gjykon të gabuar këtë qasje. Paneli i Apelit gjithashtu thekson se, sipas nenit 44(2)(c) të Ligjit, detyrimi i Trupit Gjykses për të marrë parasysh këto burime të legjislacionit shtetëror balançohet më tej nga nevoja për të shqyrtuar nëse kjo do të paragjykonte masën e dënimit sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara. Paneli i Apelit gjykon se kjo mbështet më tej përfundimin se hartuesit e Ligjit nuk kanë synuar që Trupi Gjykses ta ketë të detyrueshme të zbatojë legjislacionin shtetëror në lidhje me shkallëzimet e dënimeve, por thjesht që ta marrë atë parasysh brenda parametrave të caktuar.

467. Rrjedhimisht, duke qenë se sipas nenit 44(2) të Ligjit shkallëzimet e dënimeve në legjislacionin shtetëror nuk janë detyruese për Dhomat e Specializuara,¹²⁷¹ parimi *lex mitior* nuk zbatohet në lidhje me këto dispozita të legjislacionit shtetëror dhe rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk e gjykon të gabuar që Trupi Gjykses nuk kreu analizë *lex mitior*.

468. Mustafa më tej argumenton se interpretimi i nenit 44(2) të Ligjit prej Trupit Gjykses – se shkallëzimet e dënimeve sipas legjislacionit shtetëror nuk kanë fuqi

¹²⁶⁹ Shih, p.sh., *Stakić* Appeal Judgement, para. 398; *Blaškić* Appeal Judgement, para. 681-682; *Delalić et al.* Appeal Judgement, para. 813-818; *Tadić* Sentencing Appeal Judgement, para. 21, ku Dhoma e Apelit e TPNJ-së konstatoi gjithashtu se ekzistenca e një dispozite që i lejonte TPNJ-së të shqiptonte dënim deri me burgim të përjetshëm, tregonte se dënimet maksimale më të ulëta të zbatueshme sipas legjislacionit shtetëror në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve, nuk ishin të detyrueshme për të. Shih gjithashtu nenin 44(1) të Ligjit, që lejon Dhomat e Specializuara të shqiptojnë dënim deri në një dënim maksimal me burgim të përjetshëm.

¹²⁷⁰ Shih Aktgjykimin, poshtëshënimi 1627.

¹²⁷¹ Shih gjithashtu nenin 3(2)(c), (4) të Ligjit; Aktgjykimi i Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 149; Vendimi i Apelit mbi Hetimin në Çështjen *Lajçi*, para. 22.

detyruese për Trupin Gjykses – është në mospërputhje me nenin 33(2) dhe (4) të Kushtetutës së Kosovës.¹²⁷² Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit rikujton se neni 33(2) i Kushtetutës së Kosovës përcakton se “dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës”. Gjithashtu, sipas nenit 33(4) të Kushtetutës së Kosovës, “[dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.” Rrjedhimisht, këto dispozita mishërojnë parimin *lex mitior* në Kushtetutën e Kosovës. Ky parim, sikurse u theksua më lart, zbatohet vetëm nëse një ligj me fuqi detyruese për Dhomat e Specializuara zëvendësohet më pas me një ligj më të favorshëm i cili gjithashtu ka fuqi detyruese për Dhomat e Specializuara.¹²⁷³

469. Në kundërshtim me argumentet e Mustafës, Paneli i Apelit konstaton se këto dispozita kushtetuese nuk i detyrojnë Dhomat e Specializuara të zbatojnë legjislacionin shtetëror në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve dhe/ose legjislacionin shtetëror të mëvonshëm për krime të luftës, meqenëse ky i fundit nuk ka fuqi detyruese për Dhomat e Specializuara. Ky konstatim rrjedh nga një interpretim i thjeshtë i Ligjit. Së pari, Paneli i Apelit thekson se, sipas nenit 14(1) të Ligjit, krimet e luftës përkufizohen “sipas të drejtës ndërkombëtare zakonore”. Së dyti, sipas nenit 3(2)(b) dhe (c) të Ligjit, Dhomat e Specializuara gjykojnë në përputhje me, ndër të tjerë, Ligjin si *lex specialis* dhe dispozita të tjera të legjislacionit të Kosovës që janë përfshirë shprehimisht në Ligj dhe zbatohen nga Ligji.¹²⁷⁴ Sipas nenit 3(4) të Ligjit, çdo ligj ose rregullore tjetër e Kosovës që nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj, nuk zbatohet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.¹²⁷⁵ Duke qenë se ligjet shtetërore të sipërpërmendura nuk “përfshihen dhe zbatohen shprehimisht” nga Ligji, Dhomat

¹²⁷² Shih Dosjen e Apelit, para. 408-409, 411; Transkriptin, 26 tetor 2023, f. 60-61.

¹²⁷³ Shih gjithashtu më lart, para. 465.

¹²⁷⁴ Neni 3(2)(b) dhe (c) i Ligjit.

¹²⁷⁵ Neni 3(4) i Ligjit.

e Specializuara nuk janë të detyruara të marrin parasysh ligjet e ndryshme shtetërore për krime të luftës për të përmbushur parimin *lex mitior* sipas Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se nuk ka papajtueshmëri midis nenit 44(2) të Ligjit dhe nenit 33(2) dhe (4) të Kushtetutës së Kosovës.

470. Për më tepër, meqenëse në nenet 3(2), 12 dhe 14(1) të Ligjit përcaktohet se para Dhomave të Specializuara krimet e luftës përkufizohen sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve, Paneli i Apelit gjithashtu konstaton se Trupi Gjykses nuk shkel parimin *nulla poena sine lege* kur nuk zbatoi ligjet shtetërore në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve.¹²⁷⁶

471. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon kërkesën e z. Mustafa për t'ia referuar këtë aspekt për shqyrtim Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 49(4) të Ligjit, duke qenë se Paneli i Apelit nuk ka "asnjë dyshim në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar".

472. Megjithatë, Paneli i Apelit konstaton se analiza që i bëri Trupi Gjykses sistemit të dënimeve sipas legjislacionit shtetëror është e pamjaftueshme për përmbushjen e detyrimit të tij në bazë të nenit 44(2) të Ligjit "për t'i marrë parasysh [ato]".¹²⁷⁷ Konkretisht, Paneli i Apelit vëren së pari se, ndonëse nuk është e nevojshme që Trupi Gjykses të sqarojë çdo hap të arsyetimit të vet,¹²⁷⁸ Paneli i Apelit gjykon se në këtë rast, në analizën që bëri në bazë të nenit 44(2)(b) të Ligjit, Trupi Gjykses nuk shprehu me qartësi të mjaftueshme interpretimin e vet të shkallëzimeve të dënimeve që hynë në fuqi pas kohës së kryerjes së krimeve. Gjithashtu, sikurse shtjellohet më poshtë, Paneli

¹²⁷⁶ Shih, *Blaškić Appeal Judgement*, para. 681, citon *Delalić et al. Appeal Judgement*, para. 816-817. *Contra* Dosja e Apelit, para. 421-422. Paneli i Apelit thekson se, megjithëse Mustafa përmend edhe parimin *nullum crimen sine lege*, Paneli i Apelit gjykon se parashtrimet e tij në thelb kanë të bëjnë vetëm me parimin *nulla poena sine lege*, meqenëse i referohen dhënies të dënimit të duhur. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit lidhur me Juridiksionin në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 38; Vendimin e Apelit mbi Juridiksionin në Çështjen *Shala*, para. 24.

¹²⁷⁷ Shih Aktgjykimin, para. 781.

¹²⁷⁸ Shih më lart, para. 34.

i Apelit gjykon se analiza që bëri Trupi Gjykses në bazë të nenit 44(2) të Ligjit në këtë rast duhej të kishte përfshirë praktikat gjyqësore në lidhje me shkallëzimet e dënimeve përkatëse.¹²⁷⁹

473. Paneli i Apelit pranon se, në përputhje me nenin 44(2)(a) të Ligjit, Trupi Gjykses iu referua saktësisht neneve 38 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së.¹²⁸⁰ Megjithatë, sipas nenit 44(2)(b) të Ligjit, edhe pse theksoi saktë se Rregullorja 1999/24 e UNMIK-ut anuloi dënimin me vdekje,¹²⁸¹ Trupi Gjykses nuk nxori përfundim në lidhje me ndikimin e këtij anulimi në dispozitat e lartpërmendura të Kodit Penal të RSFJ-së dhe në shkallëzimin e dënimeve në fuqi që nga ai moment. Konkretisht, Paneli i Apelit thekson se anulimi i dënimit me vdekje me Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut, pa specifikuar një alternativë, rezultoi në një shkallëzim dënimesh prej pesë deri në 15 vjet burgim sipas neneve 38 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së.¹²⁸²

474. Krahas kësaj, Paneli i Apelit vë në dukje se, në vlerësimin e vet sipas nenit 44(2)(b) të Ligjit, Trupi Gjykses u mbështet në dispozitat e gabuara të kodeve penale të Kosovës kur gjykoi se “në ligjet apo kodet përkatëse të miratuara më vonë në Kosovë parashikohen dënime të njëjta ose më të rënda”.¹²⁸³ Paneli i Apelit vëren se Mustafa u shpall fajtor për shkelje sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, që ka të bëjë me shkelje të nenit të përbashkët 3 në kontekst të një konflikti të armatosur jondërkombëtar, kurse Trupi Gjykses iu referua dispozitave të kodeve penale të Kosovës në lidhje me shkelje sipas nenit 14(1)(a) dhe (b) të Ligjit.¹²⁸⁴ Sidoqoftë, megjithëse Trupi Gjykses nuk iu

¹²⁷⁹ Shih më poshtë, para. 477.

¹²⁸⁰ Shih Aktgjykimin, para. 781.

¹²⁸¹ Shih Aktgjykimin, poshtëshënimi 1629. Ndonëse Trupi Gjykses nuk përmendi se cilës pjesë të Rregullores 1999/24 së UNMIK-ut i referohej, Paneli i Apelit gjykon se referenca ka të bëjë me pjesën 1.5 të saj.

¹²⁸² Këtë e konfirmuan Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, Kosovë, 31 mars 2022, para. 48, 50; Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Kosovë, 20 mars 2023, f. 8 (versioni në anglishte).

¹²⁸³ Shih Aktgjykimin, poshtëshënimi 1629.

¹²⁸⁴ Shih Aktgjykimin, poshtëshënimi 1629. Paneli i Apelit thekson se dispozitat në kodet penale të Kosovës, që korrespondojnë me nenin 14(1)(c) të Ligjit janë: (i) neni 120 i KPK-së së vitit 2003 (që

referua saktësisht dispozitive të nenit 44(2)(b) të Ligjit, Paneli i Apelit gjykon se nuk ka gabim në konstatimin e tij përfundimtar se shkallëzimet e dënimeve janë më të rënda – sepse përcaktojnë dënime maksimale më të rënda – sesa ato të përcaktuara në Kodin Penal të RSFJ-së, ndryshuar me Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut.¹²⁸⁵

475. Në përputhje me sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se këto mangësi në analizën që bëri Trupi Gjykses në bazë të nenit 44(2) të Ligjit përfundimisht nuk kanë ndikim mbi konstatimet që bëri në lidhje me shkallëzimet e dënimeve që duhej të merrte parasysh.

476. Gjithashtu, Paneli i Apelit i referohet argumentit të Mustafës se Trupi Gjykses nuk mori parasysh praktikën e përcaktimit të dënimeve në Kosovë dhe as praktikën e përcaktimit të dënimeve në TPNJ dhe TPNR.¹²⁸⁶ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vëren se Mustafa nuk i paraqiti Trupit Gjykses jurisprudencë ndërkombëtare apo të Kosovës lidhur me përcaktimin e dënimeve. Paneli i Apelit rrëzon argumentin e Mustafës se, këtë nuk e bëri gjatë gjykimit për arsye se nuk mund ta dinte në atë fazë se do të shpallej fajtor dhe dënohej si rezultat i gjykimit.¹²⁸⁷ Sikurse u konstatua më lart nga Paneli i Apelit, Mustafa u njoftua se dënimi do të përcaktohej në Aktgjykimin që

përcakton, lexuar së bashku me nenet 37(2) dhe 38(1) të KPK-së së vitit 2003, dënime me pesë deri në 20 vjet burgim, ose me 21 deri në 40 vjet burgim); (ii) neni 152 i KPK-së së vitit 2012 (që përcakton, lexuar së bashku me nenin 45(1) të KPK-së së vitit 2012, dënime me pesë deri në 25 vjet burgim, ose dënim me burgim të përjetshëm); dhe (iii) neni 146 i KPK-së (së vitit 2019) (që përcakton, lexuar së bashku me nenin 42(1)-(2) të KPK-së, dënim me pesë deri në 25 vjet burgim, ose dënim me burgim të përjetshëm, ku ky i fundit mund të zëvendësohet me një dënim me deri në 35 vjet burgim).

¹²⁸⁵ Shih Aktgjykimin, poshtëshënimi 1629. Paneli i Apelit gjithashtu gjykon se, edhe pse Trupi Gjykses nuk iu referua Rregullores 2000/59 të UNMIK-ut (që zëvendësoi dënimin me vdekje me dënimin maksimal prej 40 vjetësh burgim), kjo gjithsesi nuk do të kishte ndikim në përfundimin e Trupit Gjykses lidhur me ashpërsinë relative të shkallëzimeve të dënimeve që hynë në fuqi pas Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut.

¹²⁸⁶ Shih Dosjen e Apelit, para. 418, 433; Njoftimin për Apel, nënpikat 9F, 9H, para. 12. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit, para. 444(d).

¹²⁸⁷ Shih Dosjen e Kundërpërgjigjes, para. 107.

do të shqiptohet dhe, gjatë gjykimit, atij iu dhanë mundësi të shumta për të bërë parashtrime në lidhje me dënimin.¹²⁸⁸

477. Gjithsesi, Trupi Gjykes iu referua disa herë jurisprudencës së GJPN-së, TPNJ-së dhe TSL-së, si edhe jurisprudencës së Dhomave të Specializuara.¹²⁸⁹ Mustafa rrjedhimisht shtrembëron Aktgjykimin në këtë aspekt. Megjithatë, ndonëse neni 44(2)(a) dhe (b) i Ligjit përcakton shprehimisht vetëm se Trupi Gjykes ka detyrimin të mbajë parasysh shkallëzimet e dënimeve sipas legjislacionit shtetëror dhe, rrjedhimisht, nuk kishte detyrimin që të zbatonte praktikën shtetërore në lidhje me përcaktimin e dënimit, “çfarë kërkohet është qartësisht më shumë se thjesht recitimi i dispozitave përkatëse të kodit penal” dhe Rregulloreve të UNMIK-ut.¹²⁹⁰ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se, në përcaktimin e dënimit të duhur, Trupi Gjykes duhej të kishte përfshirë referenca – aty ku ishin të disponueshme – për praktikën shtetërore të përcaktimit të dënimeve në lidhje me ato shkallëzime dënimesh.

478. Për këtë qëllim, si edhe në lidhje me pretendimin e Mustafës se “për të njëjtat lloje krimesh [,] nuk ekziston asnjë dënim i njësuar me kohëzgjatje të tillë të tepruar [...] në tribunalët ndërkombëtarë”,¹²⁹¹ Paneli i Apelit ka analizuar jurisprudencën

¹²⁸⁸ Shih më lart, para. 461.

¹²⁸⁹ Shih Aktgjykimin, poshtëshënimet 1624, 1626-1627, 1631-1633, 1635-1641, 1643, 1649, 1697, 1699.

¹²⁹⁰ *Blaškić* Appeal Judgement, para. 682, citon *Kunarac et al.* Judgement, para. 29, dhe citon *Krstić* Appeal Judgement, para. 260; *Kunarac et al.* Appeal Judgement, para. 347-349; *Tadić* Sentencing Appeal Judgement, para. 21; *Delalić et al.* Appeal Judgement, para. 813, 820; *Kupreškić et al.* Appeal Judgement, para. 418.

¹²⁹¹ Dosja e Apelit, para. 444(d); Transkripti, 27 tetor 2023, f. 149-151. Shih gjithashtu Transkriptin, 27 tetor 2023, f. 153.

ndërkombëtare¹²⁹² dhe të Kosovës¹²⁹³ në lidhje me krime lufte të krahasueshme me ato për të cilat u dënua Mustafa. Në kryerjen e kësaj analize, Paneli i Apelit ishte i

¹²⁹² Shih, p.sh., *Lukić and Lukić Trial Judgement* dhe *Lukić and Lukić Appeal Judgement* (Sredoje Llukiqi u dënua me një dënim të njësuar prej 27 vjetësh si ndihmës dhe inkurajues për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të vrasjes së paligjshme të më së paku 53 viktimave, dhe për veprime çnjerëzore, trajtim mizor dhe përndjekje); *Naletilić and Martinović Trial Judgement* dhe *Naletilić and Martinović Appeal Judgement* (Naletiliqi u dënua me një dënim të njësuar prej 20 vjetësh si kryes dhe/ose epror për torturë si krim kundër njerëzimit dhe krim lufte në lidhje me më së paku pesë viktima, si dhe për krimin kundër njerëzimit të përndjekjes dhe krimet e luftës të shkatërrimit të qëllimshëm të vuajtjes së rëndë, punës së detyruar, shkatërrimit pa kriter, plaçkitjes dhe shpërnguljes së paligjshme në lidhje me gjashtë qendra ndalimi. Martinoviqi u dënua me një dënim të njësuar prej 18 vjetësh si kryes dhe/ose epror për vrasjen e paligjshme të një personi si krim kundër njerëzimit dhe krim lufte, për krimet kundër njerëzimit të përndjekjes dhe veprimeve çnjerëzore, dhe për krimet e luftës të trajtimit çnjerëzor, shkatërrimit të qëllimshëm të vuajtjes së rëndë, shpërnguljes së paligjshme, punës së detyruar dhe plaçkitjes, të kryera në vendndodhje të ndryshme); *Kvočka et al. Appeal Judgement* (Zhigiqi u dënua me një dënim të njësuar prej 25 vjetësh si bashkëkryes në NKP për krimin e luftës të torturës në lidhje me nëntë viktima dhe për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme të katër viktimave, si edhe për krimin kundër njerëzimit të përndjekjes dhe krimin e luftës të trajtimit mizor); *Kordić and Čerkez Appeal Judgement* (Kordiqi u dënua me një dënim të njësuar prej 25 vjetësh për planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e krimeve kundër njerëzimit të vrasjes së paligjshme, përndjekjes, veprimeve çnjerëzore dhe burgosjes, dhe për krimet e luftës të vrasjes së qëllimshme, trajtimit çnjerëzor, sulmit të paligjshëm kundër civilëve, izolimit të paligjshëm të civilëve, sulmit të paligjshëm kundër objekteve civile, shkatërrimit pa kriter, plaçkitjes dhe shkatërrimit të ndërtesave të mbrojtura në 23 vendndodhje); *Krstić Appeal Judgement* (Kërstiqi u dënua me një dënim të njësuar prej 35 vjetësh për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e gjenocidit, për vrasje të paligjshme si krim lufte, dhe shfarosje e përndjekje si krime kundër njerëzimit për vrasjen e afërsisht 8.000 viktimave, dhe si pjesëmarrës në NKP për vrasje të paligjshme si krim lufte dhe përndjekje si krim kundër njerëzimit, për krimet e rastit të kryera në një vendndodhje); *Kunarac et al. Appeal Judgement* (Kunaraci u dënua me një dënim të njësuar prej 28 vjetësh si kryes i drejtpërdrejtë dhe si ndihmës dhe inkurajues, për krimet e luftës të torturës dhe përdhunimit dhe për krimet kundër njerëzimit të torturës, skllavërimit dhe përdhunimit në lidhje me tetë viktima. Vukoviqi u dënua me një dënim të njësuar prej 12 vjetësh si kryes i drejtpërdrejtë dhe si ndihmës dhe inkurajues, për krimet e luftës të torturës dhe përdhunimit dhe për krimet kundër njerëzimit të torturës dhe përdhunimit në lidhje me një viktimë); *Furundžija Trial Judgement* dhe *Furundžija Appeal Judgement* (Furunxhija u dënua me dy dënime, përkatësisht me dhjetë vjet burgim dhe tetë vjet burgim, për t'u kryer njëkohësisht, për bashkëkryerje të krimeve të luftës të torturës dhe cenimit të dinjitetit personal, përfshirë përdhunimin, në lidhje me dy viktima); *Ntakirutimana and Ntakirutimana Appeal Judgement* (Gerard Ntakirutimana u dënua me një dënim të njësuar prej 25 vjetësh si kryes i drejtpërdrejtë për gjenocid dhe për vrasje të paligjshme si krim kundër njerëzimit në lidhje me një viktimë dhe për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e gjenocidit dhe të krimet kundër njerëzimit të shfarosjes në lidhje me sulmet në tri vendndodhje të ndryshme); *Ongwen Sentencing Judgment* dhe *Ongwen Sentencing Appeal Judgment* (Onguen u dënua me një dënim të përbashkët të gjithsejtë prej 25 vjetësh, iu dhanë tetë dënime prej 14 vjetësh burgim për torturë në lidhje me katër kampe refugjatësh, si edhe dy dënime prej 20 vjetësh burgim për torturimin e katër viktimave dhe dy dënime të tjera prej 20 vjetësh burgim për torturimin e deri në njëqind prej viktimave, që të gjitha si krime kundër njerëzimit dhe si krime lufte; Onguenit gjithashtu iu dhanë tetë dënime prej 20 vjetësh burgim për vrasjen e paligjshme të midis 4 dhe 52 viktimave në secilin prej rasteve (lidhur me më së paku 132 viktima gjithsej) si krime kundër njerëzimit dhe krime lufte; Onguenit më tej iu dhanë disa dënime më vete prej tetë deri në 20 vjet burgim për krimet e luftës të sulmeve kundër popullatës

civile, plaçkitjes, tentimit për vrasje, cenimit të dinjitetit personal, shkatërrimit të pronës, përdhunimit, skllavërimin seksual, rekrutimit të fëmijëve, dhe shtatzënisë me detyrim, si edhe për krimet kundër njerëzimit të skllavërimin, përndjekjes, tentimit për vrasje, përdhunimit, skllavërimin seksual, martesës me detyrim dhe shtatzënisë me detyrim); *Katanga Sentencing Judgment* (Katanga u dënua me një dënim të përbashkët të gjithsejtë prej 12 vjetësh burgim, dhe me dy dënime me 12 vjet burgim për ndihmë në vrasjen e paligjshme të më së paku 30 viktimave si krim kundër njerëzimit dhe si krim lufte, dhe dënime më vete me dhjetë vjet secili për krimet e luftës të plaçkitjes dhe shkatërrimit të pronës, si edhe 12 vjet burgim për krimin e luftës të sulmit kundër një popullate civile); *Ntaganda Sentencing Judgment* (Ntaganda u dënua me një dënim të përbashkët të gjithsejtë prej 30 vjetësh burgim, që përbëhej, ndër të tjera, prej një dënimi me 30 vjet burgim për kryerjen e drejtpërdrejtë të vrasjes së paligjshme të një viktime dhe bashkëkryerjen e tërthortë të vrasjes së paligjshme të më së paku 73 viktimave, dhe tentimin për vrasjen e pesë viktimave, si krime kundër njerëzimit dhe krime lufte; Ntagandas gjithashtu iu dhanë dënime më vete prej tetë deri në 30 vjet burgim për krimet e luftës të sulmit kundër popullatës civile, përdhunimit, përdhunimit të fëmijëve, skllavërimin seksual, skllavërimin seksual të fëmijëve, plaçkitjes, urdhërimit të zhvendosjes së popullatës civile, rekrutimit dhe regjistrimit të fëmijëve në forcat e armatosura, sulmeve kundër objekteve të mbrojtura, dhe të shkatërrimit të pronës, si edhe për krimet kundër njerëzimit të përndjekjes, përdhunimit, skllavërimin seksual dhe zhvendosjes së dhunshme); *Fofana and Kondewa Trial Judgment* dhe *Fofana and Kondewa Appeal Judgment* (Fofana u dënua me një dënim të përbashkët të gjithsejtë me 15 vjet burgim, që përbëhej, ndër të tjera, prej një dënimi me 15 vjet burgim si epror dhe ndihmës dhe inkurajues, për vrasjen e paligjshme të më së paku 272 viktimave si krim lufte dhe krim kundër njerëzimit; Fofanas gjithashtu iu dhanë dënime më vete me pesë deri në 15 vjet burgim për trajtim mizor dhe plaçkitje si krime lufte, dhe për veprime çnjerëzore si krim kundër njerëzimit; Kondeuas iu dha një dënim i përbashkët i gjithsejtë me 20 vjet burgim, që përbëhej, ndër të tjera, prej një dënimi me 20 vjet burgim si epror dhe ndihmës dhe inkurajues për vrasjen e paligjshme të më së paku 259 viktimave si krime kundër njerëzimit; Kondeuas gjithashtu iu dhanë dënime më vete me shtatë deri në 20 vjet burgim për trajtim mizor dhe plaçkitje si krime lufte, dhe për veprime çnjerëzore si krime kundër njerëzimit).

¹²⁹³ Shih, p.sh., Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 29 tetor 2014 (apeli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Kosovë, 12 shtator 2013; tre persona, të shpallur fajtorë si bashkëkryes, secili i dënuar me 8 vjet burgim në bazë të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, lexuar së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, për krimin e luftës kundër popullatës civile të plagosjes dhe më pas vrasjes së një personi); Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Kosovë, 25 nëntor 2010 (apeli kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, Kosovë, 19 nëntor 2009; një person i dënuar me 14 vjet burgim në bazë të nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së për krimin e luftës kundër popullatës civile të vrasjes së paligjshme të një personi); Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Kosovë, 8 dhjetor 2009 (apeli kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Kosovë, 3 mars 2009; Shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Kosovë, 6 gusht 2010; një person i dënuar me 15 vjet burgim në bazë të nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, lexuar së bashku me Rregulloren 2000/59 të UNMIK-ut, për krimet e luftës kundër popullatës civile të vrasjes së paligjshme të një civili, tentimit për vrasjen e një civili dhe të cenimit të integritetit trupor të një personi); Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 11 shtator 2013 (apeli kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, Kosovë, 13 tetor 2011, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, Kosovë, 29 korrik 2011; Shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Kosovë, 7 maj 2014; S.G., i shpallur fajtor si bashkëkryes, i dënuar me 15 vjet burgim në bazë të nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, për krimet e luftës kundër popullatës civile të trajtimit çnjerëzor të më së paku tetë civilëve, torturimit të tetë të burgosurve, dhe për dy pika të aktakuzës për shkelje të integritetit trupor të më së paku nëntë të burgosurve përmes keqtrajtimit dhe rrahjeve të rënda; R.A. i dënuar me 12 vjet burgim në bazë të nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, në lidhje me dy akuza për krime të luftës kundër popullatës civile të cenimit të integritetit trupor të pesë të burgosurve përmes rrahjeve të rënda; S.R. i dënuar me pesë vjet burgim në bazë të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal

vetëdijshëm se gjykatat ndërkombëtare e kanë gjykuar të papërshtatshme të përcaktojnë një listë përfundimtare udhëzimesh mbi përcaktimin e dënimeve,¹²⁹⁴ duke mbajtur parasysh morinë e faktorëve specifikë të një çështjeje gjyqësore në përcaktimin e dënimit, që nuk mund të kthehen lehtësisht në vlera sasiore, dhe që e bëjnë të pamundur zbatimin analog të dënimeve nga një çështje gjyqësore në tjetrën.¹²⁹⁵ Për këtë arsye, Paneli i Apelit mori parasysh faktorë si: (i) forma e përgjegjesisë penale; (ii) pesha e krimit, përfshirë numrin e viktimave, ndikimin e krimit mbi viktimat, fajësinë individuale të të akuzuarit dhe tregues të tjerë të peshës së veprës penale në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore; (iii) faktorët e ndryshëm rëndues dhe lehtësues; (iv) nëse trupi gjykues përcaktoi si dënime individuale, ashtu edhe një dënim të njësuar, apo vetëm një dënim të njësuar; (v) krimet e tjera, nëse kishte, për të cilat një i akuzuar gjithashtu ishte dënuar; dhe, veçanërisht në lidhje me aktgjykimet e gjykatave të Kosovës, (vi) shkallëzimet e dënimeve që përcaktojnë dënime maksimale shumë më të ulëta se neni 44(1) i Ligjit, duke mbajtur parasysh kriteret e nenit 44(2)(c) të Ligjit.

479. Si rezultat i kësaj analize, Paneli i Apelit vëren se në jurisprudencën ndërkombëtare dhe atë të Kosovës (kjo e fundit e interpretuar në kontekstin e shkallëzimeve të dënimeve ekzistuese), dënimet e dhëna ishin më të shkurtra se dënimi i Mustafës.¹²⁹⁶ Ndonëse plotësisht i vetëdijshëm për diskrecionin e gjerë të Trupit Gjykues në dhënien e dënimit, Paneli konstaton se mospërputhja ndërmjet dënimeve të z. Mustafa dhe dënimeve që analizoi Paneli, tregon se Trupi Gjykues i

të RSFJ-së, për krimin e luftës kundër popullatës civile të torturimit të një civili; H.H. i dënuar me gjashtë vjet burgim në bazë të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, për krimin e luftës kundër popullatës civile të torturimit të një personi; S.H. i dënuar me shtatë vjet burgim në bazë të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, për krimin e luftës kundër popullatës civile të torturimit të një personi).

¹²⁹⁴ Shih, p.sh., *Blašić Appeal Judgement*, para. 680, citon *Krstić Appeal Judgement*, para. 242.

¹²⁹⁵ Shih Aktgjykimin e Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 434-435, dhe jurisprudencën e cituar në poshtëshënimet 966-967. Shih gjithashtu, p.sh., *Kalimanzira Appeal Judgement*, para. 224; *Karera Appeal Judgement*, para. 385; *Nahimana et al. Appeal Judgement*, para. 1037. Shih gjithashtu më lart, para. 449, 466.

¹²⁹⁶ Shih më lart poshtëshënimet 1292-1293.

tejkaloj kufijtë e diskrecionit të vet duke i dhënë z. Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme, me çka kreu një gabim të dallueshëm në përcaktimin e dënimit.¹²⁹⁷

480. Paneli i Apelit e gjykon të arsyeshme që dënimet individuale që iu dhanë Mustafës nga Trupi Gjykses t'i ulë në dënimet në vijim: (i) tetë vjet burgim për Pikën 1 të Aktakuzës (për krimin e luftës të ndalimit arbitrar të kryer kundër së paku gjashtë personave); (ii) 20 vjet burgim për Pikën 3 të Aktakuzës (për krimin e luftës të torturës, të kryer kundër së paku gjashtë personave); dhe (iii) 22 vjet burgim për Pikën 4 të Aktakuzës (për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme, të kryer kundër një personi). Në përputhje me këtë, Paneli i Apelit duhet të përcaktojë gjithashtu, në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores, "një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit" që "nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë". Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit gjykon se një dënim i njësuar me 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim që prej arrestimit të tij më 24 shtator 2020, pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të Mustafës në këtë çështje.

481. Gjithashtu, Paneli i Apelit thekson se konstatimet e veta lidhur me dënimin e Mustafës nuk ndikojnë në konstatimet e Trupit Gjykses në Urdhrin për Zhdëmtim kundër Mustafës,¹²⁹⁸ sepse: (i) Mustafa nuk e ka apeluar Urdhrin për Zhdëmtim;¹²⁹⁹ dhe (ii) Paneli i Apelit i ka lënë në fuqi të gjitha verdiktet e fajësisë që janë baza e Urdhrit për Zhdëmtim.¹³⁰⁰

¹²⁹⁷ Shih, p.sh., *Blaškić Appeal Judgement*, para. 680, citon *Krstić Appeal Judgement*, para. 242; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 767, citon, ndër të tjera, *Prlić et al. Appeal Judgement*, para. 3340; Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*, para. 949, citon Aktgjykimin e Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 135, *Nikolić Sentencing Appeal Judgement*, para. 19, *Kvočka et al. Appeal Judgement*, para. 681, *Jelisić Appeal Judgement*, para. 96. Shih gjithashtu më lart, para. 453.

¹²⁹⁸ Shih Urdhrin për Zhdëmtim, para. 283.

¹²⁹⁹ Shih më lart, para. 4.

¹³⁰⁰ Shih më poshtë, para. 484.

482. Së fundi, Paneli i Apelit thekson se ulja e dënimeve të Mustafës nuk sugjeron aspak se krimet për të cilat ai është shpallur fajtor dhe dënuar, nuk janë të rënda.

483. Në përputhje me sa më lart, Paneli i Apelit miraton nënpikën 9F, pjesërisht, dhe 9H, pjesërisht, të Apelit të Mustafës, miraton pjesën e mbetur të nënpikës 9K të Apelit të Mustafës, rrëzon nënpikat 9C, 9D, 9E dhe 9G të Apelit të Mustafës, dhe rrëzon pjesën e mbetur të nënpikave 9F dhe 9H të Apelit të Mustafës.

VI. VENDIM

484. Për arsyet e lartpërmendura, pasi ka shqyrtuar të gjitha argumentet e paraqitura nga palët dhe pjesëmarrësit, Paneli i Gjykatës së Apelit, në bazë të nenit 46 të Ligjit dhe rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

MIRATON nënpikat 9F, pjesërisht, 9H, pjesërisht, dhe 9K, pjesërisht, të Apelit;

RRËZON të gjitha aspektet e tjera të Apelit të Mustafës;

LË NË FUQI verdiktin e fajësisë për Mustafën për krimin e luftës të ndalimit arbitrar në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, sipas Pikës 1 të Aktakuzës; krimin e luftës të torturës, në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, sipas Pikës 3 të Aktakuzës; dhe krimin e luftës të vrasjes së paligjshme në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, sipas Pikës 4 të Aktakuzës;

ANULON dënimin me dhjetë vjet burgim në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me tetë vjet burgim;

ANULON dënimin me 22 vjet burgim në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me 20 vjet burgim;

ANULON dënimin me 25 vjet burgim në lidhje me Pikën 4 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me 22 vjet burgim;

ANULON dënimin e njësuar me 26 vjet burgim për Mustafën dhe **CAKTON** një dënim të njësuar me 22 vjet burgim për Mustafën, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim;

VENDOS që ky Aktgjykim të zbatohet me efekt të menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores; dhe

URDHËRON që, në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe rregullën 166(3) të Rregullores, Mustafa të mbetet në paraburgim të Dhomave të Specializuara

deri në finalizimin e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

_____/nënshkrimi/_____

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatës Kai Ambos

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatëse Nina Jorgensen

E enjte, 14 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë